40 - scripta manent



































VALBONA NATHANAILI

UETPRESS

AMBASADORËT TANË

Pikëtakime të diplomacisë me krijimtarinë

Me parathënie nga Ylljet Aliçka

Vëllimi I

Botimi në shqip i librit “Ambasadorët tanë. Pikëtakime të diplomacisë me krijimtarinë”, vëllimi I, me autor Valbona Nathanaili është mbështetur financiarisht nga Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë në kuadër të projektit “Ambasadorë shkrimtarë dhe shkrimtarë ambasadorë. Krijimtaria dhe mendimi krijues i ambasadorëve shqiptarë. 1912-2014”.

Opinionet, gjetjet, arritjet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Ministrisë së Kulturës.

Falënderojmë për iniciativën Qendrën UET pranë Universitetit Europian të Tiranës dhe Shtëpinë Botuese Universitare UET Press.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

www.kultura.gov.al

ide / ideas
debate / debates
kërkim / research
angazhim / commitment
UET CENTRE / QENDRA UET

Universiteti Europian i Tiranës

UETPRESS

AMBASADORËT TANË

PIKËTAKIME TË DIPLOMACISË ME KRIJIMTARINË

Vëllimi I

VALBONA NATHANAILI

Me parathënie nga Ylljet Aliçka

Tiranë, shtator 2014

UETPRESS

Verba volant, scripta manent.

Titulli i librit: **Ambasadorët tanë. Pikëtakime të diplomacisë me krijimtarinë. Vëllimi I.**
Autor: Valbona **NATHANAILI**
Art grafik: Dritan **LLESHI**

Libri është pjesë e kolanës **"SCRIPTA MANENT"**.

© 2014 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.
Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet web apo sisteme të tjerë, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës
Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.
uetpress@uet.edu.al
www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.
International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-190-06-2
Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.

Shtëpia Botuese Universitare
"UET Press" është pjesë e
Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, shtator 2014

AMBASADORËT TANË

PIKËTAKIME TË DIPLOMACISË ME KRIJIMTARINË

Vëllimi I

VALBONA NATHANAILI

PËRMBAJTJA

1 Parathënie
5 Mirënjohje
7 Parathënie, Ylljet Aliçka

11 **Pjesa e parë**

Krijues-Ambasadorë. Jetëshkrime, fakte & veprimtari

17 **ShBA dhe OKB**
19 Faik Konica
25 Pëllumb Kulla
33 Agim Nesho

39 **Jugosllavia dhe Rusia**
41 Vasil Nathanaili
49 Teodor Laço

55 **Franca**
57 Javer Malo
75 Misto Treska
99 Luan Rama
105 Jusuf Vrioni
109 Ylljet Aliçka

113 **Çeki, Danimarkë, Maqedoni**
115 Piro Milkani
121 Arben Cici
125 Shaban Murati

129 **Pjesa e dytë**

Forum

130 I Krijues diplomat apo diplomat krijues?
133 II Mendoni se ekziston një model i krijuesit diplomat?
136 III Krijimi përballë motivit, statusit dhe praktikave diplomatike.
140 IV Antropologji e diplomatit krijues.

145 Dy përralla: Gamile, numra dhe gjëra të tjera
147 Tregues alfabetik i emrave
149 Bibliografi

PARATHËNIE

Valbona NATHANAILI

Molotovi nuk po nxitohej t'i përvishej punës. Eseksi kishte ardhur t'u kërkonte diçka rusëve, kurse Molotovi nuk i jepte rast të fliste për Iranin. Kur i tregoi Eseksi për udhëtimin e tij me sajë, Molotovi qeshi me gjithë zemër dhe Eseksi, duke përfituar nga ky rast, preku çështjen që ishte qëllimi i vizitës së tij.

Më lejoni të flas për Iranin? - tha ai i shkujdesur dhe heshti që të shikonte se si do të kundërvepronte Molotovi.

Molotovi bëri një gjest kurajoz dhe i tha:

– Ju lutem.

– Është për të ardhur shumë keq, mister Molotov, që Irani na shkakton shqetësime menjëherë pas Konferencës së Moskës, - tha Eseksi dhe psherëtiu thellë, me keqardhje, - po ne jemi gati të dëgjojmë çdo sqarim rreth disa anëve të politikës sovjetike në Iran.

– A janë shfaqur rrethana të reja që papritur e kanë bërë politikën sovjetike të pakuptueshme për qeverinë britanike? - e pyeti menjëherë Molotovi.

– Të themi të drejtën, nuk është fjala për rrethana të reja, - tha Eseksi. Ne na shqetëson keqësimi i pandërprerë i gjendjes politike në Azerbaxhianin Iranian. Ne jemi të pakënaqur nga veprimet e separatistëve, që kanë marrë pushtetin në dorë në atë krahinë. Dëshirojmë shumë ta zgjidhim këtë çështje me qeverinë sovjetike dhe të sqarojmë pikëpamjen sovjetike.

– Pikëpamja jonë është fare e qartë, - tha Molotovi pa buzëqeshur dhe priti që Trojevi të përkthente fjalët e tij. Pastaj vuri pëllëmbët e duarve në gjunjë dhe vështroi me të rreptë pas xhamave të binoklit të tij. - Qëndrimi ynë u shpreh qartë në marrëveshjen e vitit 1942 mbi Iranin dhe nuk ka ndryshuar.

Dialogu i mësipërm është shkëputur nga libri "Diplomati", i James Aldrige, botuar dhe ribotuar disa herë në shqip me përkthimin e Hamit Kokalarit dhe identifikon, në mënyrë të shkëlqyer, një nga instrumentat më të fortë që përdor diplomacia: përfaqësimin me njerëz elokuentë, të përgatitur, që e kuptojnë botën jo thjesht si perceptim të çastit, në gjendje të "lexojnë", arsyetojnë e gjykojnë përtej asaj që duket ose dëgjohet.

Libri ka si synim kryesor të hulumtojë në fushën e diplomacisë shqiptare dhe të identifikojë kontributet e atij grupi përfaqësuesish të shtetit shqiptar në botë që janë "rekrutuar" nga fusha e krijimtarisë, përfshirë kulturën dhe sferën akademike. Akoma, të evidentojë llojin e komunikimit që kanë arritur të ndërtojnë e vendosin, sa kanë qenë të aftë të promovojnë Shqipërinë, vlerat e kulturën tonë.

Qasja e librit është në përputhje me pikëpamjen se politikat e jashtme të një vendi mund të përfaqësohen edhe nga aktorë të rekrutuar jashtë sistemit tradicional të karrierës, të cilët në përputhje me kontekstin ose nevojat, zgjerojnë dhe, pse jo, rrisin cilësinë e përfaqësimit.

Lavdia e punës së tyre përmblidhet jo vetëm në përmbushjen e aspiratave tona se kanë ndihmuar në begatinë dhe lartësimin e Shqipërisë, por edhe në faktin se duke qenë intelektualë, kanë ditur të përfaqësojnë denjësisht shoqërinë shqiptare, pavarësisht kohës kur kanë punuar apo sistemit që i kanë shërbyer.

Në këtë vëllim të parë janë përfshirë, kryesisht, ata ish-ambasadorë për të cilët u krijua mundësia për të gjetur materiale dhe për të kontaktuar, duke lënë opsionet e hapura për një vëllim të dytë, me një përfaqësim po aq dinjitoz.

Libri është ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë janë përfshirë Faik Konica, Pëllumb Kulla, Agim Nesho, Javer Malo, Jusuf Vrioni, Luan Rama, Misto Treska, Ylljet Aliçka, Vasil Nathanaili, Teodor Laço, Piro Milkani, Arben Cici dhe Shaban Murati.

Është e rëndësishme të theksojmë se në Francë, për periudha të gjata kohore dhe në mënyrë periodike, janë akreditуar ambasadorë me një trashëgimi të pasur në fushën e letrave, shpesh herë pa asnjë formim a përvojë të mëparshme në diplomaci. Javer Malo, Misto Treska, Jusuf Vrioni, Luan Rama dhe Ylljet Aliçka kanë qenë përfaqësuesit më të lartë politikë të vendit tonë në Francë, të cilët me veprën dhe punën e tyre pothuaj e kanë institucionalizuar kriterin kryesor të zgjedhjes për t'u akreditуar në këtë shtet, atë të "të qenit krijues". Por jo vetëm. Duket se edhe në ShBA kërkohet të ruhet e njëjta traditë, themelet e së cilës u betonuan nga puna, përkushtimi e krijimtaria e Faik Konicës. Me vendosjen sërish të marrëdhënieve me ShBA, Pëllumb Kulla, një nga autorët shqiptarë më prodhimtarë, shumëdimensional sa i takon llojit të letërsisë së lëvruar dhe kontributeve në kulturë, ishte ndër ambasadorët e parë të akreditуar në këtë shtet mbas viteve '90. Zgjedhje me nivele po aq të mira përfaqësimi kanë qenë edhe Teodor Laço dhe Piro Milkani, autorë, përkthyes, skenaristë, regjisorë e aktorë, të cilët i kanë shërbyer vendit, përkatësisht, në Rusi dhe Çeki.

Nga fusha e akademisë janë përfshirë Vasil Nathanaili, Agim Nesho, Arben Cici dhe Shaban Murati. Jo për koinçidencë, por si zgjedhje, Nathanaili ka studiuar mjekësi në Romë dhe juridik në Tiranë. Për ata që e njohin diplomacinë, Nathanaili quhet diplomat-karriere. Ka qenë ambasador në Beograd, Moskë dhe Pekin në periudhat më "të lulëzuara" të marrëdhënieve tona me to, të njohura ndryshe edhe si "miqësi historike". Agim Nesho është diplomuar dhe ka mbrojtur doktoraturën në inxhinieri. Njëlloj si Nathanaili, edhe Nesho ka kohë që i është kushtuar diplomacisë dhe ka shërbyer në vende e organizata kyç:

ShBA dhe Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Arben Cici është laureuar për gjuhë të huaja, ka mbrojtur doktoraturën në Shkenca historike të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në intervalet nga një shërbim diplomatik në tjetrin, gjithmonë i është kthyer katedrës universitare, me dëshirën për të përçuar te studentët jo vetëm bagazhin e pasur të dijeve, por edhe përvojën e fituar nga një karrierë e konsoliduar. Shaban Murati njihet për kontributet e vyera në fushën e diplomacisë e të publicistikës dhe i ka shërbyer vendit në disa misione diplomatike.

Puna për hartimin e kësaj pjese filloi me hartimin e një protokolli paraqitjeje, të njëjtë për të gjithë: biografi, çmime, vlerësime e tituj; listë e hollësishme me botime; tre-katër aktivitete kryesore të zhvilluara gjatë kohës që ushtronin detyrën e ambasadorit; fotografi; pjesë fjalimesh të mbajtura. Objektivi ishte të paraqitej se *si* e *sa* konvergjojnë diplomacia me krijimtarinë. Pra, është punuar në dy linja kryesore: krijimtari dhe diplomaci. Krijimtaria pasqyrohet në disa rubrika, ndërsa diplomacia, në termat e qëndrimit në zyrë, në të tjera, pasi mendoj dhe besoj se rolin e Ambasadorit vazhdojnë ta luajnë edhe sot, në kushtet që për arsye të ndryshme, nuk gjenden në pozicionet e përshkruara.

Kur ka qenë e mundur janë konsultuar, përzgjedhur, radhitur, redaktuar, përmbledhur ose paraqitur në formën e një faksimileje, shumë prej dokumenteve të kohës që gjenden në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Nga dokumentat e hulumtuar, listimi i tematikës së çështjeve kryesore të diskutuara ose bërë prezent në marrëdhëniet ndërmjet Ministrisë sonë të Jashtme me shtetin përkatës, e integruar në jetëshkrimin dhe veprimtarinë e shumë prej ish-ambasadorëve, mendoj se ndihmon për të krijuar një ide më të qartë jo vetëm për punën e kryer nga secili prej tyre, por edhe për natyrën që kanë pasur këto marrëdhënie, ose për të gjykuar si kanë evoluar nga viti në vit. Një burim i veçantë informacioni kanë qenë shkresat që përmbanin vendimin e emërimit në postin e ambasadorit. Edhe një shkresë e thjeshtë tregon shumë. Të ndihmon të kuptosh strukturën vendimmarrëse, nga kanë ardhur propozimet dhe ku është marrë vendimi: në Ministrinë e Jashtme, Kryeministri apo Presidencë? Akoma, nëpërmjet saj mund të gjykojmë për kulturën e institucionit e gjuhën e përdorur. Për shembull, deri në fund të vitit 1950 vazhdon të përdoret fjala "zoti ...", e cila më vonë zëvendësohet me "shoku ...". Po ashtu, përdorimi i togfjalëshit V.F.-L.P. (Vdekje Fashizmit - Liri Popullit) bën që të ndjehet ende atmosfera e luftës etj. Ishte interesant fakti që shumë nga shkresat e vitit 1945, po t'i ktheje në anën tjetër, kishin simbolet e qeverisë së paraluftës.

Katalogimi *on-line* i librave në faqen *web* të Bibliotekës Kombëtare, si dhe në *Google Book*, projekt i Google për të krijuar një katalogim ndërkombëtar të të gjithë librave shërbyen si dy burime po aq të mira. Ndoshta ka ardhur koha të gjenden partnerë edhe në Shqipëri, për të pasuruar botimet shqip në arkivën elektronike të Google jo vetëm me titujt e autorët, por edhe me elementë të tjerë të librit, një bashkëpunim që do e bënte kulturën e trashëgiminë shqiptare në fushën e krijimtarisë të njohur për lexuesin në çdo cep të botës. Faqet *web* të Botime Shqip, Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, Tirana Book Review, shumë faqe të ngjashme të ofruara nga shtëpitë botuese si dhe biblioteka ime personale ishin, po ashtu, tepër të dobishme.

Në pjesën e dytë të tilluar "Forum" janë përfshirë kontributet e Agim Nesho, Arben Cici, Luan Rama, Pëllumb Kulla, Piro Milkani, Shaban Murati, Teodor Laço dhe Ylljet Aliçka, të cilët kanë pasur mirësinë t'u përgjigjen katër pyetjeve: "Krijues diplomat, apo diplomat krijues? Mendoni se ekziston një model i krijuesit diplomat? Krijimi përballë motivit, statusit dhe praktikave diplomatike. Antropologji e diplomatit krijues".

Shtjellimi që u kanë bërë çështjeve të mësipërme, ofruar nga krijues-ambasadorë, besoj se janë një pikënisje e mirë për të hapur një debat rishqyrtues e rivlerësues të kësaj lloj diplomacie edhe në vendin tonë, i karakterizuar shpesh nga paragjykime dhe i ngjyrosur me nota arbitrariteti. Shpresa është, - shprehet Amartya Sen (2009), që një arsyetimi të keq mund t'i përgjigjemi me një arsyetim edhe më të mirë, në gjendje të influencojë edhe personin më dogmatik. Arsyetimi i keq nuk është praktika e "të bërit paarsyetuar", por mbështetja në argumenta primitivë e të dobët. Pretendimi për të arsyetuar mbi përvoja konkrete e të suksesshme, sigurisht, nuk është kusht për të arritur në marrëveshje, ose që të gjithë jeni dakord me këtë lloj zgjedhjeje.

Libri është një mundësi e mirë në diagnostikimin e kësaj dukurie. Akoma, shërben si një referencë shumë e mirë për të njohur kontekstin social e kulturor në periudha të rëndësishme të rritjes e konsolidimit të shtetit shqiptar, pasi trajton kontributet më të shqura në këtë fushë. Paraqitja korrekte e fakteve dhe ngjarjeve, shoqëruar me dokumente autentikë dhe foto të shumta ilustruese, një pjesë e mirë e të cilave publikohen për herë të parë, jo vetëm pasurojnë ndjeshëm përmbajtjen e librit, por janë edhe një shtysë shumë e mirë për të gjithë dashamirësit e historisë, letërsisë, politikës, shkencave sociale e komunikimit për të hulumtuar faqe pas faqeje.

Mendoj se libri u vjen në ndihmë studiuesve të fushave të ndryshme për të vlerësuar a njohur një aspekt tjetës të diplomacisë, për të cilin është folur e shkruar shumë pak.

MIRËNJOHJE

Mirënjohja e parë për ndihmën që kam marrë në botimin e këtij libri është për Ylljet Aliçkën, ish-ambasador dhe aktualisht pedagog në UET. Njohja me Aliçkën filloi gjatë përpjekjeve për të përkthyer e botuar në anglisht një nga librat e tij. Libri nuk është botuar, por interesat e përbashkëta në fushën e letrave, sikundër edhe statusi i tij, ai i një ish-ambasadori alternuar me atë të një shkrimtari shumë të suksesshëm, mjaftonin për t'a ftuar që këtë libër ta shkruanim së bashku. Ndonëse për shkak të disa angazhimeve të tjera, të papritura, u detyrua të tërhiqej, e falënderoj për mbështetjen e vazhdueshme që më ka dhënë gjatë gjithë procesit të hartimit të librit. Bisedat e këndshme për kohën e kaluar në Francë, shpesh të mbushura me nota nostalgjie e malli, që sado përpiqej t'i fshihte nxirrnin kokë herë pas here, më kanë ndihmuar në pasurimin e profilit kulturor të Francës e i kanë dhënë nuanca të ngrohta, të veçanta, këtij profili.

Bashkëshorti im, Andrea Nathanaili, ka aftësinë për të dëgjuar me durim dhe, më tej, për të selektuar nga gjithë moria e mëparshme, idetë më me vlerë. Mënyra e paraqitjes së materialit në këtë libër e ka zanafillën, kryesisht, në bisedat e pafundme me të.

I jam mirënjohëse Henri Çilit, një sistem i shkëlqyer referimi në ide dhe perspektiva, për mbështetjen e vazhdueshme. Ideja e përfshirjes edhe të studiuesve në këtë botim e ka burimin në kontaktet që kam pasur me Ksenofon Krisafin dhe Tonin Gjuraj, dy ish-ambasadorë me përvojë të gjatë në fushën e studimeve dhe të akademisë.

Puna në UET Press më krijoi mundësinë e mrekullueshme të njihja paraprakisht një pjesë të mirë të "personazheve" të librit. Pëllumb Kulla, Agim Nesho dhe Arben Cici kanë botuar me UET Press librat e tyre. Shkëmbimi i ideve në mënyrën e paraqitjes së materialit lehtësoi ndjeshëm volumin e punës. Për biografinë e Faik Konicës falenderimet shkojnë te Ilir Ikonomi, gazetar dhe historian me përvojë, kontributet e të cilit për këtë emër përfshijnë edhe një libër voluminoz e shumë të mirë me titull "Faik Konica, jeta në Washington".

Bashkëpunimi me të afërmit e disa prej ish-ambasadorëve, ka qenë një privilegj i vërtetë. Komentet, sugjerimet, pyetjet e informacionet që kam marrë i dhanë librit një fizionomi të veçantë. Falënderoj Zana Treskën, vajzën e Misto Treskës, për materialet dhe fotot e paharruara që me shumë dashuri i vuri në dispozicion të këtij botimi, si dhe Tomi Treskën për mbështetjen e vazhdueshme. Përkushtimi, kujdesi dhe profesionalizmi i Petrit Nathanailit, në bashkëpunimin për hartimin e biografisë së babait të tij, Vasil Nathanaili, si dhe gatishmëria në ofrimin e shumë fotove, pjesë e arkivës së tij personale, e pasuroi atë me detaje interesante e të panjohura. Ndihma e tij ishte po aq cilësore edhe në saktësimin

e emrave të shumë personazheve, bashkëpunëtorë të ambasador Vasilit, si dhe të kohës e vendit të zhvillimit të shumë ngjarjeve. Për të plotësuar detaje rreth jetëshkrimit të Teodor Laços falenderoj Pandin, të birin, njohjet dhe lidhjet me të cilin shtrihen në një periudhë afro 20 vjeçare. Margarita Zyma (Malo) dhe nipi i Ambasador Javer Malos, Vojo, kanë qenë, po ashtu, shumë dashamirës dhe bashkëpunues në vërejtjet e bëra. I falenderoj për korrektësinë me të cilën i referoheshin çdo detaji të biografisë, duke qenë të kujdesshëm të më ofronin për çdo sugjerim, edhe dokumentin faktik.

Besoj se kam ditur të përçoj në libër të njëjtën dashuri e po atë pasion me të cilat secili prej tyre i është përkushtuar detyrës së përfaqësimit të vendit, sepse sa i takon volumit ose sasisë ishte e pamundur, - do duheshin shumë e shumë libra të tillë.

Falënderoj Anilda Bozdon dhe Voltisa Lame, dy kolege të mia, që kanë pasur dashamirësinë të më dëgjojnë e të diskutojmë së bashku detaje të ndryshme që kishin lidhje me përgatitjen e librit. Për të njëjtat arsye falenderoj Neli Gribizin dhe Aida Tiranën, këtë fundit edhe për mbresat që më përcolli nga e ëma, Tefta Tirana, sa i takon figurës së veçantë dhe tepër simpatike të Jusuf Vrionit. Besnik Frashni është larguar në një institucion tjetër. Së bashku kemi punuar për dhjetra libra e kemi ndarë, për shumë kohë, edhe të njëjtën zyrë. E falenderoj për përkushtimin e treguar në tetë vjet bashkëpunim.

Përdorimi i arkivës pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme e pasuroi në mënyrë të ndjeshme përmbajtjen e këtij libri dhe u dha fakteve e argumentave të përdorur korrektësinë e nevojshme. U jam shumë mirënjohëse Pranvera Dibrës dhe Dorian Kasimatit për orientimin e frytshëm dhe gatishmërinë në gjetjen e materialeve që disponon kjo arshivë. Përdorimi i arkivës së gazetës Mapo ishte një burim tjetër shumë i dobishëm. Falenderoj Arion Sula, kreredaktorin e gazetës, Vladimir Karaj, gazetar dhe Florenc Zeneli, *design* për hulumtimin në gjetjen e shumë prej fotove dhe materialeve shtesë të përdorura. Një ndihmë të paçmuar dha Dritan Lleshi, *design* pranë UET Press, që me durim e përkushtim ka hapur e mbyllur me dhjetra herë dokumentat, për të parë e riparë vendosjen e sistemimin e materialeve.

Zana e Bujar Hudhri, dy botuesit e Onufrit, me të cilët kam bashkëpunuar për printimin e shumë librave, përfshirë edhe librin tim "Arsim e pabarazi", i falenderoj për korrektesën e vazhdueshme dhe dashurinë me të cilin punojnë me librin. Janë këto arsyet që edhe këtë radhë u drejtova përsëri te ta.

Botimi i librit ishte pjesë e një projekti më të madh, ideuar në bashkëpunim me Qendrën UET. Pavarësisht se projekti u reduktua vetëm në botimin e librit, dua të theksoj se bashkëpunimi me Blerjana Bino, drejtoren ekzekutive të qendrës, ka qenë gjithmonë i frytshëm. Një falënderim i veçantë është edhe për Ornela Çuçin, me të cilën punova për shkrimin e projektit dhe për formulimin e plotë të tij.

Shtypja e librit u bë me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës. I falënderoj që zgjodhën këtë botim në larminë dhe shumëllojshmërinë e aplikimeve që kanë pasur.

Së fundmi, jam shumë e lehtësuar që arrita ta mbyll në kohë këtë projekt.

KRIJUESI-DIPLOMAT, TRADITË APO RASTËSI?

Ylljet ALIÇKA

Ideja për të nxitur një reflektim ose hulumtim mbi përvojën e shtetit shqiptar në atë që quhet krijuesi-diplomat, ose shkrimtari-diplomat lindi jo vetëm për arsye se në praktikat e diplomacisë ndërkombëtare një dukuri e tillë është shndërruar në një rregull gati të institucionalizuar, por dhe për faktin se në Shqipëri ende nuk ka pasur studime në këtë drejtim.

Çfarë përfaqëson rasti shqiptar? Thënë ndryshe si mund të kuptohet interferimi i kulturës politike me vokacionin krijues nën prizmin e regjimeve të ndryshme politike në Shqipëri - gjatë monarkisë: përparësia e çështjes kombëtare; në komunizëm: mendimi uniform, monolitik e totalitarist; sot: republikë parlamentare, ndarja e diplomacisë kulturore nga propoganda etj. Subjekti meriton trajtim shumëplanësh: historik, sociologjik, kulturor, deri dhe "gjenealogjik".

Po t'i referohesh shembujve nga historia ky është një subjekt sa retrospektiv, aq dhe perspektiv, pasi dhe vetë tipologjia e shkrimtarit diplomat është e gjerë, pra nuk ekziston një portret unik. Më tepër kemi të bëjmë me silueta të retushuara, dalë nga majat e letrave botërore të kalibreve Nobel, të tillë si: Chatobrian, Stendal, Saint John Perse, Romain Gary, Paul Morand, Paul Claudel, Malaparte, Seferis, Ivo Andriç, Neruda, Migel Anhel Asturias, Czeslav Milosz, Carlos Fuentes, Roberto Echeverria, Gabriela Mistral, Octavio Paz….

Jo më pak të rëndësishëm për kulturën kombëtare kanë qenë personalitetet e korpusit kulturor shqiptarë të ftuar për t'u bërë pjesë e trupit diplomatik të shtetit shqiptar që nga lindja e tij, nisur nga Faik Konica, (profeti i diplomatit-shkrimtar…?), Eqerem Vlora, Jusuf Vrioni, Misto Treska, Javer Malo, për të ardhur deri në ditët e sotme si Teodor Laço, Besnik Mustafaj, Neritan Ceka, Luan Rama, Agim Isaku etj.

Dukuria shkrimtar-diplomat ka njohur evolucione në kohë, gjë që ndihmon për të kuptuar kontekstet ideologjike, ndërthurjen e historisë së letërsisë shqipe me historinë e

marrëdhënieve ndërkombëtare, praktika këto të kushtëzuara nga përparësitë e diplomacisë shqiptare gjatë historisë së shkurtër të shtetit (përparësia ndaj çështjes kombëtare, asaj ideologjike, ekonomike, kulturore, apo të imazhit...). Kjo dhe për faktin se periudhat e ndryshimeve të thella të strukturave të sistemit dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, përfshirë këtu dhe politikën e burimeve njerëzore në fushën e diplomacisë janë shoqëruar me ndryshime të ndjeshme të praktikave dhe të aparatit diplomatik me shpejtësi të ndryshueshme reagimi.

Për pasojë, ashtu si kudo në kohë dhe vende të ndryshme, kjo tendencë është përcaktuar nga përparësitë specifike të çdo vendi. Pra, nëse imazhi i vendit përkatës mbështetet mbi kulturën apo mbi politikën, pasi pranohet se diplomacia nuk është vetëm mbrojtja e interesave strategjike apo aksion tregëtar, por dhe një vektor i përfaqësimit të vetes, i një sistemi vlerash dhe i një imazhi.

Rasti shqiptar

Mes tri nënkategorive të diplomatit-krijues, apo parë sipas tri rrathëve koncentrikë: diplomatë që shkruajnë dhe publikojnë vepra letrare, ata që frymëzohen në krijimet e tyre nga vendet ku punojnë si diplomat dhe, së treti, ata që në gjirin e këtyre të fundit shkruajnë për aksionin diplomatik në vetvete, Shqipëria ofron ose dallohet në të tria rastet.

Pyetjet që lindin pas këtij parashtrimi të shkurtër janë të shumta: A ka Shqipëria një traditë të vazhdueshme të aliazhit shkrimtar-diplomat, pra a mund të ndërtohet një gjenealogji e rastit shqiptar? Nëse po, kur ka qenë më e spikatur? Cilat janë logjikat dhe rrethanat që kanë mbizotëruar në emërimin e ambasadorëve nga fusha e kulturës: promocion i brendshëm kariere, rekrutim oportunist, simbolikë e jashtme, apo mishërim i një simboli politik?

Si ka qenë raporti i motiveve politike me ato kulturore të këtyre emërimeve në epoka të ndryshme? A kanë ardhur propozimet nga Presidenca-Këshilli i Ministrave, apo nga Ministria e Jashtme? Si ka reaguar trupi diplomatik klasik nga këto emërime (të përkohshëm, trup i huaj, martesë e jashtëligjëshme ?) Përvoja ka dëshmuar se për një institucion diplomatik, shpesh emërimi i një krijuesi bëhet shkakton tensione të brendshme. “Ministria e Punëve të jashtme e urren lavdinë jashtë zyrave”, thoshte Stendal.

Pranohet se funksionari ideal në fushën e diplomacisë është ai që di të mishërojë njëherazi pushtetin politik me atë administrativ, me fjalë të tjera që dallohet nga një sens i jashtëzakonshëm i interesit publik. Rrjedhimisht, lind dhe pyetja se nëse vetë krijuesit apo personalitetet shqiptare të kulturës u përfshinë në diplomaci si anëtarë të një elite kulturore, apo si një mënyrë komode jetese, si shije e njohjes së botës, tërheqje pas ekzotizmit, apo si aktorë të privilegjuar të historisë globale? Thënë ndryshe, një nevojë për të qenë të pavarur financiarisht, apo për t’i dhënë karrierës një ngjyrim letrar?

“Jo të gjithë ambasadorët bëhen shkrimtarë që arrijnë të botojnë dhe jo të gjithë diplomatët që botojnë janë ambasadorë, shkruan *Rummelhardt*. Cilat janë konvergjencat

dhe divergjencat e përmbushjes së misionit nga kjo shtresë diplomatësh? Cilat janë rastet kur shkrimtari dhe diplomati kanë bashkëjetuar në një harmoni perfekte, pa i përzier funksionet respektive, kur pranohet se diplomati klasik jep vizionin, vlerësimin, analizën, rekomandimet e tij duke kapërcyer pasionet dhe emocionet me një stil neutral, pa artefice e zbukurime letrare si dhe propozon një pozicion në emër të shtetit dhe vendit të tij. Sa ka përfituar apo "abuzuar" shtresa e diplomatëve-krijues me të ashtuquajturën pavarësi mendimi apo reputacion jashtë zyrave diplomatike në raportin ambivalent me karrierën, sipas asaj që quhet *kompleksi kameleon*? Historia diplomatike është e pasur me kulme negative në këtë drejtim. Diplomati nobelist Ivo Andriç, në një takim me Kontin Ciano i propozon atij, as më më shumë e as më pak, ndarjen e Shqipërisë mes Italisë dhe Jugosllavisë dhe shpërnguljen e shqiptarëve myslimanë në Turqi. (Bogdan Krizman: 1977, L'analyse du Dr Ivo Andriç sur l'albanie de l'anne 1939, vol 2, Zagreb, P.77-89)

Për të skicuar tipologjinë e rastit shqiptar, Valbona Nathanaili, autorja e librit, pa me shumë interes e zgjuarsi rastet e veçanta, duke u kërkuar ish-ambasadorëve tanë të përfshirë në këtë libër të detajonin sa më shumë karakteristika dhe përvoja të rekrutimit të tyre në diplomaci, sepse veçantitë individuale pasurojnë, tërthorazi, faqet e ndryshme të prizmit diplomat-shkrimtar. Nga libri, por edhe duke pasur parasysh historinë e shkurtër të shtetit, rezulton se bilanci ose rasti shqiptar nuk mbetet pas traditës europiane apo asaj botërore. Sadoqë jo e konsoliduar si një traditë institucionale, diplomacia shqiptare ka njohur mjaft histori suksesi, kur arti i krijimit, i të shkruarit të ketë zënë vend në botën e negociatave diplomatike, si në nivel shumëpalësh ashtu dhe atë dypalësh.

Që prej krijimit të shtetit shqiptar bashkëjetesa mes dy "zanateve" ka qenë e vazhdueshme, duke vendosur një marrëdhënie harmonike mes gjuhës dhe realitetit, duke e shndërruar atë në një traditë gati-gati të institucionalizuar. Fenomeni i vërejtur me rregullsitë dhe nuancat e veta, na lejon të shohim një mori praktikash të përziera, për aq sa linjat e brendshme ndarëse nuk pengojnë identifikimin e ekzistencës së një grupi që justifikon mitin e moshës së artë të shkrimtarëve diplomatë, siç ishte rasti i viteve '90 të përfshirjes së një vale talentesh letrare e personalitetesh të spikatur kulturorë si V. Zhiti, V. Muçi, I. Zhupa etj. Ashtu si dhe në botë dukuria shqiptare mbështetet mbi raste të veçanta, të cilët janë ftuar apo kanë aplikuar sipas konjukturave politike a prioriteteve diplomatike. Parë rast pas rasti për secilin prej këtyre emërimeve, termat e paktikat kanë qenë të ndryshueshme nga njëri-tjetri. Akoma, mund të supozohet se mes antinomit aksion-krijim, për ambasadorët krijues shqiptarë diplomacia është perceptuar më shumë si aksion, se sa si vëzhgim, karakteristikë kjo për diplomatët e karrierës.

Pavarësisht nga kjo, sot mund të thuhet se perspektiva e diplomacisë dhe risitë e diplomacisë shqiptare për zgjerimin e fushës së saj në diplomaci kulturore, ekonomike, multilaterale, publike, po diktojnë dhe nevojën që letërsia dhe diplomacia të konsolidojnë termat e marrëdhënies së re që do u lejojë të vazhdojnë pjesëmarrjen aktive në një botë në rikompozim.

KRIJUES-AMBASADORË
JETËSHKRIME, FAKTE & VEPRIMTARI

PJESA E PARË

Përfaqësuar me:

Faik Konica, Pëllumb Kulla, Agim Nesho,
Vasil Nathanaili, Teodor Laço, Javer Malo,
Misto Treska, Luan Rama, Jusuf Vrioni, Ylljet Aliçka,
Piro Milkani, Arben Cici dhe Shaban Murati.

Mençuria e kohës së shkuarës është, deri në çdo grimcë,
po aq e dobishme sot, sa ishte edhe në kohën e Callières[1].
Sir Ernest Satow

Për shumë studiues, diplomacia si koncept është shpikur nga grekët. Në Greqinë e lashtë diplomatët ishin në rolin e mesazherit që ofron negociata. Diplomacia merrej, kryesisht, me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve ndërmjet palëve. Në ditët tona, përkufizimi ka evoluar, duke u bërë më i hapur dhe fleksibël. Sipas fjalorit të Oksfordit (1975), diplomacia është: 1. Menazhimi i punëve të vendit nga agjentët e tij të dërguar jashtë (vendit, *shënim*) (ambasadorë dhe ministra), në përputhje me udhëzimet që marrin nga Ministria e Jashtme përkatëse. 2. Arti/aftësia për t'u marrë vesh me njerëzit, pra që punët të bëhen pa probleme e vështirësi. Sipas fjalorit të Oksfordit (2014, *on-line*), diplomacia është: 1. Profesioni, aktiviteti ose aftësia në menaxhimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, kryesisht nga një përfaqësuesi që ndodhet jashtë. 2. Arti për t'u marrë vesh me njerëzit, në mënyrë të ndjeshme dhe takt.

Përfaqësuesit diplomatikë ndërmjet shteteve janë praktikuar për një kohë shumë të gjatë në Europë, por vetëm në shekullin XV fillojnë të shfaqen misionet e përhershme diplomatike, rezidente, ndërmjet shteteve të ndryshëm. Në këtë kohë puna e tyre rregullohet nga ligje dhe rregulla të caktuara, por me shtrirje kryesisht lokale. Shumë më vonë kemi miratimin e konventave ndërkombëtare që përcaktojnë qartë statusin e diplomatëve, si dhe të familjeve e stafeve të tyre.

Detyrat e një përfaqësie diplomatike, në mënyrë shumë të përmbledhur, përfshijnë:

[1] Cituar nga: Aurelien Colson, 2007, në *The Ambassador, Between Light and Shade. The Emergence of Secrecy as the Norm for International Negotiation.*

- Përfaqësi formale. Kjo është një nga detyrat më të vjetra dhe më të rëndësishme.
- Mbledhje informatash. Ambasadori mbledh informacion dhe identifikon çështje themelore që kanë lidhje me zhvillimet në vendin e tij, të cilat i dërgon dhe i raporton pranë qeverisë së vendit të tij.
- Shërben si burim për nisma të reja diplomatike. Pjesë e protokollit është që çdo nismë, veçanërisht kur është fryt i përpjekjeve personale të Ambasadorit, të marrë miratim dhe të jetë e orientuar me udhëzime strike të qeverisë.
- Mundësinë e zbulimit të ndonjë konflikti të mundshëm me shtetin ku është akredituar; nëse kemi lindjen e një konflikti, menazhimin për zvogëlimin e zgjidhjen e tij, por gjithmonë mbi bazën e udhëzimeve dhe në përputhje me interesat e vendit të tij.
- Propozimin ose hartimin e ligjeve a rregulloreve ndërkombëtare, që ndihmojnë në formësimin e sistemit ndërkombëtar.

Në shoqëritë moderne demokratike, përveç diplomatëve të akredituar, përdoren edhe burime të tjera, informale, që përbëjnë diplomacinë e llojit të dytë dhe përfshijnë, por jo kufizuar, udhëheqësit e komuniteteve apo llojeve të ndryshme të besimit, profesorë universiteti, gazetarë, biznesmenë, artistë etj. Kjo lloj diplomacie përdoret kur duam të ndërgjegjësojmë njerëzit për çështje të mprehta me natyrë ekonomike, sociale e kombëtare, ose të ndërmarrin veprime konkrete në dobi të zgjidhjes së tyre. Ajo u vjen në ndihmë liderëve të vendit për të menaxhuar çështjet e mësipërme, në gjetjen e zgjidhjeve të mundshme, në eksplorimin e mundësive të reja dhe në ngjalljen e ndjenjës kombëtare.

Sa i takon fjalës "ambasador", mendohet se rrjedh nga latinishtja "ambactus" që do të thotë "vasal". *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (1990, Tiranë: Akademia e Shkencave, f. 2117) jep këtë kuptim për vasal. A. (*emër*): 1. *hist.* Feudal që i nënshtrohej një feudali tjetër më të madh, një princi ose një mbreti. 2. *fig. keq*. Njeri që varet plotësisht nga dikush tjetër, ai që i përulet e i nënshtrohet dikujt; shtet që varet plotësisht nga një shtet tjetër dhe i nënshtrohet këtij. *Vasal i imperializmit amerikan*. B: (*mbiemër*) Që është i varur plotësisht nga dikush tjetër, që i përulet e nënshtrohet atij. *Shtet vasal.*

Sipas Shaw (2006, cituar *Fjalori i Diplomatit*) një ambasador është agjenti diplomatik i rangut më të lartë, i akredituar në një shtet sovran ose organizatë ndërkombëtare, rezident, përfaqësues i qeverisë së tij. Një përkufizim pak a shumë të ngjashëm ka edhe *Fjalori i gjuhës së sotme shqipe* (Ibid, f. 27): Ambasador është përfaqësuesi diplomatik i shkallës më të lartë që ka një shtet pranë një shteti tjetër, drejtuesi i ambasadës. *Ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë. E emëruan ambasador.*

Çfarë cilësish duhet të ketë një ambasador?

Në një diagnostikim të përgjithshëm, si përfaqësuesi politik i shtetit që e ka dërguar, nga ambasadori pritet të ketë dinjitet dhe të mbajë një profil sa më të lartë. Nga ana tjetër, meqënëse duhet të negociojë punët e çështjet që i janë besuar nga lideri i vendit, prej tij kërkohet të mbajë sekretin e të jetë diskret.

Për të përshkruar si kanë evoluar perceptimet tona për cilësitë që duhet të kenë dhe të mos kenë ambasadorët, një udhërrëfyes shumë i mirë ka qenë libri i Shaw J., 2006. *The Ambassador: Inside the life of a working diplomat.* Virginia: Capital Books, Inc. Një histori e shkurtër e këtij evolucioni fillon nga viti 1596 për t'u mbyllur me mendimin e ditëve tona.

Më 1596, Ottavio Maggi në librin e tij "De legato", Venezia, përshkruan standardet që duhet të plotësojë një ambasador:

> Një ambasador duhet të njohë më së miri teologjinë, të citojë Aristotelin e Platonin, të jetë i aftë të zgjidhë në çast, në mënyrë dialektike, edhe problemin më të errët. Ambasadori duhet të jetë ekspert në matematikë, arkitekturë, muzikë, fizikë, të drejtën civile dhe kanore; të flasë dhe të shkruajë rrjedhshëm latinisht dhe të ketë njohuri në greqisht, spanjisht, frëngjisht, gjermanisht dhe turqisht; të ketë formim klasik, të njohë historinë e gjeografinë; të jetë ekspert në shkencën ushtarake; të ketë kulturë rreth poezisë dhe ta shijojë atë.
>
> Kryesorja, të ketë një familje të shkëlqyer, të pasur dhe një paraqitje fizike perfekte. (*Cituar në*: Shaw J., 2006. *The Ambassador: Inside the life of a working diplomat.* Virginia: Capital Books, Inc., f.12-3)

Afro 100 vjet më vonë, më 1716, François de Callières, anëtar i Akademisë Franceze, diplomat dhe shkrimtar, një nga të dërguarit special e fuqiplotë të Luigjit XIV më 1697 në bisedimet për vendosjen e paqes ndërmjet Francës e Spanjës (që njihet edhe si Paqja e Ryswick, sipas emrit të qytetit ku zhvilloheshin bisedimet), përshkruan pothuaj të njëjtat cilësi, në librin *De la manière de négocier avec les souverains*, ndonëse në mënyrë më të detajuar:

> Ambasadori duhet të jetë vëzhgues, i aftë të refuzojë shpërqëndrimin nga kënaqësitë apo argëtimet e kota; të zotërojë një gjykim të shkëlqyer në vlerësimin e gjërave, - sipas rëndësisë që kanë, - dhe të orientuar nga synimet; këto të fundit duhet të arrihen nëpërmjet rrugëve më të shkurtëra e natyrore, pa u hyrë përkufizimeve të kota dhe të stërgjata, të cilat si rregull vetëm i sprapsin ata me të cilët kërkon të merresh vesh.
>
> Më tej akoma, ambasadori duhet të jetë negociator. Ai duhet të ketë aftësinë për të depërtuar në mendjen e tjetrit, të jetë në gjendje të dallojë e deshifrojë, së paku, lëvizjet e muskujve të fytyrës, të cilat shpesh tradhëtojnë edhe negociatorin më të stërvitur, sepse e ndihmojnë të kuptojë se çfarë pasionesh i ziejnë nga përbrenda, cilat janë pikat e dobëta, çfarë kërkon të thotë a bëjë.
>
> Ambasadori duhet të ketë një mendje aq pjellore, sa të mundë të shmangë, në mënyrën më të lehtë të mundshme, vështirësitë me të cilat i duhet të ndeshet në procesin e zbatimit të detyrës; duhet të jetë gjithmonë i vëmendshëm e i gatshëm për t'u dhënë zgjidhje edhe surprizave më të paparashikuara dhe, aq i mençur në formulimin e përgjigjeve, sa të mund të "dalë nga balta" për të shpëtuar veten edhe në

rast se ka "rrëshqitur"; të jetë në humor të vazhdueshëm, të demonstrojë një natyrë të qetë dhe të duruar, gjithmonë i gatshëm të dëgjojë me vëmendje ata që takon.

Të folurit e tij duhet të jetë pa ekuivokë, i shkëlqyer, civil, i pranueshëm, në gjendje të shkojë lehtësisht te ata që dëgjojnë dhe e rrethojnë, të ngjallë kënaqësi e bëjë përshtypje pozitive. Duke u trajnuar me cilësitë e një negociatori të mirë, ambasadori duhet të ketë kontroll të mjaftueshëm mbi vetveten, të përmbahet, të jetë në gjendje t'i rezistojë dëshirës për të folur përpara se të mendojë ato që kërkon vërtet të thotë.

Më 1919, sipas Colson (2007) diplomatëve u kërkohej që çdo gjë ta raportonin te shefi i tyre, veçanërisht politikat që zbatoheshin. Ata ishin trajnuar që të vepronin në mënyrë të tillë dhe kontrolloheshin nëse vepronin sipas protokollit.

Më 1939, Harold Nicolson, në librin e tij *Diplomacy*, e vë theksin në funksionin social të ambasadorit.

Nga ambasadori pritet të japë pritje në mënyrë të vazhdueshme, të organizojë darka të mëdha zyrtare dhe ballo, të ftojë kolegë dhe përfaqësues të biznesit në dreka e darka informale; të krijojë lidhje të ngushta me njerëz të rëndësishëm ose me pushtet në vendin e akreditуar; të zhvillojë interesa në një shkallë të caktuar për industrinë e vendit, artin, sportin, letërsinë; të vizitojë krahina të ndryshme dhe të jetë familjar me zhvillimin bujqësor e industrial të tyre; të mbajë kontakte miqësore me bashkatdhetarët e tij, të cilët për arsye të ndryshme janë në ekzil.

Sot situata paraqitet më komplekse. Udhëheqësit e shteteve flasin direkt me njëri-tjetrin në celular ose *e-mail*; takohen vazhdimisht në forume e konferenca të ndryshme; mjetet e udhëtimit mundësojnë takimin e shpejtë dhe të lirë të tyre.

Ndonëse shumë udhëheqës e filozofë të diplomacisë në ditët tona, jo rrallë kanë artikuluar se, *ambasadorët kanë dalë jashtë mode, ka ardhur koha që t'i nxjerrim në pension* ose *duhet të ndryshojmë kriteret e zgjedhjes e të përgatitjes së tyre,* të gjithë pranojnë nevojën për ambasadorë. Më 1983, Martin F. Herz, ed., në librin *The modern Ambassador: The Challenge and the Search* jo vetëm rikonfirmon rolin e ambasadorëve, por e vë theksin edhe në rëndësinë që vazhdojnë të luajnë.

Ambasadorët tanë

Tradita anglo-saksone (Britani-ShBA) e sheh *common law*, ose më mirë formulimin ligjor si një hipotezë e cila ka nevojë t'i nënshtrohet testit. Nëse shumë njerëz shkelin ligjin, konkluzioni është jo të gjithë njerëzit janë të pamoralshëm, ose duhen ndëshkuar, ose janë gabim, por ligji është i papërshtatshëm, i vjetër dhe ka nevojë të ndryshohet. Në një farë mënyrë ata krijojnë dhe vlerësojnë precedentin: çfarë ka ndodhur më parë, cilat ishin pasojat, çfarë mësuam, duke e çuar debatin nga një argument në tjetrin. Në tradita të tjera ligjore (greke, romake etj.) formulimet ligjore janë statike, të përhershme dhe të detyrueshme për t'u zbatuar.

Për shkak të kompleksitetit që shfaq shoqëria njerëzore, këtu ka vlerë interpretimi, i cili vetë shërben si burim për praktika të reja ligjore, të ndryshme nga teoria legale.

Nga shembujt e mësipërm, mund të thuhet se kultura manifeston një lloj "stili" për çështje legale. Në mënyrë të ngjashme, parë historinë e diplomacisë e të përfaqësimit në vendin tonë, por jo vetëm, meqenëse flasim për dy sisteme zgjedhjeje ose "rekrutimi" të ambasadorëve. Kultura manifeston "stil" edhe në këtë fushë: stil tradicional (ndërmarrë nga strukturat racionale burokratike) dhe një të dytë, intelektual. Sipas stilit tradicional, diplomacia zgjedh përfaqësuesit e saj dhe u krijon të gjithë mekanizmat e mundësitë për rritje profesionale. Sipas stilit intelektual, diplomacia zgjedh figurat më të spikatura nga fusha e krijimtarisë për t'i bërë pjesë të përfaqësimit të saj.

Të gjitha kulturat zhvillojnë mënyra e qasje për të argumentuar zgjedhjet. Në rastin tonë, këto modalitete kulturore që lidhen me zgjedhje e emra konkretë në kohë të caktuara dhe, për më tepër, në shtete, pesha e politikës së të cilëve ka qenë shumë e rëndësishme për vendin tonë, kanë emrat, por u mungojnë argumentat: Pse janë zgjedhur? Pse është zgjedhur Faik Konica? Pse është zgjedhur Misto Treska? E njëjta pyetje mund të bëhet edhe për 11 personazhet e tjerë të këtij libri. Nga ana tjetër, eksplorimi në veprimtarinë e tyre është i rëndësishëm, sepse na ndihmon për të grumbulluar më shumë përvojë e për të identifikuar një kornizë kërkimi; shërben si pikënisje e mirë për ndërtimin e një parimi shumë të rëndësishëm: nëse stilin tradicional e pranojmë si domosdoshmëri, stilin intelektual do e perceptojmë si alternativë, si mënyrë për të kompensuar atë tradicional, apo si burim për të diskutuar se si qasje të ndryshme zgjedhjeje, të kombinuara e lidhura me njëra-tjetrën kontribuojnë në mënyrë efektive?

Duke folur në mënyrë më praktike, Ministria e Jashtme, në mënyrë të vazhdueshme, ka përdorur "stilin intelektual" në kulturën e zgjedhjes për të përfaqësuar politikisht shtetin tonë në shtete të tjera. A duhet që modalitetet dhe qasjet e përdorura të këtij stili të vazhdojnë të përdoren përsëri? Debati duhet të fokusohet në pikat e forta dhe të dobëta që paraqet kjo zgjedhje dhe, pse jo, edhe ajo tradicionale. Për shembull, krijuesit vërtet janë më holistikë e dialektikë, por zakonisht nuk kanë shërbyer në më shumë se një mandat dhe shumë prej tyre pohojnë se u gjendën në diplomaci rastësisht. Pra, ata vetë duken të pariclueshëm në këtë fushë, shpesh për arsye që lidhen me ta. Nëse nuk riciklohen njerëzit, a duhet të vazhdojmë të riciklojmë idenë? Shtimi i këtyre argumentave shton sfidat për hartimin e një teorie e praktike zgjedhjeje që flet për krijues që bëhen diplomatë.

Murati (2013:117) zgjedhjen e ambasadorëve jashtë rrugës tradicionale të karrierës e quan politike, duke përfshirë, për kontekstin tonë, edhe zgjedhjet nga fusha e krijimtarisë, por është i kujdesshëm të theksojë se duhen ruajtur raportet, ose një lloj balance ndërmjet këtyre përfaqësimeve. Për të, prishja e raporteve është një nga fenomenet më negative të institucionit të shërbimit diplomatik. Shembulli që sjell janë ShBA (*ibid*), ku vërtet nuk ekziston ndonjë rregull apo ligj i shkruar, por për dekada me radhë, të gjithë presidentët amerikanë janë përpjekur të ruajnë një raport përfaqësimi 70:30, në favor gjithmonë të ambasadorëve të karrierës.

Shqetësimi i Muratit është i drejtë, por një gjë është e sigurt, kombinimi i mekanizmit kulturor, me atë tradicional i bën zgjedhjet më të mira dhe të gjithë sistemin funksional për interesat aktuale të vendit. Kjo do të thotë që zgjedhjet, ose stili i tyre, nuk duhet të perceptohen si dy drejtëza paralele. Në çaste e për politika të caktuara format e rekrutimit mund të ndryshojnë, të zgjerohen a tkurren, të zgjedhim nga një "stil" a tjetri, por gjithmonë të ndërgjegjshëm për përparësitë e të metat që paraqet secili.

Një qasje e tillë duhet të zbatohet në terma afatgjatë, duke vendosur në fokus ndërtimin e marrëdhënieve që shtrihen në kohë; kërkon angazhim intelektual për të ndërtuar e mbajtur infrastrukturën e duhur. Krijuesit, si ekspertë të jashtëm mund të angazhohen për të zhvilluar dhe koordinuar punën e tyre në mbështetje të nismave të ndryshme. Integrimi i qëllimtë i tyre mund të fillojë në nivele të ulëta. Ministria e Jashtme duhet të ndërmarrë studime që identifikojnë, vlerësojnë e përkrahin këto burime.

ShBA DHE OKB

Përfaqësuar me:

Faik Konica

Pëllumb Kulla

Agim Nesho

Ambasadori i parë i ShBA i akredituar në Tiranë si "I dërguar i jashtëzakonshëm dhe Ministër i plotfuqishëm" është Ulysses Grant-Smith, zyrtar i shërbimit të huaj. Emërimi është bërë më 22 shtator 1922. Letrat kredenciale i paraqet më 4 dhjetor 1922. Më 8 shkurt 1925 përfundon misionin. Më 8 prill 1939 forcat italiane pushtojnë Tiranën. Në këtë periudhë, misionin e drejtonte Hugh G. Grant (i emëruar si "I dërguar i jashtëzakonshëm dhe Ministër i plotfuqishëm" më 9 gusht 1935 dhe paraqitur letrat kredenciale më 8 nëntor 1935). Legata mbyllet zyrtarisht më 16 shtator 1939. Grant largohet nga Shqipëria më 27 shtator 1939.

Marrëdhëniet diplomatike ShBA-Shqipëri rivendosen përsëri më 15 mars 1991, pas një ndërprerjeje prej 52 vjetësh. Ambasada në Tiranë rihapet më 1 tetor 1991. Kristofer Hill është "I ngarkuar me punë, ad interim", i pasuar nga Uilliam Eduin Rajerson, Ambasador i Jashtëzakonshën dhe Fuqiplotë. Rajerson i paraqet kredencialet e tij Qeverisë së Shqipërisë më 21 dhjetor 1991.

E vetmja karakteristikë e shquar që kam qenë i aftë të zbuloj
në karakterin amerikan është dashuria për ujin e ftohtë.

Mark Twein

ShBA: Profil

Sipas Moran R., T. *et al*. (2007:678-90), trendi në shoqërinë amerikane ka të bëjë me fjalën "doing". Për amerikanët ka rëndësi koha, organizimi dhe përdorimi i burimeve. Marrëdhëniet shoqërore karakterizohen nga informaliteti dhe presupozohet që të gjithë janë të barabartë. Amerikanët motivohen nga arritjet dhe performanca. Identiteti personal i një amerikani, deri një një farë mase, formësohet nga arritjet individuale. Për ta bota është materiale dhe pak ose aspak shpirtërore. Çdo amerikan e sheh vetveten si individ i veçantë. Për antropologen Margaret Mead (*cituar nga Moran*), amerikanët kanë pikëpamje të ndryshme nga britanikët. Pra, nëse njihni britanikët, mos mendoni se jeni ekspert edhe në çështjet amerikane. Nëse një amerikan e pyesin "Cila është ngjyra juaj e preferuar?" përgjigja shoqërohet me përcaktimin e pohimin e ngjyrës së parapëlqyer; nëse i drejtoheni një britaniku me të njëjtën pyetje, përgjigja ka shumë gjasa të ketë përsëri formën e një pyetjeje: "Ngjyrën e preferuar të kujt, të një luleje?" Konkluzioni i Mead është se amerikanët kërkojnë të futen në një emërues të përbashkët.

Amerikanët kërkojnë një shoqëri të fortë institucionalisht dhe të sigurt, si dhe mënyrat më të mira, më të lehta dhe më efiçente të performancës; karakterizohen nga një etikë e fortë në punë; nuk pëlqejnë mbretërinë dhe klasat, por respektojnë pushtetin dhe begatinë. Ndonëse janë informalë në veshje dhe përshëndetje, kanë kulturën e moskontaktit: përpiqen të ruajnë distancë fizike e psikologjike me bashkëfolësin.

Kultura amerikane vlerëson shumë aftësitë verbale. Në këtë lloj kulture, e njohur ndryshe edhe si kulturë me kontekst të ulët (Hall, 1976), mesazhet verbale janë normale e specifike, tentojnë të jenë të detajuar dhe të përdoren sa më shumë. Logjika dhe arsyetimi shprehen me anë të folurit. Në bisedë nuk ka vend për heshtje, pasi lidhet me emocione negative dhe nënkupton kritikë, konfuzion a qësëndisje. Një kulturë të tillë manifestojnë edhe Gjermania, Kanadaja e Zvicra.

Në kontrast, në kulturat me kontekst të lartë (Japonia, Tajvani dhe, në përgjithësi, shumë vende në Azi) një pjesë e mirë e informacionit transmetohet nëpërmjet kontekstit fizik, ose gjendet e materializuar te individi. Këto kultura janë shumë të ndjeshme ndaj mesazheve joverbale. Gjatë komunikimit verbal flitet pak, rrallë dhe për periudha të vogla kohore; nuk kanë dëshirë të marrin iniciativën për të folur të parët ose për të "mbajtur gjallë" bisedën; tentojnë të flasin fillimisht me mendje dhe jo me fjalën e folur; për ta ka rëndësi edhe heshtja, pasi edhe heshtja "flet" e komunikon: qetësi, harmoni e besim.

Nëse krahasojmë japonezët me amerikanët, në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet: "Në Japoni gjuha është edhe mjet komunikimi; në ShBA gjuha është mjet komunikimi".

Marrëdhënia ndërmjet kontekstit dhe dimensionit kulturor shoqëror, në të dyja llojet e kulturave, mund të evidentohet nëpërmjet rolit që kanë interesat e grupit *vs* atij të individit. Në shoqëritë me kontekst të lartë kërkohet dhe pritet një nivel i lartë i identifikimit të individit me grupin. Kultura të tilla etikohen në përgjithësi edhe si kolektive. Për shumë studiues, në kultura të tilla ekziston tendenca për të shtypur synimet e individit në emër të interesave dhe mirëqenies së grupit. Në shoqëritë me kontekst të ulët, që zakonisht përbëhen nga grupe heterogjene, dimensioni kulturor lidhet me atë se ku e përcakton veten individi dhe llojin e marrëdhënieve që kërkon të vendosë me të tjerët.

FAIK KONICA

Ministër fuqiplotë i Republikës (më vonë i Mbretërisë) së Shqipërisë në Amerikë.
Periudha: 1926-1939

Ambasadori i parë shqiptar në ShBA.



Datëlindja: 15 mars 1875

Vendlindja: Konicë, Janinë.

Diplomë: (1895) Filologji romane. Universiteti i Dizhonit, Francë.

Gradë shkencore: (1912) "Master of Arts", në gjuhët neolatine, Universiteti i Harvardit.

Gjuhët e huaja: Anglisht, turqisht, italisht, frëngjisht, greqisht, latinisht dhe gjermanisht.

Ndërruar jetë: 15 dhjetor 1942, Washington, ShBA.

Motoja: "Flasin dhe vazhdojnë të flasin, por mua aq më bën"[1]



Faik Konica (qendër) në piknik me shqiptarët. Fotoja është bërë në gusht 1925, një vit para se Konica të fillonte punën si Ministër fuqiplotë në Washington. *Photo credit: I. Ikonomi*

Studimet e para i merr në turqisht në qytetin e tij të lindjes.

1884-1885 studion në Kolegjin Shën Francis Xavier (ose Kolegji Saverian i Jezuitëve), Shkodër. Më tej, Turqi: Stamboll, shkollën Gallatasaraj; Francë: Collegé de Lisieux (1890), Carcassonne (1892) dhe Universitetin e Dizhonit (1895); Amerikë: Harvard.

1897-1909 Themelon dhe boton revistën "Albania".

1903-1909 Jeton në Londër, Angli. Vazhdon botimin e "Albania".

9 tetor 1909 Zhvendoset në Amerikë dhe drejton revistën "Dielli", e përjavshme, që botohej nga shoqëria "Besa-Besë".

20 mars 1911 Themelon të përkohshmen "Trumbeta e Krujës" në Sent Luis.

1912 Sekretar i përgjithshëm i "Vatrës" dhe, më vonë, edhe kryetar i saj.

2 janar 1913 Pjesëmarrës në Konferencën e Londrës, në cilësinë e përfaqësuesit të emigrantëve të Amerikës, të bashkuar në Federatën panshqiptare të Vatrës.

Më 18 shtator 1913 Viziton Shqipërinë, por pas një mosmarrëveshje me Ismail Qemalin, bashkohet me Esat Pashë Toptanin.

1 mars 1913 Kryetar i punimeve të Kongresit të Triestes.

1914 Me fillimin e Luftës së Parë Botërore shkon në Vjenë. Njihet dhe miqësohet me A. Zogun.

1920 Zhvendoset në Romë dhe një vit më vonë përsëri në Amerikë.

1921-1926 Kryetar dhe redaktor i "Diellit", organ i "Vatrës". Sekretar dhe më vonë kryetar i Vatrës.

1926-1939 Ministër Fuqiplotë i Republikës (më tej Mbretërisë) së Shqipërisë në Amerikë.

15 dhjetor 1942 Ndërron jetë në Washington. Trupi i tij i pajetë u vendos të prehej në varrezat Forest Hills të Bostonit. Në vitin 1995, me ceremoni zyrtare, u soll në Tiranë.


Pasioni/ hobi: Teatri, muzika klasike, orët, klarineta dhe oboe.


Botime: Faik Konica (listuar jo të gjitha)

- 1895 *L'Albanie et les Turcs.* Botuar në gazetën *La Libre Parole* (Bota e lirë), Paris, gjatë periudhës 1892 - qershor 1924, themeluar nga Édouard Drumont, nën pseudonimin Tepeleni.
- 1899 *Memoire sur le mouvement national albanais*. Bruksel: dorëshkrim frëngjisht në Arkivin e Vjenës.
- 1899 *Parashtresa për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.*
- 1904 *Essai sur les Langues Naturelles et les Langues Artificielle.* Botuar me pseudonimin Pyrrhus Bardyli. Bruxelles: Librairie Kiessling et Cie., 147 f.
- 1906 *Kohëtore e letrave shqipe.*
- 1911 *Marsejeza* në "Trumbeta e Krujës".
- 1912 *Jeta e Skënderbeut.*
- 1915 *L'Allemagne et l'Albanie*, Lozanë.
- 1922 *Një ambasadë e Zulluve në Paris* në "Dielli".
- 1922 Autobiografi e Faik Konicës
- 1924 *Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit: përrallë* në "Dielli". Një satirë kundër Zogut.
- 1924 *Në Hien e Hurmave*. Përkthim e rikrijim i një zgjedhjeje të përrallave arabe nga "Një mijë e një net". Ribotim, 1943: *Në Hien e Hurmave. Pralla t' Arabisë*. Shqipëroj Faik Konitza. Tiranë: Argus.
- 1929 (25 tetor) *Shqipëria si m'u duk* në "Dielli". Përshtypje nga udhëtimi në Shqipëri. Me kërkesë të Zogut, ndërkohë që ishte ministër fuqiplotë në ShBA, Konica vizitoi Shqipërinë gjatë periudhës 6 nëntor 1928 - 5 janar 1929.
- 1940. *The background of the Italian-Greek conflict*. By Faik Konitza, former Envoy of Albania to the United States. Washington.
- 1957 *Albania – the Rock Garden of Southern Europe and other essays*.

Mark Wollaeger & Matt Eatough, eds. "The Oxford Handbook of Global Modernisms", (2012:31)

Proto-modernizmi shqiptar simbolizohet me dy figura intelektuale: Faik bej Konitza dhe Fan S. Noli, lobimi, veprat dhe aktivitetet e të cilëve në Shqipëri, Europën Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara u bënë në emër të një detyre individuale me natyrë krijuese: të sillnin në jetë një vetëdije të re shqiptare... dhe pak rreshta më poshtë: ... Në esenë *Essai sur les Langues Naturelles et les Langues Artificielle* Konica na bën me dije shqetësimin parësor të Ballkanit modern: ekzigjencën etno-historike të gjuhës. Po ashtu, sëmbimi për përkatësinë linguistike vihet re edhe në veprën e papërfunduar të Konicës, novelën-monolog satirike *Dr. Gjilpëra zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit. Përrallë.*





Div. of Publication
JAN 15 1926
Dept. of State

The Honorable
The Secretary of State,
Washington.

Sir:

I have the honor to report that Faik Bey Konitza, president of the Vatra, the federation of Albanians in America, is, according to seemingly authentic information, being considered by President Ahmet Zogu for the post of Envoy Extraordinary and Minister Plenipotentiary of Albania at Washington. Some reports from sources close to the President go so far as to declare that the proffer has been made.

Historia e përfaqësimit të Shqipërisë në ShBA[2]

- Mars 1920 Kostë Çekrezi, diplomuar në Harvard, dorëzon letrat kredenciale të nënshkruara nga kryeministri i kohës, Sulejman Delvina dhe Ministri i jashtëm, Mehmet Konica. Paga e tij paguhej nga Vatra. Ai kishte rolin e një përfaqësuesi gjysmëzyrtar të shtetit shqiptar, por emri i tij nuk figuronte në "Librin Blu" të departamentit amerikan të shtetit që përmbante listën e diplomatëve që përfaqësonin shtetet e tyre në ShBA.
- 23 tetor 1920 Me anë të një letre drejtuar presidentit Woodrow Wilson, qeveria shqiptare emëronte amerikanin Charles Telford Erickson si "i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë", por gjithmonë me funksion gjysmëzyrtar.
- 28 gusht 1922 ShBA njohin *de juro* shtetin shqiptar.
- Gusht 1922 Propozohet Mithat Frashëri si ministër fuqiplotë, por Faik Konica është kundër emërimit të tij.
- Korrik 1924 Konsull i Shqipërisë në New York është Abdul Sula.
- Janar 1925 Konsull i Shqipërisë në New York është Koço Tashko.

Gjatë kohë që ishte ministër fuqiplotë, më 22 tetor 1928, Faik Konica përgatiti për shtetin shqiptar, dy dokumente, në bashkëpunim me Sekretarin Kellogg: Traktatin e Arbitrimit dhe Traktatin e Paqtimit. Ai i propozoi palës amerikane që dokumentet e traktateve të ishin edhe në gjuhën shqipe, çka nuk qe bërë ndonjëherë më parë. "Mu duk turp të mos përdoret gjuha jonë në një traktat dhe insistova për shqipen, e cila u pranua nga Guverna Amerikane," i shkruante ai ministrisë në Tiranë. (Ikonomi, 2011, cituar.)

Traktati i Arbitrimit parashikonte që zgjidhja e çdo mosmarrëveshjeje ndërmjet dy vendeve, nëse nuk arrihej me diplomaci, të bëhej nga Gjykata e Përhershme e arbitrimit në Hagë. Traktati i Paqtimit kishte të bënte me parandalimin e një lufte mes Shqipërisë dhe Amerikës.



Konica me motrat e Zogut, mars 1938. *Photo credit: I. Ikonomi*

Më 28.2.1938 në Amerikë arrijnë për vizitë tre motrat e mbretit Zog: princeshat Myzejen, Ruhie dhe Mexhide. Në këtë kohë, në Shqipëri, Ministër i Jashtëm ishte E. Libohova. Më 4 mars princeshat u pritën në Washington nga zonja e parë, Eleanor Roosevelt. Gjatë bisedës së tyre në Shtëpinë e Bardhë, në sallë hyri Presidenti Roosevelt. Në vizitë ishte i pranishëm Konica.

Arshi Pipa

Konica njofti të gjitha të mshehtat e stilit, të gjitha kthesat. Stili i tij qe në thelb satirik. Të tana gamat e satirës ai provoi, prej ironis ma s'ambël deri në sarkazëm, prej humorit deri në pamflet. Por qe edhe i kthjellët e i ambël kur deshti.

Guillaume Apollinaire (1880-1918), poet, kritik arti, shkrimtar, mik dhe përkrahës i Konicës gjatë periudhës që qëndroi në Londër, si dhe i projektit të tij kulturor. Apollinaire do të botojë një artikull për Konicën në "Mercure de France" më 1 maj 1912, ku ndër të tjera, shkruan:

Konica ishte në gjendje që idiomat e rëndomta të një të folure mejhanesh, t'i shndërronte në një gjuhë të mrekullueshme, të pasur dhe plot zhdërvjelltësi.

Albania – the Rock Garden of Southern Europe and other essays.

Me parathënie nga Fan Noli. Edited and Amplified by Q. M. Panariti. Vatra, Boston, Massachusets. (*Shqipëria, Kopshti shkëmbor i Evropës Juglindore.* Përmbledhje e eseve të Konicës botuar nga Qerim Panariti).

Këtë vepër Konica e la dorëshkrim. Libri duhej të botohej me Shtëpinë Botuese "McBride", me titull "Një histori e shkurtër e Shqipërisë", sipas kontratës së datës 6 shkurt 1936, por sa kohë që autori ishte gjallë libri nuk u botua kurrë. Libri u botua më 1957 nën titullin *Albania: The Rock garden of Southeastern Europe and other Essays,* në anglisht. Botimi është me redaktimin dhe ndërhyrjet e Qerim Panaritit dhe shoqërohet me një jetëshkrim të Konicës të përgatitur po nga Qerimi, me titull "Faik Konica, kryqtari i vetmuar" dhe paraqitje nga Fan Noli. (Ikonomi, 2011:118). Në këtë libër Konica bën përshkrime etnografike-historike të hapësirës shqiptare, që nga Konica e deri në veri të Shqipërisë, zonë pas zone. Përkthimi i saj i parë në shqip u botua në Prishtinë nga Shtëpia Botuese "Gjon Buzuku", më 1991. Në këtë libër, sipas Hamitit (2013:78), Konica mendon se nuk mund të kuptohet historia e një populli pa njohur karakterin e tij:

> Turqit e grekët i njohin shqiptarët si kokëfortë, italianët si njerëz që shtiren (injorantë), francezët i njohin si krenarë, anglezët i karakterizojnë si popull që e do vendin e vet dhe pavarësinë, që i bashkon kombi e jo feja, i karakterizon pasioni, janë të rrëmbyeshëm; e parapëlqejnë forcën e jo mashtrimin; kanë aftësi kalorsiake. Shqiptarët kanë mirësjellje, pavarësi, tolerancë, besnikëri, inteligjencë,

Faik Konica, Washington DC, 1931. Në intervistë me radion CBS. (Library of Congress - Harris & Ewing). Në të djathtë, C.E. McGuire i radios CBS.




dinjitet, sjellje fisnike, thotë Edvin Pirs. Në vijim Konica vetë rreshton karakteristikat e shqiptarëve: 1. Individualizmin, që nuk lejon të zhvillohet shpirti i kopesë, kolektivitetit, të cilën autori e sheh si pengesë të bashkimit kombëtar. 2. Urrejtja ndaj ndëshkimit, urrejtja e dënimit me vdekje për faje politike. Edhe i burgosuri sipas Kanunit, kur e lan burgun e fiton statusin moral. 3. Mungesa e idealit, shqiptarët vdesin për cikërrime e jo për kauza e ideale të mëdha; me këtë lidhet e dhëna që shqiptarët u pavarësuan tepër vonë. 4. Mikpritja, e cila është kthyer në kult. 5. Nderi, norma e etikës së shqiptarit është besa, fjala e dhënë pa kontratë të shkruar. Prandaj, fyerja më e rëndë për shqiptarin është t'i thuhet i pabesë.

Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Faik Konica.

Prill 1938 - Fitues i çmimit "Kapelja e Artë", dhënë nga revista *The Judge*, një nga botimet më të mira satirike. Çmimi më parë u ishte dhënë: drejtorit të parë të FBI-së, Edgar Hoover, Prokurorit të Manhatanit, Thomas Dewey, Pilotit Charles Lindbergh, si dhe presidentit Franklin Roosevelt.

Kopertina e revistës Albania, Photo credit: O. Muzaka.





Kjo është fotoja me të cilën hapen të gjithë numrat e "Albania".

3*/ Austria ka provuar dhé provon sé do qi Shqipetaret te mpsojne ghuhen kombiaré édhé te hapin syté. Ne shkolhat é paketa te mbajtura ne Shqiperi nga Austria mpsohét me shume ghuha shqip. Ne shkolhat te mbajtura nga Italia ne Shqiperi mpsohét vétem italishtia, ghuha shqip esht é dbuar.

Aqe per sot ! T.S.

(Albania. B. 138. Nga vjéshta II ghér ne dimeruara. Google Book Project)

History of the Literary Cultures of East-Central Europe. *Vol. III. Edited by Marcel Cornis-Pope, 2007:92.*

Revista "Albania" konsiderohet si një nga periodikët shqip më të rëndësishëm të botuar deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore. Periodiku përmbante artikuj dhe informacion që përfshinin fusha të shumta, si: histori, gjuhësi, letërsi, folklor, arkeologji, politikë, ekonomi, fe dhe art. Si e tillë, cilësohet shpesh si "mini-enciklopedia e kulturës shqiptare" të asaj periudhe.

Faik Konica themelon dhe boton në shqip e frëngjisht dhe pak faqe në turqisht, revistën "Albania", fillimisht në Bruksel dhe, më vonë, në Londër. Numri i parë del më 25 mars 1897. Albania, Bruksel (1897-1902), Londër (1902-1909). Sipas Hamitit (2013:91), botimi i revistës mbështetej financiarisht nga qeveria e Austro-Hungarisë, që e nxiste lëvizjen kombëtare shqiptare si pengesë për shtrirjen e sllavëve në Ballkan. Të njëjtin mendim ka edhe R. Elsie.

Një nga arritjet më të mëdha të Konicës, për shumë studiues, konsiderohet kjo revistë, pasi aty gjenden të botuara jo vetëm shkrimet kryesore të Konicës, por edhe kontribute të tjera, veçuar: promovimin e talenteve të reja; fillesat e një kritike të mirëfilltë letrare; ndihmesën në kultivimin i shijeve artistiko-letrare të letërsisë së Rilindjes; nxitjen për botime cilësore (S. Hamiti, 2013; E. Xhindi, 2009: Revista Ars Poetica). Sipas Jup Kastratit (cituar: Neziri, Z. U., 2008. *Studime për folklorin. II. Epika gojore dhe Etnokultura*. Prishtinë: Instituti Albanologjik, f. 34), në dymbëdhjetë vjet të botimit të *Albanias*, janë botuar 64 këngë epike e historike (ose 1444 vargje), 70 proverba dhe 16 gojëdhëna për Skënderbeun. Shkrimet e tij në këtë revistë, Konica i nënshkruante me llagapin Trhank Spirobeg. Revista "Albania" pushon së botuari kur Konica shkon në Amerikë.

* * *

Albania, vit i dyte numeri VII 1899. "*É perkoheshmé. Del dy hére ne muaj, shkruan č do ghe ne ghuhe shqip (toskerisht e gégnisht), frenghisht e turqisht"*. Kryeshkroňetuar (Directeur) Trhank Spirobeg. Shkroňetuar-arketar Visko Babatasi.

Valhe č' kerkojme?

S'jémi lodhur se theni sé nuke dime as né véte sé č' kerkojme. Ňe hére keshtu, ňe hér' ashtu. Tani po. pastaj nuk. Sot mire, néser liksh. Ku vémi, psé dualhme? A duam te mérémi vésh édhé te bejme ndoňe pune? Ahéré lé te mblidhémi te péshojme punen mire, édhé te mos humbasim kohe. sé u-poshteruam ne sy te botes: Ghithe Toskeria mé Shqiperin' é Mésmé. édhé shume vise te Gégerise, desherojne. ne funt te shpirttit, shkolha, édhé shkolha s'kémi. Prsé? Ne eshte sé kémi rene aqe poshte sa kémi frike te kerkojme ňe te dréqte te vogel si mpsimi i ghuhes, lé te héqim dore faré nga kombesia, édhé lé té quhét i vdékur émeri jon Shqipetar. Per te péshuar si é sa mundim te bejme per shkolhat shqip, do te piqémi mé shume te miret Shqipetare te Bukuréshtit, te cilet kane kurdohére deftuar dashuri per memedhéme. Andaj, keto dite, mé te čkelqyérin memedhétar Murat bég Toptanin, kam per te bashkudhetuar ghér ne Bukuresht.

TRHANK.

Sa i takon martesës, pothuaj të gjithë studjuesit e Konicës pranojnë faktin që ka qenë beqar. Gjithsesi, i njihen dy mikesha të ngushta:

- Gjatë kohës kur ishte në Londër shoqërohej me Annie Playden, miqësi që duhet të ketë filluar që në kohën kur jetonte në Bruksel. Miku i tij, Guillaume Apollinaire, në një rrjesht të vetëm, pohon se kur u kthye për herë të dytë në Londër, e gjen Konicën të martuar. Asgjë më shumë! Duket se krahas miqësisë ndërmjet dy burrave, Apollinaire duhet të jetë ndier ndopak xheloz ndaj Konicës. Apollinaire kishte rënë në dashuri me Playden, por ajo nuk e mori kurrë seriozisht ndjenjën e tij, ndërkohë që vetë Konica jo vetëm kishte besimin e familjes ku ajo punonte, por edhe të vetë vajzës. Ndoshta për t'i hequr këtë ndjenjë xhelozie, Konica i ka pohuar që është martuar. Të njëjtët studiues pohojnë se disa nga lëvizjet e Konicës nga një shtet në tjetrin (zhvendosja nga Belgjika në Angli e më vonë në Amerikë), kanë korresponduar me lëvizjet e saj.

- Në Amerikë, në kohën kur ishte Ambasador, i pëlqente shoqëria me Ann Corion, e martuar me një pronar të disa teatrove. Sipas Ikonomit (cituar), Konica bëri një deklaratë për shtypin amerikan ku ironizonte thashethemet e gazetave për marrëdhëniet e tij me Corion dhe linte të kuptohej se midis tyre nuk kishte ndonjë lidhje romantike.

Sipas M. Stefan Popescu (2013:53), gjatë kohës që Ismail Qemali vendoset, për një periudhë kohe në Bruksel, krijon gazetën *Le Salut de l'Albanie*, botuar në disa gjuhë, me ndihmën e Faik bej Konicës.

Në vitet '912, u hodh ideja për bashkimin e të gjitha shoqërive shqiptare të krijuara në qytete të ndryshme të Amerikës verilindore, numri i të cilave ishte rritur me shpejtësi. Shoqëria "Besa-Besë" bëhet iniciatore për bashkimin. Faik Konica është anëtar i komisionit të punës për bashkimin, së bashku me Kristo Floqin, Fan Nolin dhe Paskal Aleksin. Më 28 prill 1912 themelohet "Vatra", Federata panshqiptare në Amerikë. Më 13 qershor 1912, shteti i Masacusetit e njeh si të ligjshme Federatën Panshqiptare "Vatra". Në kartën e regjistrimit figuronin këta emra: Faik Konica, Llambi Chikozi, Fan S. Noli, Kristo Floqi, Elia Tromara, Naum Cere dhe Kosta Kotta.

Kryetar i punimeve të Kongresit të Triestes, që kishte synim ndërgjegjësimin e opinionit botëror për çështjen shqiptare dhe njohjen e shtetit të saposhpallur shqiptar, si dhe gjetjen e propozimin e një emri të përshtatshëm që do të zente vendin bosh të princit të Shqipërisë.

Trupi i pajetë i Faik Konicës u vendos për ruajtje në varrezat Forest Hills të Bostonit, në një "si shtëpizë prej guri". Sipas bisedës me Ilir Ikonomin, në varrezat e Bostonit, ka disa shtëpiza të tilla. Trupi mbyllet hermetikisht në një arkivol prej bakri dhe lihet në atë shtëpi deri sa të afërmit të vendosin se çdo të bëjnë më tej. Konicën e lanë në shtëpinë prej guri, sepse mendohej që lufta do të mbaronte shpejt dhe arkivolin do ta dërgonin në Shqipëri. Por Enver Hoxha nuk e pranoi Konicën as të vdekur, prandaj më 1949 shqiptarët e Bostonit vendosën që arkivoli të futej në dhé në të njëjtën varrezë. Më 1995, trupi u zhvarros dhe u zhvendos nga arkivoli prej bakri në një arkivol më të vogël, prej druri, e u soll në Tiranë, ku u varros me ceremoni zyrtare dhe me të gjitha nderet e duhura.

[1] Marrë nga logoja që gjendej në sfondin e vulës me të cilën vuloste të gjithë librat e bibliotekës së tij. Ikonomi, I. (2011). *Faik Konica. Jeta në Washington*. Tiranë: Onufri, f. 330.

[2] *Ibid*, 18-22.

M.B. Downing "With the diplomats". Revista *The Washingtonian:*

Pinjoll i një familjeje të njohur dhe historike të Shqipërisë, ministri ka të afërm të fuqishëm në çdo fushë të jetës së saj, ushtarake, shoqërore, letrare si dhe në grupet politike që rrethojnë sundimtarin e ri.

Në foto, (treguar me shigjetë) Faik Konica në një darkë të dhënë për nder të tij në Klubin "Chevy Chase" të Washingtonit më 26 nëntor 1932. Darka u dha nga Gjenerali William Horton, personalitet i njohur në Amerikë, kryetar i Shoqatës "Miqtë e Shqipërisë".

Koleksioni Faik Konica. Kontribut nga Niko Kotherja.



PËLLUMB KULLA

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë, Përfaqësues i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), New York, ShBA.
Periudha: Dhjetor 1993 – Shtator 1997



Datëlindja: 10 janar 1940

Vendlindja: Zëmblak, Korçë.

Diplomë: Aktor & Regjisor. Instituti i Lartë i Arteve (sot Universiteti i Arteve), Tiranë.

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, rusisht, italisht, anglisht, gjermanisht.

Bashkëshortja: Xhuljeta (Strumi) Kulla

Fëmijët: Era, Flladi, Ditbardhi.

Motoja: "Janë të gjitha mundësitë që të ngrejmë çentrale që prodhojnë natë dhe terr të zi… Kjo gjë është provuar tashmë me shkollat, që pas mbarimit diplomojnë injorantë".



Foto e marrë më 26 janar 1994. Ambasadori Pëllumb Kulla i dorëzon letrat kredenciale Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Boutros Butros-Ghali.

1998-1999 Drejtor i gazetës shqiptaro-amerikane "Ilyria", New York.

1993-1997 Ambasador i Republikës të Shqipërisë OKB.

1993 Sekretar i Dytë, në Ambasadën shqiptare, Bonn, Gjermani.

1991-1992 Dekan i Fakultetit Teatral, Universiteti i Arteve, Tiranë.

Përvojë 35 vjeçare në punën me skenën, me trupat profesioniste të Vlorës, Fierit, Tiranës.

Bashkëpunime të shumta për realizimin e programeve dhe spektakleve të RTVSH.

Përpjekje shumëvjeçare në hulumtimin e humorit popullor dhe prurjen e tij në skenë dhe ekran.

Aktiv në fushën e publicistikës.

Autor i një numri të madh artikujsh, analizash dhe essesh, mbi problemet e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Shkrimet shquhen për mprehtësinë e temave që theksojnë nevojën e mentalitetit të ri demokratik dhe shigjetimit të grykësisë pasurore, që ashpëron klimën politike në hapësirat shqiptare.

Pasioni / hobi: Garat sportive.

Botime, Autor

- 2013 *Luftë pa fund. Shtegtime nëpër qiellin politik*. Me parathënie nga Filip Çakuli dhe Mero Baze dhe pasthënie nga Faruk Myrtaj, Tiranë: UET Press, 690 f., çmimi 1500 lekë.
- 2012 *Rrëmbimi i nuses në New York*. Tregime dhe novela të zgjedhura. Tiranë: Geer, 223 f., çmimi 1000.
- 2012 *Jo gjithë të vdekurit prehen në paqe*. Jetëshkrim i një familje nga Zëmblaku i Korçës. Tiranë: Geer, me pasthënie nga Agim Shehu, 295 f., 32 fl. me foto, çmimi 1000 lekë.
- 2011 *Teatri kjo lojë magjepëse*. Vëllimi 4. Përzgjedhje nga mielli për magjen e skenës. Drama, komedi, skeçe, dialogë, monologë, skica, intervista dhe shënime. Tiranë: Albin, 535 f.
- 2010 *Rrëfenja nga Amerika* Botimi i dytë. Tiranë: Toena, 264 f., çmimi 900 lekë.
- 2008 *Vdekja e Enver Hoxhës*. Shumë romane në një. Tiranë: Arbëria, 228 f. Ribotim: 2013. Tiranë: Geer, 192 f., çmimi 800 lekë. *Ribotim* (në greqisht): 2008 Me titull "Thanatos tou Enver Chotzia. Polla mythistorimata se ena." Tiranë: Geer, 218 f. ; 21 cm.
- 2007 *Teatri kjo lojë magjepëse*. Vëllimi 3. Përzgjedhje nga mielli për magjen e skenës. Drama, komedi, skeçe, dialogë, monologë, skica, intervista dhe shënime. Tiranë: Ideart, 418 f.
- 2007 *Teatri kjo lojë magjepëse*. Vëllimi 2. Përzgjedhje nga mielli për magjen e skenës. Drama, komedi, skeçe, dialogë, monologë, skica, intervista dhe shënime. Tiranë: Ideart, 396 f.
- 2007 *Teatri kjo lojë magjepëse*. Vëllimi 1. Përzgjedhje nga mielli për magjen e skenës. Drama, komedi, skeçe, dialogë, monologë, skica, intervista dhe shënime. Me parathënie nga Maku Pone f. 7-27. Tiranë: Ideart, 386 f.
- 2005 *Pushtimi i Amerikës*. Tregime. Tiranë: Toena, Me parathënie nga Teodor Laço. 334 f.
- 2005 *Lejlekët nuk vijnë më*. Tiranë: Arbri, 334 f., çmim 700 lekë.
- 2003 *Rrëfenja nga Amerika. Përjetime dhe portrete shqiptarësh në mërgim*. Tiranë: Arbri, 292 f.
- 2001 *Skënder Sallaku ose si qeshnim nën diktaturë*. Esseistikë. Tiranë: Arbri, 2001, me parathënie nga Dritëro Agolli, 248 f., me il.
- 1989 *Këshilla për fëmijët nga 5 deri 55 vjeç*. Tregime. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 196 f.
- 1986 *Po martojmë Malon*. Skica, tregime, skeçe, komedi njëaktëshe. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 199 f. me il.
- 1984 *Portrete pa makiazh*. Monologë, dialogë, skeçe, komedi njëaktëshe. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 208 f. me ill.

Mero Baze dhe Filip Çakuli

Kur një njeri rri kaq gjatë në jetën publike, si artist, si politikan dhe publicist, e ka të nevojshme dikur të mos ketë dëshirë t'i kujtosh ndonjë pjesë të jetës, ose të qëndrimeve publike. Pëllumb Kulla, është një "diktator" i cili ka sunduar rreth njëzetekatër vjet publikun shqiptar dhe jo vetëm nuk ka asgjë për t'i ardhur keq nga jeta e tij, por është aq arrogant sa do të na i tregojë të gjitha….

I tillë është libri "Luftë pa fund" i Pëllumb Kullës, një leksion i hapur për studentë, gazetarë, por dhe për intelektualët shqiptarë, për mënyrën se si duhet t'i përkasin shoqërisë.



- 1980 *Shoku Niqifor.* Komedi. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 104 f.
- 1980 *Lipe Shtogu në listë.* Komedi njëaktshe, skeçe, monologë. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", f. 128 me il.

Përkthime

- 1961 *Olesja* Novelë. Autor: Aleksandër Kuprin. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 162 f.
- Për repertorin e studentëve të Fakultetit Teatral në vite:
- 1990 *On ne badine pas avèc l'amour!* (Nuk bëhet shaka me dashurinë!) Autor Alfred de Musset.
- 1964 *Igroki* (Bixhozçinjtë). Autor Nikollaj Gogol.
- 1964 *I limoni di Sicilia* (Limonët e Siçilisë) Autor Luigi Pirandello.
- 1963 *Monserat.* Autor Emanuel Robles.

Redaktime

- 2009 *Si nuk u ngrit një bust për mua!* Tregime satiro-humoristike. Autor: Agron Goga. Tiranë: Emal, 148 f.
- 2009 *Luftar Paja*. Shënime, të dhëna, kronika, opinione mbi një artist të rrallë. Autor: Albert Zholi. Tiranë: Toena, 256 f., me foto, çmimi 700 lekë.
- 2006 *Amerika në sytë e mi.* Mbresa dhe kujtime. Autor: Agim Shehu. Tiranë: Globus R., Pj. 1, 397 f.

Çmime në veprat e paraqitura

- 2011, janar *Çmimi i parë* për komedinë "Milioneri" me trupën e Teatrit "Bylis", në festivalin e dramaturgjisë shqipe, Gjilan, Kosovë.
- 1989, nëntor *Çmim i parë* për komedinë "Sa shumë gjethe të thata atë vjeshtë" me trupën e Teatrit "Skampa" në Festivalin Kombëtar të Teatrove, Tiranë.
- 1989 *Çmimi i dytë* për vëllimin me tregime "Këshilla për fëmijët nga 5 deri 55 vjeç" në Konkursin e Madh të 45 vjetorit të Çlirimit.
- 1989 *Çmimi i dytë* për spektaklin "E bukur shtëpi e vjetër" në Festivalin Kombëtar të Teatrove.
- 1981 *Çmimi i dytë* për spektaklin "Dy krisma në Paris" në Festivalin Kombëtar të Teatrove.
- 1979 *Çmimi i dytë* për spektaklin "Shoku Niqifor" në Festivalin Kombëtar të Teatrove.
- 2003 *Mjeshtër i Madh*
- 2005 *Nderi i Qarkut* Fier

Ligjërata në foltore të huaja:

- 2009, 9 tetor *Grotesku i të qeshurës së ndaluar. Humori në një diktaturë komuniste*. Biblioteka e Kongresit Amerikan, Washington, ShBA.
- 1991, 23 janar *Bashkekzistenca e artistit me çensurën*, Universitet i Lecces, Itali.

Teodor Laço

Ashtu si edhe vetë përfytyrimi
që zgjon lënia pas e një shekulli,
i cili befasisht fillon e quhet
"i vjetër", edhe Kulla në këtë
shekull të ri, shtyn (pa bërryla!)
nga piedestalet e tyre disa nga
autorët më me emër të humorit
dhe ngjitet vetë, një kokë më lart.
Ai shënon një risi për prozën tonë
të shkurtër të këtij zhanri.

Faruk Myrtaj

Duke lexuar shkrimet e Kullës s'mund ta refuzosh. Po, mund të mendosh kundër, ose diku mund të ndalesh dhe ta akuzosh se shpesh e tërheq sharrën në mish të gjallë, por më tej e tërheq këtë akuzë teksa vëren se mishi ku dhemb sharra e fjalës së tij është i gjymtyrëve të trupit të tij... Kjo besoj është pse-ja dhe sepse-ja që, së paku heshturazi, nuk mund të mos pranojmë se rrëfimi dhe, po aq edhe interpretimi i fakteve, ngjarjeve dhe fenomeneve të marra në shqyrtim është i drejtë dhe lehtësisht i verifikueshëm si i tillë.



Me Nënë Terezën, New York. Takimi i parë me të në njërën nga shtëpitë e Urdhërit, qershor 1995.

Komunikimet me Nënë Terezën

Më 17 mars 1997, Jeanette Petry, motra e Urdhërit Nënë Tereza, erdhi në zyrën time dhe më njoftoi se Nënë Tereza ndiqte me shqetësim ngjarjet tronditëse në Shqipëri. Shenjtorja e ardhshme ndodhej e sëmurë në shtratin e saj në Kalkuta të Indisë dhe, gjashtë muaj më vonë, do të mbyllte sytë përgjithnjë. Ajo kish shfaqur dëshirë që të bënte një bisedë telefonike me mua, pra desh të bënte një deklaratë publike me një përfaqësues zyrtar. Motra Jeanette erdhi në mbrëmjen e 16 marsit tek unë dhe u lidhëm me Kalkutën. Motra u kujdes me takt që askush të mos regjistronte dialogun tonë. Megjithatë, në një mikrokasetë unë ruaj një copëz të dialogut me Nënën e Madhe. Po atë natë ia përcollëm lajmin Tiranës duke zbardhur të gjithë bisedën.
Ishte dhe mbetet një mesazh historik, jo nga dokushdo, por nga Nënë Tereza!

Sa më poshtë, fragmenti i një letre të dërguar nga Kulla për Nënë Terezën:

E dashur Nëna Terezë!

Zoti Ju bekoftë e paçi jetë të gjatë. Ju falenderoj për gjithë bisedën që patëm dje në telefon, Ju falenderoj për bekimin Tuaj, për dërgimin e motrave në Shqipëri dhe për mesazhin që po u jepni atyre me vete, atë mesazh shkruar me dorën Tuaj.

I mora të gjitha masat që motra Getrude dhe motra Shobha t'i marrin menjëherë në Romë vizat dhe aty tu vihen në dispozicion të gjitha mjetet për të arritur në Shqipëri pa vonesë.

Si mund të mos e bëja këtë kur ajo është kërkesa Juaj?! E si mund të mos vihen të gjithë në veprim kur është puna për të plotësuar dëshirën Tuaj?!

Në një kohë që Shqipërinë po e lenë turistët, diplomatët e huaj, familjet e tyre, biznesmenët dhe, bile vetë shqiptarët, të krijohet përshtypja se kjo braktisje, kjo arratisje e madhe po bëhet për të qenë sa më shpejt larg nga diçka, që së shpejti do të mbytet, nga diçka që së shpejti do të digjet.

Bash në atë kohë motrat e Urdhërit Tuaj nuk largohen nga vendi dhe nga misioni i tyre. Parashikojnë që mund të mbeten edhe pa ngrënë. Dhe nuk arratisen, por rrinë pranë të sëmurëve, pranë fëmijëve, pranë sakatëve. Ato nuk marrin pjesë fare në braktisjen e madhe të Shqipërisë, ku fajtorë dhe të pafajshëm po bëhen gati të digjen tok në një zjarr të çmendur.

1996, 13 nëntor

Pjesë nga fjala e mbajtur në analizën e programeve të UNICEF (me shkurtime)

I nderuar zoti President!

Dëshiroj të them dy fjalë në lidhje me programin e vendeve CPR '95, program që ndodhet për diskutim në këtë mbledhje të Këshillit Administrativ.

Programi frymëzohet nga ndjenja fisnike, që meritojnë vëmendje dhe respekt të madh, sepse shtjellon gjendjen dhe merr në konsideratë masat e duhura që duhen marrë në një rajon që vuan një luftë vëllavrasëse dhe absurde.

Si Përfaqësues i Republikës së Shqipërisë, do desha të tërhiqja vëmendjen tuaj drejt Kosovës, vend që është i populluar thuajse tërësisht nga shqiptarë dhe ku për shkak të diskriminimit e varfërisë, të një sistemi arsimor krejtësisht të cunguar, si edhe për shkak të disa

Problemet e Kosovës në fokus

Viti i parë i detyrës ishte i tëri i ngarkuar, sidomos me problemet që solli dizintegrimi i ish-Jugosllavisë. Na duhej që të sensibilizonim nevojën shtetformuese të vëllezërve tanë kosovarë. Për këtë qëndronim të lidhur ngushtësisht me informacionin mbi shfaqjet e dhunës në tërë Kosovën. Ishte një arritje e bujshme, për shembull, miratimi në Asamblenë e Përgjithshme i Rezolutës së paraqitur nga ne për të Drejtat e Njeriut në Kosovë, që praktikisht sillte mbi tryezat diplomatike Kosovën, si emër fillimisht dhe, më pas, si njohje e njësisë shtetërore.

Për këtë, ndonëse rezoluta ishte punuar edhe më parë, akoma vazhdonin të punonin ethshëm Tirana edhe vetë Prishtina. Ne u munduam të gjenerojmë përkrahje të gjerë për t'iu bashkuar rezolutës sonë. Dhe ia dolëm në krye. Në selinë e Misionit tonë ishin të pranishëm edhe aktivistët e figurat e rëndësishëme kosovare.

Këtu është vendi që të tregoj një episod të thjeshtë, por emocionant. Një ditë i dorëzova Këshillit të Sigurimit të OKB-së një notë proteste për mbylljen e Institutit Albanologjik dhe të Akademisë së Shkencave në Prishtinë, si edhe për vrasjen e dy shqiptarëve në rrugët e Kosovës. Menjëherë pas protestës sonë në New York, Presidenti Rugova në një konferencë shtypi në Prishtinë, para gazetarëve tha: "Këto ditë ne protestuam pranë Këshillit të Sigurimit të OKB-së për mbylljen e Institutit Albanologjik dhe Akademisë, si edhe për vrasjen e dy shqiptarëve…

Kur lexova deklaratën e Presidentit Rugova m'u lagën sytë nga lotët. Ai thoshte "ne protestuam" dhe jo "Misioni Shqiptar protestoi". E pra ne nuk patëm marrë urdhër nga Presidenti Rugova e megjithatë ai e ndjente se ne ishim Misioni i tij dhe ai ishte Presidenti ynë.



Me President Rugovën

sëmundjeve të ndryshme të përmendura në raport dhe të njohura tashmë gjerësisht nga Komuniteti Ndërkombëtar, jeta e fëmijëve të tyre është vështirësuar...

Ne përshëndesim ngrohtësisht praninë e UNICEF-it në Prishtinë, kryeqytetin e Kosovës dhe urojmë që, falë kësaj pranie, atje të mund t'i kushtohej një vëmendje e kujdesshme edhe shpërndarjes së rregullt të burimeve financiare, gjë të cilën fëmijët e Kosovës e kanë mjaft të nevojshme...

Gjatë periudhës dhjetor 1993 – shtator 1997, kur Pëllumb Kulla ushtronte detyrën e Ambasadorit:

Presidentë të Shqipërisë: Sali Berisha (Partia Demokratike), Rexhep Meidani.

Kryeministra të Shqipërisë: Aleksandër Meksi (Partia Demokratike), Bashkim Fino (Partia Socialiste), Fatos Nano (Partia Socialiste).

Ministra të Jashtëm: Alfred Serreqi (Partia Demokratike), Tritan Shehu (Partia Demokratike), Arian Starova (Partia Bashkimi Social-Demokratike), Paskal Milo (Partia Social-Demokrate).

Sekretar i Përgjithshëm i OKB: Boutros Boutros-Ghali, Kofi Annan.



9 tetor 2009. Ligjëratë në Bibliotekën e Kongresit Amerikan, Washington DC, me temë "Grotesku i të qeshurës së ndaluar".

Kadarenë e nderojnë ambasadorët e OKB-së.

Sapo ishte botuar në anglisht libri "Piramida" i Ismail Kadaresë, ndërkohë që menduam të organizojmë një festë në përfaqësinë shqiptare të OKB-së me rastin e kësaj ngjarjeje. Ndamë ftesat mjaft kohë përpara. Ftesat për ambasadorët e OKB-së i shoqëruam edhe me një kopje të librit të sapobotuar. Ideja u finalizua më 12 shtator 1996, me pjesëmarrje të gjerë të afro njëzet e pesë titullarëve, në katin e 65-*të* të një hoteli që shihte mbi Central Park. Ndër të pranishmit veçoj katër anëtarë të Këshillit të Sigurimit, miq të veçantë dhe njohës të problemeve tona kombëtare. Për më tepër, ndihej kërshëria që kishin për të takuar Kadarenë, me veprën e të cilit njiheshin më së miri, veçanërisht Sergej Llavrov, përfaqësues i Federatës Ruse (sot Ministër i Jashtëm i atij vendi), ambasadori Butler i Australisë dhe Tono Eitel, i Gjermanisë. Të pranishëm ishin edhe shumë botues. Takimin e përshëndetën Ambasadori i Francës i akredituar në ShBA, Alain Dejammet, vetë autori, Ismail Kadare, dhe Ambasadori Pëllumb Kulla.

Një fragment i shkëputur nga fjala përshëndetëse e Kullës:

Për milionat e bashkatdhetarëve të tij, për milionat e njerëzve kryq e tërthor hemisferës komuniste që provuan të njëjtat vuajtje nën diktaturat, si dhe për milionat e lexuesve dhe studiuesve të letërsisë në tërë



Ballina e romanit *Rrëfenja nga Amerika* është realizuar nga Admirim Banaj, me emër arti i njohur si Like Rehova, grafist i mirënjohur me një të kaluar diplomatike. Nga viti 2005 deri më vitin 2013 ka shërbyer si Ambasador i Shqipërisë në Riyadh të Arabisë Saudite.

Valbona Nathanaili

Në tërësinë e veprimtarisë së tij, Pëllumb Kulla paraqet figurën e një intelektuali të sofistikuar, me një reputacion që prej kohësh i ka kaluar kufijtë e Shqipërisë.

Arion Sula

Bashkëpunimi me Pëllumb Kullën është gjithmonë i suksesshëm. Të mahnit mënyra se si e shpreh mendimin dhe dimensionet që i krijon fjalës.

botën, Ismail Kadare përfaqëson një akt madhor dhe triumfal mbijetese. Ata që kanë vuajtur format më të egra të diktaturës janë në gjendje ta çmojnë më mirë veprën e një shkrimtari që ia doli të krijojë letërsi të madhe edhe nën vëzhgimin e syrit të policisë dhe të regjimit.

Të thuash të vërtetat në të tilla rrethana do të thotë ta paguash me jetë. Por meqënëse për shkrimtarin janë të shtrenjta si jeta, ashtu edhe krijimtaria, atij i duhet të gjejë rrugët që t'i shpëtojë të dyja njëkohësisht, jetën dhe veprën.

Ai nuk shkruan dot "vdekje diktatorit", sepse kjo do të thotë "vdekje poetit". Për të thënë të parën kërkon e gjen zgjidhje sa të fuqishme, aq edhe dhelpërore, si për shembull duke krijuar imazhe poetike përzier me mesazhe të fshehta që të frymëzojë milionat dhe të ruajë kokën e vet.

Vepra e Kadaresë është e mbushur e tëra me realitetin e përditshëm të një vendi totalitar, por e gjitha është e vënë nën kontekste historike, është thënë alegorikisht dhe metaforikisht me art të lartë, për të mbrojtur lartësitë e tij dhe sidomos për të mbrojtur veten nga pasojat që sillte e vërteta e vënë në dukje...

1997, dhjetor. Marrë nga gazeta"Dielli" *(me shkurtime)*.

Federata "Vatra" ka qenë, mbetet dhe do të jetë një emër tepër i shtrenjtë në faqet e historisë kombëtare. Për vetë misionin që morën përsipër ata që e themeluan, për platformën që përmban kanunorja e saj dhe kryesisht për aktivitetin që ka kryer e kryen në bazë të kësaj platforme, gjeneratat e sotme shqiptare dhe ato që do të vijnë, me të ndeshur emrin e "Vatrës", ndjejnë t'u rigjallërohen ndjenjat e bukura të patriotizmit...

Ata që udhëheqin federatën tani, meritojnë respekt të thellë jo vetëm për ndjenjën e lartë të patriotizmit që kanë në ato që bëjnë, por edhe për devotshmërinë e sakrificën për idealizmin, që i shtyn të mbajnë ndezur thëngjijtë në "Vatër" duke pritur që zjarri të shtohet e njerëzit të mblidhen rreth saj, të ngrohen e të kuvendojnë...

Administrimi civil i Kosovës me mbikëqyrje ndërkombëtare është njëra prej disa zgjidhjeve të propozuara nga vetë shqiptarët kosovarë dhe është pozitiv çdo deklarim i favorshëm qoftë edhe nga një organizatë joqeveritare, siç është rasti që përmendët... Meriton të përshëndetet vendosmëria me të cilën qeveria e ShBA kërkon t'i shtyjë drejt zgjidhjes të gjitha problemet e mbetura në territoret ish-Jugosllavë... E gjithë bashkësia ndërkombëtare e mbështet këtë gjë dhe, natyrisht, mbështetja më e vendosur është ajo e Republikës së Shqipërisë.



Festimet e 50 vjetorit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

1995, 27 dhjetor. Ambasada jonë në Shkup informon se çfarë ndodh në Nju Jork!

Letër Presidentit Berisha (cc. Ministrit Serreqi)

Zoti President!

Më lejoni, ju lutem, ta quaj shumë të çuditshëm faktin që Ministria e Punëve të Jashtme qarkullon në një telegram të mbyllur me kod, një lajm të datës 13 dhjetor, nga Shkupi i Maqedonisë. Është lajmi mbi një letër proteste me të cilën ambasadorët e Maqedonisë, Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës kundërshtojnë këtu në OKB një rezolutë, e cila favorizon Jugosllavinë e Millosheviçit për t'u bërë direkt anëtare e Organizatës! Në atë lajm të shifruar ambasadori ynë në Shkup, zoti Murati, premton se do të arrijë të shtjerë në dorë dhe tekstin e letrës së katër ambasadorëve, gjithnjë duke shpresuar se një miku i tij i ngushtë në qarqet diplomatike të akredituara në kryeqytetin maqedon, do të arrijë t'ia japë nën dorë, fshehurazi, kryepërfaqësuesit tonë, zotit Shaban Murati.

Kështu, ky lajm sekret, që në ministri vjen nga Shkupi me kod të shifruar, tregon shkoqur se Misioni i Republikës të Shqipërisë, pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, nuk punon si duhet. Nga kabineti i ministrit Serreqi nuk e komentojnë aspak këtë, por e lenë të kuptohet katërcipërisht se në një rrjedhë normale, duhej që ky lajm të vinte që këtej, nga New Yorku, ku jemi dërguar të punojmë ne. Pra, lajmi nga Shkupi i qarkulluar edhe nga ministria për të gjitha përfaqësitë tona në botë, nuk është gjë tjetër veçse një kritikë fort e sjellshme, që le tërthorazi dhe me takt, të nënkuptohet se përfaqësia jonë këtu, në OKB, nuk i ndjek fare ngjarjet.

E vërteta, zoti President, është ndryshe. Përfaqësia jonë në New York punon me përkushtim dhe lajmin "sekret" e ka dërguar në ministri të hapur (!), ashtu siç është këtu, i hapur, dhe i ditur nga të gjithë. Bile edhe letrën konkrete, të firmosur nga të katër ambasadorët dhe të shtypur në qindra-mijëra kopje si dokument i OKB-së, pa qenë nevoja për aq konspiracion sa në Shkup. Për më tepër, stafi ynë e ka dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, jo më 13 dhjetor, (data e Shkupit), por më datë 7 dhjetor, (data e New York-ut), me faksin numër 346! Na vjen vërtet keq për punonjësit e shifrës, që futen në mundim për të përkthyer në shifër lajme që nuk janë aspak për shifër.

Siç mund ta dini, zoti President, ka afro një vit që çdo mëngjez, ne faksojmë në ministri fotokopjen e një ose dy artikujve më problematikë nën okelion "Veçojmë nga New York Times". Për shkak të mospërdorimit ende të internetit, kjo gjetje na u duk e dobishme. Pas nja tre muajsh, duke mos ndjerë efektin në ministri, provuam ta ndërpresim disa ditë këtë dërgim shtypi, për të shijuar zhurmat e alarmeve nga ministria. Nuk patëm asnjë alarm dhe asnjë protestë! Rifilluam ta dërgonim përsëri, nuk patëm asnjë njoftim për rivlerësimin dhe, natyrisht, asnjë falënderim. Dhe kjo, nëse ju kujtohet, nuk do të kishte dalë në plan të parë, sikur artikulli i rëndësishëm i New York Times, ku akuzoheshim për thyerjen e embargos së naftës me Malin e Zi (dhe që natyrisht ne e dërguam që në mëngjez herët), të mos kërkohej nga presidenca pas dy ditësh, me insistim dhe me plot qortime për ne!

Sa i takon ngjarjes së Shkupit, me lejën tuaj zoti President, na mbetet të nxjerrim disa përfundime:

Informacioni në ministri merret dhe jepet pa asnjë rregull dhe evidencë (gjë që po e vemë re që prej dy vjetësh).

Informacioni i misionit tonë, për shkak të një lloj "alergjie", nuk lexohet. Kjo të kujton pak atë ngjarjen me pasagjerët kavajas që afronin valixhet tek portat e vagonëve dhe nuk zbrisnin dot: treni nuk ndalonte më në Kavajë, sepse makinisti i trenit dhe shefi i stacionit kavajas ishin grindur me njëri tjetrin.

Nuk mund të mos vemë re një nuancë dashakeqësie edhe nga ana e përfaqësuesit tonë në Shkup. Ta zemë se zoti Shaban Murati vërtet beson në karakterin sekret të lajmit. Por thjesht për të qenë edhe më i besuar mund të ishte konsultuar me ne, këtu. Shkurt ai e dinte rëndësinë e goditjes së tërthortë që po na jepte.

Ose, - dhe kjo do të ishte paradoksale - që të kenë efekt njoftimet, nuk na mbetet veçse informacionet tona të hapura t'ia dërgojmë më parë Shkupit, në mënyrë që prej andej t'i përcillen ministrisë të mbyllura në kod, siç po bën ajo përfaqësi jo rrallë, si rezultat i përvojës së dërgatave tona komuniste që lajme të gazetave perëndimore me tirazhe shumëmilionëshe, i'a përcillnin dikur kryeqytetit me shifër të fshehtë!

Zoti President! Shpreh indinjatë për këtë gjest të ri përbuzës të Kabinetit të Ministrit ndaj punës së përfaqësisë shqiptare në New York.

Me respekt, Pëllumb Kulla.

AGIM NESHO

Ambasador, i ngarkuar a.i., Shef i Misionit shqiptar në ShBA.
Periudha: 2005-2006

Përfaqësues i Përhershëm (i dhjeti në radhë) i Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, New York.
Periudha: 1997-2006



Datëlindja: 29.03.1956

Vendlindja: Tiranë

Diplomë: Inxhinier dhe Jurist, Universiteti i Tiranës.

Gradë shkencore: Doktor i Shkencave në Inxhinieri.

Gjuhët e huaja: Anglisht, Italisht.

Fëmijët: Blerta dhe Dritan.

Motoja: "Të mbijetosh duke kontribuar në një tranzicion të vështirë".

EKSPERIENCA PROFESIONALE

2009 - aktualisht President, "Këshilli Shqiptar për Marrëdhënie me Jashtë" (Albanian Council on Foreign Relations), (Think-Tank).

2011-2012 Këshilltar i Zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Punëve të Jashtme.

2007-2012 Përfaqësues për Shqipërinë, WAZ Meddien Gruppe, Tirana.

2009-2010 Drejtor Ekzekutiv, Media Vizion Sh.a./ Vizion Plus TV, Tirana.

2005-2006 I ngarkuar me Punë, Ambasador në ShBA, Washington DC.

2005-200 Përfaqësues i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, New York.

1997-2006 Këshilltar Politik i Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

1995 Avokat, Tiranë.

1992-1995 Drejtor Ekzekutiv, Fondacioni Shqiptar për Çështjet Europiane dhe NATO-n, Tiranë.

1985-1992 Drejtor i Përgjithshëm, Qendra Kombëtare për Informacionin dhe Dokumentacionin Shkencor dhe Teknologjik, Akademia Shqiptare e Shkencave, Tiranë.

1983-1985 Inxhinier Profesionist, Tiranë.

1982-1983 Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria e Organizatave Ndërkombëtare, Republika e Shqipërisë.

1982 Instituti i Shkencave Informative, Akademia e Shkencave, Tiranë.




Foto e marrë më 1 shkurt 2004. Arben Malaj, Ministër i Financave, Hillary Rodham Clinton, Senatore e New York-ut dhe Agim Nesho, me rastin e zhvillimit të një aktiviteti në Shtetin e New York-ut.

Botime: Agim Nesho

- 2013, maj *Boshte të mbivendosura të politikës së jashtme. Për një diplomaci aktive në shekullin XXI*. Tiranë: UET Press, 117 f.
- 2007 *Në mirëbesim. Kujtime të një ambasadori*. Tiranë: Korbi, 539 f., 8 fl. me foto.
- 1995 *Parandalimi i një tjetër luftë ballkanike (Preventing Another Balkan war)* Athinë: Eliamep.

Medalje dhe Nderime

- 2012 *Knight Commander of Merit with Star* nga "Sacred Military Constantinian Order of Saint George".
- 2006 *Medalja Presidenciale e Mirënjohjes*, me motivacion: "Për shërbime të dalluara diplomatike ndaj Republikës". Republika e Shqipërisë, Presidenti Alfred Moisiu.
- 2005 *Diploma Presidenciale e Mirënjohjes* me motivacion: "Për shërbime të dalluara ndaj Popullit të Kosovës". Presidenti Ibrahim Rugova, Republika e Kosovës,
- 2002 *Qytetar Nderi* i Tenafly, New Jersey, ShBA.

AKTIVITETE NDËRKOMBËTARE

2005-2006 Zëvendës President i Këshilli Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC).

Zëvendës kryetar i Delegacionit Shqiptar në Sesionet 52-60 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara

2004 Zëvendës Kryetar i Delegacionit Shqiptar në Samitin e Monterrey, Meksikë.

2003 Kryetar, Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Aktivitetet e Zhvillimit.

2003 Kryetar i Delegacionit Shqiptar në Sesionin Special të Nivelit të Lartë mbi HIV/AIDS, New York.

2001 Kryetar i Delegacionit Shqiptar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve, New York.

2000 Anëtar i Delegacionit Presidencial, Samiti i Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara, New York.

2000 Anëtar i Delegacionit Presidencial, Konferenca Ndërkombëtare për Zhvillimin Social, Gjenevë.

1999 Kryetar i Delegacionit Shqiptar në Konferencën Ndërkombëtare për Çarmatimin, New York.

1999 Kryetar i Delegacionit Shqiptar në Sesionin e Veçantë të Kombeve të Bashkuara mbi drogat e ndaluara, New York.

AKTIVITETE POLITIKE

1995-1996 Kandidat për deputet, Partia e Aleancës Demokratike.

1997 Këshilltar Politik i Kryeministrit të Shqipërisë, z. Fatos Nano.


1993-1996 Këshilltar Politik i Kryetarit të Partisë Kryesore Opozitare në Parlament, z. Fatos Nano.

2006-2009 Këshilltar i Liderit të Opozitës, z. Edi Rama.

Pasioni / hobi: Historia, politika, vera.

Virgjil Muçi "*Boshtet e mbivendosura të politikës së jashtme. Për një diplomaci aktive në shekullin XXI*"

Ajo çka të bie në sy në gjykimet dhe vlerësimet e Neshos është njohja, deri në hollësi të imta, e dinamikave diplomatike në politikën e jashtme të çdo vendi, si dhe perceptimi realist dhe i esëllt i konceptit të marrëdhënieve me të mëdhenjtë e politikës europiane e amerikane. Ndoshta si rrallëkush nga analistët dhe studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare, Nesho shpalos një qasje pragmatiste nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, gjithë dinjitet, edhe pse është i vetëdijshëm për përmasat dhe peshën modeste në skenën botërore për një shtet i vogël si yni.





Chicago Tribune


EVENING. PEOPLE. QUOTES OF THE DAY.

`President Milosevic should make no mistake: The United...

April 02, 1999

`President Milosevic should make no mistake: The United States takes care of its own. And President Milosevic should make no mistake: We will hold him and his government responsible for their safety and for their well-being.' -- President Clinton, threatening retribution if any harm comes to three U.S. soldiers captured by Serbian forces.

ALBANIAN AMBASSADOR TO THE UNITED NATIONS AGIM NESHO, SPEAKING TO A GROUP OF UN DELEGATES: `Milosevic is a mixture of Hitler and Saddam Hussein.'



JTA

THE GLOBAL JEWISH NEWS SOURCE

Jewish Groups Mobilize to Aid Kosovar Refugees

April 6, 1999

NEW YORK (Apr. 5)

Jewish groups are taking an active role in aiding the hundreds of thousands of refugees fleeing the war-torn province of Kosovo.

The Albanian ambassador to the United Nations, Agim Nesho, recently met with the American Jewish Joint Distribution Committee to thank them for the efforts of the American Jewish community in helping the approximately 200,000 Kosovar refugees who are currently in Albania.

- 2000 *Qytetar Nderi* i qytetit të Worcester, Massachusetts, ShBA.
- 1999 *Qytetar Nderi* i qytetit New Orleans, ShBA.
- 1986 *Medalja e Punës*, Republika e Shqipërisë.
- 1981 *Medalja e Artë* me motivacionin "Për Rezultate të Shkëlqyera Akademike", Republika e Shqipërisë.

Çështja e Kosovës dhe e ardhmja e saj.

Kriza në Kosovë dhe roli parësor i OKB-së në zgjidhjen e kësaj krize kërkonin aktivizimin e veçantë të misionit shqiptar në OKB, gjë që rriti peshën dhe rolin e tij, reflektuar në takime, ftesa për biseda dhe intervista të shumta. Misioni Shqiptar në OKB ka ndjekur në mënyrë prioritare çështjen e Kosovës, që në fillesat e saj. Përveç pjesëmarrjes direkte dhe aktive në të gjitha mbledhjet e Këshillit të Sigurimit për Kosovën, misioni ka realizuar takime të nivelit të lartë, të presidentit Rugova, Kryeministrit Thaci, personaliteteve të tjera nga Kosova dhe Shqipëria, si dhe ka mundësuar përfaqësues të politikës së Kosovës të takohen dhe të shprehin pikëpamjet e tyre me anëtarë të Këshillit të Sigurimit dhe diplomatë, si dhe realizimin e konferencave të shtypit, përkrahje në stacionet më të mëdha televizive si CNN, ABC News etj.

The Global Jewish News Resourse, JTA: The Albanian ambassador to the United Nations, Agim Nesho, met this week with the American Jewish Joint Distribution Committee to thank them for the efforts of the American Jewish community in helping the approximately 200,000 Kosovar refugees who are currently in Albania. Tens of thousands more have settled in Macedonia. As in past crises, several Jewish organizations are taking donations, and hundreds of contributions have already poured into the JDC's offices in New York to help with the shelter, medical, food and clothing needs of the refugees, according to Steven Schwager, the group's associate executive vice president. As of Monday, some 650 donations totaling more than $78,000 had been received by the JDC, an "unprecedented" response in such a short time, according to JDC officials.

Henri Cili gjatë prezantimit të librit "*Boshte të mbivendosura të politikës së jashtme*", në ambientet e Universitetit Europian të Tiranës:

"Më bëhet qejfi që Ambasador Nesho i paraqet lexuesit shqiptar një refleksion, një sintezë, një kontribut për debatin publik dhe politikën e jashtme. U them studentëve dhe pedagogëve të Shkencave Politike, Marrëdhënieve Ndërkombëtare ose të fushave publike, se këto janë vepra të një rëndësie të dorës së parë".

Skënder Minxhozi, Revista "MAPO", për librin *Në mirëbesim*:

Presidentë, kryeministra dhe deputetë e ambasadorë, të gjithë janë aty, në majën e penës së kujdesshme të Neshos, i cili me një gjuhë të shkathët na paraqet anën e padukshme të zyrtarit shqiptar. Atë që ekspozohet në momentin që ai ulet para homologut të tij të huaj.

26 mars 1999

Në takimin e Këshillit të Sigurimit për të diskutuar projekt-rezolutën për ndalimin e veprimeve ushtarake të NATOs në Republikën Federale të Jugosllavisë, thirrur nga Federata Ruse, përfaqësuesi rus deklaroi se NATO po vret edhe popullsinë civile shqiptare dhe është organizatë kriminale që duhet të ndalohet. Reagimi i delegacionit shqiptar në këtë mbledhje të Këshillit të Sigurimit, ishte i menjëhershëm:

"Shqiptarët e kuptojnë se liria e tyre ka një çmim dhe janë të përgatitur ta realizojnë lirinë dhe pavarësinë me çdo çmim të mundshëm. Ata me keqardhje, por të ndërgjegjshëm, i pranojnë këto humbje të dhimbshme të njerëzve të pafajshëm, përpara një murtaje të egër, shfaruese që po bën të vuajë një popull të tërë… Shqiptarët e konsiderojnë NATO-n shpëtimtarin e tyre të madh."

2000, 17 Nëntor

Deklaratë për shtyp e UNIS (United Nations Information Service) Viena, për zgjedhjet në Kosovë të datës 28 tetor 1999. Në përmbledhje, të gjithë janë dakord që zgjedhjet kanë qenë një sukses teknik dhe kanë shënuar një fitore për ndërtimin e demokracisë në këtë vend. Kemi shkëputur pjesë të deklaratës së Ambasadorit Nesho:

"Kosovo's future status would be decided at a later time, when democratic institutions had been consolidated. Efforts to find a partial solution, influenced by enthusiasm for rapid change, would neither result in a long-term solution, nor justify the international community's long-standing commitment to the Balkans. It was in the interest of regional peace that comprehensive solutions on the final status of Kosovo be mature and lasting, and that they take into account the legitimate rights of the Kosovar Albanians to self-determination."

2005, 21 shkurt

Media ndërkombëtare Radio Free Europe (RFE/RL) lidhur me statusin e Kosovës, citon Ambasadorin Nesho nga intervista e realizuar me të.

"Albania's UN ambassador, Agim Nesho, whose country supports independence for Kosovo, told RFE/RL a decision this year could calm rather than inflame tensions in the region. "It's a necessity that the international community this year come to a decision that they will not only open the discussion about the future status of Kosovo but [come] to a conclusion on the future status of Kosovo and that must be very clear," Nesho said.

(Burimi http://www.rferl.org/content/article/1057584.html)

* * *

Lufta në Irak.

2002

Përdorimi i armëve kimike kundër popullsisë civile kurde kishte tronditur opionin publik botëror, por nga Këshilli i Sigurimit nuk ishte ushtruar asnjë masë kundër regjimit të Sadam Hussein. Duke respektuar





parimin e sovranitetit të shteteve, ideja për ndryshim regjimesh ishte *tabu* në diskutimet në Asamblenë e Përgjithshme dhe Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Për herë të parë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, gjatë diskutimit për çështjen e Irakut, delegacioni shqiptar hodhi idenë e nevojës për ndryshim të regjimit (*regime change*) në Bagdad. Në mbarim të fjalës së përfaqësuesit shqiptar, Ambasadorit Agim Nesho, përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadori Negroponte, në mënyrë të pazakontë për procedurën e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit, ngrihet nga vendi dhe i shtrëngon dorën përfaqësuesit shqiptar, gjë që shkaktoi reagim në sallën e mbledhjes.

2003, janar

Për të njëjtën çështje, në periodikun "International Debates", Vol. 1, Issue 1, p. 30, "Should the UN Security Council Authorize the Use of Force if Iraq does not Comply with Inspections?", fjala e z. Nesho përmblidhet nëpërmjet këtij abstrakti: "Presents an excerpt from a speech delivered by United Nations Ambassador Agim Nesho of Albania, at the 4,625th meeting of the Security Council in New York, in favor for the UN Security Council to authorize the use of force if Iraq refused to comply with inspections of its weapons of mass destruction".

(Burimi: http://connection.ebscohost.com/c/articles/11056642/should-un-security-council-authorize-use-force-if-iraq-does-not-comply-inspections-pro)

* * *

Aderimi në ECOSOC

2004

Gjatë kohës që Nesho ushtronte detyrën e ambasadorit, Shqipëria bëhet pjesë e ECOSOC (Këshilli Ekonomik dhe Social), organ po aq i rëndësishëm sa Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Për vitin 2005, në një deklaratë për shtyp të datës 20 janar 2005, ECOSOC/6143 bën me dije se Agim Nesho do të jetë një nga katër zëvendës kryetarët e saj.

* * *

Pjesëmarrje

2005, 29 maj - 1 qershor

Në Shangai të Kinës u zhvillua forumi i 5-të vjetor për "Informatizimin e Qyteteve" në rajonin Azi-Paqësor. Ambasadori i Shqipërisë, Agim Nesho, në cilësinë e Zëvendës Presidentit të ECOSOC-ut (Economic and Social Council, United Nations), përfaqëson Sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së Kofi Annan dhe përshëndet forumin. Në forum ishin të pranishëm rreth 1100 zyrtarë, qeveritarë dhe ekspertë nga 44 vende dhe rajone të botës. "*At the afternoon of 30 th May, Mr. Agim Nesho, Vice-President of ECOSOC met the correspondents at the Information Centre of the 5th Annual Forum on City Informatization in the Asia-Pacific Region. Mr. Nesho stated that the Forum itself has become a platform for exchanges and cooperation on city informatization in the Asia- Pacific region. UN will continue to promote the cooperation between countries and region.*"



Foto 1: Ambasadori Agim Nesho, duke folur në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.

Foto 2: Foto si drejtues i mbledhjes së Këshillit Ekonomik e Social (ECOSOC) në cilësinë e Zëvendës Presidentit të ECOSOC.

"Agim Nesho, Albania's Ambassador to the UN, stressed the role of monetary and exchange rate policies on the achievement of the MDGs and other development goals."

Sfida e Gjermanisë: Demokracia në Ballkanin Perëndimor. Nga Agim Nesho

Konferenca e nivelit të lartë të Ballkanit Perëndimor, e organizuar në Berlin, do të përdoret gjerësisht nga Gjermania për rikthimin e vëmendjes në Ballkan, një rajon që lëkundet midis pritshmërisë për t'u bërë pjesë në Europën e Bashkuar dhe pasionant për "demokracitë e kontrolluara", një term që sot përdoret gjerësisht për të përshkruar sistemet politike të demokracive jo-liberale që kontrollojnë shoqëritë e tyre, por në dukje japin imazhin e demokracisë.

Lëvizja e Gjermanisë për t'u angazhuar me Ballkanin vjen pas një dekade të shkëputjes së interesave amerikane nga rajoni dhe në një kohë kur deklarohet "ndërprerje e zgjerimit" të Bashkimit Europian të paktën për pesë vitet e ardhshme.

Megjithatë Bashkimi Europian nuk mund të lejojë ekzistencën e "vrimave të zeza" në territoret e saj gjeografike, për më tepër në një rajon ku influencat e huaja historikisht kanë lënë gjurmë. Kriza në Ukrainë me të drejtë ka zgjuar vëmendjen e Gjermanisë për të trajtuar me kujdes Ballkanin Perëndimor, edhe kur Bashkimi Europian nuk mund të ofrojë hapa konkretë drejt anëtarësimit.

Angazhimi me Ballkanin Perëndimor është më tepër sesa një çështje e sigurisë europiane. Influenca në rritje e Turqisë me strategjinë e saj neo-otomane gjen terren në Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Ndryshe nga sa propagandohet, kjo nuk është një qasje që reflekton lidhjet kulturore dhe traditat fetare të përbashkëta, por mbështetet në interesa ekonomike dhe është mënyrë e *lidershipeve* të këtyre vendeve për të përdorur modelin autoritar të pushtetit. Nga ana tjetër, përpjekjet e Serbisë për të përdorur interesat ruse, janë më tepër tendenca për të përfituar nga BE për çështjen e Kosovës dhe përkujdesin e tyre për investime dhe rol prioritar në rajon.

Problemi kryesor në Ballkan sot janë demokracitë jo-funksionale. Bosnja dhe Hercegovina po lëkunden nga protestat sociale kundër një regjimi jo-funksional. Maqedonia e ruan Marrëveshjen e Ohrit si fasadë, ndërsa marrëdhëniet ndër-etnike janë bërë më të dukshme dhe problematike. Shqipëria po drejtohet nga një regjim klientelist, i ngjashëm me modelin "hungarez", që po prish balancat e pushtetit dhe mund të krijojë në të ardhmen trazira sociale. Në Malin e Zi e njëjta elitë politike drejton vendin për mëse dy dekada. Në disa vende të Ballkanit Perëndimor opozita bojkoton parlamentin me shpresën e rritjes së vëmendjes për cënimin e parimeve dhe institucioneve demokratike.

Demokracia e kontrolluar është e pranishme dhe duket sikur iu vjen për shtat elitave udhëheqëse. Demokracia liberale që ishte frymëzimi i popujve të Europës Lindore pas rënies së Murit të Berlinit po fillon të zbehet në favor të demokracisë jo-liberale.

Hyrja në Ballkanin Perëndimor e një demokracie udhëheqëse dhe aktori global si Gjermania mund të ndihmojë në transformimin e *status-quo* dhe do të rrisë shpresën. Ky është një moment që duhet të shfrytëzohet nga të dyja palët: Gjermania për të rritur rolin e saj të *lidershipit* dhe përgjegjësisë në Europë; Ballkani Perëndimor për të përshpejtuar procesin e integrimit në Bashkimin Europian. Nëse kjo iniciativë nuk do të prodhojë efektet pozitive politike dhe ekonomike të pritshme, drejtimi i ardhshëm i Ballkanit Perëndimor nuk do të jetë më një surprizë.

Botuar në The National Interest, SHBA, 29 gusht 2014.
http://nationalinterest.org/blog/germanys-challenge-ensuring-democracy-the-western-balkans-11159

Gjatë periudhës 1997-2006, kur Agim Nesho ushtronte detyrën e Ambasadorit:

Presidentë të ShBA: Bill Clinton (Demokrat), George W. Bush (Republikan).

Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara: Kofi Annan.

Presidentë të Shqipërisë: Rexhep Meidani (Partia Socialiste), Alfred Moisiu.

Kryeministra të Shqipërisë: Fatos Nano (Partia Socialiste), Pandeli Majko (Partia Socialiste), Ilir Meta (Partia Socialiste), Sali Berisha (Partia Demokratike);

Ministra të Jashtëm: Paskal Milo (Partia Social-Demokrate), Arta Dade (Partia Socialiste), Ilir Meta (Partia Socialiste), Kastriot Islami (Partia Socialiste), Besnik Mustafaj (Partia Demokratike).

JUGOSLLAVIA DHE RUSIA

Përfaqësuar me:

Vasil Nathanaili

Teodor Laço

Mbas Luftës së Dytë Botërore, ambasadori ynë i parë në Beograd është Hysni Kapo, me emërimin e datës 18.7.1945. Vasil Nathanaili emërohet sekretar i parë më datë 13 nëntor 1945 dhe mbërrin në kryeqytetin jugosllav më 1 dhjetor të po atij viti.

Ambasadori i parë jugosllav në Tiranë, pas lufte, është Velimir Stojnič, i cili qëndron për një periudhë të shkurtër kohore, nga 7.7.1945 - 12.10.1945. Në çastin e emërimit ambasador, Velimir Stojnič ka këtë CV (në mënyrë shumë të përmbledhur): Shkollën normale e kreu në Banja-Luca; mësues në fshatrat e Bosnjës dhe rrethit Divar; i bashkohet Luftës Nacionalçlirimtare si partizan, komandant kompanie dhe, më 1943, komisar i Korpusit të Armatës V të Bos-Kranjia. Ministër i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë është Ivan Ŝubaŝić.

Më 12.10.1945 zëvendësohet nga Josip Djerdj. Në çastin e emërimit ambasador, Josip Djerdj ka këtë CV (në mënyrë shumë të përmbledhur): U lind më 1901, Vindija, Zadar; këshilltar në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Beograd; profesioni, publicist; pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacionalçlirimtare.

Kryeministër i Shqipërisë dhe i Mbrojtjes Kombëtare është Enver Hoxha. Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë Dr. Omer Nishani.

Bashkimi Sovjetik, 1945

Lidhja e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Shqipërisë pas luftës së dytë botërore, shfaqet në dokumenta, për herë të parë, nëpërmjet një komunikate të datës 8 nëntor 1945.

Në komunikatë bëhet me dije se më 8 nëntor 1945, ora 8 e mëngjesit, kryeministri i Shqipërisë, gjeneral-kolonel Enver Hoxha, priti në audiencë shefin e misionit ushtarak sovjetik, z. kolonel Sokolof, i cili i paraqiti një notë ku kërkonte, në emër të Qeverisë Sovjetike, vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë dhe shkëmbimin e përfaqësive diplomatike.

I Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike në Shqipëri (i pari) është Dimitri Stepanovitç Tchuvakin, sipas notës verbale datë 12 dhjetor 1945 (Arkiva e MPJ, Tiranë, BRSS, viti 1945, Dosja nr. B/I-1). Letrat kredenciale paraqiten më datë 11 janar 1946, ora 9.00.

Më 12 shkurt 1946 (Arkiva e MPJ, Tiranë, BRSS, viti 1946, Dosja nr. C-3, F. 16-20), me vendimin nr. A.XVIII.43, z. Koço Tashko emërohet në cilësinë e të Dërguarit të Jashtëzakonshëm dhe Ministrit Fuqiplotë të Republikës Popullore të Shqipërisë në Moskë. Koço Tashko mbërrin në Moskë më 20 prill 1946 dhe i paraqet Molotovit letrat kredenciale. Në informacionin që dërgon në Shqipëri ku përshkruhet biseda e bërë gjatë pritjes, është edhe një pyetje që i drejton Molotovi: Keni vendosur marrëdhënie me Francën? Marrëdhëniet me Francën vendosen pas disa muajsh.

Në çastin e emërimit si ambasador, në mënyrë shumë të përmbledhur, CV e Koço Tashkos: datëlindja 1899; diplomuar në shkenca politike në Universitetin e Harvardit, ShBA; zv.konsull i Shqipërisë në Neë York, ShBA, gjatë periudhës 1922-1925; në ekzil më 1938; i bashkohet Luftës Nacionalçlirimtare; pjesëmarrës në Kongresin e Përmetit; sekretar i Presidiumit të Këshillit Antifashist për Çlirimin e Kombi Shqiptar. Pjesë e stafit të ambasadës janë edhe: Gaqo Nasto, sekretar i parë; Sadik Bocaj, atashe ushtarak; Selim Shpuza, atashe për shtypin.

Rusia, mbas viteve 1990: Ambasadori Cici ishte Ambasadori i parë i Shqipërisë i akreditуar në Federatën Ruse dhe në Armeni, Bjellorusi, Kazakistan, Gjeorgji dhe Uzbekistan me përfaqësuesit e të cilave zhvilloi bisedime dhe shkëmbeu nota zyrtare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

Rusia: Profil

Rusët janë shumë të kursyer në mimikë, në takime pune buzëqeshin pak dhe sytë pothuaj nuk shprehin asgjë, por dallojnë shumë mirë jetën publike nga ajo private, në mënyrë thelbësore. Rusët janë shumë mikpritës. Sipas Moran R., T. *et al*. (2007:590), e njëjta gjë mund të thuhet edhe për liderët e vendit. Nëse ju ftojnë për drekë, përgatituni, - drekat e tyre janë të gjata dhe me shumë ushqime e pije, që shtohen periodikisht kur pjatat janë bosh; dollitë, bisedat dhe të qeshurat janë pjesë e procesit. Por evitoni zhurmat gjatë ngrënies, - përplasja e pirunit ose lugës në pjatë quhet mungesë edukate. Komunikimi thjeshtëzohet nëse flisni rusisht, ndonëse pjesa më e madhe flasin frëngjisht, një kulturë e trashëguar që nga koha e Carit dhe e përjetësuar në karakteristikat e një personi që kërkon të etiketohet si intelektual. Rusët përdorin shumë emrin e mesit, që në përgjithësi është një zgjatim i emrit të parë të babait, për shembull Ivanoviç do të thotë djali i Ivanit. Gratë i shtojnë një a emrit të mesit dhe mbiemrit, që do të thotë se Ivanoviçi bëhet Ivanova, pra vajza e Ivanit. Përdorimi i emrit në këtë formë tregon familjaritet. Duket se kemi shumë gjëra të përbashkëta me ta, për sa kohë që gjatë marrëdhënieve të viteve ‘50, shumë prej shqiptarëve u kthyen të martuar me gra ruse. Mbrëmjet e të shtunave në Hotel “Dajti” gjatë viteve ‘60, me muzikë e vallzim, mbahen mend jo vetëm për muzikën ruse që luhej vazhdimisht, por edhe sepse pjesa më e madhe e frekuentuesve kishin studiuar në Rusi ose në lindje.

Rusët pëlqejnë modën, veshjet cilësore dhe komfortin, por në takime pune janë shumë konservatorë. Respektojnë me fanatizëm çdo marrëveshje të shkruar. Kanë një sistem shumë të mirë edukativ, veçanërisht në shkenca të sakta, një kulturë jashtëzakonisht të pasur dhe kontribute të çmueshme në art.

VASIL NATHANAILI

Sekretar i parë i Legatës së Republikës së Shqipërisë në Beograd, Jugosllavi.
Periudha: 1945, 13 nëntor -1947, shkurt

I dërguar i jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë i R.P.Sh pranë Presidiumit të Sovjetit Suprem të Republikave Socialiste Sovjetike, Moskë.
Periudha: 1949, tetor -1953

Ministër fuqiplotë i R.P.Sh në Sofie, Bullgari.
Periudha: 1953, gusht-1954

Ambasador i Jashtëzakonshëm e Fuqiplotë i R.P.Sh, në Pekin, R.P. Kinë.
Periudha: 1966, 18 mars – 1969, 7 janar

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i R.P.Sh në Mbretërinë e Kamboxhias (jorezident).
Periudha: 1966, 16 maj – 1969, 7 janar



Photo credit: Arkiva personale, Petrit Nathanaili.




Foto e marrë më 1967. Nga e majta, i dyti dhe në vijim: Lin Biao, Shefqet Peçi, Mao Zedong, Kryetar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ambasadori ynë Vasil Nathanaili, Zhou Enlai.
Photo credit: Arkiva personale, Petrit Nathanaili.

Datëlindja: 24 shtator 1916
I biri i Janit dhe Kleopatrës.

Vendlindja: Dhrovjan, Delvinë, Gjirokastër.

Nënshtetësia: Shqiptar, Ortodoks.

Diplomë: Juridik, Universiteti i Tiranës.

Gjuhët e huaja: Greqisht, frëngjisht, italisht, rusisht.

Ndërron jetë: 13 prill 1984.

Bashkëshortja: Kleopatra (Mano).

Fëmijët: Petrit, Zana.

Shkollën fillore e kryen në vendlindje, në greqisht e shqip.

1930 Ndërron jetë i jati, Jani, mjek. Shkollën e ndjek me shpenzimet e të vëllait, Andrea, nëpunës shteti.

1930-1938 Ndjek Liceun francez të Korçës, me shpenzimet e të vëllait, Andrea, nëpunës shteti.

> Në këtë periudhë: 1934 merr pjesë në protestën e zhvilluar për kushtet dhe ushqimin e keq në internat, së bashku me 3 shokë të tjerë. E përjashtojnë nga Liceu për 3 muaj. 1935 Për 3 muaj, anëtar i grupit të Niko Xoxes. 1936 Pjesëmarrës në grevën e Korçës.

1938-1941 Për katër vjet, me bursë të shtetit Italian, ndjek studimet universitare pranë Universitetit të Romës (Sot: Universiteti i Romës "La Sapienza") në mjekësi.

1941, shkurt I ndërpritet bursa në universitet për pjesëmarrje në grupet antifashiste. Në prill arrestohet për 24 orë për shkak të veprimtarisë e përfshirjes në grupet antifashiste. Në qershor kthehet në atdhe.

1941, dhjetor-1943, mars Ndihmës sekretar, pranë zyrës së statistikës, Tiranë.

Anëtar i "Grupit të Korçës"

1941, 8 nëntor Anëtar i Partisë Komuniste të Shqipërisë; një nga 200 komunistët e parë.

1942 Anëtar i Komitetit Qarkor të Tiranës, i ngarkuar me problemet e agjitacionit dhe propogandës dhe, më vonë, Sekretar Organizativ i Komitetit të qarkut Tiranë. Njihet me pseudonimin "Shoku Rosho".



Pragë, tetor 1950. Konferenca e Ministrave të Jashtëm të Vendeve të Demokracive Populllore për problemin gjerman. Fjala e hapjes dhe prezantimi i problemit mbahen nga përfaqësuesi i Shqipërisë, ambasadori ynë në Moskë, Vasil Nathanaili. *Photo credit: Arkiva personale, Petrit Nathanaili.*

Emërimi si Ambasador – shkresa përcjellëse.

RPSh Tiranë, më 22.7.1966

Ministria e Punëve të Jashtme
Dega Administratë - Kuadër / Nr. 600

Shokut Vasil Nathanaili

Ju njoftojmë se me vendim të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSh, nr. 56, datë 18/3/1966 emëroheni Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i R.P. të Shqipërisë në Republikën Populllore të Kinës. Rrogën bazë do ta keni 1200 lek në muaj. Marrëdhëniet financiare me detyrën e re fillojnë nga data e mbërritjes në përfaqësi.

Ministri / (Nesti Nase) / (Firma, vula)

1943, shtator Zv. Komisar në Brigadën III.

1943,1-2 gusht Pjesëmarrës në takimin që u zhvillua në Mukje, pranë Krujës, si përfaqësues i Frontit Nacionalçlirimtar.

1944, maj Pjesëmarrës në Kongresin e Përmetit.

1944, qershor Zëvendës komisar i Brigadës XII sulmuese.

1944, nëntor-1945, nëntor Sekretar i Përgjithshëm pranë Ministrisë së Shëndetësisë.

1945, 27 nëntor -1947, shkurt Sekretar i parë i Legatës Shqiptare në Beograd, Jugosllavi. Shkresa A.XVII 622/ IV. Rroga: 1500 franga shqiptare/muaj. Fillon punë më 1 dhjetor 1945.

1947, shkurt-1948, nëntor Shef Seksioni për tratativat, Ministria e Punëve të Jashtme.

1947, qershor Për një muaj është në Zvicër, në mbledhjen e Bankës Ndërkombëtare.

1948, nëntor - 1949, nëntor Ndihmës Ministër, Ministria e Punëve të Jashtme.

1948, korrik Për një muaj është në Zvicër, në Asamblenë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

1949, nëntor Ministër Fuqiplotë në Moskë.

1949 Anëtar i Komitetit të Partisë të qytetit Tiranë dhe anëtar i Këshillit Popullor të qytetit Tiranë.

1949, tetor. Ambasador në Moskë. Me dekretin nr. 946, datë 29.10.'949 të Presidiumit të Kuvendit Populllor. Kryeministri: Gjeneral Kolonel Enver Hoxha. Shkresa përcjellëse e Kryeministrisë pranë Ministrisë së Jashtme mban datën

Çmime, vlerësime

Urdhërin *Kujtimi i çlirimit*

1962, 3 shtator *Urdhërin e lirisë* së klasit III Me vendim nr. 3559, me rastin e 45 vjetorit të lindjes, me motivacion: *Për besnikëri dhe kontribut të vlefshëm në luftën për çlirimin e Atdheut.*

1949, 26 nëntor Urdhërin *Ylli partizan* i klasit III Me vendim nr. 330.

1947, 22 dhjetor *Medaljen e kujtimit* Me vendim nr. 5854.

1946, 8 maj *Medaljen e çlirimit* Me vendim nr. 940.

1949, 26 nëntor *Urdhërin e Flamurit* i klasit III Me vendim nr. 254.



Kinë, 1967. *Photo credit: Arkiva personale, Petrit Nathanaili.*

Lirimi nga detyra si Ambasador – shkresa përcjellëse.

Republika Popullore e Shqipërisë
Tiranë, më 17.1.1969

Ministria e Punëve të Jashtme
Dega Administratë - Kuadër / Nr. 40

Shokut Vasil Nathanaili

Tiranë

Ju njoftojmë se me vendim të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSh, liroheni nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të R.P. të Shqipërisë në Pekin dhe transferoheni në Atdhe.

Duke filluar nga data 7.I.1969 emëroheni këshilltar në rang zv. Ministri pranë kësaj ministrie, me rrogë 1500 lekë/muaj.

Ministri / (Nesti Nase) / (Firma, vula)

* * *

1984, 13 prill Vasil Nathanaili ndahet nga jeta.

Për fjalën e rastit, nekrologjia përgatitet nga: Ramiz Alia, Manush Myftiu, Foto Çami, Nexhmije Hoxha, Reis Malile, Jashar Menzelxhiu, Shahin Ruka, Sofo Lazri, Sokrat Plaka, Siri Çarçani, Shefqet Musaraj, Zeqi Agolli dhe Veiz Gjebero. Aprovuar nga: Mihal Bisha.

5.XI.1949, nr. protok. 134/99.

1953, 1 gusht Ministër fuqiplotë në Sofie, Bullgari. Rroga: 10.500 lekë/muaj. Me vendim të Sekretariatit të KQPPSh, nr. 357, datë 21.9.'953.

1954, 1 maj Zv. Ministër në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Ministër Behar Shtylla. Me vendim të Byrosë Politike, nr. 89, datë 25.3.'954.

1956 Anëtar i Kolegjiumit të Ministrisë së P. Jashtme, së bashku me Halim Budo, Dhimitër Lamani dhe Musin Kroi. Nga data 1 prill 1956, të gjithë anëtarët e kolegjiumit përfitonin një shpërblim prej 1000 lekë/muaj.

1966, 14 prill Prezanton letrat kredenciale si Ambasador i Jashtëzakonshëm e Fuqiplotë i Republikës Popullore të Shqipërisë, në Pekin, Republika Popullore e Kinës

1966, 16 maj. Emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Kamboxhias.

1969, 7 janar Këshilltar në rang zv. Ministri, MPJ, Tiranë.

1970, 21 dhjetor Përfundon një vizitë shëndetësore në Itali. Sipas epikrizës të dërguar nga mjeku italian, Prof. Mario Gazano, përcjellë në Shqipëri nga ambasadori ynë në Romë Ksenofon Nushi,vuan nga një "depresion ciklik, por mbas kurave të bëra gjendja e tij është në përmirësim... ka sensibilitet të theksuar".

1975, 1 korrik Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Jashtme. Rroga bazë 920 lekë/muaj.

1975, 1 gusht Pension pleqërie të jashtëzakonshëm.

Pasioni/ Hobi: Gjuetia.

KONCEPT

SHTETI SHQIPTAR
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
A.XVIII.622

Tiranë, më 13.XI.1945
V.F.- L.P

KRYEMINISTRIS
Tiranë

Në vendin vakant të Legatës sonë në Beograd, propozojmë emrimin e z. Vasil NATHANAILI, me cilësi si Sekretar Legate i klasit të I-rë. Me qënë se paraqitet nevojë e ngutëshme për plotësimin e këtij vendi, Ju lutemi që pëlqimi eventual për emrimin në fjalë të dalë sa më parë.

Ministri i P. të Jashtme / D.V. (firma)

Më 24 shtator 1980, Vasil Nathanili harton për qeverinë shqiptare një draft tezë me disa variante mbi mundësinë për gjetjen e rrugëve më të përshtatshme për kthimin e arit monetar në vend. Teza mbeti gjithmonë një draft. "Epopeja" e arit vazhdoi të mbetej një legjendë.

Në lidhje me bisedimet eventuale me Anglinë për kthimin e arit monetar dhe normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve

Vasil Nathanaili

Bisedimet të bëhen direkt midis përfaqësuesve të posaçëm të dy vendeve; variantet të shtrohen në faza konsekutive dhe në një vend të përshtatshëm, si për shembull Parisi. Kjo procedurë zhvillimi e bisedimeve bëhet në mënyrë që t'i jepet serioziteti maksimal çështjes. Shumë e rëndësishme është zgjedhja e kujdesshme e emrave për negociim. Synimi është që pala angleze të detyrohet t'i shkojë deri në fund zgjidhjes së çështjes, ose të paktën të zbulohen qëllimet e saj finale.

Është e kështillueshme të shihen mundësitë, - deri ku mund të shkohet me anën e një kompromisi të arsyeshëm, pa cënuar parimin e kthimit të arit dhe pa njohur vendimin e Gjykatës së Hagës për shpërblim nga ana jonë. Anglezët mbrohen me vendimin e Komisionit Tripalësh që u njeh atyre të drejtën e bllokimit të arit tonë. Në fakt, në këtë situatë, anullimi i këtij vendimi nuk është i mundur, sepse as anglezët dhe as amerikanët, për arsye të ndryshme, nuk janë disponibël. Nga ana tjetër, edhe francezët nuk kanë as mundësinë dhe as kurajon për të ndërmarrë një angazhim të tillë. Këto pengesa duhen kapërcyer, duke i mënjanuar në një farë mënyre. Procedura e propozuar na jep mundësinë të hyjmë në thelbin e çështjes, pra me bisedime direkte e propozime konkrete. Në çastin e përshtatshëm, kur të jemi të bindur se bisedimet kanë arritur në një fazë konkrete, mund të kërkohet ndihma e qeverisë franceze. Propozoj që një mjet tjetër të jetë edhe sondazhi nëpërmjet kanaleve diplomatike, direkt me anglezët, ose me ndërmjetësimin e francezëve, - gjithmonë nëse pala angleze është e gatshme të pranojë një të tretë në këto bisedime. Rendi i ditës të formulohet në mënyrë të përgjithshme: "Çështja e kthimit të arit monetar Shqipërisë dhe normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve".

Varianti i parë: Anglia të kthejë arin pa kushte

Në këtë variant, të dy shtetet vihen në kushte të barabarta, sepse Shqipëria është e cënuara me bllokimin e arit. Dy shtete sovrane duhet të jenë të barabartë. Në këtë variant, çështja nuk ka pse të lidhet me shpërblimin sipas Komisioni Tripalësh, sepse janë dy çështje të veçanta, të shkëputura. Nuk mund të pranohet imponimi nga njëra palë. Ari është mbajtur arbitrarisht dhe Komisioni Tripalësh nuk ka dhe as nuk ka pasur ndonjë kompetencë për t'i dhënë Anglisë një të drejtë të tillë. Në këtë rast, Komisioni Tripalësh ka marrë kompetencat e një gjykate angleze.

Nuk ka kuptim që edhe sot, pas 34 vjetësh, të mbahet një gjendje jonormale ndërmjet dy vendeve. Duhet eliminuar shkaku. Nëse një variant i tillë funksionon, rivendosen marrëdhëniet diplomatike ndërmjet dy vendeve dhe krijohen kushte për relata normale ndërmjet dy qeverive.

Varianti i dytë: Anglia të kthejë arin, por me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike palët mund të ngrenë, po në rrugë diplomatike, çështje të mbetura pezull në marrëdhëniet ndërmjet tyre. Të hidhet poshtë pretendimi anglez për shpërblim, domethënë njohja e vendimit të Gjykatës së Hagës si kusht paraprak. Në këtë formulë të përgjithshme nuk mbyllet rruga dhe i jepet mundësi palës angleze të dalë nga qëndrimi i saj i ngurtë dhe të ruajë formalisht, deri-diku, prestigjin, rrjedhojë e qëndrimit të deritanishëm. Pra, anglezëve u ofrohet një lloj kënaqësie se po respektojmë pretendimet e qëndrimet e tyre. Ndërkohë, pala shqiptare çdo angazhim konkret e ka shtyrë për një kohë të dytë. Në këtë variant, mund të ngrehen pretendime edhe për interesat që ka përftuar Anglia nga mbajtja e arit monetar.

Varianti i tretë: Anglia të kthejë arin, por me vendosjen e marrëdhënieve diplomatike palët mund të ngrenë, po në rrugë diplomatike, çështje të mbetura pezull në marrëdhëniet ndërmjet tyre. Nga pala shqiptare të ngrihet pretendimi për interesa nga mbajtja



Foto e marrë më 1948, Delegacioni shqiptar në Gjenevë (nga e majta: Vasil Nathanaili, Behar Shtylla dhe Sherif Klosi). *Photo credit: Arkiva personale, Petrit Nathanaili.*

arbitrare e arit.

Të pranohet reciprokisht që, si kërkesa angleze për shpërblim, edhe ajo shqiptare për interesa, të konsiderohen në mënyrë të heshtur (*tacite*) të paqena. Aftësisht dy shumat kompensohen. Kjo nuk presupozon, as indirekt, se ne njohim vendimin e Gjykatës së Hagës për shpërblim, sepse duke e lënë në heshtje kërkesën tonë për interesa ne nuk prekim në thelb parimin e kthimit të arit pa kushte sipas vendimit të Komisionit Tripalësh, kurse çështja e interesit është një mbishtesë, një rrjedhë e mëvonshme.

Nga ana tjetër, edhe pala angleze mund të pretendojë për interes për të hollat që ka shpenzuar për dëmet e pasuara nga anijet e dëmtuara, si dhe për shpërblimin e marinarëve (fitim i humbur). Por, sidoqoftë, është e pamundur që pala angleze të pranojë të paguajë interesa, sepse është një shumë e madhe dhe, për këtë, do përpiqet të gjejë e sjellë lloj-lloj arsyesh, juridike e financiare, gjë që duhet pasur mirë në vëmendje. Pra, argumenti i interesit të përdoret si presion, si kundërpeshë ndaj kërkesës angleze për shpërblim, ose si "pazarllëk" gjatë bisedimeve, që ta detyrojmë palën angleze të tërhiqet nga pretendimi për shpërblim.

Varianti i katërt (si "fillim" për variantin e tretë): Të ftohet Franca si negociatore për bisedime, një shtet që ka marrëdhënie të mira me Anglinë e Shqipërinë dhe, në të njëjtën kohë, anëtare e Komisionit Tripalësh. Franca mban përgjegjësi që ka pranuar kërkesën e Anglisë. Franca ka bërë një padrejtësi të madhe ndaj Shqipërisë. Duke e ftuar në rolin e negociatorit i ofrohet mundësia të korrigjojë një veprim të padrejtë. Francës duhet t'i bëhet me dije se votimi saj në Komision në favor të Anglisë është një *minus* në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Shqipëria nuk mund ta harrojë një padrejtësi të tillë, padrejtësi që ka cënuar rëndë interesat e saj. Në këtë variant duhet të kihet parasysh tendenca që po shfaqin shumë vende perëndimore për të normalizuar marrëdhëniet me ne, gjë e cila mund të influencojë e lëkundë qëndrimin e Anglisë. Sigurisht që të dy vendet, për të gjitha bisedimet e arritjet gjatë tyre do i'a bëjnë me dije edhe Amerikës, si palë e tretë në Komisionin Tripalësh, në mos do kërkojnë edhe të konsultohen.

Roli i Francës në përshpejtimin e përfundimit të një *ujdie* të pranueshme për të dyja palët do të kufizohet në një ndihmë dashamirëse (bons office). Me shpresën se Franca do e pranojë një rol të tillë, variant i tretë mund të pasurohet me elementë të tillë, për shembull, me arin e kthyer të angazhohemi që do blejmë mallra në Angli. Anglia ka nevojë për eksporte dhe valutë. Pra, Anglia e depoziton arin në një bankë angleze në emrin e qeverisë shqiptare dhe tregtia ndërmjet dy vendeve bëhet nëpërmjet kësaj banke. Duke u angazhuar me një detyrim të tillë, e kemi të lehtë të bindim edhe Francën se qeveria shqiptare po bën maksimumin e përpjekjeve konstruktive në favor të zgjidhjes së çështjes.

Arkivi Qendror Shtetëror, Fondi 14/AP, V. 1949, D.617, fl.1-3.

Mbi disa pikëpamje të gabuara sa i takon marrëdhënieve ekonomike të vendosura ndërmjet Shqipërisë me vendet e "Demokracive Popullore".

Shkëputur dhe përmbledhur me shkurtime nga një proces-verbal takimi ndërmjet Enver Hoxhës dhe Vasil Nathanailit

Nga proces-verbali i dt. 5.03.1949, i mbajtur për bisedën e zhvilluar ndërmjet kryeministrit, Enver Hoxha, me zv. Ministrin e Punëve të Jashtme, Vasil Nathanaili, në zyrën e kryeministrit, i kërkohet Nathanailit të shprehë edhe një herë pikëpamjet e tij mbi marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe disa vendeve të Demokracive Popullore, të cilat duket se ky i fundit duhet t'i ketë trajtuar në burime ose grupe të pasigurta. Sipas këtij proces-verbali del se disa funksionarë qeveritarë me përgjegjësi, përfshirë Nathanailin, kanë shfaqur pikëpamje që shprehin rezerva dhe pakënaqësi ndaj vendeve të Demokracive Popullore të cilat, sipas tyre, nuk po e ndihmojnë sa duhet Shqipërinë. Në gjykimin e tyre, Këshilli Ekonomik (*fjala është për KNER-in*) duhet t'i ndreqë këto çështje dhe Shqipëria të ndihmohet. Po sipas tyre, në shumë prej këtyre vendeve, si p.sh. Hungaria, ka bollëk ndërsa në Shqipëri nuk ka. Për më tepër, Polonia tregohet e shtrënguar në dhënien e fabrikave. Për ta duket i papranueshëm fakti që Bullgaria e merr naftën nga Shqipëria me çmime të lira dhe e shet atë në Itali më shtrenjt, prandaj do ishte mirë që Shqipëria t'ia shiste vetë direkt naftën Italisë.

Këto pikëpamje, me të cilat pjesërisht është bashkuar dhe zv. ministri Vasil Nathanaili, Enver Hoxha i kërkon t'ia paraqesë edhe personalisht. Por Hoxha i gjykon të gabuara, - gjë që ja thotë edhe Nathanailit, - dhe i cilëson jo në përputhje me vijën e partisë: "*janë të dëmshme pasi godasin direkt kampin demokratik" (cituar nga proces-verbali).*

Po sipas proces-verbalit të takimit që gjendet në Arkivin Qendror Shtetëror (shih burimin), Hoxha argumenton se: BRSS dhe "Demokracitë Popullore", pa ndihmën e të cilave ne nuk jetojmë, na japin kredi, ndërsa ju propozoni që ne t'ua shesim naftën amerikanëve. Kjo tregon se ju keni shkuar shumë larg, - i drejtohet ai Nathanailit. *"*Nën maskën e demokracisë partia nuk lejon diskutime jashtë vijës së saj*"*, dhe e paralajmëron se "diskutimi i këtyre gjërave jashtë vijës së partisë konsiderohet nxjerrje në shesh e sekretit shtetëror, që të çon direkt në Gjyq Ushtarak".

Fletë-Anketë e nëpunësit

Në fletë-anketën e nëpunësit, plotësuar nga Vasil Nathanaili më 19.4.1952 janë shkëputur disa rubrika, gjithmonë në funksion të shpalosjes së figurës së tij, si dhe për të krijuar një ide se çfarë duhej të deklaronte një person për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore.

Rubrika: Profesioni ose specialitetet që ke fituar në shkollë, ose në praktikë me punë.

V. Nathanaili*: Nuk kam fituar ndonjë profesion.*

Rubrika: A ke marrë pjesë në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, në ç'formacion (nga ç'datë deri në ç'datë), ç'funksion e grada ke pasur dhe a je plagosur?

V. Nathanaili*: Anëtar i grupit të Korçës dhe i Partisë Komuniste Shqiptare. Me urdhër të Komitet Qendror të Partisë jam hedhur partizan dhe kam qenë në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare gjatë periudhës nëntor 1943-nëntor 1944. Kushërinjtë e mi në Muzinë kanë qenë të lidhur me luftën.*

Rubrika: Me ç'punë janë marrë prindërit para okupacionit të prillit 1939, gjatë okupacionit prej 1939 deri në nëntor 1944 dhe mbas çlirimit?

V. Nathanaili*: Im atë deri në vdekjen e tij, më 1932, ka qenë mjek privat. Nëna gjithmonë shtëpiake.*

Rubrika: Ke ndonjë nga familja jashtë shtetit, çfarë lidhje familjare kanë me ty, në ç'vend janë, kur dhe pse kanë shkuar, ç'punë bëjnë, ç'nënshtetësi kanë dhe çfarë lidhje ke me to.

V. Nathanaili*: Nipi im, Pavllo Nathanaili, vjeç 17, ndodhet në Egjipt së bashku me nënën e tij, pranë familjes së nënës. Pjesëtarët e familjes kanë pasur korrespondencë me të. Burri i motrës, Jorgji Nako, më prill 1944 ka ikur në Greqi ku ndodhet edhe sot.*

Rubrika: A të është marrë gjë nga reformat e shtetit popullor, çfarë sasie toke ose pasurie dhe kur të është marrë?

V. Nathanaili*: Nga reforma agrare më është marrë një kopësht i vogël në fshat.*

Jugosllavia dhe çështje të trajtuara nga Ministria e Jashtme në marrëdhënie me të

Gjatë kohës që Vasil Nathanaili ushtronte detyrën e Sekretarit të Parë të ambasadës tonë në Jugosllavi, çështjet kryesore të trajtuara nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë në marrëdhëniet me Jugosllavinë (sipas protokollit dhe arkivës të kësaj ministrie) paraqitet në mënyrë të detajuar, në tabelën më poshtë, tematika e tyre, shënuar me kryq poshtë vitit përkatës.

Burimi: Fondi i arshivës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Vitet 1945, 1946 Jugosllavia.

Çështja	1945	1946
Mbi marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve.	x	
Mbi riatdhesimin e shtetasve ndërmjet dy vendeve.	x	
Mbi gjetjen e eshtrave të Nikolla Gojcevič, vrarë në Shqipëri në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.	x	
Mbi dekorimin e personaliteteve shqiptare nga qeveria Jugosllave.	x	
Mbi problemet e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy vendeve në kuadrin e marrëdhënieve dhe jashtë tyre.	x	
Mbi hapjen e një llogarie të veçantë në bankën tonë për Legatën Jugosllave të një shume prej 18.000.000 fr.	x	
Mbi shtypjen e një sasie pullash dhe kartolinash në Jugosllavi.	x	
Mbi dimërimin e bagëtive në Kosovë.	x	
Probleme me punimin e tokave në zonat tona kufitare.	x	
Korrespodencë ndërmjet dy qeverive mbi rregullimin e trafikut kufitar dhe nënshkrimin e një marrëveshje.	x	
Mbi pasuritë shqiptarë në Jugosllavi dhe anasjelltas.	x	
Mbi shoqatën e miqësisë në Jugosllavi.	x	
Ftesa dhe pjesëmarrja jonë në Kongresin e Mjekëve Ushtarakë në Beograd.	x	
Projekt-Marrëveshje mbi PTT dhe radion ndërmjet dy vendeve.	x	
Mbi një marrëveshje ndërmjet dy vendeve për riatdhesimin e shtetasve shqiptarë që ndodhen jashtë.	x	
Mbi projektin e "Traktatit të Miqësisë" dhe "Ndihmës Reciproke" ndërmjet dy vendeve.	x	
Lista e marrëveshjeve ndërmjet dy vendeve.	x	
Mbi vizitën e delegacionit shqiptar të kryesuar nga shoku Enver Hoxha në Jugosllavi.		x
Çështje të ndryshme me rëndësi në marrëdhëniet me Jugosllavinë.		x
Raporte të Legatës në Beograd mbi çfarë shkruan shtypi jugosllav.		x
Mbi çështje të ndryshme të riatdhesimit dhe kërkesa për ekstradim.		x
Mbi kërkime eshtrash të partizanëve tanë vrarë në Jugosllavi dhe të humburve etj.		x
Mbi dëmet nga përmbytjet në vendin tonë.		x
Mbi dekoratat jugosllave dhënë disa qytetarëve shqiptarë.		x
Mbi marrëveshjet dhe protokollet për shkëmbime tregtare ndërmjet dy vendeve.		x
Mbi çështje të veçanta ekonomike në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve.		x
Mbi çështje të marrëdhënieve me Jugosllavinë në fushat bujqësore dhe të metereologjisë.		x
Mbi shkëmbime specialistësh të veterinarisë dhe polombarëve.		x
Mbi çështje të transportit detar me Jugosllavinë.		x
Mbi ankesën e katundit Kllobçisht për ujin që nuk i jep katundi Banisht (praktikë e filluar në vitin 1939).		x

Çështja	1945	1946
Mbi çështje të pasurive ndërmjet dy vendeve.		x, x
Mbi pasuritë e Nikolla Siliqit (vazhdim nga paralufta).		x
Shkëmbim notash me legatën jugosllave lidhur me përfundimin e një marrëveshje kulturore.		x
Mbi shkëmbimet kulturore në fushën e shkrimtarëve, teksteve shkencorë, filma, arte të bukura dhe studimin e tërmetit të vitit 1905 në Shkodër.		x
Ftesë nga pala jugosllave për Kongresin I të Shkrimtarëve dhe Inxhinierëve.		x
Mbi botimin, në formën e librit, të proces-verbaleve të seancave të gjyqit kundër Organizatës Nacionalçlirimtare Shqiptare në Shkup, në vitin 1946.		x
Mbi traktatin e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke me Jugosllavinë 9.VII.1946.		x
Mbi marrëveshjen e bashkëpunimit ekonomik me Jugosllavinë, 12.7.1946.		x
Mbi traktatin e koordinimit të planeve ekonomikë dhe barazinë e monedhave 27.12.1946.		x
Mbi marrëveshjen për krijimin e bankës së përbashkët shqiptaro-jugosllave.		x
Mbi protokollin për shkëmbimet tregtare, marrëveshjet mbi pagesat, protokollin për cedimin e kredive në dollarë.		x
Mbi marrëveshjet për krijimin e shoqërive shqiptaro-jugosllave, mbi derdhjen e kapitaleve themelore, mbi krijimin e shoqërive për shfrytëzimin e naftës, mbi shoqëritë elektirke, mbi ndërtimin e një centrali hudraulik në Kuçovë.		
Mbi marrëveshjet për krijimin e shoqërive për shfrytëzimin e minierave dhe ndërtimin e hekurudhave.		x
Mbi marrëveshjet për trafikun e kombëtar ndërmjet dy vendeve.		x
Mbi marrëveshjet postale dhe telegrafonike ndërmjet dy vendeve.		x
Mbi shkëmbimin e notave ndërmjet dy vendeve lidhur me marrëdhëniet në fushën e veterinarisë.		x
Mbi protokollin për personel teknik e specialistësh në Jugosllavi.		x




Foto e marrë më 28 nëntor 1949, Moskë, me rastin e paraqitjes së letrave kredenciale. Nga e majta, i treti, Shvernik, Kryetar i Presidiumit të BRSS; i katërti, Ambasadori Vasil Nathanaili; i gjashti, Reis Malile. *Photo credit: Arkiva personale, Petrit Nathanaili.*

TEODOR LAÇO

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Federatën Ruse.
Periudha: 2006-2008

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Kazakistan, Biellorusi, Uzbekistan (jorezident).
Periudha: 2006-2008



Datëlindja: 27 shtator 1936.

Vendlindja: Dardhë, Korçë.

Diplomë: Agronom, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Gjuhët e huaja: Rusisht, italisht, anglisht.

Bashkëshortja e parë: Loreta Balli (ndërruar jetë).

Bashkëshortja e dytë: Mirjana Deti, aktore.

Fëmijët: Pandi, Bledi.

Motoja: "Altrusit, sipas thënies popullore Bëje të mirën dhe hidhe në det. Në s'ta ditshin peshqit, ta di zoti vetë".

Laço ka bërë të vetën edhe një thënie të Senekës: *Duro, ashtu si duron atë që nuk ndryshon dot.*



Foto e marrë më 10 tetor 1998. Ambasadori Piro Milkani i dorëzon letrat kredenciale Presidentit të Republikës Çeke, Václav Havel.

1954-1958 Kryen studimet për agronomi pranë Insitutit të Lartë Bujqësor, Kamëz.

1958-1960 Agronom në seksionin e bujqësisë të Komitetit Ekzekutiv, rrethi Korçë.

1960-1964 Pedagog i lëndëve profesionale (Bujqësi, Darvinizëm, Praktikë Bujqësore) në Bilisht (shkollë eksperimentale me profil bujqësor).

1963-1964 Mësues pranë Shkollës Pedagogjike, Korçë.

1964-1970 Përgjegjës i sektorit të manipulimit të duhanit, ndërmarrja e Grumbullimit, Korçë.

1967-1970 Kryetar i Degës të Shkrimtarëve dhe Artistëve, Korçë.

1970-1975 Shkëputet nga profesioni dhe i kushtohet letërsisë. Deri në këtë kohë kishte botuar tri libra. Transferohet në Tiranë në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, instruktor në seksionin e letërsisë.

1975-1982 Transferohet në Fier, ndryshe "qarkullohet", një lloj dëbimi i kohës me të cilën "shpërbleheshin" figurat më të spikatura për ide e vizione në kundërshtim me ato të regjimit. Në rastin e Laços, për shkak të librit me tregime "Ajri i ftohtë i mesnatës" (1973) dhe novelës "Ditë dhe netë që mund të

Romane

- 2014 *Gropas '67*. Tiranë: Tirana Times, 399 f.
- 2009 *Mjegull*. Tiranë: Tirana Times, 344 f.
- 2007 *Vrasja e buzëqeshjes*. Tiranë: Toena, 200 f.
- 2004 *Ishulli i mëkatarëve*. Tiranë: Toena, 178 f.
- 1995 *Një vit i hidhur*. Elbasan: Onufri, 338 f.; *Ribotuar*, 1997 me titull *Anul tristeţii*, përkthyer në rumanisht nga Marius Dobrescu, Bukuresht: Mavios-Clio, 256 f.
- 1990 *Pushimet e kolonelit*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
- 1986 *Të gjithë lumenjtë rrjedhin*. Çmimin "Migjeni".
- 1981 *Korbat mbi mermer*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 284 f.
- 1978 *Lëndina e lotëve*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri". *Ribotuar* në frëngjisht nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
- 1975 *Përballimi*. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 317 f. Me këtë libër ka fituar "Çmimin e Republikës". *Ribotuar* në anglisht nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
- 1971 *Tokë e ashpër*. Novelë. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".

Vëllime me tregime

- 2010 *Statusi i qenit*. Tregime satirike. Tiranë: Toena, 214 f.
- 2005 *Valsi i hënës*. Tregime të zgjedhura. Tiranë: Toena, 300 f.
- 2003 *Trokitje në shpirt*. Tregime. Tiranë: Mësonjëtorja, 238 f.
- 2000 *Vdekja e nëpunësit X*. Tregime. Tiranë: Toena, 248 f.

vijnë" (1974). Përmbajtja e tyre u kritikua për mungesë realizmi dhe "rrëshqitje" nga vija. Librat u hoqën nga qarkullimi. Rekomandohet nga Organizata e Partisë si mësues në Shkollën Bujqësore, Libofshë. Drejtuesit e rrethit e emërojnë libretist në Teatrin "Bylis" të qytetit, bashkëpunim i cili ndikoi pozitivisht në arritjet e Teatrit.

1982-1986. Rikthehet në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve si përgjegjës i seksionit të talenteve të reja.

1986-1991, korrik Shef i Redaksisë së Filmit Artistik në Kinostudion "Shqipëria e Re", ku drejton përgatitjen e skenarëve për 14 filma artistikë në vit, si dhe drejton shumë kurse për përgatitjen e regjisorëve e skenaristëve të rinj.

20 Korrik 1990 Një nga protagonistët kryesorë të mbledhjes së krijuesve të Kinostudios, në polemikë me të dërguarin e Komitetit Qendror të PPSh, Foto Çamin. Laço flet për vrasjet në kufij, për kreditë e huaja etj. Mbledhja cilësohet nga opinioni publik si "Skandali i Kinostudios"dhe ishte një nga ato ngjarje që paraprinë "Lëvizjen studentore" në Dhjetor të atij viti.

1991, janar-1992, korrik Emërohet drejtor i Kinostudios "Shqipëria e Re". Me propozimin e Laços u quajt "Albafilm" Studio.

1991, janar Bashkë me disa intelektualë të tjerë të fushave të ndryshme është në grupin nismëtar prej 12 vetash për krijimin e Partisë Social-Demokrate. Partia miratohet në fund të muajit mars dhe nuk arrin të marrë pjesë në zgjedhjet e para pluraliste. Shoqëron të dërguarin e Socialdemokratëve gjermanë, Peter Rauschenbah,



??????????

??

- 1998 *Mozaik dashurish*. Tregime. Tiranë: Toena, 207 f.
- 1991 *Tre novela*
- 1990 *Zemërimi i një njeriu të urtë*.
- 1988 *A Lyrical Tale in winter*. Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 200 pp.
- 1984 *Një dimër tjetër*. Tregime. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 277 f. *Ribotuar* 1986.
- 1984 *Ata që kemi pranë*. Tregime të zgjedhura nga talente të reja. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 267 f.
- 1980, 1 janar *The face-up*. A novel. Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 354 pp.
- 1980 *Portat e dashurisë*. *Çmimin e Republikës.*
- 1976 *Pylli në vjeshtë.*
- 1972 *Ajri i ftohtë i mesnatës*. Tregime. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 230 f. Kritikuar për nxirje të realitetit dhe veçuar për shumë kohë në "Fondin Rezervë të Bibliotekave". Për ta lexuar librin duhej autorizim i veçantë.
- 1971 *Tregime*. Zgjodhi Ramiz Kelmendi. Prishtinë: Rilindja, 174 f.
- 1969 *Një natë shiu*. Tregime. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 185 f.
- 1967 *Rruga e bardhë*. Çmimin e Republikës.
- 1965 Era e tokës. *Çmimin e tretë* në konkursin letrar për 40-vjetorin e Çlirimit.

Publicistikë letrare e politike

- 2012 *Bashkëjetesë me kohën.* Shënime politike, letrare, intime. Tiranë: Tirana Times, 399 f.

i cili përcjell mesazhin e kryetarit të Internacionales Socialiste, Vili Brandt, se PSD ka të gjitha premisat për t'u pranuar anëtare e saj. Socialistët e PS-së ende nuk besohen si të reformuar. Zgjidhet nën kryetar i Partisë Social-Demokrate.

1992, korrik -1996 Deputet. Jep dorëheqjen nga posti i drejtorit të Kinostudios, pasi zgjidhet Deputet në Kuvendin e Shqipërisë - ligji nuk lejon që deputeti të mbajë edhe funksioneve drejtuese shtetërore.

1994-1997 Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në qeveritë e kryesuara nga Aleksandër Meksi. Gjatë kohës që ushtron detyrën e Ministrit, mundëson ardhjen në Shqipëri të disa prej figurave më të shquara, si: Ernesto Sabato, Pierre Cardin, Ibrahim Kodra, Huan Antonio Samaras etj.

1994-1997 Kryetar i Partisë "Bashkimi Liberal", parti e djathtë e qendrës.

1997-2001 Deputet

2001-2005 Deputet dhe Kryetar i Grupit Parlamentar. E djathta e qendrës tani është në opozitë.


2006 Pedagog për lëndën e skenarit. Akademia e Filmit "Marubi".

2006-2008 Ambasador në Rusi, Kazakistan, Bjellorusi dhe Uzbekistan. Më 30 gusht paraqet letrat kredenciale pranë Ministrisë së Jashtme të Federatës Ruse. Në takim ishte zv. Ministri i Jashtëm, Vladimir Titov.

Pasioni / hobi: Muzika, futbolli, pokeri.

??????????

??





??????????

- 2008 *Një dritare në Kremlin. Nga Hrushovi tek Putini*. Shënime publicistike. Tiranë: Toena, 335 f.
- 2005 *Bardh' e Zi.* Shënime për dramat e Fadil Paçramit dhe kohën e tyre. Tiranë: Vatra, 189 f.
- 1998 *Kohë për të kujtuar, kohë për të harruar. Shënime politike e letrare, 1997-1998*. Tiranë: Toena, 302 f.

Drama dhe komedi

- 2011 *Beqarët*. Komedi. Teatri i qytetit Korçë.
- 2007 *Vrasësit i lamë pas*. Teatri i qytetit Vlorë.
- 2007 *Këmbanat e muzgut*. Teatri Popullor, Tiranë.
- 2006 *Këmbanat e muzgut & Vrasësit i lamë pas*. Dy drama. Tiranë: Vatra, 151 f.
- 1994 *Fryrja*. Komedi. Teatri i qytetit Korçë.
- 1984 *Shi në plazh*. Instituti i Lartë i Arteve, Tiranë & Teatri i qytetit Korçë.
- 1983 *Qyteti i akuzuar*. Instituti i Lartë i Arteve, Tiranë & Teatri i qytetit Korçë. Botohet më 1996 me titull *Qyteti i akuzuar. Një det helmi*. Drama. Tiranë: Toena, 111 f.
- 1983 *Ditë dhe njerëz. Pas heshtjes*. Drama. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 138 f.
- 1982 *Pas heshtjes*. Teatri i qytetit Durrës, Teatri "Bylis", Fier, Teatri i Shkupit, Maqedoni etj
- 1982 *Dorina*. Teatri i qytetit Durrës.
- 1981 *Plagë dhe plumba*. Dramatizim. Teatri "Bylis", Fier.
- 1980 *Vranësirë i shkurtër*. Dramë në dy pjesë. Prishtinë: Rilindja, 81 f.
- 1979 *Gryka e nëmur*. Teatri Popullor, Tiranë & dhe Teatri i qytetit Peshkopi.
- 1976 *Gjëmimi i atij dimri*. Teatri "Bylis", Fier, Teatri Popullor, Tiranë & teatri i qytetit Berat.
- 1971 *Shtëpia në rrugicë,* dramë *& Një nuse për Stasin,* komedi. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri". *Një nuse për Stasin* luhet në Teatrin Popullor, Tiranë, në Korçë dhe Prishtinë.
- 1968 *Shtëpia në rrugicë*. Vënë në skenë nga teatri i qytetit Korçë.

Çmime

- 2009-2011 Kryetar i Bordit të Filmit Artistik pranë Albafilm studio.
- 2007 *Mecenat i Shekullit*, akorduar në Moskë. Dekoratë që jepet për figura të njohura të diplomacisë dhe kulturës. Emri shënohet në një obelisk të lartë.
- 2005 Kryetar i Komisionit të Festivalit të Teatrit.
- 1987 *Çmimin e tretë* në konkursin letrar për 40-vjetorin e Çlirimit për vëllimin me tregime "Era e tokës".
- 1981 *Çmimin e Dytë* të Republikës për vëllimin me tregime "Portat e dashurisë".
- 1976 *Çmimin e Dytë* të Republikës për romanin "Përballimi".
- 1969 e deri në mbyllje Anëtar i Komitetit Drejtues të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.



???????????

- 1945 *Duke u gdhirë viti 1945*. Teatri Popullor, Tiranë & Teatri i Gjirokastrës. Dramë në dy pjesë. Botohet më 1975. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 82 f.

Përkthime

- 2003 *Një vrasje safi angleze*. Roman. Autor: Siril Hejr. Përktheu: Teodor Laço. Tiranë: Vatra, 207 f.

Skenarë filmash

- 1990 *Vitet e pritjes*. (Skenari së bashku me Esat Mysliu). Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Esat Musliu. Film Artistik.
- 1988 *Flutura në kabinën time*. Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Vladimir Prifti. Film Artistik.
- 1986 *Tre ditë nga një jetë*. (Skenari së bashku me Roland Gjoza). Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Lisenko Malaj. Film Artistik.
- 1986 *Dhe vjen një ditë*. Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Vladimir Prifti.

Film Artistik.
Filmi është shfaqur në Festivalin e Venecias në të njëjtin vit dhe është vlerësuar nga kritika italiane në një artikull të "Corriere della sera" me titull "Dall'Albania con coraggio" për subjektin që vinte në dukje tjetërsimin e njeriut nga pushteti.

- 1985 *Asgjë nuk harrohet*. Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Esat Ibro. Film Artistik.
- 1981 *Shtëpia jonë e përbashkët*. Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Ismail Zhabjaku. Film Artistik.
- 1977 *Streha e re*. Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Spartak Pecani & Vladimir Kasa. Film Artistik.
- 1976 *Përballimi*. Kinostudio "Shqipëria e re". Regjizor: Viktor Gjika. Film Artistik.
- **xxx** *Rrënjët*. Dokumentar artistik në TV.
- **xxx** *Dorina.* Film Televiziv
- **xxx** *Ditë që sollën pranverën*. Dy seri televizive.
- **xxx** *Butrinti*. Kinostudio "Shqipëria e re". Dokumentar artistik.

- 1967 *Çmimin e tretë* të Republikës për vëllimin me tregime "Rruga e bardhë".
- xxx Urdhërin *Naim Frashëri* të klasit të tretë.
- xxx Urdhërin *Naim Frashëri* të klasit të tretë.
- xxx Urdhërin *Naim Frashëri* të klasit të parë.
- xxx Urdhërin *Naim Frashëri* të klasit të parë.
- xxx Çmimin kombëtar *Migjeni* për romanin "Të gjithë lumenjtë rrjedhin".




Foto nga koncerti bamirës në sallën e madhe të Bashkisë së vjetër të Pragës.



Ngjarje & Aktivitete

Përveç ngjarjeve protokollare, si pritjet për festat kombëtare, bisedat me interes të ndërsjelltë me ambasadorë të vendeve miq, shkëmbimin e delegacioneve të Ministrive të Punëve të Jashtme, Laço veçon kontaktet e mira që ka pasur me ambasadorët e Kroacisë, Greqisë e Maqedonisë të akredituar në Moskë. Po ashtu, gjatë kohës që ushtronte detyrën e ambasadorit, ka pritur e përcjellë figura të rëndësishme të shtetit shqiptar, sikundër edhe ka marrë pjesë në shumë takime të vendeve anëtare të organizatës së Detit të Zi. Ndonëse e ka të vështirë të bëjë një bilanc të plotë të të gjithë aktivitetit të kryer, thekson se ka negociuar ose iniciuar vizitën e shumë artistëve dhe trupave artistike nga Shqipëria. Nga ana tjetër, thekson se autorë e producentë kanë sjellë veprat e tyre për të konkurruar në festivalet e shumta që zhvillohen në Rusi ose edhe thjesht për të dhënë shfaqje. Për shembull në Festivalin e Filmit të Moskës, filmi ynë "Mao Ce Dun" zgjoi interes të veçantë, ose shfaqjet e Teatrit të Korçës në St.Petersburg dhe të një trupe folklorike nga Elbasani në Susdat u pritën shumë ngrohtë nga publiku dhe media etj.

Mbledhja e komisionit të bashkëpunimit ekonomik në Moskë

Gjatë periudhës 2006-2008, shteti shqiptar ka pasur si prioritet për politikën e jashtme diplomacinë ekonomike. Në mbledhjen e komisionit të bashkëpunimit ekonomik në Moskë morën pjesë shumë biznesmenë shqiptarë dhe rusë. Biznesmenët rusë ngulmonin për hapësirë në kërkimet e naftës dhe mineraleve me ngjyrë, sepse zotëronin studime dhe harta të trashëguara që nga vitet '50-'60. Ndonëse takimi u pasua me një rritje të vogël në vëllimin e shkëmbimeve tregtare, e rëndësishme është të theksohet se marrëdhëniet nuk njohën ndonjë rritje të ndjeshme të peshës së investimeve ruse në vendin tonë dhe kryesore vazhdoi të jetë importi ynë i grurit dhe hidrokarbureve.

Gjuha shqipe në Rusi dhe Universiteti Shtetëror i Saint-Petersburg

Deri në fillim të viteve '60, marrëdhëniet Shqipëri-Bashkim Sovjetik kanë qenë më shumë se të shkëlqyera. Pjesë e tyre ka qenë edhe ofrimi i shumë bursave të studimit për studentët shqiptarë në Universitetet më të mira ruse. Një nga këta universitete, ku kanë studiuar e janë diplomuar me qindra studentë shqiptarë, është edhe ai i Universitetit të Saint-Petersburg-ut (Saint-Petersburgut, gjatë periudhës komuniste 1924-1991 ju ndërrua emri në Leningrad). Në Universitetin Shtetëror të Saint-Petersburg isha krenar të jem pjesë e aktiviteteve të zhvilluara me rastin e 50 vjetorit të degës së gjuhës shqipe, pjesë e katedrës së gjuhëve ballkanike pranë këtij universiteti. Aty mësojnë shqipen, çdo vit, rreth 20-25 studentë, disa prej të cilëve më vonë hyjnë në shërbimin diplomatik. Të pranishëm ishim edhe shumë albanologë nga vende të ndryshme të botës.

Gratë ruse të Shqipërisë

Duke vazhduar me marrëdhëniet Shqipëri-Bashkim Sovjetik, shumë nga studentët shqiptarë u martuan me vajza ruse, vajza që vinin nga familje shumë të mira, me kulturë e të sofistikuara. Por fati i shumicës prej tyre u kthye në një tragjedi të vërtetë me prishjen e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Duhet vënë në dukje se edhe në periudhat më dramatike të jetës, ato ditën të ruajnë dinjitetin e mbrojnë familjet që krijuan.

Festimi i 8 Marsit në Ambasadë, ditës ndërkombëtare të gruas, me gra ruse që kanë jetuar në Shqipëri me bashkëshortët e tyre është një kujtim që më pëlqen ta ndaj me lexuesin e këtij libri.

FRANCA

Përfaqësuar me:

Javer Malo

Misto Treska

Luan Rama

Jusuf Vrioni

Ylljet Aliçka

Ambasadori ynë i parë në Paris, pas lufte, është Kahreman Ylli, i cili më 25 prill 1946 paraqet letrat kredenciale si i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Paris, me notën verbale Nr. F. III, 139. Llambi Dishnica emërohet sekretar i parë i ambasadës dhe Javer Malo atashe për shtypin. Republika Franceze jep agrementin për K. Yllin më 6 qershor 1946; më 16 korrik 1946 paraqet letrat kredenciale.

Në çastin e emërimit ambasador, Kahreman Ylli ka këtë CV (në mënyrë shumë të përmbledhur): U lind më 25 prill 1917 Leshnje (Skrapar), Berat; përfundon studimet në Institutin e Shkencave, Lyon, Francë; drejtor shkolle në qytete të ndryshme të Shqipërisë; drejtor didaktik në Korçë dhe inspektor arsimi në Berat; anëtar i Luftës Nacionalçlirimtare; ish-drejtor i përgjithshëm i personelit në Kryeministri. Medaljen e Kujtimit dhe Urdhërin e Punës.

Ambasadori i parë francez në Tiranë, pas lufte, është Guillaume Georges-Picot, i akredituar si Ministër Fuqiplotë i Francës në Shqipëri më 14.1.1946. Ambasadori mbërrin në Tiranë, së bashku me të shoqen, më 5 mars 1946. President i Qeverisë së Përkohshme të Republikës Franceze është Felix Gouin.

Më 12.7.1946 zëvendësohet nga Guy Menant, ish-ambasador në Algjeri. President i Qeverisë së Përkohshme të Republikës Franceze është Georges Bidault.

Kryeministër i Shqipërisë, Ministër i Punëve të Jashtme (pas 9 shkurtit 1946) dhe i Mbrojtjes Kombëtare është Enver Hoxha.

Francezët përbëjnë kombin më të shkëlqyer dhe më të rrezikshëm në Europë, si dhe kandidatin më të kualifikuar për të qenë objekt admirimi, urrejtjeje, mëshire e terrori, por kurrsesi indiference!

Alexis de Tocqueville

Si një amerikan që jetoj në Francë, e ndjej se cilësia e jetës së përditshme që kam këtu është shumë më tepër se ajo që më ofrohet në shtëpinë time në ShBA.

Richard Chessnoff, autor *Arroganca franceze*

Francezët kanë ngecur tmerrësisht keq në pikën që me çdo kusht duhet të gjejnë vendin që ka Franca në Europë ... ose çdo të thotë të jesh francez... Franca ka problem me identitetin. Mendoj se ka nevojë për kurajo për të ripërkufizuar veten.

J. Andrea *A Divided Self - A Survey of France* The Economist, 16 nëntor 2002

Franca: Profil

Sipas Moran R., T. *et al*. (2007), francezët priren të besojnë se vlerat e vërteta të jetës rrjedhin nga parime ose ligje universale. Esenca e këtyre vlerave ka rëndësi për ta. Motoja e Republikës Franceze është "Liri, barazi, vëllazëri", vlera që shkojnë përtej të gjithave e frymëzojnë shumë francezë.

Shoqëria franceze është shumë e shtresëzuar, me klasa shoqërore të përcaktuara më së miri. Klasa shoqërore dhe statusi social ka rëndësi në Francë. Ky i fundit përcaktohet nga çfarë je. Shenja të jashtme që lidhen me statusin social janë niveli i edukimit, një shtëpi me arkitekturë të bukur, njohuritë rreth letërsisë dhe arteve të bukura, si dhe paraardhësit, - kush e çfarë kanë qenë.

Francezët janë miqësorë dhe me humor, kanë dëshirë të admirohen dhe paraqesin interes për dikë që paraqet pikëpamje të kundërta me ta. Të mos jesh dakord me pikëpamjet e një francezi, do të thotë mundësi për debat, i cili zakonisht mbyllet me shprehje të formës "Ishte bukur të bisedonim bashkë, shpresoj të shihemi së shpejti". Fjala "konkurrencë" nuk nënkupton konkurrencë në Francë, as në jetën e përditshme, dhe as në punë, përveç se në sport.

Francezëve ju pëlqen koha e lirë dhe socializimi, por nëse keni lënë takim me një francez dhe vonohet, nuk duhet të mërziteni, - të jesh vonë në një takim, me përjashtim të drekës, nuk është subjekt debatesh e pyetjesh që fillojnë, kryesisht, me *pse*. Ushqimi është shumë i rëndësishëm. Nëse ju ftojnë për drekë a darkë, ai që bën ftesën zakonisht paguan dhe bën edhe rezervimin e restorantit. Nëse ju ftojnë në shtëpi, duhet ta vlerësoni si shenjë respekti dhe e mira është të çoni një dhuratë, ku preferohen vera dhe lulet (jo trëndafilë, dhe as krizantema, sepse janë të përshtatshme për funeral).

Pushimet vjetore të tyre zgjasin deri në 5 javë; puna jashtë orarit pothuaj nuk njihet. Ajo që ka rëndësi është cilësia e jetës. Kur bisedoni me një francez mos u lëvdoni dhe evitoni pyetje me karakter personal, sepse nuk u pëlqejnë dhe, në përgjithësi, u shmangen. Me francezët nuk duhet të bisedosh për paratë ose për rrogën, sepse puna, rroga dhe të ardhurat janë personale dhe jo puna e të tjerëve. Kur takohen shtrëngojnë duart dhe bëjnë një kontakt të shkurtër me sy; nëse takohen me një femër, është ajo që duhet të zgjasë dorën e para. Kërcitja e gishtave gjykohet si vulgare. Janë aq krenar për gjuhën, sa presin që çdo i huaj t'u drejtohet në frëngjisht. Nëse nuk jeni i sigurt në frëngjishten tuaj, fillojeni bisedën më një shprehje kortezie e keqardhjeje, të tipit "Më vjen keq që nuk mund të shprehem ashtu si dua në gjuhën tuaj të mrekullueshme".

JAVER MALO

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Francës.
Periudha: Qershor 1967 - Shtator 1975

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Hollandë, Belgjikë dhe Luksemburg (jorezident)[1].
Periudha: 1972 - 1975

Ambasador i Shqipërisë pranë UNESKOs.
Periudha: Qershor 1967 - Shtator 1975



Photo credit: Arkiva personale Margarita Zyma (Malo).

Datëlindja: 1 janar 1920

Vendlindja: Delvinë

Diplomë: Mësues i gjuhës dhe letërsisë shqipe për shkollat e mesme. Fakulteti Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës.

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, italisht, anglisht dhe rusisht.

Bashkëshortja: Vera Malo (Tetova).

Fëmijë: Margarita Zyma (Malo)

Ndërruar jetë: 30 gusht 1997.

Motoja: "Të bënte të njohur Shqipërinë, të ngrinte në piedestalet më të larta dhe të merituara vlerat e saj në rrugë diplomatike dhe, kryesisht, nëpërmjet artit dhe kulturës".



Foto e vitit 1967. Ambasadori Javer Malo i dorëzon letrat kredenciale Presidentit të Francës, Charles de Gaulle dhe Ministrit të Jashtëm të Francës, Maurice Couve de Murville.
Photo credit: Arkiva e gazetës MAPO.

1937, verë Zgjidhet nga shkolla, si pjesë e një grupi nxënësish, më të mirët e Shqipërisë, për të ndjekur një kurs eksperience dhe të kalojë pushimet verore në Bari të Italisë.

1941 Mbaron Shkollën Normale, Elbasan.

1942, qershor-1942, gusht Emërohet mësues në një fshat të Prishtinës, por e mbajnë në qytet si sekretar për inspektimin e arsimit.

1942, tetor-1943, janar Transferohet si mësues në fshatin Mursi, Sarandë.

1943, janar-1944, nëntor Aktivizohet në radhët e luftës nacionalçlirimtare në zonat Delvinë e Gjirokastër. Anëtar i Partisë komuniste në organizatën bazë të Delvinës.


1944, 24 maj Pjesëmarrës në Kongresin e Permetit. Zgjidhet anëtar i Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar (KANÇ).

1944, nëntor-1945, shkurt Përgjegjës i Kulturës dhe Arsimit në Komitetin Ekzekutiv, Gjirokastër.

1945, shkurt-1945, qershor Referent në Drejtorinë e Mbrojtjes së Popullit, Ministria e Brendshme.

1945, qershor-1945, tetor Redaktor, gazeta "Bashkimi".

1945, tetor-1945, dhjetor Zv. Kryeredaktor, gazeta "Bashkimi".



Botime, Autor

- 2011 *Si i sollëm eshtrat e Ali Kelmendit në Shqipëri. Shënimet e diplomatit të vitit 1947 në Francë, mbi riatdhesimin e eshtrave të Ali Kelmendit*. Gazeta "Telegraf", nr. 251, 15 tetor, f. 14 - 15.
- 2011 *Konferenca e Paqes. Greqia sulm ndaj Shqipërisë për mosnjohjen e luftës. 65 vjet nga Konferenca e Parisit.* Ditari i diplomatit shqiptar, pjesëtar i delegacionit që kryesohej nga Enver Hoxha e Hysni Kapo. Gazeta "Telegraf", nr. 202, 22 gusht.
- 2011 *Jugosllavët nxjerrin në shesh propozimin grek. Ta ndajmë Shqipërinë në mes. 65 vjet nga Konferenca e Parisit*.
- 2004 *Napoleon Botimi i dytë*. Titulli në original: Napoleon. Autor: Evgenij V. Tarle. Përktheu: Javer Malo. Tiranë: Toena, 494 f.

1945, dhjetor -1946, maj Kryeredaktor, gazeta "Bashkimi".

1946, qershor-1948, dhjetor Atashe Shtypi, Legata Shqiptare në Paris. Anëtar i Delegacionit Shqiptar në Konferencën e Paqes, Paris, Francë.

1949, Janar-1950, korrik Sekretar i Parë, Legata Shqiptare në Paris.

1950, gusht-1952, 1 qershor Sekretar i Përgjithshëm i Komitetit për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme", Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.

1951, 4 korrik Martohet me Vera Tetovën. Vera Malo (Tetova), diplomuar për juridik. Për një periudhë kohe ka punuar si kryeredaktore e revistës "Shqiptarja e re" dhe, më vonë, prokurore pranë Gjykatës së Tiranës.

1952, 1 qershor-1967, 1 qershor Shef i seksionit të kulturës dhe bibliografisë, gazeta "Zëri i Popullit".

1953-1960 Mbaron studimet universitare, (sipas vërtetimit të datës 25.VI.1960, lëshuar nga institucioni i punëdhënësit).


1967-1975 Ambasador i Shqipërisë në Francë.

1975, 16 shtator-1982, qershor Kryetar i KMKMBJ (Komiteti për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme), Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.

1982, 16 shtator Del në pension. Sipas relacionit të përpiluar nga Piro Koçi, drejtor i drejtorisë së kuadrit pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, "meqënëse ka mbushur moshën, propozojmë të dalë në pension".

Nga udhëtimet e shumta që kryen gjatë ushtrimit të detyrës, si në Bullgari, Hungari, Itali, Bashkimin Sovjetik, Egjipt, Tunizi, Siri, Gana, Kubë etj., boton vazhdimisht artikuj e reportazhe në shtypin periodik.

Pasioni/ hobi: Leximi, arti, udhëtimet.



Çmime dhe vlerësime

1979, 24 nëntor Urdhërin *Për shërbime të shquara shtetërore dhe shoqërore* të klasit II. Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPSSh me dekret nr. 6058, datë 24.11.1979 e ka dekoruar me urdhërin "Për shërbime të shkëlqyera shtetërore dhe shoqërore" të klasit II me këtë motivacion: "Për mobilizim e arritje shumë të mira në plotësimin e detyrave të ngarkuara, për ndihmën e dhënë në zbatimin e vijës së parties në politikën e jashtme dhe për besnikëri ndaj Marksizëm –Leninizmit". Sekretari: Telo Mezini. Kryetari: Haxhi Lleshi.

- 2003 *Si e prezantova "Gjeneralin e ushtrisë së vdekur"*. Gazeta "Korrieri", nr. 158, 8 korrik, 2003.
- 2001 *Rrugëtimi i "Gjeneralit..." në Paris*. Si u botua romani i Kadaresë për herë të parë në Francë. Revista "Klan", nr. 222, 26 gusht, 2001, f. 26 – 29.
- 1994 *Paris, 1967-1975*. Shënime e mbresa. Tiranë: Albin, 270 f.
- 1987 *Përshtypje dhe mbresa. Paris 1946-1950*. Tiranë: Shtëpia Botuese "8 Nëntori", 301 f.
- 1964 *Khrushchev Rehabilitates the Agents of Imperialism and Supports the Murderers of Communists.* Authors Sofokli Lazri & Javer Malo. Tiranë: Shtëpia Botuese " Naim Frashëri".
- 1962 *Failure of Yugoslav "special Socialism" and the New Manoeuvres of the Belgrade Revisionists*. Authors Sofokli Lazri & Javer Malo. Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 19 f. *Ribotuar,* 1963.
- 1960 *Në burgjet dhe kampet e përqëndrimit të Jugosllavisë*. Autorë Sofokli Lazri & Javer Malo, 104 f.

Fletë-Anketë e nëpunësit

Në fletë-anketën e nëpunësit, plotësuar nga Javer Malo më 30.10.1951 janë shkëputur disa rubrika, gjithmonë në funksion të shpalosjes së figurës së tij, si dhe për të krijuar një ide se çfarë duhej të deklaronte një person për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore.

Rubrika: Profesioni ose specialitetet që ke fituar në shkollë, ose në praktikë me punë.

***J. Malo**: Në shkollë kam fituar profesionin e mësonjësit. Pas lufte atë të gazetarit.*

Rubrika: A ke marrë pjesë në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, në ç'formacion (nga ç'datë deri në ç'datë), ç'funksion e grada ke pasur dhe a je plagosur?

***J. Malo:** Nuk kam marrë pjesë direkt në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare.*

Rubrika: Me ç'punë janë marrë prindërit para okupacionit të prillit 1939, gjatë okupacionit prej 1939 deri në nëntor 1944 dhe mbas çlirimit?

***J. Malo:** Prindërit e mi nuk janë marrë me ndonjë punë të caktuar. Para okupacionit të vitit 1939 babai im ka patur një kafene në Delvinë e pastaj një dyqan të vogël fshati. Pas 1939 nuk ka pasur punë.*

Rubrika: Ke ndonjë nga familja jashtë shtetit, çfarë lidhje familjare kanë me ty, në ç'vend janë, kur dhe pse kanë shkuar, ç'punë bëjnë, ç'nënshtetësi kanë dhe çfarë lidhje ke me to.

***J. Malo:** Kam në Amerikë vëllanë e babait dhe dajën tim, të ikur për të gjetur punë (1913). I pari është pronar i një restoranti dhe i dyti punëtor. Nuk e di se çfarë nënshtetësie kanë.*

Rubrika: A të është marrë gjë nga reformat e shtetit popullor, çfarë sasie toke ose pasurie dhe kur të është marrë?

***J. Malo:** Më është marrë një sasie e vogël toke dhe pjesën tjetër e kam dhënë vetë.*

1962, 22 gusht *Urdhërin e Punës* të klasit I, dekreti nr. 3549, me këtë motivacion:

"Për merita të veçanta dhe punë të gjatë dhe të palodhur krijuese, drejtuese dhe organizative në organet e shtypit tonë popullor duke kontribuar, kështu, në ndërtimin e socializmit në vendin tonë". Presidenti: Haxhi Lleshi. Sekretar: Sami Baholli.

1949, 24 gusht *Urdhërin e Punës* të klasit II, dekreti nr. 912, me këtë motivacion:

"Ka punuar në shtypin ilegal të Qarkut të Gjirokastrës dhe ka qenë për një kohë Kryeredaktor i gazetës Bashkimi. Është dalluar për udhëheqje dhe organizim të mirë në punë." Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë. Presidenti: Dr. Omer Nishani. Sekretar: Sami Baholli.

1945, 14 nëntor *Medalje Kujtimi.* Me vendim nr.164.

Karakteristikë, Javer Malo (*Fragment)*

Javeri e njeh sektorin dhe e kryen mirë punën. Ka edhe iniciativë në punë, bën vërejtje e propozime, dmth ka shumë kurajo në punë. Po shoku Javer ka edhe disa të meta që nuk i bëjnë mirë, po të mos i kishte do të jepte shumë më tepër.

Përpjekjet që po bën kohët e fundit, me ndihmën e shokëve, tregojnë se ay mund t'i zhdukë këto të meta. Të metat e tij janë këto:

a. Nuk është mësuar të punojë me pllan në mënyrë rigoroze. E pranon se kjo është metoda më e mirë dhe ka bërë përpjekje për të punuar kështu, por akoma lypset të përpiqet.


b. Ka raste neglizhence në punë, jo me qëllim, por në lidhje me të metën e parë, dmth pse nuk organizon punën e tij siç duhet. Ka raste që nuk ka respektuar me përpikmëri orarin, por rregullisht është jashtë orarit si gjithë shokët, është në zyrë.

c. Veç këtyre, shoku Javer është pak nevrik. Kjo rrjedh edhe nga shëndeti i tij i dobët.

Këto të meta nuk janë në masë të atillë sa të influencojnë rëndë në punë dhe kam besim se do t'i ndreqë. Kritikën e pret mirë dhe mundohet të përfitojë nga kjo ...

Paris, 20 dhjetor 1949.

Ministri, Behar Shtylla



Faksimile e shënimeve të mbajtura për biografinë e kandidatit për Ambasador të Francës, Andre Millot.

Informacion nga Ambasada jonë në Paris për kandidatin për Ambasador të Francës, Andre Millot.

Të dhënat biografike për Andre Millot, kandidat për ambasador i Francës në Tiranë.

Lindur 19 mars 1913. Dipllomuar në drejtësi dhe laureat i shkollës së shkencave politike. Nga 1945 deri më 1950 ka qenë në administratën qendrore të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Nga 1950-1954 ka qenë atashe ambasade, pastaj sekretar i parë në Budapest. Nga 1954-1956 ka qenë në drejtorinë e Europës të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Nga 1956-1958 sekretar i Ambasadës në Helsinki. Nga 1958-1960 në drejtorinë e Europës. Nga 1960-1962 në drejtorinë kulturore e teknike. Nga 1962-1969 konsull i gjithanshëm i Francës në Frankfurt. Nga 1969-1972 shef i seksionit dipllomatik i Institutit të Studimeve të Larta dhe Mbrojtjes Kombëtare.

Karakteristikë, Javer Malo *(Fragment)*

Punon me detyrë Ambasador i Republikës Popullore të Shqipërisë në Francë nga muaji gusht i vitit 1967...

Në drejtim të propogandimit të vendit tonë në Francë është treguar i interesuar dhe është munduar të krijojë lidhje me rrethe të ndryshme gazetareske, me publicistë etj. Ka pasur një farë tendence të mbështetet vetëm te njerëzit e sferave të larta, sidomos të shtypit, duke mos bërë përpjekje sa duhet për zgjerimin e lidhjeve edhe me rrethet e ulta. Me një mobilizim më të math mund të arrinte rezultate më të mira në punë.

Gjatë punës tek shoku Javer ka pas çfaqje liberalizmi si në çmuarjen e disa problemeve, ashtu dhe në drejtim të organizimit dhe disiplinës në punën e përfaqësisë. Liberalizmi çfaqet dhe në bisedat që ai zhvillon me të huaj. Ka raste që në biseda ai zgjerohet shumë, duke mos i lidhur ato gjithmonë me qëllimet e detyrës së tij.

Tiranë, 16.1.1970

Zv. Ministri, Reis Malile.

Informacion ditor

Ambasadori francez kërkoi më 12 qershor agrementin si Ambasador i Francës në vendin tonë për Andre Millot, këshilltar i klasit të I-rë. Biografinë e tij, siç na e dërgon Ambasada jonë në Paris po e bashkangjisim.

Ne jemi dakord që t'i japim përgjigje të favorëshme dhe, duke pasë parasysh faktin që francezët na e dhanë agrementin për Ambasadorin tonë pas 21 ditësh, agrementin ta japim më 2 korrik d.m.th. pas 20 ditësh nga dita që kërkuan ata. (Ibid, fleta 3).

(*Shënim: Në zbardhjen e dokumentave është përpjekur të ruhet e njëjta gjuhë e përdorur, me përjashtime të vogla).*



Photo credit: Arkiva e gazetës MAPO.

Informacion-relacion në lidhje me marrëdhëniet e partisë e të shtetit tone me parti e shtete të tjera

(Viti 1971 Dosja nr. 311. Titulli i dosjes B/I-8). / Paris, më 11.7.1972.

Marrëdhëniet midis Francës dhe Shqipërisë gjatë dy vjetëve të fundit: 1970-1971.

Nga Ambasador Javer Malo *(Fragment)*

Eksperienca tregon se shumica e kuadrove që vinë në ambasadat tona, vijnë pa pasur asnjë dijeni për vendin dhe në krye të 3-4 vjetëve kthehen në Shqipëri duke marrë me vehte disa njohuri shumë të përcipta. Kur është fjala për vende të vogla si Algjeria p.sh., kjo nuk paraqet ndonjë problem, se brenda një kohe të shkurtër mund të njihet lehtë vendi me politikën e tendencat e tij, njerëzit që bëjnë politikën, forcat kryesore të inteligjencës etj. por në vende si Franca, shpesh herë ndodh që shokët tanë të humbasin toruan. Prandaj është e nevojshme të mendohet që tani, që dalë nga dalë të marrim si kuadro për diplomacinë të rinj që kanë kryer vitet e fundit studime në Francë, ose të rinj të tjerë me përgatitje mjaft të mirë intelektuale e kulturale. *(vazhdon)*

Emërimi si Ambasador – shkresa përcjellëse.

Republika Popullore e Shqipërisë — Tiranë, më 10.VI.1967
Ministria e Punëve të Jashtme / Dega Administratë - Kuadër Nr. 436

Shokut Javer Malo

Tiranë

Ju njoftojmë se me vendim të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSh, emëroheni Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i R.P. të Shqipërisë në Francë, me rrogë 1.100 lek në muaj. Marrëdhëniet financiare me këtë Ministri u fillojnë nga data 1/6/1967.

Ministri / (Nesi Nase) / (Firma, vula)

Franca dhe çështje të trajtuara nga Ministria e Jashtme në marrëdhënie me të

Gjatë kohës që Javer Malo ushtronte detyrën në Francë, çështjet kryesore të trajtuara nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë në marrëdhëniet me Francën (sipas protokollit dhe arshivës të kësaj ministrie) kanë qenë: aktivitete me rastin e festave kombëtare; ftesa për veprimtarinë kulturore e artistike; marrëdhëniet kulturore, tregtare e politike ndërmjet dy vendeve; veprimtaria e Shoqatës së Miqësisë Francë-Shqipëri dhe e miqve francezë; opinione të diplomatëve francezë për vendin tone; pasqyrimi në shtypin francez i vendit tonë; konventa fito-sanitare dhe materiale të tjera të lidhura me të.

Në tabelën më poshtë tematika e këtyre marrëdhënieve paraqitet në mënyrë të detajuar, shënuar me kryq poshtë vitit përkatës.

Burimi: Fondi i arshivës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Vitet 1967, 1970, 1971, 1972, 1973, 1974 dhe 1975, Franca.

Çështja	1967	1970	1971	1972	1973	1974	1975
Aktivitete me rastin e festave kombëtare.	x	x	x	x	x	x	x
Aktivitete të shkrimtarëve, publicistëve etj. francezë për vendin tonë.					x		
Biografi e të dhëna për kuadro e diplomatë.			x				
Çështje që kanë lidhje me dy ekspozita në Francë.	x						
Çështje të pasurive të shqiptarëve në Francë: Meksi, Xhemile Vrioni dhe Faber; të pasurive të Francës në Shqipëri: Elisabeth de Roland, Geogre Knuenlis, Gorrigues, Amelie Gonrousi. Mbi disa pasuri shqiptare në Francë e Belgjikë.	x	x				x	
Delegacione të ndryshme e grupe turistësh.				x		x	
Gazetarë e publicistë francezë për Shqipërinë. Dëbimi i një gazetari francez nga vendi ynë.		x					
Incidente në marrëdhëniet me Francën. Mbi incidentet e ndodhura në Ambasadën tonë në Paris. Hedhja e një bombe në oborr dhe pasojat e saj.		x				x	
Informacion rreth takimeve me Ambasadorin francez lidhur me forcat e OKB-së dhe çështje të tjera.	x						
Interesimi francez për dy shqiptarë (Nëna dhe motra e Gonxhe Bojaxhi, Nënë Tereza) për të cilat interesohet Vatikani.		x					
Interesimi i Ambasadës franceze për dy të rinj të humbur.		x					
Kërkesa për mbështetje kandidature nga ana e Francës.				x			
Kërkesë përkrahje kandidaturash në BIT.		x					
Kërkohen mendime për albanologun Kristian Gut.	x						
Kopje e protokollit për shkëmbimin e mallrave.					x		
Mbi ardhjen e Zh. Moretu në vendin tonë.					x		
Mbi bashkëpunimin e institucioneve kulturore të dy vendeve, si dhe mbi studiues të ndryshëm të ftuar për Kongresin Drejtshkrimor dhe të Gjenezës Ilire.			x	x			



12 Dhjetor 1968, Javer Malo me Drejtorin e Përgjithshëm të UNESCO-s Z. René Maheu, gjatë paraqitjes së letrave kredenciale.



Photo credit: Arkiva personale, Margarita Zyma (Malo).

Çështja	1967	1970	1971	1972	1973	1974	1975
Mbi bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shkencore të dy vendeve.					x	x	
Mbi çështje shkëmbim delegacionesh ndërmjet dy vendeve.		x					
Mbi dëbimin e atasheut të Francës Henri Monteil.	x						
Mbi ekspozitën tonë në Francë "Arti shqiptar në shekuj".						x	x
Mbi ftesat për veprimtarinë kulturore e artistike etj.	x		x	x		x	
Mbi gjerësinë e ujrave tona territoriale, si dhe mbi rregullat e lundrimit në ato ujëra të kërkuara nga Franca.			x				
Mbi hapjen e një ekspozite të artit dhe të kulturës shqiptare, si dhe të ftohet një asambël folklorik i vendit tonë për festivalin e Dizhonit.		x		x			
Mbi Konventën veterinare me Francën.		x					
Mbi marrëdhëniet kulturore ndërmjet dy vendeve.			x	x	x	x	x
Mbi marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve (informacione, relacione, korrespodenca).	x	x	x	x	x	x	x
Mbi marrëdhëniet tregtare e ekonomike ndërmjet dy vendeve.	x	x	x	x	x	x	x
Mbi marrëveshjen ndërkombëtare rrugore me Francën.		x					
Mbi njohjen e vlefshmërisë së pasaportës së Andorrës.					x		
Mbi Partinë marksiste-leniniste të Francës. Opinione të ndryshme (si për shembull ai i Patrik Kesset për marrëdhëniet me PPSH-në).						x	x
Mbi përkrahjen e vendit tonë në organizata ndërkombëtare.			x				
Mbi pjesëmarrjen tonë në javën europiane					x		
Mbi punën e bërë në sallonin ndërkombëtar të turizmit në Paris.	x						
Mbi punën propogandistike të Ambasadës në Paris dhe botimin e romanit "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"		x					
Mbi qëndrimin e vendit tonë dhe opinione të diplomatëve.			x				

Çështja	1967	1970	1971	1972	1973	1974	1975
Mbi shkëmbime delegacionesh midis dy vendeve etj.			x				
Mbi Shoqatën e Miqësisë Francë-Shqipëri dhe veprimtarinë e saj dhe të miqve francezë.		x	x	x	x	x	x
Mbi specialistët e bujqësisë, përshkrimet etj. të shkëmbyera ndërmjet dy vendeve.			x				
Mbi studentët tanë në Francë.						x	
Mbi takime me personalitete të larta të vendit tonë.			x				
Mbi veprimtarinë e shkrimtarëve, gazetarëve, publicistëve etj.			x	x		x	
Mbi veprimtarinë në panairin ndërkombëtar të Parisit.		x					
Njoftime mbi qëndrimin e personave që priten në Shqipëri e atyre që shkojnë në Francë.	x						
Mbi mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për uljen në Tiranë të avionëve francezë. Nota të Ambasadës së Francës mbi përfaqësimin Air-Francë në vendin tonë dhe mbi rregullat e aktivizimin e aeroportit të Parisit.	x		x	x			
Opinione nga qytetarë francezë për vendin tonë. Të dhëna për qytetarë francezë.					x		
Opinione të diplomatëve e personaliteteve francezë për vendin tonë.	x	x		x	x	x	x
Projekti i konventës fito-sanitare dhe materiale të tjera të lidhura me të.		x			x	x	
Projekt-konventa veterinare propozuar palës franceze, si dhe jo për mbrojtjen e bimëve. Përgjigja e palës franceze.				x			
Projekt-marrëveshja për shkëmbime tregtare ndërmjet dy vendeve për vitet 1972-1974. Çështje që lidhen me të.		x		x			
Shprehje solidariteti nga pala franceze me rastin e tërmetit në vendin tonë.	x						
Shtypi francez për vendin tonë.	x	x	x	x		x	x
Takim i Ambasadorit tonë në Paris me kryeministrin e Francës, si dhe i Ambasadorit francez me shokun Mehmet.				x			
Takime të diplomatëve francezë me autorite të vendit tonë dhe anasjelltas.					x		
Të dhëna biografike për Ambasadorin francez në Tiranë (dosja është e klasifikuar).				x			
Të dhëna mbi botime në Francë të librave që lidhen me Shqipërinë.	x						
Të dhëna për ambasadorin francez Albert Vantie.		x					

MPJ ARKIVI
VITI: 1972 FLETA: 25
BOSJA: 344

AMBASSADE
DE LA RÉPUBLIQUE POPULAIRE
D'ALBANIE
EN FRANCE

131, RUE DE LA POMPE, PARIS 16e
TÉL. 553-51-32

Nr 73

Dept. Pol. Ec. Str. Ambasada Shqiptare në Paris 20/7/1972

20-VII-72

(21)

Paris, me 11.7.1972

Marrëdhëniet midis Francës dhe Shqipërisë gjatë dy vjetëve të fundit

(1970 - 1971)

Marrëdhëniet e Francës me Shqipërinë me gjithë se kanë mbetur në një nivel të caktuar, ku kanë qenë prej shumë vjetësh, kanë një farë zhvillimi, sidomos vitet e fundit. Por përpara se të hyjmë në çështjet konkrete të marrëdhënieve midis të dy vendeve, duke i konsideruar këto në një plan të gjerë (në planin qeveritar dhe jashtë qeveritar), duhet të përcaktojmë drejtimet e përgjithshme të politikës franceze ndaj Shqipërisë :

Kjo politikë bën pjesë në një kuadër më të gjerë, në kuadrin e politikës mesdhetare dhe Ballkanike të Francës. Si një fuqi e madhe, me zotërime koloniale në bregun e Masdheut e në Afrikë, në rivalitet me fuqitë e tjera në këtë zonë, Franca ka patur gjithmonë një politikë mesdhetare. Duke mbrojtur e zgjeruar interesat e saj si fuqi e madhe imperialiste, dhe duke luftuar kundër rivalëve të saj, ajo ka patur në Mesdhe përveç posedimeve koloniale ose gjysmë koloniale, edhe vende nën influencë ose që i ka përkrahur në synimet e tyre kundër vendeve të tjera. Mbasi për një kohë shumë të gjatë, në zonën e Mesdheut Lindor dominoi çështja e orientit, ose trashëgimia e perandorisë otomane, dhe, më vonë egzistenca dhe rivaliteti midis shteteve ballkanike, Franca

(Raporti shkëputet. Më tej, e plotë pjesa e botimeve)

40

2) BOTIMET. Brenda dy vjeteve te fundit nga kater shtepi boto njese franceze,Albin Michel,Seuil,Maspero,dhe Hachette jane botuar keto vepra Shqiptare,ose mbi Shqiperine:

ARKIVI
TI: 1921
DOSJA: 377 FAQJA: 40

"Gjenerali i Ushtrise se vdekur" i Kadarese,"L'Albanie terre de l'homme nouveau" e Myrise,"L'Albanie"e Zakhos,"Face au revisionisme" e shokut Enver Hoxha dhe "Les Tambours de la Plui e Kadarese.

Jane ne perpunim per t'u botuar "Historia e Shqiperi nga autore shqipetare,"Lufta e partizaneve Shqipetare nga D.Eudi","Lufta e P.P.SH.kunder revizionizmit"nga P.Kessel dhe "Kronike ne gur" e Ismail Kadarese.

Ketyre u duhet shtuar shitja e botimeve tona ne nje numur librash në Paris dhe qytetesh te tjera ne France.

3) Studimet shqipetare dhe gjuha shqipe. Franca nuk ka tradita te medha te studimeve albanologjike dhe gjuha shqipe,qe mesohet ne shkollen e gjuheve orientale ne Paris,eshte dhene vazhdimisht nga nje profesor qe nuk e ka ditur vete mire kete gjuh Me gjitheate keto 10-15 vjetet e fundit eshte krijuar nje ekip i vogel,qe tani e zoteron gjuhen shqipe.Te tille jane historiani Ducellier,gjeografia Odila Daniel,perkthenjesit nga letersia shqipe Michel Metais dhe Christian Leteux. Dy te paret kane bere teza doktorati mbi Shqiperine dhe dy te dytet diploma universitare mbi gjuhen shqipe.

Por perveç ketyre,ka edhe disa universitare te tjere si ne Lile,Bordo,Eks-en Provans qe po bejne diploma me tema Shqipetare.Me nje fjale,ne rrethet universitare duken shenja te qarta te nje interesimi per studime Shqiptare.Sigurisht, keto jane studime studentesh,por qe ne nje te ardhme mund te perfundojne ne studime serioze shkencore,siç eshte teza e doktoratit e Ducellies "Durresi dhe qytetet bregdetare Shqiptare nga shekulli XI ne shekullin XIV.

Me ne fund ka mundesi qe gjuha shqipe te futet ne te ardhmen

(Raporti shkëputet. Më tej, mbyllja e tij.)

45

kenges dhe baletit,bile edhe te teatrit,per te ftuar ne Shqiperi,ne baze te nje plani perspektiv me afat te gjate,publiciste,gazetare,shkrimtare,historiane etj.te ndershem e progresiste,por qe te kene pështhe ne opinionin publik ne vendet e tyre.

Nje propagande e studiuar mire ne te gjitha aspektet, dhe jo e rastit,do te ndihmoje ne shtimin e miqve te Shqiperis dhe njekohesisht do te influencoje edhe ne tregetine ne boten e jashteme,ne rritjen e eksportit,dhe ne te gjithe punen tone politike e diplomatike. Por kyçi dhe kanali kryesor i trasmetimit te gjithe punes mbetet gjithmone Ambasada,e cila duhet te kete nje fizionomi qe t'u pergjigjet ketyre detyrave.

A M B A S A D O R I

Javer Malo

AMBASADA E REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE SHQIPËRISË PARIS

NPJ ARKIVI
VITI: 1971
DOSJA: 311 FLETA: 115

Gjatë periudhës 1 qershor 1967-16 shtator 1975, kur Javer Malo ushtronte detyrën e Ambasadorit:

Sekretar i Parë i Partisë së Punës të Shqipërisë: Enver Hoxha.

Presidentë të Shqipërisë: Haxhi Lleshi.

Kryeministër i Shqipërisë: Mehmet Shehu.

Ministër i Jashtëm i Shqipërisë: Nesti Nase.

Presidentë të Francës: Charles de Gaulle, Alain Poher (interim), Georges Pompidou, Alain Poher (interim), Valéry Giscard d'Estaing.

Ministra të Jashtëm të Francës: Maurice Couve de Murville, Michel Debré, Maurice Schumann, André Bettencourt, Michel Jobert, Jean Sauvagnargues.

[1] Marrëdhëniet diplomatike me Belgjikën janë vendosur më 12 nëntor 1970 dhe mbuloheshin nga ambasadori ynë në Francë. Ambasada jonë në Belgjikë hapet më 1991.

P. O. Box: 82
Cable: SHOQKOMIS.
Telephone: 34108

SHOQËRIA KOMISIONARIA

COMMISSION SOCIETY
Head Office TIRANA ALBANIA

State Bank
Comte 682-205

Agency: SHKODËR - KORÇË - GJIROKASTËR

MPJ ARKIVI
VITI: 1970
DOSJA: 290 FLETA: 9

Your Reference

Our Reference

Tiranë, më 4 mars 1970 196

ÇËSHTJE PËR TU NDJEKUR NË FRANCË

Çështjet që Shoqëria Komisionaria trajton në Francë nëpërmjet të Ambasadës aty janë këto:

1. Pasuria e Pierre Faber, F-1: Pasuria është shitur për 230,000 franga dhe me radiogram të datës 16 janar 1970 Ambasada njoftonte se të hollat do të mirreshin së shpejti së bashku me një llogari të çkoqitur të të gjitha t'ardhurave dhe shpenzimeve të kësaj trashëgimie. Deri sot nuk kemi ndonjë njoftim lidhur me sa sipër. Prokura në favor të sh. Nos Qosja.

2. Islam Sulejmani, F-3: Kjo çështje ka mbetur në një pikë të vdekur. Letra e fundit e Ambasadës për këtë çështje mban datën 7 maj 1968 dhe njoftoheshim se Noterit Rougon në Gap i ishte paguar paradhënje për ndjekjen e çështjes që në shtator 1967. Rezultati nuk na është njoftuar akoma.

3. Pasuria e Tasim Agaçit, F-5: Edhe për këtë çështje njoftimi i fundit i Ambasadës është i datës 7 maj 1968. Sipas këtij njoftimi, dosja i ishte dërguar qysh në tetor 1967 Ministrisë P. të Jashtëme belge dhe pritej njoftimi nga ana e saj. Deri më sot nuk dijmë se si po zhvillohet kjo praktikë. Si për çështjen e Islam Sulejmanit ashtu dhe për këtë, prokura ishte bërë në favor të sh. Muslim Ginoimeri.

4. Pasuria e Xhemile Dinos (Vrionit), F-6): Lidhur me këtë pasuri na dalin këto çështje: së pari ajo e qerave të pra_ pambetuara për të cilat Xhemil Dino ka paraqitur një llogari, e cila, sipas njoftimit të Ambasadës Nr.8/25 dt. 7.5.1968, është e pjesëshme dhe e padekumentuar nga bankat për qeratë që pre_ tendon se i ka dërguar Xhemiles dhe të cilat mund të kapin $5,000.- Së dyti, kemi çështjen e shumës prej 20,000.- fr. franceze të bllokuara për llogari të Xhemile Vrionit pranë Noterit Albert Cremery. Ndiqet nga avokat Weil. Së treti është paraqitja e një llogarie përfundimtare nga ana e administratorit deri ditën e shitjes të pasurisë (30.4.1968). Prokura ishte në favor të sh. Myslim Ginoimeri.

5. Pasuria e Urania Paspaleos, F-21: Për këtë çështje janë dërguar nga ana jonë të gjitha dokumentat dhe informatat e duhura që më 14 maj 1968, por nuk dijmë akoma në se u arkëtuan shumat që u përkasin klientëve tanë. Që më tetor 1967 njoftoheshim se Noteri po pregatiste dokumentat për pagimin e taksave të trashë_ gimisë dhe mendojmë se tani, pas dy vjet e gjysëm, kjo duhet të jetë përfunduar. Prokura ishte në favor të sh. Servet Backa.

AMBASSADE
DE LA RÉPUBLIQUE POPULAIRE
D'ALBANIE
EN FRANCE

131, RUE DE LA POMPE, 16E
TÉL. 553-51-32

France
A/II-8

10
3-II-70

MPJ ARKIVI
VITI: 1970
DOSJA: 280 FLETA: 1

Paris, me 25 janar 1970

Nr. 174 Prot.

MINISTRISE PUNVE TE JASHTME

T i r a n e

Lënda : Mbi trajtimin e problemeve te "Komisionares"

Prej disa vjetesh, Ambasada eshte ngarkuar te trajtoj dhe te ndjeke probleme te ndryshme trashegimije per llogari té "Shoqerise Komisionaria". Nga eksperienca e deritanishme rezulton se keto probleme jane zakonisht te komplikuara, jane te nje profili te specializuar dhe zgjidhja e tyre lyp kohe te gjate. Ka pas dhe raste ngatresash dhe ~~kaqka~~ dredhirash nga ana e notereve, etj. qe kane vene ne pozite te veshtire personelin diplomatik te Ambasades. Keshtu psh., lidhur me pasurine Faberi, Noteri desh te imp nonte shitjen e pasurise me gjysmen e vleftes qe ramë dako me pretekst se jane aplikuar rishtas taksa te reja trashegimie. Shoku Nos Qosja, qe kishte prokuren u detyrua te mos neneshkruaje aktin duke mos evituar te beje edhe fjalë. Ka pas raste kur qiraxhinjte jane zënë dhe rahur per arsye te apartementeve dhe qe policia i eshte drejtuar personit te Ambasades qe ka prokuren per te nderhyre te verë rregull dhe te zgjidhe konfliktet. Raste te tilla ka patur mjaft. Mejtojme se keto nuk jane pune qe u takojne diplomateve. Nuk duam te permendim rastet e shumta te nderhyrjeve qe na behen per shitjen ose anullimin e pasurive, shpifjet dhe akuzat qe vine e na bejne per njeri-jatrin, ngatresat mi-

./.

MPJ ARKIVI
VITI: 1970
DOSJA: 280 FLETA: 1 / 2

dis qiraxhinjve dhe administratoreve, shpalljet ne mur pe
tu na drejtuar neve, etj. Per te evituar kete gjendje dh
per te shpejtuar zgjidhjen e çeshtjeve mejtojme se eshte
nevojshme qe Komisionaria te lidhet direkt me nje jurist
te specializuar per kete problem, te cilit ti besoje te
gjitha çeshtjet, ti trajtoje direkt, ashtu si bejne te
gjitha ndermarrjet e tjera, dhe rolli i Ambasades te kon-
sistoje ne ndjekjen dhe nxitjen nepermjet kontakteve qe
do te kete here-mbas here me perfaqesuesin e Komisionares.
Keshtu veprojne te gjithe dhe vetem keshtu mund te zgjidhe
drejt dhe mirë problemet e trashegimise se personi perfa-
qesues i Komisionares do jete kompetent. Ne rast se Komisi
onaria nuk don ti jape keti juristi prokurat e shitjes,
ahere prokurat le tu a jape punonjesve te Ambasades, ashtu
si deri tani, por ajo qe ka rendesi eshte qe problemet te
trajtohen nga nje jurist jashte Ambasades dhe qe Komisio-
naria ti trajtoje direkt sepse ajo eshte e interesuar dhe
kompetente per keto çeshtje. Ambasada behet nje hallke
nderlikuese ne kete rast.

Lidhur me pasurine e Vrionasit, kjo eshte shitur dhe
parate jane inkasuar. Sa i takon pasurise Faberi, kjo u sh
sikunder ju kemi njoftuar, por si rregull, te hollat nuk
mund te inkasohen menjehere mbasi shitja publikohet me
qellim te konstatohet se mos kete opozite nga ana e kredi-
toreve mi te drejten e trashegimise. Ky formalitet zgjat
deri dy muaj, mundet edhe me teper. Nuk perjashtohen edhe
rastet qe noteret te abuzojne duke vonuar likuidimin per
te ~~perfundur~~ perdorur fondet sa me gjate. Per rastin e
pasurise Faber, psh. noteri eshte duke na thene se kish
bere me vonese pregatitjet e trashegimise, se nuk ishin pa
guar te gjitha shpenzimet, etj., prandaj edhe likuidimi
po vonohet. Sidoqofte, te hollat do te inkasohen shpejt
se jemi duke e ndjekur vazhdimisht kete çeshtje.

Lutemi te shikohet sugjerimi yne qe Komisionaria ti
trajtoje direkt problemet e veta nepermjet nje perfaqe-

./.

NPJ ARKIVI
VITI: 1947
DOSJA: 160 FLETA: 3

suesi te specializuar per çeshtjet juridike dhe te trashegimise, i cili, i nxitur nga mbikqyrja e kesaj Ambasade sidhe nga komisioni qe do ti jepet, do te interesohet te shpejtoje zgjidhjen e problemeve dhe te shese pasurite me leverdi. Centralizimi i problemit ne nje perfaqesues te vetem te Komisionares do te kete edhe shpenzime me pak.

Perveç disa trashegëmive te rendesishme, Komisionaria ka nje numur problemesh te vogla si hetime dhe sondazhe mbi pasurira te ndryshme, te shperndara ne France dhe per te cilat nuk jepen te dhena konkrete, llogarira te varura dhe te komplikuara me administratoret, pasurira te vogla te lujteshme ne duar të të treteve, etj.; ka dhe mosmarreveshje, shperdorime dhe konflikte. Keto te gjitha nuk mund te ndiqen nga personeli i Ambasades qe nuk eshte kompetent do tu duhet te humbasin kohe te gjate dhe, sikunder permendem me lart, jane shpesh akte diskriminimi dhe kompromet ue per funksionaret e kesaj Ambasade. Ne nuk shohim arsye pse Komisionaria te rezistoje dhe mos vihet direkt ne lidhje me nje perfaqesues te saj, ashtu si do te vepronte ne vend ku nuk ka Ambasade. Ne te vertete, Komisionaria eshte duke kerkuar nje jurist per te perfaqesuar te drejtat e saj ne Greqi.

AMBASADORI :
(Javer Malo)

MPJ ARKIVI
VITI: 1976
DOSJA: 460 FLETA: 34

Marredheniet e vendit tone me Francen gjate viteve te fundit

Viti 1976

- Ne mars 1976, qeveria franceze dergoi nje ftese, ne emer te qeverise se saj, ku ftohej shoku Luan Babameto, te mirrte pjese ne ekspoziten nderkombetare "Transport-Expo 77".

Ne nuk morrem pjese dhe pala franceze u falenderua ne emer te shokut Luan Babameto.

- Ne shtator 1976 ishte ne vendin tone delegacioni tregtar qeveritar francez i cili zhvilloi bisedime me palen tone. Ne bisedime midis te tjerash, theksuan gadishmerine e tyre per te "inkurajuar Shqiperine qe te rrise volumin e shitjeve ne France si krom, duhan, etj".

- Ne dhjetor 1976, ambasada franceze ne Tirane dorezoi nje ftese per te marre pjese ne nje konference nderkombetare mbi shfrytezimin e energjise diellore. Pala franceze u falenderua per ftesen, por nuk u muarr pjese.

- Me 24 dhjetor 1976 ne ambasaden tone ne Paris u krye nje provokacion (u hodh nje bombe). Edhe ne shtator 1974 ka patur nje provokacion te tille.

- Pala franceze nderhyri menjehere dhe ndihmoi per te gjetur fajtoret. Per kete aresye nuk iu dergua as nota e protestes qeverise franceze, ku ngarkohej ajo me pergjegjesi dhe kerkohej marrja e masav per mosdemtimin e marredhenieve normale midis te dy vendeve.

Viti 1977

- Pala franceze dergoi nje ftese, ne emer te shoqes Themie Thomai, per te marre pjese ne javen nderkombetare te blegtorise.

Falenderuam per ftesen, por nuk morrem pjese.

- Me 31 dhjetor 1977 u nenshkrua ne Tirane konventa Fitosanitare.

MPJ ARKIVI
VITI: 1978
DOSJA: 46° FLETA: 32

- U organizua ne France java e filmit shqiptar (moren pjese edhe S. Prosi dhe Demir Hyska).

Viti 1978

- Ne shkurt 1978 u nenshkrua proces verbali tregtar. Gjate bisedimeve delegacioni francez ngriti çeshtjen e transportit dh sugjeruan dy rruge: me det ose me toke (nepermjet hekurudhes ne Titograd).

- Pala franceze dergoi nje ftese per te marre pjese ne panairin e 14-te te programeve te televizionit.

Ambasada e jone ne Paris falenderoi organizatoret e panairit per ftesen, ne emer te drejtorit te radiotelevizionit tone.

- Ambasada franceze ka bere kerkese, me note, per t'u lidhur me rrjetin telex nderkombetar.

I eshte dhene pergjigje se ky sistem eshte akoma ne prove dhe, deri ne stabilizimin e tij te plote, nuk do te zgjerohet me lidhje te tjera. (Kete kerkese pala franceze e ka perseritur edhe gjate vitit 1979. I eshte dhene e njejta pergjigje).

Viti 1979

- Nje grup deputetesh franceze kane marre inisiativen dhe kane dale me propozim per krijimin e nje grupi parlamentar te miqesise me Shqiperine.

-Ne nuk e kemi nje praktike te tille.

- Drejtoria e marredhenieve nderkombetare e Dhomes se deputeteve franceze ka sugjeruar per nje vizite ne France te ndonje grupi deputetesh nga vendi yne.

- Ambasadori francez ne takim me shokun Çeno ka perseritur kerkesen per nje vizite te zevendesministrit te jashtem shqiptar ne France.

Ftesen e kemi ne konsiderate dhe mbetet qe ta diskutojme

(Materiali vijon i radhitur)

Konkretisht:
-Ftesa e bërë nga Zhoberi për një vizitë të shokut Nesti në Francë. Pas largimit të Zhoberit nuk na është përsëritur një ftesë e tillë, prandaj dhe nuk është bërë vizita. Ne jemi të mendimit që këtë çështje ta shqyrtojmë përsëri. Ne asnjëherë nuk i kemi refuzuar ftesat e bëra, por kemi vënë në dukje se ato do të realizohen në një kohë të përshtatshme.
-Nota e qeverisë tonë drejtuar qeverisë franceze lidhur me pranimin në universitetet franceze të studentëve dhe të specialistëve.
-Çështja e dërgimit të grupit të specialistëve në Francë për të marrë njohuri mbi shfrytëzimin e shtresave të qymyrit në formacione të paqëndrueshme e të vështira. (3 vetë për 1 muaj).
- Vizita e Marko Xeges në Francë.

* * *

Kopje e informacionit për disa probleme të diskutuara ndërmjet Javer Malos, në cilësinë e Kryetar të Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, pranë MPJ dhe Ambasadorit Francez në Tiranë më 1981. Informacioni gjendet në Arkivën e kësaj ministrie.
MPJ Arkivi / Viti: 1981, Franca. Dosja: 577 Fletët: 17 -18

Tiranë, më 5.3.1981

INFORMACION

Më datë 4 mars prita, me kërkesën e tij, ambasadorin francez Gabriel Lekonte, i cili erdhi i shoqëruar me atasheun kulturor.

Pasi më shprehu kënaqësinë e tij mbi vizitën që është duke bërë shoqja Themie Thomai në Francë, më dorëzoi kopjen e një note që i është dorëzuar Ministrisë së Jashtme lidhur me bursat për vitin shkollor 1981-1982.

Ambasadori tha se Ministria e Jashtme Franceze ndodhet përpara një vështirësie në dhënien e bursave. Në përgjithësi, shprehet ai, bursat që u jepen studentëve të huaj janë të nivelit të ciklit 3 vjeçar të universitetit, pra për studime që zgjasin deri në tre vjet. Ministria e Jashtme konstatoi se bursat që i janë dhënë Shqipërisë janë shfrytëzuar, në shumicën e rasteve, për studentë fillestarë, të cilët duhet të qëndrojnë në Francë 5-6 vjet. Për këtë arsye, shtoi ai, Ministria e Jashtme e Francës do të sigurojë vazhdimësinë e studimeve të këtyre studentëve, por për vitin shkollor 1981-1982 nuk mund të akordojë më shumë se 2-3 bursa të tjera.

Gjithashtu, ambasadori francez më dorëzoi edhe një notë tjetër, drejtuar Komitetit, ku thuhet se Ministria e Jashtme Franceze merr përsipër të sigurojë për stazhierë 37 mensualitete që citohen në planin kulturor, 30 prej të cilave nuk u shfrytëzuan vitin e kaluar. Ambasadori theksoi se pret, sa më shpejt, kërkesat tona konkrete për bursat e stazhit. Në vazhdim, ambasadori propozoi, në bazë të planit kulturor, ardhjen në Shqipëri të një linguisti francez që do të mbajë leksione për pedagogët e Katedrës së Frëngjishtes të Universitetit të Tiranës, për 2-3 javë, në fund të vitit shkollor, si dhe dërgimin në Francë të dy pedagogëve shqiptarë të gjuhës frënge për t'u njohur me metodat e reja audio-vizuale.

Në fund, ambasadori francez preku çështjen e porositjes së librave shkencorë nga ana jonë. I shpreha mendimin se do të ishte me interes ajo që na kishte propozuar ai vetë disa kohë më parë, domethënë të hapej në Tiranë një ekspozitë e librave shkencorë në gjuhën frënge. Ambasadori e quajti të mundshme këtë, ndërkohë që kërkoi t'i përcaktojmë fushat që na interesojnë. Ai shtoi se praktika, në raste të tilla është që një pjesë e librave të blihen, sigurisht me çmime të reduktuara. Ambasadori ynë pyeti pastaj nëse Ismail Kadareja do të shkojë në Paris (në fakt Kadareja ndodhet atje) dhe pyeti, gjithashtu, se se çfarë bëhet me filmin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". I thashë se Pikoli ka bërë gjithë përgatitjet dhe e konsideron gati si të sigurt financimin, i cili do të bëhet nga 3 firma, midis tyre edhe Televizioni Francez, por siç na tha ai, firmat nuk mund të japin përfundimisht fjalën përpara se të bëhen zgjedhjet presidenciale në Francë. - Nuk kuptoj, tha ambasadori, se ç'punë kanë zgjedhjet në financimin e një filmi.

Pastaj ai pyeti: - Kam përshtypjen se italianët nuk e duan realizimin e këtij filmi. Ambasadori pyeti përsëri: - Po Mastrojani do të luajë në këtë film? Nga pyetjet e tij, si dhe nga mënyra e tërthortë e gjithë kësaj bisede mbi filmin, pata përshtypjen se italianët duhet të kenë bërë përçapje në Paris që filmi të mos realizohet.


KRYETARI / (Javer Malo) / (Firma)

MISTO TRESKA

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Francës.
Periudha: 1979 - Janar 1981

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Hollandë, Belgjikë dhe Luksemburg (jorezident)[1].
Periudha: 1979 - Janar 1981

Ambasador i Shqipërisë pranë UNESKOs.
Periudha: 1979 - Janar 1981



Datëlindja: 19 prill1914

Vendlindja: Treskë, Korçë.

Diplomë: Histori-Letërsi, Universiteti i Tiranës.

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, italisht, anglisht dhe rusisht.

Ndërruar jetë: 23 qershor 1993, Tiranë.

Bashkëshortja: Donika

Fëmijët: Natasha, Ana, Shpresa, Andrea, Zana.

"Të përkthesh Hugo është si të përkthesh Francën".
Shkëputur nga parathënia e një libri

1934 Përfundon shkollën e mesme pranë Liceut të Korçës.

1934 Ndërron jetë i ati, emigrant në Boston (ShBA).

1935 Fillon të shkruajë letërsi dhe të përkthejë në dy revista të kohës: "Rilindja" dhe "Bota e Re".

1935, 25 tetor-1936, korrik Sekretar komune, Shëmtir, Kolonjë, Korçë.

1936, korrik-1938, prill Sekretar komune, Fan, Mirditë.

1938, prill-1938, dhjetor Sekretar komune, Ostren-Trebishtë, Dibër.

1938, dhjetor -1939, qershor Sekretar komune, Shosh, Dukagjin, Shkodër.

1937 Kryen shërbimin ushtarak, shkollën e plotësimit të oficerëve.

1939, 30 qershor 1941, 30 maj Arrestohet për rezistencë nga fashistët italianë dhe dënohet pa gjyq dy vjet me "burg dhe internim"; dënimin e vuan në Shqipëri dhe Itali.

Anëtar i Grupit Komunist të Korçës.

1941, 8 nëntor Anëtar i Partisë Komuniste

1941, nëntor Arrestohet për një javë e lirohet.

1942, fundi i korrikut Arrestohet përsëri, këtë radhë në Korçë, për 10-12 ditë e, më pas, lirohet.



Foto e vitit 1979, 10 maj. Ambasadori Misto Treska i dorëzon letrat kredenciale Presidentit të Francës, Valéry Giscard d'Estaing dhe Ministrit të Jashtëm të Francës, Jean François-Poncet (nga e majta në të djathtë).
Photo credit: Arkiva personale, Zana Treska.

Përkthime

- 1999 *Heshtja e detit.* Titulli origjinal "Le silence de la mer" Tregime dhe novela Autor Vercors (Emri i vërtetë i autorit: Jean Bruller). Përktheu nga frëngjishtja Misto Treska. Tiranë: Phoenix, 74 f.
- 1986 *Kola Benjoni* Colas Breugnon Autor Romen Rolan Përktheu nga frëngjishtja Misto Treska. Tiranë: Naim Frashëri, 316 f. (Botuar fillimisht në revistën "Nëntori")
- 1985 *Malva.* E përktheu nga origjinali Misto Treska. Në: Vepra të zgjedhura (tregime), vëll. 1, *Rasskazi* Autor Maksim Gorkij (f. 308-371). Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 378 f. Çmimi 7 lekë.
- 1984 *Lindja e një njeriu*. E përktheu nga origjinali Misto Treska. Në: Vepra të zgjedhura (tregime), vëll. 2, *Rasskazi* Autor Maksim Gorkij (f. 184-198). Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 412 f. Çmimi 7 lekë.
- 1983 *Të mjerët*. Titulli origjinal "Les miserables*"* Autor Victor Hugo. Vëll. 1 E përktheu nga origjinali Misto Treska. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 608 f. Me parathënie nga Misto Treska. Çmimi 7.50 lekë. Pajisur me shënime në fund të librit. Tirazhi 15 000 kopje. *Ribotim*: 2012. Tiranë: Bota Shqiptare, 526 f.
- 1983. *Të mjerët*. Titulli origjinal "Les miserables*"* Autor Victor Hugo. Vëll. 2 E përktheu nga origjinali Misto Treska. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri". Çmimi 7.50 lekë. Pajisur me shënime

1943, mars Deri në këtë periudhë punon për ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtare dhe organizimin e sindikateve ilegale në rrethin e Korçës.

1941-1943, mars Në seksionin e Agjitacion-Propogandës, qarku Korçë.

1943, mars Partizan në çetën e Gores.

1943, maj Komisar politik, Batalioni "Tomorri".

1943, tetor Komisar politik, Batalioni "R. Çollaku".

1944, qershor Komisar politik, Shtabi i qarkut, Korçë.

1944, shtator Komisar politik, Brigada XX Sulmuese.

1944 Merr pjesë në Konferencën e Beratit.

1944, nëntor Shef kuadri në Komandën e Përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, Berat. Fiton gradën "Major".

1945, 1 korrik Martohet me Donika Çikopano.

1946, prill -1956, 31 korrik Drejtor i Shtypit dhe informatave, punonjës i Aparatit të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë, Tiranë. Detyrat që kishte: Shef seksioni dhe zëvendës drejtor për Agjitacion-Propogandën; drejtor për kulturën; kryeredaktor i revistës "Rruga e Partisë".

1956, 1 gusht-1958, 31 mars Nënpresident Permanent i Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik. Teksti i vërtetimit: Shoqëria e Miqësisë Shqipëri-Bashkimi Sovjetik, Tiranë, më 24 mars 1962, Nr. 21/2, Vërtetim. Me të cilin vërtetojmë se shoku Misto Treska prej datës 1/ Gusht/1955

26.09.2009 Në një intervistë të Dritëro Agollit me Petrika Grosi, Agolli i referohet Treskës si një nga personat që e mbështetën propozimin e tij për pluralizëm. Botuar në Lajme (online):

Sa u dha raporti në Kongresin X të Partisë së Punës (8-12 qershor 1991) erdha në shtëpi dhe nuk thashë asnjë fjalë... Do të shkruaja diskutimin tim dhe deri natën vonë ndenjëm zgjuar... Pasi e mbajta diskutimin e kuptova se nuk po më jepnin të drejtë. Kishte shumë fanatikë. Megjithatë, Misto Treska, Petro Lalaj, Moikom Zeqo dhe Qamil Buxheli më mbështetën, ndërkohë që të tjerët më bënin letra nga më të ndryshmet, ku më kujtonin të gjitha të mirat që kishte bërë Partia e Punës për mua.



në fund të librit. *Ribotim*: 2012. Tiranë: Bota Shqiptare, 605 f.

- 1982 *Të mjerët*. Titulli origjinal "Les miserables*"* Autor Victor Hugo. Vëll. 3 E përktheu nga origjinali Misto Treska. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 640 f. Çmimi 8 lekë. Pajisur me shënime në fund të librit. *Ribotim*: 2012. Tiranë: Bota Shqiptare, 572 f.
- 1979 *Lysien Lëven.* Titulli origjinal "Lucien Leuwen" Autor Stendal. E përktheu nga origjinali Misto Treska. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri", 688 f. Me parathënie nga Piro Misha. Çmimi 5 lekë. Pajisur me shënime në fund të librit. Tirazhi 20 000 kopje.
- 1972 *Eliza ose jeta e vërtetë.* Titulli origjinal "Elise ou la vraie vie" Roman Autor Claire Etcherelli E përktheu nga origjinali Misto Treska. Tiranë: Naim Frashëri, 251 f.
- 1962 *Albanie Nouvelle: Revue politique et sociale illustrée, paraissant en français, russe, chinois, anglais et arabe* Autor Misto Treska Tiranë: Naim Frashëri.
- 1962 *Gjëri i vogël.* Roman Titulli origjinal "Le Petit Chose. Historie d'un enfant." Autor Alphonse Daudet Përktheu nga frëngjishtja Misto Treska. Tiranë: Naim Frashëri, 294 f., me il. *Ribotim*, 1989. Tiranë: Naim Frashëri.
- 1961 *Viti nëntëdhjetë e tre*. Roman Titulli origjinal "Quatre-vingt-treize" Autor Victor Hugo Përktheu nga frëngjishtja Misto Treska. Tiranë: Shtëpia

deri në fund të muajit mars 1958 ka punuar pranë kësaj Shoqërie me cilësi si N/President i Shoqërisë. I lëshohet ky vërtetim për efekte të plotësimit të librezës së punës. Sekretari i përgjithshëm Nasho Nathanaili (Firma, Vula).

1958, 1 prill-1959, 28 maj Kryetar i KMKMBJ (Komiteti për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme), Ministria e Arsimit dhe Kulturës, Tiranë. Teksti i emërimit: Ju njoftojmë se në bazë të vendimit të Byrosë Politike të K.Q. të P.P.Sh., Nr. 92 dt. 27/3/1958 emëroheni Kryetar i Komitetit për Marrëdhënie me Botën e Jashtme. Marrëdhëniet financiare i fillon më 1/4/1958. Ministri (Manush Myftiu). Degës së Administratës (Llogarisë) Biografisë Këtu Për njoftim e veprim. Sh. Misto Treska përkohësisht do të paguhet me 13.000 (trembëdhjetëmijë) lek në muaj. Ministri (Manush Myftiu) (Firma, vula) Konc: A. F. Dakt. N.Ll. 14/4/58 Kopje 4.

Mbas çlirimit deri më 24 tetor 1958, ka udhëtuar, në cilësinë e përfaqësuesit të Shtetit Shqiptar dhe pjesëmarrës/drejtues i delegacioneve të ndryshme, në: Rumani, Francë, Bullgari dhe Bashkimin Sovjetik.

1958, 4 nëntor-1958, 5 dhjetor Kryetar i delegacionit të Republikës Popullore të Shqipërisë pranë Këshillit të Përgjithshëm të UNESCOs, Paris, Francë.

Del në pension si Kryetar i Komitetit për Marrëdhënie Kulturore me Botën e Jashtme.

Në kohën kur e thërrasin për të marrë postin e Ambasadorit në Francë ishte në pension, sipas rrëfimit të vajzës, Zana Treska. Po sipas saj, urdhërimi për lirimin nga detyra ka qenë i papritur.

Charles de Gaulle, President i Republikës së Francës.
Marrë nga libri "Paris 1967-1975. Shënime e mbresa", Autor Javer Malo, Tiranë: Albin, 1994.

Ky njeri, Misto Treska, e njeh letërsinë tonë, pothuaj më thellë se ne.

Mehlem Mobarak, publicist, autor i librit "Kujtimet e një albanozauri. 1965-1991". Tiranë: Onufri, 2013.
Marrë nga intervista për Mapo e Naum Priftit, datë 28. 12. 2013:

Autori, në vizitën e dytë të tij në Shqipëri, më mars 1978, shoqërohej nga Misto Treska, Ambasador i Shqipërisë në Francë. Sapo Mobaraku iu lut ta ndihmonte ta takonte Enver Hoxhën dhe mundësisht ta intervistonte, Mistoja me humorin e tij i tha duke buzëqeshur: "Është më lehtë të kapësh morra me dorëza boksi, sesa të takosh Enver Hoxhën." Enver Hoxha u mënjanohej gazetarëve të huaj dhe nuk mbahet mend të ketë dhënë ndonjë intervistë.



Foto e marrë më 23.5.1979, Maison de l'Unesco, Paris, Francë. Ambasadori i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë, Delegat i Përhershëm i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Misto Treska, i dorëzon letrat kredenciale Drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s, zoti Amadou-Mahtar H'Bow
Photo credit: Arkiva personale, Zana Treska.

Botuese "Naim Frashëri", 440 f. *Ribotim,* 1999. Tiranë: Dituria, 320 f.

- 1960 *Poezi.* Autor Louis Aragon Zgjodhi e përktheu Misto Treska Tiranë: Naim Frashëri, 39 f., me il., 1fl. portr. Ribotim: 1997 *Poezi* Autor Louis Aragon Zgjodhi e përktheu Misto Treska. Përgatiti për botim Flutra Haçka Elbasan: Onufri, 135 f.
- 1958 *Bel-Ami. Mik i bukur*. Roman. Autor Guy de Maupassant Përktheu nga frëngjishtja Misto Treska. Tiranë: Naim Frashëri, 366 f. *Ribotim*, 1995, 2002. Tiranë: Dituria, 318 f.
- 1951 *Malva. Lindja e një njeriut* Autor Maksim Gor'kij Përktheu nga frëngjishtja Misto Treska. Tiranë: Naim Frashëri, 67 f.

Redaktime

- 1983 *Chansonnier epique Albanais.* Botuar në frëngjisht. Autorë: Kolë Luka (version franc.) Ismail Kadare (avant. propos) Qemal Haxhihasani (preparat. et red.) Alfred Uçi (preparat. et red.) Misto Treska (preparat. et red.) Sali Shijaku (ilustr.) Tiranë: Tirana: Académie des sciences de la RPS d'Albanie, Institut de culture populaire, 456 f., 24 fl. me il.
- 1961 *Vargje të zgjedhura.* Autor Paul Eluard Përkthyen nga origjinali Dhimitër Pasko & Sotir Caci Redaktor Misto Treska Tiranë: Naim Frashëri, 136 f.

Çmime

- 2004 *Qytetar nderi* i qarkut Korçë. Këshilli i Qarkut Korçë, me vendim nr. 56, datë 19.11.2004 i jep Misto Treskës (pas vdekjes) titullin "Qytetar nderi i qarkut Korçë". Me motivacion: "Për merita të shquara në organizimin dhe drejtimin e formacioneve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Diplomat i shquar i shtetit shqiptar, ka mbrojtur me dinjitet nderin e atdheut të vet në arenën ndërkombëtare". Ilo Kostandini, sekretar i Këshillit të Qarkut. Fehmi Xhemo, Kryetar i Këshillit të Qarkut.



Dalë me Viktor Eftimiun.

Pjesë nga parathënia e "Të mjerët", vëll. 1, shkruar nga Misto Treska, f. xxviii:

Viktor Hygoi vdiq më 22 maj të vitit 1885... Dy milionë veta e përcollën trupin e ti në Panteon. Ai hyri në Panteon, por jo vetëm. Ai mori me vete dhe i bëri të pavdekshëm Zhan Valzhanin, Anzholrasin, Gavroshin, Mirielin, Guinplenin, Kazimodon, Esmeraldën dhe të gjithë personazhet e tjerë të veprave të tij, aq fort të dashur për lexuesin e çdo kombësie, që e bënë gjenial autorin e tyre.

Sami Frashëri ka përkthyer turqisht dhe botuar, qysh në vitin 1881, d.m.th. që në të gjallë të Viktor Hygoit, tre librat e parë të romanit "Të mjerët". Në parathënien që ka shkruar Sami Frashëri për këtë vepër, ka thënë midis të tjerash:

> Megjithëse çdo vepër e Viktor Hygoit ka një vlerë të veçantë, ajo që është mbi të gjitha veprat e tij dhe që ia ka ngritur famën në atë shkallë, është vepra "Të mjerët".

Fletë-Anketë e nëpunësit

Në fletë-anketën e nëpunësit, plotësuar nga Javer Malo më 30.10.1951 janë shkëputur disa rubrika, gjithmonë në funksion të shpalosjes së figurës së tij, si dhe për të krijuar një ide se çfarë duhej të deklaronte një person për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore.

Rubrika: Profesioni ose specialitetet që ke fituar në shkollë, ose në praktikë me punë.

***M. Treska**: Me praktikë në punë kam fituar profesionin e publicistit.*

Rubrika: A ke marrë pjesë në Ushtrinë Nacionalçlirimtare, në ç'formacion (nga ç'datë deri në ç'datë), ç'funksion e grada ke pasur dhe a je plagosur?

***M. Treska**: Mars 1943 - 1944, shtator Partizan në formacione të ndryshme.*

Rubrika: Me ç'punë janë marrë prindërit para okupacionit të prillit 1939, gjatë okupacionit prej 1939 deri në nëntor 1944 dhe mbas çlirimit?

***M. Treska**: Im atë ka qenë punëtor në Boston (ShBA) dhe ka vdekur atje. Nëna ka qenë gjithmonë në shtëpi.*

Rubrika: Ke ndonjë nga familja jashtë shtetit, çfarë lidhje familjare kanë me ty, në ç'vend janë, kur dhe pse kanë shkuar, ç'punë bëjnë, ç'nënshtetësi kanë dhe çfarë lidhje ke me to.

***M. Treska**: Kam disa kushërinj që kanë shkuar prej më shumë se 40 vjetësh në ShBA për arsye ekonomike. Nuk e di se çfarë nënshtetësie kanë, por duhet të kenë nënshtetësi amerikane.*

Rubrika: A të është marrë gjë nga reformat e shtetit popullor, çfarë sasie toke ose pasurie dhe kur të është marrë?

***M. Treska**: Asgjë nuk na është marrë nga reformat e pushtetit.*

- *Nderi i trevës së vakëfeve,* Korçë. Me motivacion "Për kontribut të shquar në luftën për çlirimin dhe rindërtimin e vendit". Sekretar: Valter Shtylla. Kryetar: Lufti Topçiu.
- *Medalja e Kujtimit / Urdhëri i Flamurit /* Urdhëri *Ylli Partizan* i klasit III / *Urdhëri i Trimërisë / Urdhëri i Punës* i klasit I / *Urdhëri i Punës* i klasit II / *Medalja e Çlirimit / Urdhëri i "9 shtatorit",* Bullgari.



Në foto, me një grup studentësh shqiptarë që studionin në Francë.

Viti 1981 Dosja nr. 553 Fleta 2 **Paris, 7 janar 1981**

Ministrisë së Punëve të Jashtme
(Shokut Ksenofon Nushi)
Tiranë

Bashkangjitur po ju dërgojmë të përkthyer artikullin e sekretarit të shtetit për punët e jashtme, Olivier Stirn, botuar në gazetën "Le Figaro" të datës 3 janar 1981, për dijeni dhe material informacioni në parashikim të viztës së mundshme që mendon të bëjë, nga fundi i marsit ose fillimi i prillit.

Ambasador, Misto Treska (Firma)

Një Francë që zotëron të ardhmen e vet

Olivier Stirn *Sekretar Shteti për Punët e Jashtme*

Për t'u bërë ballë krizës botërore dhe kërcënimeve të jashtme, Franca ka nevojë të ketë besim në veten e saj dhe tek ai që e mëshiron.

Ne mund të kemi besim në veten tonë: kemi një prej niveleve të jetesës nga më të lartat në botë, jemi bërë vendi i tretë eksportues dhe kemi arritur në industri një teknologji të lartë, spektakolare, (në fushën bërthamore, aeronautike, të hapësirës, informatikës, telekomunikacionit, kërkimit mjekësor). Sistemi ynë shoqëror është njëri nga më efikasët në botë, garanci për rreziqet që vinë nga sëmundjet, pleqëria, papunësia.

Kultura jonë mbetet njëra prej më krijueseve, në të gjitha shprehjet e saj.

Duke i konstatuar të gjitha këto, nuk kemi qëllim të fshehim vështirësitë me të cilat na duhet të përballemi, si për shembull për shkak të mungesave në burime energjitike dhe lëndë të parë, por pikërisht për të stimuluar ndjenjën e përpjekjeve, shijen e punës dhe kapacitetin e novacioneve që karakterizojnë francezët kur kanë besim në veten dhe udhëheqësit e tyre.



23 prill 2014

Biblioteka Kombëtare, në Ditën Ndërkombëtare të Librit organizon një aktivitet në nder të përkthyesit Misto Treska.

Megjithë epokën e vështirë, Presidenti i Republikës ka ditur ta çojë përpara shoqërinë tonë, drejt një drejtësie, lirie dhe barazie më të madhe. Shembujt që mund të sjellim në këtë drejtim janë të shumtë, si rritja e përgjegjësive të gruas, e dreja e votës në moshën 18 vjeç dhe masat konkrete që janë marrë në favor të njerëzve të moshuar, të atyre me aftësi të kufizuara apo të kategorive shoqërore më pak të favorizuara.

Gjithë këtyre u shtohet veprimi determinues i Presidentit të Republikës për ngjalljen e ndërgjegjes ekologjike, për vlerësimin e punës së dorës e nxitjen e arsimit teknik, si dhe në vlerësimin e pasurisë tonë kulturore kombëtare.

Nën nxitjen e kryetarit të shtetit, vetë jeta politike ka pësuar shndërrime të thella, sikundër janë çmpirja e debatit politik dhe vëmendja më e madhe që i kushtohet rolit të opozitës.

Detyrat qeveritare më kanë dhënë rast, prej shumë vjetësh, të udhëtoj në të gjitha kontinentet. Ato që kam përjetuar më mundësojnë të them se, në qoftë se Franca mëshiron gjithmonë lirinë, ajo është bërë, gjithashtu, vendi i paqes dhe barazisë. Pasi kam vizituar në kampet e tyre refugjatë të juglindjes aziatike, Afganistanit e Afrikës, nuk harroj të sjell para jush besimin dhe mirënjohjen që shprehin vazhdimisht ndaj vendit dhe presidentit tim.

Veprimi ndërkombëtar i Valeri Zhiskard D'Esten çmohet nga të gjithë. Kujdesi i tij për të ndërtuar një rend ekonomik më të drejtë, vullneti i tij për të ruajtur të drejtën e popujve për të vendosur vetë për fatet e tyre, përpjekjet e tij për të ndërtuar një Europë demokratike, i sigurojnë një lavdi të pakundërshtueshme dhe e bëjnë për Francën të pazëvendësueshëm. Për ata që asiprojnë për më shumë liri, ose që dëshirojnë të ruajnë dinjitetin e tyre njerëzor, Valeri Zhiskard D'Esten është një simbol shprese.

Kur historianët të shkruajnë historinë e Francës së shek. XX, do e vendosin pranë Klermonson, që e forcoi edhe më shumë Republikën me patriotizmin e tij dhe pranë De Golit, që ka ditur të mëshirojë vyrtytet më fisnike të Francës. Valeri Zhiskard D'Esten do të paraqitet si njeriu që pa dhunë e revolucion e shndërroi vendin e tij në një vend modern, liberal dhe të aftë të zotërojë të ardhmen e vet.

Gjatë periudhës 1979-1981, kur Misto Treska ushtronte detyrën e Ambasadorit:

- Sekretar i Parë i Partisë së Punës të Shqipërisë: Enver Hoxha.
- Presidentë të Shqipërisë: Haxhi Lleshi.
- Kryeministër i Shqipërisë: Mehmet Shehu.
- Ministra të Jashtëm të Shqipërisë: Nesti Nase.
- Presidentë (kryeministra) të Francës: Valéry Giscard d'Estaing.
- Kryeminsitër: Jacques Chirac, Raymond Barre.
- Ministra të Jashtëm të Francës: Louis de Guiringaud, Jean François-Poncet, Claude Cheysson.

Viti 1980 Dosja nr. 531 Titulli i dosjes: B III-6/a Franca

Deshifrim / Nr. 100 Datë 14.I.1980

Ministrisë së Jashtme

Marks Urban, kryeredaktor i gazetës *Franc Futboll* i bëri një vizitë Haxhiut në përfaqësi. Ai u shpreh për shkëmbime të ekipeve të futbollit dhe se ishte i gatshëm të kontribuonte në këtë drejtim. Duke komentuar artikullin rreth Jugosllavisë në revistën *Figaro*, ai tha se BS, pas agresionit në Afganistan nuk mund të ndërmerrte një tjetër, siç është fjala për Jugosllavinë, sepse më parë i duhet të qetësojë opinionin botëror dhe të tij brenda. Kjo, tha Marks, mund të jetë periudhë vitesh. Por sipas tij, francezët mendojnë se BS tani për tani nuk do të angazhohet me veprime në Europë, sepse është i zënë me veprime aktive në zonat e Gjirit Persik, Oqeanin Indian, vende që rrethojnë Kinën dhe ku realiteti i BS, Kinës e Amerikës po bëhet gjithnjë e më i mprehtë.

Misto

Franca dhe çështje të trajtuara nga Ministria e Jashtme në marrëdhënie me të

Gjatë periudhës kur Misto Treska ushtronte detyrën në Francë, çështjet kryesore të trajtuara nga Ministria e Jashtme e Shqipërisë në marrëdhëniet me Francën (sipas protokollit dhe arshivës të kësaj ministrie) kanë qenë: aktivitete me rastin e festave kombëtare; Ansambli ynë në Francë; ftesa për veprimtarinë kulturore e artistike; marrëdhëniet politike dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve; njoftime të përfaqësisë në Paris mbi takimet e bisedat me diplomatë e personalitete franceze, opinione etj.; veprimtaritë e zhvilluara nga shoqata e miqësisë Francë-Shqipëri dhe e miqve francezë ndaj vendit tone; shtypi, radio, televizioni dhe opinioni publik francez për vendin tonë si dhe çështje që lidhen me mbarëvajtjen e studentë universitarë dhe pasuniversitarë etj.

Në tabelën më poshtë tematika e këtyre marrëdhënieve paraqitet në mënyrë të detajuar. Me kryq janë shënuar, poshtë vitit përkatës, se çfarë çështjesh janë trajtuar.

Burimi: Fondi i arshivës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Vitet 1979, 1980, 1981, Franca.

Çështja	1979	1980	1981
Aktivitete festash kombëtare dhe data historike.	x	x	
Ansambli ynë në Francë.	x	x	
Bashkëpunimi ndërmjet Akademisë të Shkencave dhe universiteteve.		x	
Bisedimet me AIR Francë. Radiogram dërguar përfaqësisë Paris mbi bisedimet me AIR Francë për të ulur në Rinas një avion francez.	x		x
Çështja e Kadaresë.		x	
Delegacionet tona në Francë.		x	
Dërgim e marrje materialesh.	x		
Dërgim materiale dhe dhuratash.		x	
Festivali i filmit në Kanë.	x		
Ftesa për aktivitete të ndryshme kulturore e sportive.	x	x	
Info e Ministrisë së Arsimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi vizitën e grupit të kineastëve francezë në Shqipëri.			x
Info rreth takimeve me diplomatë të përfaqësisë franceze në Tiranë.			x
Info të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe përfaqësisë Paris dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në panairin e Parisit.			x
Info të përfaqësisë Paris rreth botimit të veprës "Eurokomunizmi është antikomunizëm".			x
Info të përfaqësive në Paris mbi temën "Gjendja e konomike të Francës pas ardhjes në pushtet të partisë socialiste".			x
Kërkesë e qeverisë franceze për përkrahjen tonë për kandidaturën që ka paraqitur Franca për postin e drejtorit të Epizootisë.		x	
Kongresi i 23-të i Partisë Komuniste Franceze.	x		
Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me përfaqësinë në Paris dhe Ministrinë e Arsimit për ardhjen e mjekëve francezë në Shqipëri.			x

Çështja	1979	1980	1981
Korrespondencë e Albturizmit me Ministrinë e Punëve të Jashtme për lidhje kontrate me firmat turistike franceze e italiane.			x
Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me drejtorinë e RTSh për të marrë filma në Francë dhe pjesëmarrje në festival etj.			x
Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me Ministrinë e Bujqësisë mbi ftesat dërguar vendit tonë për të marrë pjesë në Kongresin Europian.			x
Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme me përfaqësinë Paris mbi vizitën e specialistëve francezë të bujqësisë në Tiranë.			x
Marrëdhënie ekonomike ndërmjet dy vendeve.	x	x	
Marrëdhëniet kulturore, teknike e shkencore me Francën.		x	
Marrëdhëniet politike me shtetet e tjera.	x	x	
Marrëdhëniet politike ndërmjet dy vendeve.	x	x	
Mbi botimin e veprave të Enver Hoxhës në Francë.	x		
Mbi çështjen e vendosjes së linjës ajrore me Francën.		x	
Mbi filmin "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"	x		
Mbi ftesat për pjesëmarrjen e vendit tonë në panaire, simpoziume etj.		x	
Mbi gjendjen e brendshme politike.	x	x	
Mbi gjendjen ekonomike në vend dhe marrëdhëniet ekonomike me shtetet e tjera.	x	x	
Mbi grupet parlamentare të miqësisë ndërmjet dy vendeve.	x		
Mbi planet kulturore ndërmjet dy vendeve.	x		
Mbi shkeljen e ujrave franceze nga anija "Vlora".		x	
Mbi tërmetin e 15 prillit në vendin tonë.	x		
Mendime të prof. Milezit për Hysni Kapon.		x	
Njoftim i Lidhjes së Shkrimtarëve për Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi ftesën që i është bërë Ismail Kadaresë nga një klub francez.			x
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi dërgimin e farërave franceze në Shqipëri.			x
Njoftim i përfaqësisë Paris mbi dërgim librash etj.			x
Njoftim i përfaqësisë Paris mbi ftesën që i është bërë vendit tonë për të marrë pjesë në festivalin e librit.			x
Njoftim i përfaqësisë Paris mbi kronologjinë e ngjarjeve ndërkombëtare për vitet 1974-1980.			x
Njoftime të përfaqësive respektive, Paris e Tiranë, mbi një artikull për punët e jashtme shkruar nga O. Stirn.			x
Radiogram i Ministrisë së Punëve të Jashtme me Drejtorinë e Arkivave për të dërguar dy arkivistë në Francë për specializim.			x
Radiograme dhe korrespodenca të Ministrisë së Punëve të Jashtme me përfaqësinë në Paris dhe Ministrinë e Transporteve për bisedimet tregtare me Francën.			x
Radiograme shkëmbyer me përfaqësinë Paris mbi dërgim specialistësh të ndryshëm në Francë dhe anasjelltas.			x

Çështja	1979	1980	1981
Radiograme shkëmbyer me përfaqësinë Paris mbi kurimin e shtetasve tanë në Francë & qytetarë shqiptarë që shkojnë për kurim në Francë.	x		x
Radiograme të përfaqësisë në Bukuresht ku personalitete franceze interesohen për vetëvrasjen e Mehmet Shehut.			x
Radiograme të përfaqësisë në Paris mbi takimet e bisedat me diplomatë e personalitete franceze, opinione etj.	x	x	x
Radiograme të përfaqësisë në Paris mbi takimet me gazetarë e profesionistë francezë. Opinionet e tyre për vendin tonë.	x		x
Radiograme të përfaqësisë Paris mbi emërimin e ambasadorit të ri francez.			x
Radiograme të përfaqësisë Paris mbi marrëveshjen nënshkruar me libraritë franceze për shkëmbim libri.			x
Radiograme të përfaqësisë Paris mbi pritjet e organizuara me rastin e festave dhe datave historike.			x
Radiograme të përfaqësisë Paris mbi rezultatet e realizimit të planit në sektorin e tregtisë me Francën.			x
Radiograme të përfaqësisë Paris mbi studentët dhe pasuniversitarët në Francë (dhënie burse, sjellja etj).	x	x	x
Radiograme të përfaqësisë Paris mbi vizitën e delegacionit tonë në Francë.			x
Radiograme të përfaqësisë Paris me Ministrinë e Punëve të Jashtme mbi marrëdhëniet politike të Francës me shtetet e tjera.			x
Radiograme të përfaqësisë Paris, Meksiko, Buenos Aires që flasin mbi gjendjen politike në Francë.			x
Radiograme të përfaqësive tona ku diplomatë francezë flasin me simpati për vendin tonë.			x
Radiograme të shkëmbyera me përfaqësinë në Paris mbi aktet terroriste të kryera ndaj shtetasve tanë dhe zyrës së miqësisë.			x
Raport mbi vizitën e delegacionit bujqësor në Francë.			x
Raport, relacion i përfaqësisë Paris mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me Francën, Belgjikën, Hollandën e Luksemburgun.			x
Relacion dhe informacione që flasin mbi fushatën e zgjedhjeve presidenciale në Francë, mbi socializimin e tipit III etj.			x
Relacion i Akademisë së Shkencave dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi vizitën e profesorëve francezë në Shqipëri.			x
Shit-blerje filmash televizë.	x		
Shtypi, radio, televizioni dhe opinioni publik francez për vendin tonë.	x	x	x
Specialistë pasuniversitarë dhe të sektorëve të tjerë & Specialistët tanë në Francë dhe francezët te ne.	x	x	
Takim i MPJashtme Shqipëri me MPJashtme Francë.		x	
Takime me militantë komunistë francezë.	x		
Takime të ambasadorit tonë në Paris me personalitete të larta franceze, si dhe të ambasadorit francez në Tiranë.	x		
Veprimtari e shoqatës së miqësisë Francë-Shqipëri dhe e miqve francezë ndaj vendit tonë. Kërkesë e paraqitur.	x	x	x, x
Vizita e Andreanit në vendin tonë.	x,x		

LIDHJA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË

Nr. 121 Prot.

Tiranë, me 22-5- 1980

MPJ ARKIVI
VITI: 1980
DOSJA: 528 FLETA: 45

MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
Drejtorisë së Dytë

Tiranë

Shkrimtari Ismail Kadare ka marrë një letër prej firmës kinematografike franceze " Films 66" , e cila po pergatitet për xhirimin e filmit " Gjenerali i ushtrisë së vdekur ", ku i kërkohet që ai të shkojë në Francë për të parë edhe një herë skenarin e filmit .

Problemi qëndron kështu :

Në shkurt të këtij viti kineastët francezë erdhën në Shqipëri për të diskutuar me autorin e romanit skenarin e pergatitur prej tyre . Ky diskutim ishte një kerkesë e kontratës, bërë me qëllim, që pa u angazhuar në bashkëautorësi me kineastët e huaj, të kishim një kontroll mbi veprën .

Për të patur mundësi që skenari të shqyrtohej sa më me kujdes, u kërkua prej autorit një shtyrje e afatit të diskutimit, kështu që kineastët francezë u larguan, pa i marrë verrejtjet tona.Ndërkaq u krijua një grup pune i përbërë nga Anastas Kondo,Javer Malo, Vangjush Zallemi,Viktor Gjika dhe autori i romanit Ismail Kadare. Grupi i punës pasi e shqyrtoi skenarin me kujdes formuloi verrejtjet dhe sugjerimet ,të cilat autori ua dërgoi me shkrim kineastëve të huaj .Këto konsistonin në :

1) Verrejtje konkrete,kryesisht episode,pasazhe ose sekuenca që duhej të hiqeshin ose të zëvëndësoheshin sepse nuk ishin konform librit.

2) Sugjerime për dy çeshtje: e para të dalë më mirë lufta e popullit tonë, e dyta, të dalë më mirë pozicioni i Shqipërisë sot në botë.

Ndërsa verejtjet ishin tepër precize sepse tregoheshin konkretisht në tekst, nuk mund të thuhet e njejta gjë për sugjerimet, të cilat do të realizoheshin me anë të shtesave dhe që ishin dëshira tona që filmi të dalë sa më i favorshëm për vendin tonë dhe luftën e popullit tonë .Këtu duhet theksuar se përsa i përket sugjerimeve,realizimi i tyre varet kryesisht nga mirëkuptimi i kineastëve francezë.Veç kësaj duke qenë se kemi të bëjmë me kineastë të huaj, për të cilët kuptimi i luftës e heroizmit është i ndryshëm nga i joni, kuptohet se transmetimi i këtyre sugjerimeve ishte i vështirë

MPJ ARKIVI
VITI: 1980
DOSJA: 518 FLETA: 16

të bëhej me sukses me korespondencë.

Në 6 maj 1980 ,kineastët francezë i dërguan një letër autorit ku i njoftojnë se morën verrejtjet e tij, me të cilat janë pothuajse krejtësisht dakord.Po në këtë letër ata kërkojnë që pas 15 gushtit autori të shkojë në Francë, për të parë edhe një herë bashkë me tre skenaristët e " Films 66" skenarin e filmit .

Mendojmë se kjo kerkesë që bëhet pëej kineastëve francezë është e favorëshme për ne, sepse na jep edhe një herë mundësi për përmirësimin e skenarit dhe sidomos për shpjegimin gojarisht të sugjerimeve që kanë të bëjnë me evidencimin e luftës së popullit tonë dhe me pozitën e Shqipërisë sot në botë, dy mungesat kryesore të skenarit .

Gjithashtu duhet patur parasysh se me këtë kerkesë kineastët francezë e shlyejnë detyrimin e tyre ndaj autorit të veprës , prandaj është e nevojshme të përfitohet prej këtij rasti të fundit, që na jepet.

Për këto arësaye ne mendojmë se e kërkon interesi i punës që shkrimtari Ismail Kadare të kryejë këtë sherbim jashtë shtetit në kohën që kërkohet .

Bashkangjitur ju dërgojmë letrën e " Films 66" .

Lutemi na jepni mendimin tuaj për sa më sipër; që të vemë në dijeni organin përkatës pranë Kryeministrisë.

K R Y E T A R I
(Dritëro Agolli)

Viti 1980, Dosja: 528, Fleta: 18. Franca Tiranë, më 3.6.1980

DREJTORIA E DYTË / Nr. 1648/1

Lënda: Për vajtjen e Ismail Kadaresë në Francë
Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve / (Sektorit të jashtëm) / TIRANË

Në përgjigje të shkresës tuaj Nr. 191, datë 22.5.1980, ju njoftojmë se jemi dakord me propozimin tuaj që Ismail Kadare të shkojë në Francë për të marrë kontakte dhe të bisedojë me përfaqësuesit e firmës "Films 66" për realizimin e filmit artistic "Gjenerali i ushtrisë së vdekur".

Zëvendëskryeministri / (Ksenofon Nushi) (Firma)

Të rikthehet në organin e shifrës
ndalohet me nxjerrë kopje

DESHIFRIM

B III-3 Franca

TEPËR SEKRET

Nr. Fletës 116

Nr. 33516 Nga: Parisi

Shoq. Tuffa Caun — L. Roun — L. Lisuer — 4K

PËR SHËNIME
Mora njoftim
Data
ora

Nr. 2358 Data: 29.9.1980

MINISTRISE JASHTEME

Kadareja qysh me 18 shtator mori nga Pikoli variantin e fundit te skenarit. Ky ka mjafte ndryshime dhe permiresime ne krahasim me ate qe u studju ne Shqiperi por ka akoma disa ane te dobeta. Kadarej arriti te heqe nga skenari pjeset e papershtateshme dhe te shtoje disa ane sidomos per te vene me mire ne pah luften nacinal clirimtare (vijon)

MPJ ARKIVI
VITI: 1980
DOSJA: 528 FLETA: 17

I DEKLASIFIKUAR

kthehet në orga rës

het me nxjerrë

DESHIFRIM

TEPËR

Nr. Fl

Nr. 33517 Nga: Parisi

4K

PËR SHËNIME
Mora njoftim
Data
ora

Nr. 2359 Data: mbaroi

dhe ate qe perfaqeson Shqiperia ne boten e sotme. Kadareja mendon se me keto ndryshime e shtesa skenari do te kete nje permiresim te dukshem. Puna per skenarin duhet te perfundoje rreth dates 3-4 tetor.

MPJ ARKIVI
VITI: 1980
DOSJA: 528 FLETA: 18

I DEKLASIFIKUAR

Misto

U-muar në dorëzim		Kur filloi deshifrimi		Kur mbaroj deshifrimi		Firma e shifrantit	Firma e kontrolluesit
data	ora	data	ora	data	ora		
		1.10	11.20	1.10	11.40	H.J.	

MPJ ARKIVI
VITI: 1978
DOSJA: 460 FLETA: 34

Mbi disa çështje të shkëmbimeve kulturore me Francën

- Programi i shkëmbimeve kulturore, shkencore dhe teknike me Francën, që vazhdon të zbatohet aktualisht, është nënshkruar më 19 qershor 1978 në Tiranë dhe i mbaron afati po në këtë datë të vitit 1980.

- Pala franceze gjatë këtij viti herë pas here ka çfaqur interes të veçantë për të realizuar të gjitha pikat e parashikuara në program nga të dyja palët. Më 28 Mars Ambasada franceze na dorëzoi dhe një Aide-Memoire, në të cilën përmëndeshin cilat pika mbeteshin pa u realizuar akoma, sidomos nga pala jonë, dhe theksohej gadishmëria për të ndihmuar në realizimin e tyre brënda afateve. Konkretisht në këtë Aide-Memoire theksoheshin pikat si vijon:

1)- Pala franceze mund të akordojë 36 bursa për studentë ose profesorë të frëngjishtes, me qëllim që të perfeksionojnë njohjen e gjuhës franceze. Mund të mendohet për 4 stazhe për një kohë prej 9 muajsh (nga të cilat dy mund të ofrohen për profesorë të universitetit të Tiranës dhe dy për pedagogë të shkëllës së gjuhëve të huaja).(Paragrafi 6).

2)- Mbeten edhe disa bursa shkencore për të shfrytëzuar për vitin 1978-79. Ky numur mund të rritet, por duhet që propozimet e stazhit të bëhen para 15/4/79.

Nga ana tjetër, nëqoftëse pala shqiptare dëshëron të ngrejë koston e bursave që ofron pala franceze për vitin 1979-1980, duhet të preçizojë këtë gjatë muajit Prill 79.(Parag.10).

3)- A dëshëron pala shqiptare material pedagogjik modern për mësimin e frëngjishtes për shkëllën e gjuhëve të huaja?

A dëshëron material për mësimin e fërngjishtes në radio dhe televizion? (Paragrafi 4).

4)- Pala franceze është e gatëshme të presë specialistë shqiptarë në fushat që citohen në paragrafët 3 dhe 9. Në paragrafin 3 citohet:"Pala franceze është e dispozuar të organizojë gjatë verës, nëqoftëse pala shqiptare dëshëron, një stazh specializimi gjuhësor për profesorë e specialistë shqiptarë të lëndëve shkencore ose teknike, të cilët kanë njëfarë njohurie të gjuhës frënge. Forma e këtij stazhi do të rregullohet në rrugë diplomatike.

Në paragrafin 9 të programit citohet(në mënyrë të përmbledhur) :- Të dy palët përkrahin sipas nevojës një numur

MPJ ARKIVI
VITI: 1974
DOSJA: 460 FLETA: 31

ftesash dhe misionesh për personalitete e specialistë në fu-shën e shkencave ekzakte, themelore e të aplikuara të shkenca-vemjeksore dhe të teknikës. Këto misione janë 4-5 për çdo palë dhe për një kohë të përgjithëshme prej afro 3 muaj në secilin vend.

Pala shqiptare është e dispozuar të presë: një mathemati-cien francez 3 javë për iformatikën e administrimit; tre mjekë për renimacionin e të porsa lindurve dhe të obstetrikës për rreth 3 javë.

Pala franceze shpreh dëshirën të dërgojë në Shqipëri 3-4 specialistë të bujqësisë për prodhimin e qumështit e mishit. Pala shqiptare do shqyrtojë mundësinë e përmbushjes së kësaj dëshire.

Pala franceze është e dispozuar të presë specialistë shqip-tarë për të studjuar problemet në fushat: bujqësi, energji, kimi, bimë mjeksore, siderurgji të metalurgjisë e metaleve jo feroze, industri mekanike, industri elektrike, informetike dhe elektronike, teknikën e shitjes në tregun ndërkombëtar dhe industritë agro-ushqimore.

Lidhur me 4-5 misionet për një afat prej 3 muajsh, në Aide-Memoire të saj Ambasada franceze theksen se ky numur mund të rritet mbi bazën e reciprocitetit(sipas paragrafit 21).

- Në takimin e saj në Komitet, atasheja e kulturës Migela,pyeti: "A mendoni se mund të ~~kem~~ zgjerojmë programin kulturor që kemi? Edhe propozime të reja jashtë programit, po të keni, i bëni, sepse ne jemi për zgjerimin e marrëdhënieve kulturore me Shqi-përinë."

- Gjatë këtij viti pala franceze ka propozuar në bazë të progra-mit, të vijnë në vendin tonë specialistë në këto degë:
  - ~~5~~ specialistë në fushën e bujqësisë(ekonomia dhe siste-mimi i fshatit, për mishin, qumështin dhe fruta-zarza-vate)
  - ~~5~~ specialistë për të studjuar në fushën e shkencave sho-qërore, art-kulturë dhe hist~~ori~~)
  - 1 specialist për t'u njohur me rrjetin urbanistik.

  Që të gjithë këta specialistë janë aprovuar për të ardhur.
- Janë aprovuar të vijnë gjithashtu 3 mjekët për reanimacionin e të porsalindurve,*nga të cilët njëri do vijë këtë vit dhe dy vitin e ardhëshëm. Për mathematicienin akoma nuk ka njof-tuar pala franceze kur do të vijë.

MPJ ARKIVI
VITI: 1974
DOSJA: 460 FLETA: 38

- Pala jonë gjatë këtij viti ka dërguar në Francë 9 mjekë, 7 prej të cilëve do qëndrojnë 6 muaj dhe 2 do qëndrojnë 3 muaj. Kemi dërguar gjithashtu dy punonjës shkencorë të Akademisë për dy muaj për kërkime arkivale dhe bibliografike.

- Ambasada franceze në mënyrë sistematike dorëzon(kryesisht falas) filma kronikalë dhe shirita me muzikë franceze për Radio-Televizionin tonë, si dhe libra frëngjisht(literaturë) për Universitetin tonë; këtë e bën duke u mbështetur në një pikë të programit kulturor, ku parashikohen gjëra të tilla.

- Gjatë muajit maj këtë vit Ambasada franceze me notë na dorëzoi një listë me adresat e institucioneve pedagogjike të arkitekturës në Paris, me qëllim studimi nga ana jonë për të bërë propozime kandidaturash nga ne për në këto institucione.

- Ambasadori francez këtu ka treguar interes të veçantë pë r të ndjekur gjëndjen e bazës materiale si dhe zhvillimin e nivelin e leksioneve në gjuhën frënge në fakultetin tonë. Gjatë vizitës që ai bëri kohët e fundit në fakultet, ngriti këto:

1)- Propozoi që ne të dërgojmë këshilltarë pedagogjikë(metodistë apo specialistë të fushave të bdryshme) si për universitetin, ashtu dhe për shkollat e mesme. Foli për kurse e stazhe të ndryshme për specializim në Francë. Sugjeroi që nga ana e jonë mund të mendohej për dërgim studentësh pasuniversitarë në shkollën e lartë të interpretëve në Paris.

2)- Shprehu gadishmërinë për të zëvëndësuar aparaturat e tanishme që ka fakulteti për mësimin e frëngjishtes me aparatura të reja nga më modernet. Këtë e ka shprehur e dhe në takim në Komitet.

3)- U interesua për raportin midis studentëve të gjuhës anglisht dhe frëngjisht.

4)- Gjatë bisedës në fakultet u shpreh se në Francë ka interes për të njohur Shqipërinë, përvojën e saj, historinë dhe letërsinë shqiptare. Theksoi se përveç disa personaliteteve, që kanë pasë rast të vijnë në Shqipëri, francezi i mesëm nuk e njeh Shqipërinë, ose krijon ide të gabuar për të. Prandaj duhen shtuar bisedat, temat nga specialistët që shkojnë në Francë enkas për këtë qëllim, ose dhe ata që shkojnë për punë arkivale njëkohësisht të zhvillojnë edhe biseda të ndryshme për Shqipërinë. Përmëndi jehonën e bisedës së I.Kadaresë në Bordo.

MPJ ARKIVI
VITI: 1978
DOSJA: 4 BOTLETA: 34

- Çdo vit një ose dy pedagogë francezë kanë dhënë mësim për gjuhën frënge në fakultetin e Universitetit tonë. Kjo në bazë të një pike në programin kulturor, që parashikon një gjë të tillë. Edhe për vitin 1979-80 i kemi propozuar palës franceze të ba dërgojë dy pedagogë për gjuhën frënge në fakultet.
- Duke qenë parashikuar edhe në programin kulturor, gjatë muajit qershor po pregatitet nga ana jonë, në bashkëpunim me Ambasadën franceze, organizimi i javës së filmit francez në vendin tonë.
- Me rastin e shkrimit të një artikulli në gazetën "Drita" për 100 vjetorin e piktorit përparimtar francez, Honore de Domje, Ambasada franceze ofroi ndihmën e saj për të na dërguar materia plotësuese nga Franca për t'u thelluar më tej në njohjen e këtij piktori. Ne në parim pranuam ofertën e saj.
- Në mars të këtij viti pala franceze ftoi Drejtorin e Televizionit tonë për të marrë pjesë në ekspozitën ndërkombëtare në Kan të Francës, ku paraqiten aparaturat më moderne të Televizionit francez. Shpenzimet e qëndrimit në Francë ishin të pal franceze. Kjo ftesë i qe bërë TV tonë edhe vitin e kaluar, por qe lënë në heshtje. Edhe këtë vit TV ynë nuk tregoi interes për t'iu përgjigjur ftesës.
- Për t'u shënuar është se pala franceze në programin aktual kulturor midis dy vendeve paksoi numurin e muajve të bursave nga 126 më parë, në 100 tani.
- Lidhur me pritjen e Ansamblit tonë në Francë, pala franceze ka treguar rezerva vitin e kaluar. Delegacioni kulturor francez, që ishte vitin e kaluar në qershor për nënshkrimin e programit kultukror, u rezervua që të mos e fuste pritjen e Ansamblit në program. Pranoi vetëm të shkruhej kjo si një dësh rë e palës shqiptare për të dërguar Ansamblin në Francë, pa ndonjë angazhim të plotë.

Vetëm tani, ditët e fundit, Ambasadori francez njoftoi se pala franceze do të presë Ansamblin tonë në vjeshtë 1980, nën kujdesin e MPJ franceze. ~~Për këtë pala jonë ra dakort në parim~~

- o -

NPJ ARKIVI
VITI: 1981
DOSJA: 57 FLETA: 2

RAPORT

informativ per muajin Janar 1981

1. Marredheniet e vendit tone me Francen, Belgjiken, Hollanden dhe Luksemburgun.

• Gjate kesaj periudhe, ne biseda te ndryshme me funksionare te MPJ franceze eshte ngritur çeshtja e vizites se Stirnit ne Shqiperi. Pala franceze ngul kembe qe vizita te behet para zgjedhjeve presidenciale. Vete Stirni, me te pranuar ftesen, propozoi muajin mars ose prill 1981. Me nje fjale, per palen franceze çdo gje ka qene vendosur qe me pare. Cilat mund te jene arsyet e nje insistimi te tille? Mund te jene personale : Stirni do te desheronte te mbetej si personaliteti qe kryesoi te parin delegacion te rendesishem qeveritar francez ne Shqiperi. Por mund te jene edhe shteterore : Perballe pasigurise ne zgjedhjet e ardheshme, D'Esteni do te desheronte qe viziten ne Shqiperi ta rregjistronte ne favor te aktivitetit 7 vjeçar te qeverisjes se tij.

• Edhe gjate muajit Janar, shtypi francez ka vazhduar te shkruaje per Shqiperine. Deri tani, kemi marre 9 artikuj e shkrime midis te cileve nje reportazh i gjate ne gazeten "Libération" (organ i Partise socialiste) qe boton nje interviste te sh. Dritero Agolli dhene vizitorit Yves Michaud e qe i kushtohet zhvillimit te artit ne vendin tone. Artikujt e tjere jane njoftime te shkurtra mbi "statistikat ekonomike inkurajuese" te zhvillimit te vendit tone, mbi thirrjen per "normalizim te marredhenieve" bere nga social-imperialistet sovjetike dhe mbi "pergjigjen" qe vendi yne i beri ketyre ne fjalimin mbajtur me rastin e 35 vjetorit te themelimit te RPSH.

• Me 24 janar 1981, Komiteti i shoqates se miqesise France-Shqiperi per qytetin e Rubese organizoi aktivitete te ndryshme per te bere sa me te njohur punen dhe arritjet e vendit tone ne ndertimin socialist te vendit nen udheheqjen e Partise me shokun Enver Hoxha ne krye. Me kete rast u botuan shkrime edhe ne shtypin lokal te Rubese.

• Edhe gjate ketij muaji jane bere kontakte te vazhdueshme per perhapjen e mendimit te Partise. Jane organizuar takime me drejtues te shoqatave te miqesise ne qender dhe ne periferi per ti nxitur qe te organizojne aktiviteti te rendesishme ne kuadrin e 40 vjetorit te themelimit te PPSH dhe te Kongresit te 8-te te saj.

.../..

NPJ ARKIVI
VITI: 1981
DOSJA: 376 FLETA: 3

Keshtu, shoqata e miqesise France-Shqiperi ka hedhur idene e organizimit te nje koloku mbi librin e shokut Enver "Eurokomunizmi eshte antikomunizem". Aktiviteti eshte parashikuar te behet nen drejtimin e nje grupi te kerkimeve nderdisiplinore.

Pune e dendur dhe e planifikuar eshte bere ne drejtim te shtypit. Me takt, jane bere sugjerime qe te shkruhet per qendrime dhe ngjarje te vendit tone dhe sidomos per veprat e sh. Enver. Ne gazeten " Le Monde " jane dorzuar tre artikuj te shkruar per vendin tone nga gazetari T. Schreiber. Sipas Fontenit, ato do te fillojne te botohen se shpejti. Nga gazetat " Le Quotidien de Paris" dhe "La Croix" kemi premtime se do te shkruajne per librin e shokut Enver "Hrushovianet".

Po vazhdojme punen ne drejtim te UNESCO-s me qellim qe te shfrytezojme mundesite per te propaganduar vendin tone. Jemi ne bisedime per botimin e ndonje libri te literatures artistike shqiptare, per organizimin, ne vjeshten e vitit te ardhshem, te nje jave te kultures shqiptare dhe po marrim kontakte per te organizuar aktivitete te tilla me mia te Ambasades ne qytete te ndryshme ne bashkepunim me klube te UNESCO-s.

Gjate ketij muaji hyme ne kontakt me bashkine e qytetit ne Le Mans dhe drejtorine e muzeumit te ketij qyteti per te pare mundesite praktike te organizimit te nje jave te kultures shqiptare ne ate qytet.

• Gjate muajit Janar nga sektori i tregtise jane ndjekur keto probleme kryesore :

Ne mbeshtetje te detyres se ardhur nga Ministria e Tregetise se Jashtme per mineralin e kromit dhe te ferro-kromit, jane marre kontakte me firmat franceze, belge, te Luksemburgut dhe spanjolle lidhur me interesimin e tyre per keta artikuj per vitin 1981 dhe veçanerisht per tremujorin e pare. Ne baze te nje programi, u organizuan takime ne Bruksel dhe me 6 firma belge qe trajtojne keta artikuj. Rezultoi se per ferro-kromin ka nje perspektive per tremujorin e pare dhe per gjithe vitin 1981 ndersa per mineralin e kromit, tani per tani, nuk ka kerkesa;

Me firmen franceze CEP dhe firmen spanjolle EXIMTRADE kane vazhduar bisedimet per kontraktimin e nenprodukteve te naftes. Po keshtu, per keta artikuj kemi marre takime edhe me nje firme portugeze e cila se shpejti do te njoftoje kerkesat e veta. Gjate janarit, u livrua nje anije me tre mije ton gazoil per firmen franceze CEP.

NPJ ARKIVI
VITI: 1981
DOSJA: 59 \ FLETA: 6/

Mbi bazen e kredive te çelura nga firmat franceze dhe ndermarrjet tona te tregtise se jashtme, eshte ndjekur livrimi i mallrave perkatese ne te dyja drejtimet. Keshtu, nga ana e ndermarrjeve tona jane livruar konfeksione, peshqira, kapse rrobash, karrike, etj. Nga firmat franceze ka vazhduar livrimi i paisjeve elektrike, argjiles, daltave te çpimit per naften si dhe i pjeseve te ndryshme te kembimit.

Kemi marre kontakte me perfaqesuesit e Ministrise se Ekonomise se Hollandes si dhe te Ministrise se jashtme te Belgjikes per zhvillimin e bisedimeve per nenshkrimin e proçes-verbaleve perkatese per vitin 1981. Propozimet e tyre i jane njoftuar Ministrise se Tregtise se Jashtme.

Kemi mbajtur kontakte me Ministrine e Jashtme te Frances lidhur me ardhjen e delegacionit tregtar.

Si problem ka dale mos çelja e kredive per paisjet e televizionit per firmen TOMSON si dhe per tre elektroeskavatore per firmen POCLAIN. Po keshtu, kane mbetur dhe disa kredi te tjera per firmat franceze, belge dhe hollandeze per te cilat jane vene ne dijeni ndermarrjet tona perkatese.

• Ne Bruksel, me 20 Dhjetor 1980 eshte krijuar klubi i punetorev te shqiptareve te Jugosllavise " Perparimi ". Vetem gjate diteve te para u rregjistruan rreth 1.000 persona. Per tu bere antar i shoqerise paguhet nje kuote vjetore prej 500 frangash. Ne diten e hapjes mori pjese edhe ambasadori jugosllav i cili i pershendeti te pranishmit ne gjuhen shqipe. Me daten 7 shkurt eshte parashikuar te behe inaugurimi zyrtar i klubit me pjesmarrjen e nje perfaqesuesi nga Prishtina. Thuhet se do te jete Nihat Islami.

Ne Keshillin e klubit bejne pjese kryesisht disa kosovare qe njihen si agjente te Ambasades jugosllave ne Bruksel. Deri tani nuk kane zhvilluar ndonje aktivitet. Kane perpiluar nje projekt statut, nje kopje te te cilit e disponojme edhe ne. Qysh tani, ndihet reaksioni i emigracionit serb te cilet, grupe grupe, shkojne ne klub dhe kendojne kenge serbe. Disa te tjere kane hapur fjale se me formimin e kesaj shoqerie shqiptaret do te rrihen me njeri tjetrin. Klubi frekuentohet edhe nga te arratisurit per te cilet nuk ka asnje kufizim. Formimi i ketij klubi eshte pritur mire nga emigracioni kosovar.

NPJ ARKIVI
VITI: 1981
DOSJA: 57 FLETA: 5

2. Gjendja politike, ekonomike, shoqerore, etj, ne France, Belgjike, Hollande dhe Luksemburg dhe marredheniet e tyre nderkombetare.

• Ne planin e brendshem, Franca eshte perfshire nga fushata e zgjedhjeve presidenciale. Jane paraqitur shume kandidatura por 5 jane kryesoret : Miterani, Marsheja, D'Esteni, Debreja dhe Shiraku Ndonse publikisht, secili kandidat ben fushate ne emer te partise qe perfaqeson, ka te dhena qe flasin per thurrje kombinacionesh te ndryshme politike te cilat mendohet se do te behen kryesisht ne favor te D'Estenit apo dhe te Miteranit qe jane edhe pretendentet kryesore për ne postin e Presidentit te Republikes.

Gjere eshte trajtuar gjate janarit qeshtja e caktimit te ministrave komuniste ne qeveri. Mendimi me i pranueshem eshte se kjo kerkese e paraqitur nga P.Komuniste synon pikerisht rrezimin e mundesise se Miteranit per tu bere president. Miterani, deri tani, ka refuzuar te prononcohet ndonse nxitet qdo dite nga komunistet qe ta beje nje gje te tille. Sigurisht Miterani ka arsyet e veta : po te shprehej ne favor ahere do akuzohej nga e djathta (te cilen ai eshte duke e perfaqesuar) se po kalon nga e majta dhe ideja e "pranimit te ministrave komuniste ne qeveri" sigurisht e tremb borgjezine franceze e cila, per rrjedhim, do ta siluroje kandidaturen e Miteranit. Ne rast se do te refuzonte publikisht pranimin ahere PK e cila nuk perjashtohet se punon ne favor te D'Estenit per shkak te marredhenieve te privilegjuara te ketij te fundit me BS, do te gjente nje justifikim te mire per te mos i dhene votat Miteranit. Miterani vetem deklaron se, me tu zgjedhur president, do te shperndaje Asamblene kombetare dhe kjo e zgjedh pastaj qeverine.

• Ka te dhena se "PKML" e Frances qe udhehiqet nga Zhyrkeja eshte futur ne nje krize te thelle. Sipas nje burimi, asaj nuk i kane mbetur me shume se 50 vete. Perveç gazetes javore, nuk boton gje tjeter sepse tani nuk e ka me as shtypshkronjen e saj.

• Muaji Janar ka patur nje densitet jo te zakonshem te aktivitetit diplomatik te Frances gje qe eshte shkaktuar nga shume faktore te brendshem si dhe te jashtem. Reagimi ndaj ketyre ngjarjeve e ka vene ne pozite te veshtire presidentin francez i cili ndodhet dicka me shume se tre muaj larg zgjedhjeve. Por, natyra e ngjarjeve ka qene e tille qe kerkonte mbajtje pozicionesh. Nga ana tjeter nuk duhet menduar se Franca eshte terhequr nga keto ngjarje. Inte-

NPJ ARKIVI
VITI: 1981
BOSJA: 55 FLETA: 61

6

resat elektorale e kane detyruar D'Estenin qe te ndermarre hapa te caktuara ne fushen e politikes se jashtme.

Ardhja e Reganit ne fuqi nuk shkaktoi ndonje reagim te madh te Frances drejt SHBA dhe politikes se saj. Pat komente, telegrame, etj, por hapa te caktuara qe do tu lejonin te tjereve nxjerrje konkluzionesh mbi te ardhmen e marredhenieve SHBA-France nuk pat. Por, indirekt gjerat u bene te qarta. Franca tregoi "deshiren e saj per te vazhduar dialogun e saj me BS". Kjo duhet te jete permbajtja thelbesore e mesazhit qe D'Esteni i dergoi Brezhnjevit. Kjo e dhene u botua ne shtypin francez me 27 janar, d.m.th., vetem 7 dite pasi Regani ishte vendosur ne Shtepine e Bardhe?

Nderkohe nga ana tjeter e Atllantikut filluan te bien presione mbi Francen dhe ato filluan ne piken e dobet te saj : ne ate ekonomike. Filloi nje rritje ritmike e vleres se dollarit e cila solli sigurisht mundesine e ngritjes se cmimeve te naftes. Nuk ka dyshim se nje mase e tille qe behet ne prag te fushates se zgjedhjeve ne France godet drejtepersedrejti presidentin francez.

Prova me e veshtire per diplomacine franceze gjate muajit janar ishte "bashkimi" Libi-Çad. Ky problem preku te gjitha partite politike franceze te cilat, nga ana e tyre, e shfrytezuan kete rast per te kritikuar politiken e D'Estenit. Ne shtresa te ndrysh me te vendit rilindi fryma e vjeter koloniale. Interesat e borgjezise franceze shtruan ne rend te dites problemin e sigurimit te nje pranie ushtarake franceze ne Afrike. Ne kete kuader, u kryen nje sere vizitash te Ponsese dhe te Stirnit ne nje sere vendesh afrikane.

Problemi i Çadit dhe "bashkimi" i ketij me Libine vuri perballe politiken franceze me ate sovjetike. Nuk ka dyshim se Libia vepron ne llogari te sovjetikeve. Per nje fare kohe u fol per nje "ashpersim" ne marredheniet midis Frances dhe BS por pastaj gjera erdhen duke u zbutur persa kohe ashpersohej gjendja ne Poloni dhe behej iminente nje nderhyrje ushtarake sovjetike ne kete vend.

Misto Treska

MPJ ARKIVI
VITI: 1981
DOS.: 57 FLETA: 7

AMBASSADE
DE LA RÉPUBLIQUE POPULAIRE SOCIALISTE
D'ALBANIE
EN FRANCE

131, RUE DE LA POMPE, PARIS 16e
TÉL. 553-51-32

547
18.II.81

Paris, me 11.2.1981

MINISTRISE PUNEVE TE JASHTME

T I R A N E

Nr. 66 .Prt.- Bashkangjitur ju dergojme informacioni per studentet e Bordose, te pregatitur nga shoku Haxhi Taga, sipas kerkeses se Ministrise Aresimit e Kultures te R.P.S. te Shqiperise.

A M B A S A D O R I
/ Misto Treska /

NPJ ARKIVI
VITI: 1981
DOSJA: 577 FLETA: 8

I N F O R M A C I O N

" Mbi disa kontakte me institucionet franceze, per problemet qe u kane dale 11 studenteve tane ne Bordo, gjate ketij viti mesimor.

Gjate muajit janar 1981,muarem takime me Qendren Nacionale te Organizatave Universitare dhe Shkollore me Depuis dhe me perfaqesuesin e bursave per te huajt ne M.P. Jashteme francez me André Couribiet,te cileve ju kerkuam sqarime per problemin e ekuj valences dhe per veshtiresite qe kane ndeshur studentet tane ne Bord Me te lartepermendurit, ne kerkuam te takoheshim qysh ne muajin dhje tor 1980,por ata per shkak pushimesh na i lane takimet ne fillim te muajit janar 1981.

Andre Couribet dhe Depuis na thane se te tentarit per tu futur ne shkollat e medha,eshte nje gje e mire dhe se eshte bere me kerkesesn e pales shqiptare, Ata, u shprehen,se e kishi te veshtire per te thene ne se e fitojne ose jo konkursin,sepse seleksionimi edhe per studentet franceze eshte shume i madh. Persa i takon çeshtjes se ekujvalences,thane gjithashtu se eshte problem delikat dhe se nuk ka formula ekzakte e te pergjitheshme,sepse kjo mua vet nga universitetet qe ndryshojne shume njeri nga tjetri ne percaktimin e ekujvalences? Ata shtuan se vitet e fundit,universitetet preferojne nxenes te mire dhe jo nga te dobetit qe nuk mund te marrin konkurset. André Couribet shprehu mendimin,se do te ishte mire, qe ne te mernim kontakte me profesoret e liceut te Michel Montaigne ne Bordo per ta pare konretisht kete problem.

Pasi i rregulluam takimet me pare me 23.1. 1981 shkuam ne Bordo dhe takuam me profesoet e studenteve tane ne Bordo. Per kete problem takuam dhe shkembyem mendime edhe me Robert Eskarpitin, i cili e mbeshteti organizimin e ketij takimi. Nder te tjera ai vuri ne dukje per veshtiresite qe do te ndeshen per te fitu konkurset e pranimet ne shkollat e medha. Ai shprehu gjithashtu mendimin,qe per ndonje student qe do te paraqitet shume dobet ne konkur dhe nuk mund te marre edhe ekujvalencen ne universitet,mund te futet ne I.U.T (Institut Universitaire Technique),qe zgjat 2-3 vjet,te cilet vitet e fundit pregatisin kuadro shume te mira per ekonomine.

(Pjesë nga raporti)

LUAN RAMA

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Francës, Republikën e Portugalisë dhe Principatën e Monakos.
Periudha: 1997-2001

I dërguar a.i. i Shqipërisë në Paris dhe Delegat i Përhershëm i Shqipërisë në UNESKO[1].
Periudha: 1991-1993



Datëlindja: 05 janar 1952.

Vendlindja: Tiranë.

Diplomë: 1974, Gazetari, Dega Gazetari, Universiteti i Tiranës.

Gradë shkencore: 1975, Master, "Gazetari", Dega Gazetari, Universiteti i Tiranës.

1995 Studime të thelluara në fushën audiovizuale, komunikim dhe kinematografi pranë Paris VII "Denis Diderot", Francë.

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, italisht.

Bashkëshortja: Silvana.

Fëmijët: Ilda, Sara.

Motoja: "Të përpiqemi të jemi qytetarë të botës, duke qenë njëkohësisht shqiptarë".

Luan Rama tregon se ka përshtatur shprehjen e Sokratit "Unë nuk jam as athinas dhe as grek, por jam qytetar i botës". Për të, kjo shprehje është aktuale më shumë sot.



Ambasadori Luan Rama dhe Presidenti i Francës Jacques Chirac, dalë me rastin e paraqitjes së letrave kredenciale.

1998-2001 Përfaqësues personal i Presidentit të Republikës pranë Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (OIF).

1998-2001 I pranishëm, vazhdimisht, në median e shkruar dhe vizive të Francës. Bashkëpunon me disa media: Libération, Le Témoignage chrétien, La Nouvelle Alternative, Courrier International, Cahiers méditerranéennes, Les extrémismes en Europe, Les écrits des images, Amsterdammer, si dhe jep intervista në "TV5, "France 2" etj.

1997-2001 Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Francë, Portugali dhe Monako.

1998-2001 Përfaqësues personal i Presidentit të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë (OIF).

1995-1997 Redaktor pranë "Courrier International", Paris.

1994-1997 Gazetar në organe të ndryshme periodike në Shqipëri dhe Francë.

1991-1993 I dërguar a.i. i Shqipërisë në Paris.

1991-1993 Delegat i Përhershëm i Shqipërisë në UNESCO.

1988 Në sektorin e shtypit dhe kulturës, pranë Ministrisë së Jashtme.

1975-1988 Skenarist pranë Kinostudios "Shqipëria e Re". Shkruan rreth 40 skenarë për filma dokumentarë, filma me metrazh të gjatë dhe vizatimorë.


Pasioni / hobi: Kinematografia.

Botime: Luan Rama (listuar jo të gjitha)

- 2014 *Bonjour d'Albanie. Shkrime nën hijen e bombave*. Paris: Livres Rama, 292 f., 8 fl. me foto, çmimi 700 lekë.
- 2012 *Bujtës të largët. Mbresa të udhëtarëve francezë gjatë shek. XIX në Shqipëri*. Tiranë: Klean, 527 f., me foto, çmimi 900 lekë.
- 2010 *Léon Rey ... dhe gurët filluan të flasin.* Tiranë: Globus R., 250 f., 32 f. me foto. Në fund të botimit një kronologji e jetës së autorit, çmimi 800 lekë. Ribotohet më 2012 në frëngjisht në titullin: *Léon Rey à la découverte d'Apollonie.* Paris: Non Lieu.
- 2010 *Kalorësit e stuhisë. Normandët, frankët dhe shqiptarët.* Tiranë: Globus R., 269 f., 16 fl. me il., çmimi 700 lekë.
- 2008 *Parisi letrar* Tiranë: Globus R., 377 f., me foto, çmimi 700 lekë.
- 2007 *Dino, shtegtari i portës sublime. Piktori i madh me origjinë shqiptare*. Tiranë: Globus R., 181 f., 8 fl. me piktura, në fund të librit pikturat e Abedin Dinos dhe një kronologji e jetës dhe veprës së tij, çmimi 600 lekë.
- 2005 *UNESCO, shtëpia e shpresës* Tiranë: Korbi, 246 f., me il., çmimi 700 lekë.
- 2005 *Santa Quaranta. Gërsheti i prerë i Isadora Dunkanit*. Roman historik. Tiranë: Argeta-LMG, 185 f., 12 fl. me foto. *Botimi i dytë*: 2009 *Santa Quaranta. Gërsheti i prerë i Isadora Dunkanit*. Roman historik. Tiranë: Globus R., 224 f., me foto, çmimi 600 lekë.
- 2005 *Pont entre deux Rives*, *Albanie-France*. Paris: La Société des Écrivains, 524 f.
- 2005 *Miteran. Zotërit vdesin gjithashtu...* Monografi. Tiranë: Arbëria, botimi i dytë i plotësuar, 288 f., me foto.
- 2003 *Sharl de Goli-një legjendë e gjallë.* Tiranë: Dudaj, 330 f., 8 fl. me foto, çmimi 700 lekë.
- 2001, korrik *Couvrez-moi avec un morceau de ciel*, poema. Titulli në origjinal: Mbulomë me një copëz qiell. Nantes: Le Petit Véhicule, 301 f., çmimi 800 lekë.
- 1999 *Nën hijen e eklipsit. Tiranë, Prishtinë, Paris*. Tiranë: Toena, 327 f.
- 1999 *Le long chemin sous le tunnel de Platon. Le destin de l'artiste sous la censure en Albanie* 1945-1990. Nantes: Le Petit Véhicule, 228 f., 8 fl. me il. *Botimi i dytë*: 2007. Tiranë: Globus R., 243 f.

Botuesi *La Société des Écrivains:*

Ish-ambasador i Shqipërisë në Francë, nga viti 1997 deri në vitin 2001, Luan Rama sapo ka botuar një ese të re të quajtur *Pont entre deux Rives*, *Albanie-France*. Në këtë vepër të rëndësishme, shkrimtari zbulon mbresa dhe kujtime personale, të cilat janë shkruar me një forcë të madhe shpirtërore. *Pont entre deux Rives*, *Albanie-France* na përshkruan historinë e gjatë të marrëdhënieve franko-shqiptare që nga fillimet e tyre, në vitin 1272. Luan Rama na çon në fillim te një «urë shpirtrash» dhe, nga ai moment, s'na mbetet gjë tjetër veçse të udhëtojmë e të zbulojmë një histori mijëra vjeçare të një miqësie të lashtë midis dy popujve, shqiptar e francez.



- 1996 *Fransua Miteran. Romantizmi i pushtetit*. Tiranë: Shtëpia Botuese Dituria. *Ribotim:* 2005. Tiranë: Arbëria.

Përkthime

- 2012 *Hyjnitë kishin të drejtë*. Titulli në origjinal: *Les dieux avaient raison* Autor Léon Rey. Përktheu nga origjinali Luan Rama. Tiranë: Dituria. Në libër shënime mbi autorin nga përkthyesi, 152 f., 8 fl. me foto.
- 2010 *Rrugëtimi i mbramë i Arthur Rimbaud.* Poezi të zgjedhura nga A. Rimbaud. Tiranë: Globus R., 328 f., me foto e il.
- 2009 *Pikëtakim me Jean Cocteau, (nga poezitë e Jean Cocteau),* Shtëpia Botuese Globus R. Tiranë.
- 2009 *Amer est le miel des tombes*, poèmes. Editions L'Harmattan.
- 2006 *Faraoni i fundit* Gilbert Sinoué, *(Le dernier pharaon)* Tiranë: Globus R.
- 2005 *Bubulina* Titulli në origjinal: "Bouboulina", Autor Michel de Grèce. Roman historik. Tiranë: Korbi, 271 f., çmimi 700 lekë.
- 1999 *Nesër pa mua.* Titulli në origjinal: "Demain sans moi", Autor Alain Bosquet. Tiranë: Toena, 140 f., me il.

Çmime të akorduara

- 2014 *Personalitet i Frankofonisë*, nga Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë.
- 2002 *Grand Officier* de "*Ordre national du Mérite*" (Oficer i Madh i Urdhërit Kombëtar te Meritës) nga presidenti i Republikës franceze, Jacques Chirac.
- 2001 *Çmim europian* për esenë "*Le long chemin sous le tunnel de Platon*", dhënë nga Shoqata e "Shkrimtarëve të gjuhës franceze", Paris.
- 1988 *Çmimi i Parë* i Festivalit Shqiptar të Filmit Dokumentar e Vizatimor për skenarin e filmit me dokumentar "*Mos harroni*".
- 1986 I akordohet medalja "Naim Frashëri", nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.
- 1986 *Çmimi i Dytë* i Festivalit Shqiptar të Filmit Dokumentar e Vizatimor për skenarin e filmit vizatimor "*Ilira*".
- 1985 *Çmimi i Dytë* i Festivalit Shqiptar të Filmit Dokumentar e Vizatimor për skenarin e filmit me vizatimor "*Merimanga dhe brumbulli*".
- 1983 *Çmimi i Parë* i Festivalit Shqiptar të Filmit Dokumentar e Vizatimor për skenarin e filmit vizatimor "*Dy Gostitë*". E njëjta vepër është nderuar me çmimin e parë për filmin vizatimor në Festivalin kinematografik të Giffonit, në Itali (1984).
- 1983 *Çmimi i Dytë* i Festivalit Shqiptar të Filmit Dokumentar e Vizatimor për skenarin e filmit me dokumentar "*Nëpër ditaret e luftës*".

Anëtarësime

- 2000 Anëtar themelues i Shoqatës Franko-Shqiptare "Albania", Paris.
- 1993 Anëtar themelues i Shoqatës "CEMPEA", Paris.

Luc Vidal, botues, shkrimtar, për përmbledhjen poetike *Couvrez-moi avec un morceau de ciel:*

Couvrez-moi avec un morceau de ciel e Luan Ramës është një libër i poezisë së lartë, i rrugëve të padukshme që nisin nga shpirti dhe gjoksi i grave. Udhë të mundimshme, re të rënda mbi supet tona, pasqyra që kullojnë si plagë në kujtesën e poetit. Vite-vendimtare për të kuptuar dhimbjen e refugjatëve shqiptare. 1990, 1991, 1992... 514 emigrantë zbarkuan në Marsejë për t'i shpëtuar ferrit…





Grand Officier de "Ordre national du Mérite"



1999, Hotel Matignon, rezistenca zyrtare e kryeministrave të Republikës së Francës. Ambasadori Luan Rama, me kryeministrin e Francës, Lionel Jospin (Partia Socialiste) dhe presidentin e Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani, gjatë vizitës së këtij të fundit në Francë.

1999

Shoqëron kryeministrin francez, Lionel Jospin, në një vizitë zyrtare në Shqipëri, vizita e parë e një kryeministri francez. Rama e shoqëron kryeministrin francez edhe në qendrat e refugjatëve kosovarë në Tiranë, Durrë, Fier.

1999


Është viti kur ngjarjet që lidhen me Kosovën janë të pranishme në pothuaj të gjitha tavolinat e diskutimet europiane. Në këtë vit, më shkurt-mars 1999 organizohet Konferenca e Rambouillet-së për Kosovën. Ambasadori Luan Rama organizon takime të shumta për një pjesë të madhe të diplomacisë shqiptare, sikundër edhe prononcimeve për shtyp, pjesëmarrje në "Konferencën e nënshkrimit të Deklaratës përfundimtare në sallën Kleber" etj.

Delegacioni kosovar ishte vendosur në hotel "Hilton" dhe, fshehurazi nga të tjerët, në shoqërinë e një oficeri të sigurimit francez, së bashku me Ram Bujën dhe Bukurie Gjonbalaj (shoqëruese e austriakut Petriç, përfaqësuesit evropian) po shkonim me makinën time diplomatike për të takuar Kadarenë. Ndërsa kalonim në atë natë të ngrohtë urën plot drita "Aleksandri i III", bie telefoni i Thaçit. Në anën tjetër të linjës ishte Ramush Ramadani, nga Llapi. "Ngushëllime!" – dëgjoj Thaçin të thotë pas pak. Ramadani po e njoftonte për luftëtarët e rënë të UÇK-së gjatë një beteje.

Tek porta e shtëpisë na priti Ismaili. Ai ishte kureshtar ta njihte Thaçin, i cili pas disa minutash do t'i kërkonte hapur që të mbështeste me një deklaratë publike UÇK-në. Të nesërmen Ismaili më dërgoi deklaratën që u botua në KosovaPresse dhe Koha ditore…

Jacques Rouil, kritik letrar, në librin Le long chemin sous le tunnel de Platon. Le destin de l'artiste sous la censure en Albanie:

Libri *Le long chemin sous le tunnel de Platon. Le destin de l'artiste sous la censure en Albanie* i Luan Ramës mund të kishte shërbyer, fare mirë, si lëndë letrare për G. Oruellin, pasi ne gjendemi në një univers surrealist, ku survejimi i shtetit bëhet çdo çast, ku historia shkruhet çdo minutë, ku fotografitë zyrtare retushohen, ku zgjedhjet që kërkonte të bënte individi në jetë shpreheshin në formulën e thjeshtë «ose bashkëpuno, ose vdis»… Libri është një dëshmi e fortë e kohës. Aktualisht ambasador, ky autor e tregon të kaluarën me syrin e një intelektuali…



2000

Bashkëpunon me akademikun Vasil Tole për regjistrimin e "Iso-polifonisë" në programin e UNESCO-s me titull "Mémoire du Monde".



Çaste nga pritja e organizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OIF, Butros-Butros Ghali. Luan Rama është në statusin e Përfaqësuesit Personal të Presidentit të Republikës së Shqipërisë pranë Frankofonisë

2000

Shoqëron presidentin e Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë dhe ish-sekretarin e Përgjithshëm të OKB-së, Boutros Butros-Ghali, në një vizitë zyrtare në Shqipëri. Pjesë e axhendës është edhe takimi me intelektualët frankofonë shqiptarë, me temë "Frankofonia në Shqipëri". Jehonën e kësaj vizite, Ambasadori Rama e pasqyron në librin "Shqipëria Frankofone", Tiranë: Onufri, 2001. Libri u botua me mbështetjen e Agjencisë së Frankofonisë.

2000


Bashkëpunon me profesor Shaban Sinani për regjistrimin e Kodikëve të Beratit "Beratinus 1" dhe "Beratinus 2" në Regjistrin e Trashëgimisë Botërore. Puna e kryer pasqyrohet në librin "Dorëshkrimet e Purpurta", Botimet Globus R., Tiranë, 2009.

2001, mars

Në Akademinë Diplomatike Franceze, Paris, organizon Konferencën me temë "Shqipëria, kooperimi rajonal dhe europianizimi i Ballkanit". Referues: Kryeministri Ilir Meta, Ministri i Jashtëm Paskal Milo, Ambasadori Luan Rama, deputetë, senatorë dhe analistë francezë. Materialet e konferencës u botuan në një libër.

Joël Baffou, shkrimtar, në parathënien e tij për *Le long chemin sous le tunnel de Platon. Le destin de l'artiste sous la censure en Albanie:*

... është libri i një njeriu që ka mbijetuar dhe kërkon tashmë të nderojë viktimat që s'patën fatin të jetojnë. Ky libër është një udhëtim i ngadaltë, ashtu si hapat e një vizitori në një varrezë… Luan Rama i përshkruan pesëdhjetë vitet e plumbit të shoqërisë shqiptare përmes fatit tragjik të një morie artistësh, shumica e të cilëve nuk patën kohë të bëheshin të njohur, sepse shpesh u shtypën dhe vranë. Ai vë në dukje përdorimin me forcë të artistëve në shërbim të diktaturës së proletariatit, rolin e kudogjendur të çensurës, si dhe veçantinë e saj në Shqipëri…





Ambasadori Luan Rama me presidentin e Portugalisë, Jorge Sampaio, dalë me rastin e paraqitjes së letrave kredenciale.

Veprimtaria diplomatike në Francë ka një dimension të fuqishëm kulturor. Në hollet e ambasadës janë organizuar me dhjetra koncerte e ekspozita piktorësh, skulptorësh e qeramistësh, si nga Shqipëria, ashtu edhe me ata me origjinë shqiptare, sikundër edhe veprimtari të organizuara në bashkëpunim me institucione franceze, si *Maison de la Poesie, Théâtre Lucerne* etj.

Një kujtim i bukur ishte organizimi i një koncerti në një kishë anglikane të Parisit nën patronazhin e zonjës Bernadette Chirac për fëmijët e Kosovës, ose bashkëpunimi me aktoren e njohur Jane Birkin, e cila të ardhurat e një serie shfaqjesh teatrale i dha për refugjatët kosovarë. Eshtë e paharruar mbrëmja kur, së bashku, në zemër të Parisit, ndezëm *Pishtarin e Kosovës*, në Les Halles.

* * *

Bashkëpunimi me Portugalinë

Një nga çastet më interesante të punës diplomatike me Portugalinë ishte pjesëmarrja e Shqipërisë në *Ekspozitën Universale*, me rastin e Ditës së Shqipërisë. Përfaqësimi i vendit tonë ishte mjaft dinjitoz. Ne u përfaqësuam me një pavion të madh, në të cilin ishin përmbledhur shumë të dhëna dhe objekte të një rëndësie të veçantë kulturore e ekonomiko-industriale. Delegacioni shqiptar kryesohej nga kryeministri i kohës, Fatos Nano. Ishte kontakti i parë i nivelit të lartë me autoritetet e Portugalisë. Veçoj pjesëmarrjen e presidentit të vendit, Jorge Sampaio; kryeministrin Guterres; ministrin e Jashtëm, si dhe shumë personalitete të tjera.

Akoma, nga Lisbona ruaj me nostalgji bisedat dhe takimet me ish-presidentin e Portugalisë, Mario Soares, heroin e "Revolucionit të karafilëve" që përmbysi diktaturën dhe solli në krye socialistin Soares, dikur azilant politik në Francë. Si një humanist i madh që ishte, Soares ishte në krye të një fondacioni të rëndësishëm në rang botëror dhe kishte mjaft simpati për shqiptarët.

[1] Emërtimi si përfaqësues i shtetit në UNESCO, është në varësi të shtetit, por gjithmonë shoqërohet me togfjalëshin: "Delegat Permanent – Delegat i Përhershëm". Për shumë shtete, Ambasadori i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Francë luan edhe rolin e Delegatit të Përhershëm pranë UNESCOs, me synimin për të reduktuar sa më shumë fondet.
Vendi ynë, e ndau postin e Ambasadorit në Francë nga ai i Delegatit të Përhershëm pranë UNESCOs me emërimin e Jusuf Vrionit. Aktualisht, vendi ynë në UNESCO përfaqësohet nga Besiana Kadare (vajza e Ismail Kadare), nga 14.04.2011. Emërtimi i saj është Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë, Delegat i Përhershëm.

Gjatë periudhës 1997-2001, kur Luan Rama ushtronte detyrën e Ambasadorit:

President i Shqipërisë: Rexhep Meidani (Partia Socialiste).

Kryeministra të Shqipërisë: Fatos Nano (Partia Socialiste), Pandeli Majko (Partia Socialiste), Ilir Meta (Partia Socialiste).

Ministër i Jashtëm i Shqipërisë: Paskal Milo (Partia Social-Demokrate).

President i Francës: Jacques Chirac.

Kryeministër i Francës: Lionel Jospin.

Ministër i Jashtëm i Francës: Hubert Védrine.

JUSUF VRIONI

Ambasador Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë, Delegat i Përhershëm i Shqipërisë në UNESKO.
Periudha: 1998-2001



Photo credit: Arkiva personale, Luan Rama.

Datëlindja: 16 mars 1916.

Vendlindja: Korfuz, Greqi

Diplomë: Ekonomi në *L'École des Hautes Études Commerciales, Jouy-en-Josas, Yvelines* dhe Drejtësi në *Instituts D'études Politiques*

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, anglisht, italisht.

Ndërruar jetë: 25 maj 2001.

Bashkëshortja: Agi.

Fëmijët: Alan.

Motoja: "Kam kënaqësi kur gjej vështirësi në punë. Puna e mirë nuk del kollaj".



22 maj 1988. Ambasadori Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë, Delegat i Përhershëm i Shqipërisë në UNESKO, Jusuf Vrioni, me Ministrin e Kulturës së Francës, Jacques Lang.
Photo credit: Arkiva personale, Luan Rama.

Vitet e tij të para i kaloi në Korfuz e më pas në Berat.

1925 Pas emërimit të babait të tij, Ilias bej Vrioni, si Ministër i Jashtëm dhe Ministër i Plotfuqishëm në Paris, familja e tij u shpërngul në Paris. Ciklin e ulët dhe të mesëm arsimor Jusuf Vrioni e kreu pranë liceut "Janson de Sailly", Paris dhe atë të lartë në "L'École des hautes études commerciales", Jouy-en-Josas, Yvelines dhe në "Instituts d'études politiques" të Parisit.

1939 Rikthehet në Shqipëri, por shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore e detyron të shpërngulet po atë vit në Romë.

1943 Rikthehet në Tiranë.

13 Shtator 1947 Arrestohet dhe akuzohet për spiunazh dhe agjitacion e propagandë. Në atë kohë punonte si përkthyes te Bashkimi i Grave të Shqipërisë.

Korrik 1950 Dënohet me 15 vite heqje lirie dhe punë të detyruar. Lirohet në fund të vitit 1960 dhe internohet në Fier për një periudhë disamujore.

1959 Njihet me bashkëshorten e ardhshme, Agin, një të diel korriku në plazhin e Durrësit. Martohen më prill 1963.

1962, qershor Transferohet në Shijak të Durrësit, bashkë me mamanë.

Botime: Përkthime (listuar jo të gjitha)

- 1962 Përkthen në frëngjisht një përmbledhje me novela të Dhimitër Shuteriqit.
- 1968 *Le Général de l'armée morte.* Gjenerali i ushtrisë së vdekur. Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
- 1970 *Le Général de l'armée morte.* Gjenerali i ushtrisë së vdekur. Paris: Albin Mechel, 288 f.
- 1972 *Les tambours de la pluie*. Paris: Hachette, 342 f. Kështjella. Romani Kështjella i Ismail Kadaresë fillon të përkthehet nga Jusuf Vrioni ndërkohë që libri nuk kishte dalë akoma në qarkullim.
- 1973 *Chronique de la ville de pierre*. Kronikë në gur. Paris: Hachette.
- 1978 *Le Grand Hive.* Dimri i madh. Paris: Fayard. Emri i përkthyesit, Jusuf Vrioni, përsëri mungon.
- 1981 *Le Pont aux trois arches*. Ura me tri harqe. Paris: Fayard.
- 1982 (2 nëntor) *Chronique de la ville de pierre*. Kronikë në gur. Paris: Gallimard, 315 f.
- 1986 *Qui a ramené Doruntine*. Kush e solli Doruntinën. Paris: Fayard.
- 1989 (23 mars) *Le Crépuscule des dieux de la steppe.* Muzgu i perëndive të stepës. Paris: Gallimard, 218 f.
- 1989 Ura me tri harqe. *Le pont aux trois arches*. Paris: Fayard, 152 f.
- 1991 *Invitation à l'atelier de l'écrivain*. Ftesë në studio. Paris: Fayard, 217 f.

1963 Transferohet në Tiranë dhe jeton te shtëpia e së shoqes, Agit. Po këtë vit bën pasaportizimin në Tiranë.

Emërohet në Tiranë si përkthyes, pranë Shtëpisë Botuese "8 Nëntori".

1963 Fillon për herë të parë të përkthejë Kadarenë, veprën e tij "Gjenerali i ushtrisë së vdekur". Romani botohet në frëngjisht më 1968 me titull "General de l'armée morte" nga Shtëpia Botuese "Naim Frashëri" dhe në Francë më 1970, por në të dyja botimet frëngjisht mungon emri i përkthyesit.

1978 Botohet përsëri në Francë, në frëngjisht, libri i dytë i Ismail Kadaresë "Dimri i madh", por këtë radhë është edhe emri i përkthyesit, Jusuf Vrioni.

Instituti i Studimeve marksiste-leniniste.

1979 Udhëton drejt Suedisë, për të përfunduar përkthimin e vëllimit të parë të "Shënime për Kinën".

1984 Pëson një infarkt

1985 Udhëton drejt Italisë, për një vizitë të specializuar mjekësore dhe për të takuar të motrën. Arrin të flaës dhe takohet me miqtë e viteve të paraluftës: Susanna Agnelli, në atë kohë zëvendëssekretare shteti në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe më 1995 Ministre e Jashtme e Italisë, e para femër në këtë post; Gianni Agnelli, pronar i Fiatit dhe njeriu më i pasur i



Spartak Ngjela, në librin *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare*. UET Press, vëll. III: 35 f., 89 f., 205 f. (në mënyrë të përmbledhur).

Jusuf Vrioni ka formim realisht perëndimor, me kulturë të madhe dhe të gjithën në funksion të qytetërimit perëndimor. Vrioni rrjedh nga një shtresë e lartë e shoqërisë shqiptare klasike. Familja e tij, pas pavarësisë, i ka dhënë vendit një kryeministër dhe gjatë gjithë historisë së kombit tonë veprimtaria e saj ka pasur një jehonë reale. Duhet duhet gjetur mundësia që në shtetin e ri Ismail Kadare të jetë presidenti i ardhshëm i Republikës dhe Isuf Vrioni kryeministri i parë i demokracisë shqiptare.

- 1994 *Les tambours de la pluie*. Kështjella. Paris: Fayard, 218 f.
- 1995 (1 janar) *La légende des légendes.* Legjenda e legjendave. Paris: Groupe Flammarion, 275 f.
- 1995 *Dialogue avec Alain Bosquet*. Dialog me Alain Bosquet. Paris: Fayard, 218 f.
- 1996 Shqiponja *L'Aigle* Paris: Fayard, 152 f.
- 1997 *Le Firman aveugale suivi de la grande muraille et de le vol du sommeil royal*. Qorrfermani. Paris: Editions Stock, 125 f.
- 1998 (15 prill, botimi i parë) *Trois chants funèbres pour le Kosovo.* Tri këngë zie për Kosovën. Paris: Fayard, 119 f.
- 1998 (1shtator) *Mauvaise saison sur l'Olympe: tragédie de Prométhée et d'un groupe de divinités en quatorze tableaux*. Stinë e mërzitshme në Olimp: tragjedia e Prometheut dhe e një grupi hyjnish në 14 dukje. Paris: Fayard, 218 f.
- 1999 (3 mars) *La ville sans enseignes.* Qyteti pa reklama. Paris: Editions Stock, 153 f.
- 2000 (5 janar, botimi i parë) *Il A fallu ce deuil pour se retrouver: journal de la guerre du Kosovo.* Ra ky mort e u pamë: ditar për Kosovën, artikuj, letra. Paris: Fayard, 244 f.
- 2006 *Froides fleurs d'avril*. Prill i thyer. Paris: Librairie générale française, Le Livre de Poche.
- 2009 (15 prill) *Qui a ramené Doruntine?* Kush e solli Doruntinën? Paris: Éditions Larousse, 220 f.

historisë moderne të Italisë; Sharl Bertran, ish-shok në L'École des Hautes Études Commerciales, Jouy-en-Josas, Yvelines.

1987 Kthehet përsëri në Itali për një shërbim më të specializuar mjekësor.

1989 Viziton Parisin, me këmbënguljen e Iv Maben, një zyrtar i Lartë i Ministrisë së Punëve të Jashtme që kishte vizituar Tiranën. Bashkë ishin takuar në Muzeun Historik Kombëtar, me rastin e hapjes së një ekspozite të librit francez. Vizita shoqërohet me takime të shumta dhe një konferencë për veprën e Kadaresë dhe problemet e përkthimit nga shqipja në Institutin e Studimeve të Larta Sociale.

Deri më 1990 është përkthyesi kryesor i fjalimeve të Enver Hoxhës dhe i materialeve të PPSH në frëngjisht; përkthyes i shumë teksteve zyrtare të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

1990 Përsëri në Paris.

Kryetari i Komitetit Shqiptar të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

1997 Zhvendoset në Paris.

1998 Emërohet Amabasor i Republikës së Shqipërisë në UNESCO.

25 maj 2001 Ndërron jetë. Më 4 korrik 2001 trupi i Vrionit udhëton për në atdhe, ku prehet edhe sot.

Njihet si përkthyesi zyrtar i Ismail Kadaresë në frëngjisht. Vendin e tij sot e ka zënë Tedi Papavrami.

Tedi Papavrami, violinist, përkthyes, shkrimtar

Kur Jusufi më flet në frëngjisht, gjë që e bën gjithmonë kur gjendemi vetëm të dy, intonacionet e tij në këtë gjuhë e veshin atë me një personalitet tjetër. Pa njohur Francën dhe Parisin, për ata që kanë jetuar vetëm në Shqipëri, është e vështirë të kuptojnë se sa francez është Jusufi, francez dhe parizian, nga koka tek këmbët.

Elegant ... me buzëqeshje dashamirëse.

("Fugë për violinë". Tiranë: UET Press, 2014: 107 f., 138 f.)

Eric Fay, studiues dhe romancier francez

A mundet vallë që Europa e sotme, historia bashkëkohore, të sjellë fate kaq të vetëtimta dhe çoroditëse, të çrregullta dhe të pasura si ai i këtij njeriu? Fëmijëri si ajo që përshkruan Nabokovi, rini të artë të shoqëruar me studime të gjata, të cilat prodhuan një mendje të aftë për të interpretuar situata shumë të koklavitura dhe për të debatuar në një sërë disiplinash...

("Kujtimet e një evropiani. Psherëtima fati". Tiranë: Albimazh, 2008:5-6)



Photo credit: Arkiva e gazetës MAPO.

Botime: Autor

- 1998 *Mondes Effaces: Souvenirs D'un Europeen*. Jusuf Vrioni. Paris: Editions J.C. Lattes, f. 318. Përgatitur nga studjuesi dhe romancieri francez Eric Fay.
- 2008 Libri përkthehet në shqip nga Viktor Kalemi, me titull "Kujtimet e një evropiani. *Psherëtima fati*", Tiranë: Albimazh, 263 f.

* * *

Përkthimet në anglisht të veprave të Kadaresë janë bërë, kryesisht, nga David Bellos, mbi bazën e frëngjishtes së Vrionit. Më poshtë janë sjellë dy tituj, *Piramida* dhe *Kështjella*:

Botimi shqip: 1992 *Piramida.* Ismail Kadare. Tiranë: Çabej MÇM, 139 f. (ribotuar: Onufri, 2010, 183 f.)

Botimi frëngjisht: 1994 *La Pyramide* (Le Livre de Poche). Paris: Fayard, 158 f.

Botimi anglisht: 1996 *Pyramid*. Ismail Kadare Përktheu në anglisht: David Bellos (transl. from the French of J. Vrionit). New York: Arcade, 161 f.

Botimi shqip: 1970 *Kështjella.* Ismail Kadare. Tiranë: Naim Frashëri, 237 f.

Botimi frëngjisht: 1972 *Les tambours de la pluie*. Ismail Kadare. Paris: Hachette, 342 f.

Botimi anglisht: 2008 *The siege*. Ismail Kadare. Përktheu në anglisht: David Bellos (This translation made from the French translation by Jusuf Vrioni of the Albanian original). New York: Canongate, f. 328.

Çmime dhe vlerësime

2006 Ministria e Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Shqipërisë krijoi çmimin "Jusuf Vrioni"me motivacion: "Për mirënjohjen dhe vlerësimin e përkthyesve me kontribut të çmuar në njohjen dhe promovimin e letërsisë shqipe në gjuhë dhe kultura të huaja".

2001, 18 Qershor *Qytetar Nderi* i Beratit.

1998, 22 Maj *Chevalier de la Légion d'Honneur* Për kontributin e tij të pasur në gjuhën frënge, dekorohet nga Republika Franceze me urdhërin.

1998 *Penda e Artë*

1994 Le Prix Halpérine-Kaminsky Consécration attribué pour l'ensemble de l'œuvre: "Yusuf VRIONI pour sa traduction de l'oeuvre d' Ismaël Kadaré (Albanais)" nga "Societe des Gens de letters".

1993 *Qytetar Nderi* i Arles, nga Kryetari i bashkisë së qytetit, Michel Vauzelle, ish-ministër i Drejtësisë gjatë presidencës Mitterrand.

Urdhërin e punës *Naim Frashëri*

YLLJET ALIÇKA

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Francës, Republikën e Portugalisë dhe Principatën e Monakos.
Periudha: 2007-2013

Ambasador i Shqipërisë pranë UNESKO-s.
Periudha: 2008-2010



Datëlindja: 23 qershor 1951

Vendlindja: Tiranë

Diplomë: Fak. i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Gradë shkencore: Prof. Asoc. në "Shkenca edukimi"

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, Anglisht, Italisht, Rusisht.

Bashkëshortja: Lindita

Fëmijët: Joni dhe Julia

Motoja: "Padrejtësia fshihet pas moralit të mirë".



Ambasadori Ylljet Aliçka dhe Princi Albert i Monakos, dalë me rastin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike Shqipëri - Principata e Monakos, 2011. Monako bëhet vendi i 177-të, me të cilin Shqipëria vendos marrëdhënie diplomatike.

Nga 1973 deri në vitin 1983 ka punuar si mësues në shkollat e fshatrave malore të zonës së Matit.

1983 - 1991 Redaktor pranë "Shtëpisë Botuese të Librit Shkollor".

Më 1990 i akordohet një bursë specializimi në Universitetin "Stendhal", Grënobël, Francë, në fushën e Didaktikës & Psikologjisë.

1991-1992, Drejtor i "Shtëpisë Botuese të Librit Shkollor".

1992 - 1997 Drejtor i Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Kulturës, Rinisë e Sporteve.

Më 1995 kryen një specializim për "Institucionet Ndërkombëtare", pranë Këshillit të Evropës, Strasburg.

1992 - 1997 Përfaqëson Shqipërinë pranë Komitetit të Kulturës së Këshillit të Evropës.

1997-1998 jep lëndën e Etologjisë pranë Degës së Psikologjisë, Universiteti i Tiranës.

1997-2007 Përgjegjës për Informacionin & Komunikimin pranë Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë.

2007-2013, Përfaqësues Personal i Presidentit të Republikës pranë Organizatës Botërore të Frankofonisë.

Nga viti 2013 e në vijim është pedagog pranë Universitetit Europian të Tiranës.

Pasioni/ hobi: Sporti, vera, leximi….

Botime didaktike

- Bashkautor në 14 tekste të biologjisë shkollore.

Letërsi artistike

- 1996: *Tregime*. Tiranë: Onufri.
- 1999: *Les Slogans de Pierre.* Montpellier: Climats.
- 2000: *Kompromisi*. Tiranë: Onufri.
- 2002: *Kompromisi.* 13 tregime. Sejny: Borderland Foundation (Fundacja Pogranicze).
- 2003: *Parullat me gurë*. Tiranë: Albimazh.
- 2006: *Një rrëfenjë me ndërkombëtarë*. Tiranë: Omska.
- 2006: *I slogan di pietra.* Rimini: Guaraldi.
- 2006: *Balkan Blood, Balkan Beauty***.** Chicago: Northpress University Press.
- 2009: *Koha e puthjeve*. Tiranë.
- 2009: *Les Slogans de Pierre.* Paris: Pyramidion.
- 2011: *Les etrangeres.* Paris: Chapitre 12.
- 2012: *Valsi i lumturisë*. Tiranë: Toena.

Çmime të fituara

- 2000: "Çmimi i Parë" (seksioni i letërsisë së huaj). Teramo: Konkurs ndërkombëtar i tregimit.
- 2000: "Çmimi i dytë" me *Parrullat me gurë*. Bordeau: Konkursi ndërkombëtar "Arts et Lettres de France".
- 2001: "Medalje bronxi" me *Parrullat me gurë*. Paris: Academie Internationale de Lutece.
- 2001: "Penda e argjendtë", seksioni i prozës, me librin *Kompromisi*. Tiranë: Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve.
- 2006: "Çmimi i Parë" për "Skenarin më të mirë" ("Sllogans"). Tiranë: Festivali i Filmit Shqiptar.
- 2006: "Romani më i mirë i vitit" për librin: *Një rrëfenjë me ndërkombëtarë*. Tiranë: Akademia KULT.
- 2009: "Premio speciale" për librin *I compagni di pietra*. VII Premio Letterario Nazionale (seksioni: "Libri editi").
- 2011: "Çmimi i parë" për skenarin (Meilleure scenario) e filmit *Kronikë provinciale*. Paris: Festival de Film de l'Europe de l'Est à Paris.
- Skenari i filmit *Parullat*, bashkëprodhim franko-shqiptar, përzgjedhur për konkurrimin zyrtar të Festivalit të Kanës, Francë 2001 dhe marrë disa çmime ndërkombëtare.
- 2013: "Penda e argjendtë" për librin *Valsi i lumturisë.* Tiranë: Ministria e Kulturës, Rinisë e Sporteve.

Anëtarësime

- 2006: Anëtar i "Shoqatës së Autorëve Dramatikë dhe Audiovisualë", SACD, Paris, Francë.
- 2010: Anëtar i Akademisë "Berry - Zhorzh Sand", Paris, Francë.
- 2011: Anëtar themeltar i Shoqatës Kulturore "Fabrizio de Andre", Milano, Itali.
- 2011: Anëtar, Qytetar Nderi i "Republika e Artistëve të Montmartrit", Paris, Francë.
- 2012: Anëtar i "Shoqatës së Shkrimtarëve Frankofonë", Paris, Francë.



Revista e CRIF (Këshilli Përfaqësues i Institucioneve Hebreje në Francë).

Përtej talentit si diplomat, Ambasadori i Shqipërisë në Francë, S.E. Ylljet Aliçka, është një shkrimtar fin, autor i disa veprave letrare. Ai njihet, gjithashtu, për disa skenarë filmash mbështetur në veprat e tij. Në Festivalin e Kanës 2001 skenari për filmin "Slogans" u nderua me çmim. Më 23 shtator 2009, një tjetër metrazh i gjatë, "Prière d'amour", realizuar mbi bazën e një prej krijimeve të Aliçkës, u shfaq në sallat e Parisit. Me këtë rast u lançua dhe ribotimi i përmbledhjes së mrekullueshme me tregime "Parrullat me gurë".

Ricszard Kapuçinski

Tregimet e Aliçkës …. copëza të një letërsie të madhe...



Konferenca "E ardhmja europiane e Ballkanit" - Universiteti Politik i Parisit (SciencesPo.) Në panel, nga e majta: Mirko Galic (Ambasador i Kroacisë), Dusan Batakovic (Ambasador i Serbisë), Pierre Mirel (Drejtor i Zgjerimit në Komisionin Europian), Ylljet Aliçka (Ambasador i Shqipërisë).

Bashkimi Europian, në bashkëpunim me Universitetin Politik të Parisit "SciencesPo." dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës, organizuan një konferencë me ambasadorët e Kroacisë, Serbisë dhe Shqipërisë, si dhe Drejtorit për Zgjerimin pranë Komisionit Europian, Pierre Mirel, në prani të analistëve politikë, stafit akademik të këtij universiteti si dhe medias, me temë "Perspektiva e zgjerimit të Ballkanit Perëndimor në BE". Takimi u karakterizua nga debate të nxehta mes ambasadorit serb Batakovic dhe ambasadorit Aliçka, në lidhje me vizionet e ndryshme si përsa i përket të ardhmes së integrimit europian të këtyre vendeve, ashtu dhe perspektivës europiane të shtetit të sapoformuar të Kosovës.

Gjatë kohës së qëndrimit si Ambasador në Paris, Aliçka organizon mbajtjen e një meshe në gjuhën shqipe, në nder të Nënë Terezës, me rastin e shenjtërimit të saj, në katedralen "Notre Dame".



Më 2010 Ylljet Aliçka bëhet anëtar i Akademisë "Berry - Zhorzh Sand", Paris, Francë. Në seancën solemne të zhvilluar me këtë rast, Presidenti i Akademisë, Dr. Alain Bilot, Oficer i arteve e letrave franceze, theksoi, ndër të tjera, se: "Përveç personalitetit të veprës së tij, Aliçka do na sjellë në gjirin e Akademisë sonë ëndrrat dhe realitetin e Shqipërisë, këtij vendi disi misterioz, atdheut të shqiponjave".



Jean Soublin, "*Le Monde*", 2002


Si përgjatë makthit të partisë unike, ashtu dhe nën anarkinë liberale që e zëvendësoi atë, mbetet e njëjta shpërbërje morale që i zhvlerëson personazhet e Aliçkës… Absurdi me të gjitha format e tij që të çon tinëzisht drejt poshtërsisë.

Pierre Hazan, "*Le Temps*" Genève

Trembëdhjetë tregime nga ku kupton se ideologjia s'është veçse një guaskë boshe.

Mylada Jedrysik, zv.kryeredaktore e gazetës "Wyborcza", në numrin e datës 16 dhjetor 2012, për librin *Kompromisi* botuar në gjuhën polake, shkruan:

Shumë shpejt Aliçka po shndrrohet në një nga tregimtarët më në zë të postkomunizmit… Për dobësitë njerëzore dhe qëndrimin ndaj pushtetit Aliçka vlen dhe tregon për Shqipërinë më shumë se sa gjithë artikujt shkruar e botuar për Shqipërinë. Nën penën e tij mund të ndodhë gjithçka…



Letërsia shqipe e përzgjedhur në projektin "10 shkrimtarë bashkëkohorë prezantojnë arritjet e letërsisë së sotme europiane".

Europa mund të njihet më mirë përmes letërsisë. 10 shkrimtarë të njohur europianë do të bëhen pjesë e projektit ndërkombëtar të Bashkimit Europian "Netë të letërsisë europiane 2012-2014", i cili do të hapë siparin e tij më 21 shtator nga qyteti i Wroclaw për të ndaluar, më pas, në Bukuresht, Dublin, Lisbonë, Vilnius dhe Pragë". "Netët e Letërsisë Europiane" janë konceptuar mbi idenë se letërsia mbetet *mediumi* i vetëm krijues që përqafon zërat e shkrimtarëve bashkëkohorë me vlerat e shoqërive ku ata jetojnë.

Këtij grupi të përzgjedhur do t'i bashkëngjitet edhe shkrimtari shqiptar, Ylljet Aliçka. Ai është përzgjedhur si autori që do të përfaqësojë letërsinë shqipe në këtë eveniment. "10 shkrimtarë të njohur bashkëkohorë nga vende të ndryshme europiane, ardhur nga gjuhë e stile të ndryshme, do mundësojnë audiencën të udhëtojë nëpër Europë si dhe të njihet në një formë të re me vlerat e letërsisë së sotme europiane", thuhet në komunikatën për shtyp të këtij aktiviteti.

Koha e qëndrimit të Aliçkës si Ambasador në Francë ka përkuar me deklaratat e Dick Marty në Paris, i ngarkuar i Këshillit të Europës, bazuar në akuzat e ngritura nga Carla del Ponte, në lidhje me trafikimin e supozuar të organeve njerëzore në territorin shqiptar. Përballë fushatës denigruese dhe antishqiptare që pasoi këto deklarata, vlen të përmendet mobilizimi mediatik i Ambasadorit Aliçka në mediat e shkruara dhe ato vizive. Kemi shkëputur dy reagime të ambasadorit Aliçka: në televizionin ndërkombëtar TV 5, (një lloj "BBC" e Francës), në një nga fashat orare më të ndjekura, si dhe në shtypin e shkruar, "Courriers del Balkans".



Le Courrier des Balkans
le portail francophone des Balkans

Trafic d'organes en Albanie: la réaction de l'ambassadeur Ylljet Aliçka

Carla Del Ponte évoque dans son dernier livre un trafic d'organes de prisonniers serbes du Kosovo, qui aurait eu lieu en Albanie en 1999. Malgré la création d'une commission d'enquête du Conseil de l'Europe, cette terrible accusation ne semble pas reposer sur des preuves solides. La réaction d'Ylljet Alicka, écrivain et ambassadeur d'Albanie en France, qui a résidé et travaillé durant cinq années, sous le communisme, dans le village de Ripa, théâtre présumé du trafic d'organes. Par Ylljet Alicka

ÇEKI, DANIMARKË, MAQEDONI

Përfaqësuar me:

Piro Milkani

Arben Cici

Shaban Murati

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Danimarkën, Maqedoninë dhe Çekinë kanë shtrirje të gjatë në kohë, krahasuar me jetëgjatësinë e shtetformimit tonë. Paraqitja e disa prej dokumentave që gjenden në arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme që trajtojnë një tematikë të tillë është në funksion të hulumtimit për shtrirjen në hapësirë, në drejtim horizontal, të këtyre marrëdhënieve dhe të synimit të librit, evidentimin e formimit kulturor e akademik të emrave të përveçëm.

Maqedonia, 1930

Në arkivën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Viti 1930, Dosja 228, Fl. 7, është shkresa Nr. 105, datë 20 fruër 1930, me të cilën kryekonsulli ynë në Shkup i drejtohet Shkëlqesisë së tij, Ministrit të Punëve të Jashtme, z. Rauf Fico. Shkresa përmban informacion për Srebren Petroff, i cili prej disa kohësh gjendej në Shqipëri. CV e Petroff, bërë nga konsulli ynë në Shkup, në mënyrë të përmbledhur, përmban: korrespondent i disa gazetave ballkanike; në kohërat e vjetra të regjimit turk ka qenë drejtor i shkollave bullgare në Tetovë; në kohën e luftës së përgjithshme, nën sundimin bullgar, ka qenë nën/prefekt i këtij qyteti.

Në të njëjtën korrespondencë, por të datës 8 mars 1930, Ministri i Punëve të Jashtme, z. Rauf Fico, konfirmon se kryekonsulli ynë në Shkup është rezident.

Danimarka, 1938-1939

Në arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme, (Viti 1939, Dosja nr. 134), në korrespondencën ndërmjet Ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Shqipërisë, Ekrem Libohova, me Konsullin e Përgjithshëm të Shqipërisë në Kopenhagen, Danimarkë, Dr. Paul Tvermoes, gjatë periudhës dhjetor 1938 – janar 1939, përshkruhet vizita që kanë bërë në kryeqytetin danez motrat e Mbretit Zog, Lartmadhënitë e tyre Mbretërore, Princeshat Myzejen, Ruhije dhe Maxhide (titujt janë cituar sipas dokumentit original), nga data 20 – 26 nëntor 1938, përfshirë edhe një informacion rreth jehohës që pati në shtypin vendas kjo vizitë.

Çekia, 1945

Korrespondenca për njohjen e Republikës së Shqipërisë nga Çekia është kryer nëpërmjet stafit të Legatës sonë në Beograd, Jugosllavi.

Josef Korbel, i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplotë i Republikës Çeke në Beograd, Jugosllavi, me notën verbale nr. 619/45 drejtuar legatës sonë në Beograd, deklaron se qeveria çeke e ka njohur qeverinë demokratike shqiptare më 16 nëntor 1945. Ministri ynë Fuqiplotë në Beograd, Hysni Kapo, nëpërmjet radiogramit të datës 22 nëntor 1945 (Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Tiranë, Dosja nr. B/I-1), dërguar Tiranës, komunikon lajmin se qeveria çeke njeh qeverinë demokratike shqiptare dhe shfaq dëshirën e lidhjeve diplomatike të menjëhershme.

Maqedonia, mbas viteve 1990: Ambasadori Murati ishte Ambasadori i parë i Shqipërisë i akredituar në Maqedoni, 1993-1997.

Danimarka: Profil

Danezët janë tërësisht të pavarur dhe egalitarë; parapëlqejnë t'i shprehin opinionet e tyre lirisht; janë shumë të edukuar; shqetësohen për cilësinë e jetës dhe mirëqenien sociale; ju pëlqen që gjërat t'i marrin shtruar. Ligji siguron një kujdes shëndetësor shumë bujar për fëmijët dhe njeh kujdesin atëror për foshnjat, gjë që bën që shumë nëna të reja të jenë në gjendje të ndjekin karrierën e tyre në të gjitha nivelet. Ndonëse pjesa më e madhe e popullsisë i takon besimit evangjelist luterian, feja nuk luan ndonjë rol të rëndësishëm në jetën e përditshme. Në punë nuk u pëlqen autoriteti dhe, po ashtu, nuk kanë dëshirë t'u thuash se çfarë duhet të bëjnë; menazherët shihen më shumë si trajnerë ose *fasilitatorë*. Meritokracia është shndërruar në normë. Nepotizmi nuk njihet.

Takimet duhet të jenë të organizuar më së miri dhe me axhendë specifike; vijnë të përgatitur me kujdes dhe janë të gatshëm të kontribuojnë në marrjen e vendimeve; gjetja e konsensusit është e rëndësishme. Punojnë pesë ditë në javë dhe dita e punës fillon në 8-9 të mëngjesit deri në 4.30-5.30 mbasdite. Pjesa më e madhe e kompanive janë të vogla, me jo më shumë se 200 punëtorë. Puna ndahet nga jeta private; nëse ju ftojnë në shtëpi, duhet ta quani si një nder të madh. Shoqëria daneze vlerëson modestinë, të vërtetën dhe profesionalizmin; shmang salltanetet, por begatia është e dukshme në çdo cep të vendit.

PIRO MILKANI

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke.
Periudha: 1998-2002

Ambasador fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Sllovake (jorezident).
Periudha: 1998-2002



Datëlindja: 5 janar 1939

Vendlindja: Drenovë, Korçë.

Diplomë: Drejtor fotografie pranë Akademisë së Arteve të Bukura, Fakulteti i Filmit, Pragë, Çekosllovaki.

Artist i Popullit

Gjuhët e huaja: Çekisht, frëngjisht, italisht, rusisht.

Bashkëshortja: Margarita Kristidhi Milkani.

Fëmijët: Eno, Gjergji.

1940 Familja transferohet në Korçë.

1955 Përfundon studimet e mesme pranë gjimnazit "Raqi Qirinxhi", Korçë.

1961 Mbaron studimet e larta, Fakultetit i Filmit, Pragë, Çekosllovaki. Punimi i diplomës është filmi artistik "Urrejtja".

1961-1967 Drejtor fotografie pranë Kinostudios "Shqipëria e re" për filmin dokumentar dhe artistik.

1967-1991 Pedagog i Jashtëm pranë Institutit të Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve) në lëndën e historisë dhe artit të kinemasë.

1968- 1990 Regjizor pranë Kinostudios "Shqipëria e re" për filmin dokumentar dhe artistik.

1991-1993 Drejtor i kinofikimit pranë Kinostudios "Shqipëria e re".

1992 Themelon kompaninë private filmike "Bunker Film".

1998-2002 Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën Çeke dhe Republikën Sllovake.

2002 vazhdim Kineast i pavarur dhe pedagog i jashtëm pranë Akademisë së Filmit dhe Multimedias "Marubi", Tiranë.

Pasioni / hobi: Udhëtimi, njohja e vendeve dhe kulturave të ndryshme.



Foto e marrë më 10 tetor 1998. Ambasadori Piro Milkani i dorëzon letrat kredenciale Presidentit të Republikës Çeke, Václav Havel.

Regjizor në filmat artistikë me metrazh të gjatë:

- 2008, 14 mars. *Smutek paní Šnajderové* (Titulli original. Në shqip: Trishtimi i zonjës Shnajder) Regjisor së bashku me Eno Milkani. Prodhim i Studio Fáma 92. Në shqip dhe çekisht. Bashkëprodhim shqiptaro-çek.

Filmi ka arritur të shfaqet në shumë festivale ndërkombëtarë dhe ka marrë katër çmime. Në festivalin e 26-të Ndërkombëtar të Filmit të Vendeve të Mesdheut në Aleksandri u vlerësua për "skenarin më të mirë". Sikundër shprehet Milkani "Filmi na dha shumë shqetësime në planin financiar, por kënaqësi pafund në planin artistik".

- 1990 *Ngjyrat e moshës.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1988 *Pranvera s'erdhi vetëm.* Kinostudio "Shqipëria e re".

Filmi ka fituar "Kupën e Festivalit" të filmit Shqiptar, organizuar nga Kinostudio "Shqipëria e re".

- 1987 *Eja!* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1985 *Në kufi të dy legjendave.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1986 *Në prag të jetës.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1984 *Militanti.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1983 *Fraktura.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1982 *Besa e kuqe.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1981 *Në kufi të dy legjendave.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1980 *Shoqja nga fshati.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1979 *Ballë për ballë.* Kinostudio "Shqipëria e re".

Filmi ka fituar "Kupën e Festivalit" të filmit Shqiptar, organizuar nga Kinostudio "Shqipëria e re".

- 1977 *Shembja e idhujve.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1976 *Zonja nga qyteti.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1974 *Çifti i lumtur.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1973 *Festa e madhe.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1971 *Kur zbardhi një ditë.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1969 *Përse bie kjo daulle.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1967 *Ngadhënjim mbi vdekjen.* Kinostudio "Shqipëria e re".

Sipas Milkanit, muzika e këtij filmi u bë hymn për shoqatën e grave kineze që kishin luftuar kundër imperializmit japonez.

- 1966 *Oshëtimë në bregdet.* Film artisitk. Kinostudio "Shqipëria e re".

Drejtor fotografie në filmat artistikë:

- 1973 *Festa e madhe.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1963 *Detyrë e posaçme.* Kinostudio "Shqipëria e re".

Regjizor në filmat dokumentarë:

- 1994 *Hic leones sunt.* (Këtu jetojnë luanët)
- 1969 *Festivali 7-të i fëmijëve.* Kinostudio "Shqipëria e re".

Gjatë periudhës 1998-2002, kur Piro Milkani ushtronte detyrën e Ambasadorit:

President i Shqipërisë: Rexhep Mejdani (Partia Socialiste).

Kryeministra të Shqipërisë: Pandeli Majko (Partia Socialiste), Ilir Meta (Partia Socialiste).

Ministra të Jashtëm: Paskal Milo (Partia Social-Demokrate), Arta Dade (Partia Socialiste).

President i Çekisë: Václav Havel / President i Sllovakisë: Rudolf Schuster.

Kryeministra të Çekisë: Miloš Zeman / Kryeministër i Sllovakisë: Mikuláš Dzurinda.

Ministër i Jashtëm i Çekisë: Jan Kavan, Cyril Svoboda / Ministër i Jashtëm i Sllovakisë: Eduard Kukan.



Një nga posterat e filmit "Trishtimi i zonjës Shnajder"

Drejtor fotografie në filmat dokumentarë:

- 1974 *Një firmë e hekurt.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1966 *Vangjush Mio.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1965 *Vitet e para.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1963 *Detyrë e posaçme.* Kinostudio "Shqipëria e re".
- 1961 *Kalitja.* Kinostudio "Shqipëria e re".

Producent

- 2012 *Kryekënga e Kombit.* U shpall si filmi më i mirë dokumentar në Festivalin e Filmit Shqiptar më 2012. Skenari dhe regjia Petrit Ruka.
- 2012 *Skënderbeu.* Restaurim, dublim.
- 2011 *Matanë lumit.* Film artistik me metrazh të mesëm, fitues i disa çmimeve ndërkombëtare. Regjia Sabir Kanaqi. Skenar Vladimir Prifti.

Skenarist në filmat:

- Kur zbardhi një ditë (bashkautor); Çifti i lumtur (bashkautor); Trishtimi i Zonjës Shnajder (bashkautor).

Aktor në filmat:

- 2005 *Syri magjik.* Prodhim shqiptar.
- 2000 *...kai to treno paei ston ourano.* (Treni shkon drejt qiellit) Prodhim qipriot.
- 1994 *Lamerica.* Milkani interpreton rolin e Selimit. Regjisor Gianni Amelio. Prodhim i Cecchi Gori Group.
- 1960 *Srpnová nedele.* (E diela e gushtit) Prodhim çek.

Autor

- 1997 *Débuts de la photographie en Albanie*, *1863-1967*. Autorë: Gérard Girard. Në bashkëpunim me Gegë Marubi (parathënie), Piro Milkani (parathënie), Pirro Naçe (parathënie). Paris: Universite de Vincennes à Saint-Denis, 58 f., me il.

Përkthime

- 2012 *Opera e leckamanëve*. Titulli në original "The Beggar's Opera", baladë në tre akte, shkruar më 1728 nga John Gay, mbështetur në idenë e Jonathan Swift dhe muzikë të Johann Christoph Pepusch. Veprës i janë bërë disa përshtatje, në kohë dhe nga autorë të ndryshëm. Më 1975, Václav Havel krijoi një përshtatje në çekisht të veprës. Piro Milkani e përkthen nga çekishtja dhe e përshtati për teatrin shqiptar të Shkupit.
- 2012 *Nga Çaslavi në Hollywood. Autobiografia e Miloš Forman.* Titulli në original "Co ja vim?" Autorë Miloš Forman & Jan Novák. Përktheu nga origjinali Piro Milkani. Tiranë: Onufri, 300 f., 10 fl. me foto.
- 2004 *I kam shërbyer mbretit të Anglisë.* Titulli në original "Obsluhoval jsem anglickeho krale" Autor: Bohumil Hrabal Përktheu nga origjinali: Piro Milkani. Tiranë: Korbi, 210 f., çmimi 500 lekë.

Prémysl Vinŝi, studiuesi çek që studion historinë e Shqipërisë

Në fillim të vitit 1999 më erdhi në zyrë një djalë i ri. Në dorë mbante dy albume për vendin tonë. Bisedën e hapi duke më thënë se kishte dëgjuar rastësisht për Shqipërinë nga një program i Dojçe Vele në një moshë fare të vogël dhe, që nga ajo kohë, sistemonte e klasifikonte çdo lajm që shkruhej e thuhej për këtë vend. E mbajta afër dhe e ftoja në të gjitha aktivitetet që zhvilloheshin në ambasadë. Sot është studiues dhe merret me historinë e Shqipërisë gjatë periudhës së diktaturës.



Kuadër nga filmi "Ngadhënjim mbi vdekjen". Në foto E. Kume në rolin e Mira Bules dhe E. Luarasi në rolin e Afërdita Persefonit



Konti Zdeněk Sternberg dhe Piro Milkani dalë në një nga mjediset e kështjellës së tij, ndërtuar më 1241. Në këtë kështjellë janë xhiruar disa skena nga filmi "Trishtimi i zonjës Shnajder". *Photo credit: Arkiva personale, Piro Milkani.*

Vlerësime e çmime

- 2014 *Çmimin e mirënjohjes,* dhënë nga Digitalb si nismëtar dhe bashkëpunëtor në restaurimin e filmit "Skënderbeu" (së bashku me Eno Milkani dhe Esat Mysliu).
- 2013 *Çmimi special i karrierës,* nga Akademia "Kult"
- 2013 *Çmimin e karrierës,* në Festivali i 6-të Ndërkombëtar të Filmit, Durrës.
- 2012 *Qytetar nderi* i qytetit të Korçës, titull i dhënë me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë nga Këshilli Bashkiak Korçë me motivacionin "Për kontribut të shquar në kinematografi".
- 2012 (12-19 shtator) Piro Milkani është President i Jurisë Ndërkombëtare në Festivalin e 28-të Ndërkombëtar të Filmit të Vendeve të Mesdheut, Aleksandri, Egjipt.

Anëtarë: Fatehy Abdel-Wahab, Egjipt; Nedal Debs, Siria; Libleba; Laila Yorgo, Greqi; Valeiry Pender Akoveski, Rusi; Sadai Enshezo, Turqi.

- 2011 Anëtar në Jurinë Ndërkombëtare të Festivalit të katërt Ndërkombëtar të Filmit "East & West. Classics and avant-garde", Orenburg, Rusi.

Festivalin e përshëndetën: A. Avdeev, Ministër i Kulturës së Federatës Ruse; Yury Berg, Guvernator i Orenburg; Grigory Ivliev, zëvendës Kryetar i Dumës dhe kryetar i Komitetit për Kulturën; V. Telnov, Kryetar i Departamentit të Kinematografisë, pranë Ministrisë së Kulturës së Federatës Ruse; Sergei Lavrentyev, Drejtor i programeve, IFF "East & West. Classics and Avant-Garde"; Tatyana Voronetskaya, Presidente e festivalit. Juria ndërkombëtare përbëhej nga: Ali Khamraev, regjizor, skenarist (Uzbekistan); Piro Milkani, regjizor, skenarist, fotograf (Shqipëria); Sofia Kuzeva-Tschernev, Aktore (Bullgaria); Andrea Piersanti, gazetar, autor, organizator për TV dhe radio (Itali, RAI).

- 1988 *Artist i Popullit.*
- 1980 *Artist i Merituar.*
- 1968 *Çmimin e Republikës* për filmin "Ngadhënjim mbi vdekjen".
- 1967 *Urdhërin Naim Frashëri* për filmin "Oshëtimë në bregdet".

Kosova dhe çështja e saj. Milkani merr detyrën e Ambasadorit në një moment historik për fatet e Kosovës.

1999

Në pranverën e vitit 1999 fillon lufta e Kosovës. Kosova e Shqipëria gjenden në qendër të vëmendjes së shtypit e medias së të gjithë botës.

Krahas shkrimeve e intervistave për shtypin çek e sllovak sa i takon ngjarjes, Milkani veçon një debat të drejtpërdrejt televiziv me ambasadorin serb në Çeki, një debat që ndiqet nga më shumë se dy milionë shikues. Një diplomat shqiptar që vinte nga radhët e krijimtarisë, përballë një diplomati serb karriere. Sipas Milkanit, fakti që argumentet e sjella në debat nga ana e tij ishin të bazuara vetëm në referenca historike e kulturore, një fushë ku ai ndihet i sigurt dhe i plotësuar, tërhoqën vëmendjen e audiencës dhe u pasua me një mbështetje të fuqishme.

Detyra si ambasador, komuniteti shqiptaro-kosovar në Çeki dhe Ismail Kadare

Ambasadori i një vendi ka për detyrë të bëjë të njohur vendin e tij dhe, mundësisht, të forcojë marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve, sikundër edhe të promovojë arritjet e vendit që përfaqëson, - shprehet Milkani. Ndërkohë, rutina e punës përmbante pritje e përcjellje të delegacioneve, kryesisht atyre shtetërore, që vinin nga Shqipëria në Çeki dhe anasjelltas. Do veçoja vizitën e delegacionit qeveritar çek në kohën e bombardimeve të NATO-s, si dhe të delegacionit shqiptar në Kongresin e Fondit Monetar Ndërkombëtar në Pragë. Po ashtu, kam pasur privilegjin të jem pjesë e vizitës zyrtare të Presidentit Mejdani në Çeki, që u pasua nga një vizitë analoge, ajo e presidentit Havel në Shqipëri dhe Kosovë vetëm pak ditë mbas përfundimit të luftës.

Nga ana tjetër, më duhet të pohoj se një kënaqësi të veçantë ndjeja kur kisha mundësi të organizoja aktivitete kulturore. Kështu, çdo vit, në kuadër të muajit të frankofonisë arrija të mblidhja kineastë shqiptarë që shfaqnin në Pragë filmat e tyre për komunitetin shqiptar e atë kosovar. Puna ime si ambasador ka qenë vërtet interesante dhe shpresoj e besoj se kam bërë më të mirën për vendin tim.

Në çdo ngjarje kulturore a politike të Ambasadës tonë në Pragë, shqiptarët e kosovarët, sikundër edhe shqiptarët e Maqedonisë që jetonin në Çeki ishin gjithmonë të mirëpritur. Duhet vënë në dukje se numri i tyre ishte shumë i madh. Pjesa dërmuese e tyre ushtronte profesionin e argjendarit dhe të floripunuesit, por nuk mungonin edhe ata që ofronin shërbime hotelerie e kafetari.



Në ceremoninë e inaugurimit të ekspozitës së artistëve shqiptarë në Pragë.
Photo credit: Arkiva personale, Piro Milkani.

Në ditët e vështira të pragluftës në Kosovë jo rrallë në dyert e ambasadës trokisnin djem të rinj të ardhur nga Kosova që ishin larguar për t'i shpëtuar shërbimit ushtarak në Serbi, ku dihej se shumë prej tyre zhdukeshin më vonë në mënyrë misterioze. Dyert tona ishin të hapura për të gjithë ata. Ne përpiqeshim të vendosnim kontaktet e kërkuara dhe shume shpejt, figura të njohura ishin të pranishme për të bërë verifikimet e duhura, përfshirë qytetin a fshatin nga vinin, formimin profesional etj. Më tej, bëheshin rekomandimet dhe merrej aprovimi i personit përkatës, për t'i sistemuar në mjedise të tjera. Shumë prej tyre niseshin drejt Shqipërisë a Kosovës për t'u bërë pjesë e UÇK-së. Nga kujtimet e mia për këtë kohë veçoj një takim në aeroportin e Pragës. Takova me kënaqësi disa nga djemtë me të cilët kohë më parë, në aktivitetet e organizuara në Pragë ku diskutohej për të ardhmen e Kosovës, ishin ndër të parët që diskutonin, djem që bënin

2000

Në këtë vit, Ambasadori Milkani është nismëtar për organizimin e një koncerti të madh bamirës në sallën e madhe të Bashkisë së vjetër të Pragës.

Në koncert interpretuan dy nga artistët më të mëdhenj shqiptarë: Margarita Kristidhi në piano dhe Bledar Zajmi në violinçel, njëherazi violinçel i parë në Teatrin e Operas së Pragës. Koncerti u ndoq nga një publik i gjerë, përfshirë shumë ambasadorë të vendeve të tjera të akreditуar në Çeki. Falë koncertit u mblodhën afro 15000 dollarë. Shuma e mbledhur, ju dhurua Kryqit të Kuq Ndërkombëtar në ndihmë të Kosovës.



Foto nga koncerti bamirës në sallën e madhe të Bashkisë së vjetër të Pragës.

një jetë të reahtshme në Çeki, por sikundër më pohuan, po i braktisnin të gjitha për të luftuar për vendin e tyre. Vite më vonë takova njërin prej tyre, Muhametin, kosovarin intelektual që ishte shpirti i kësaj nisme. E kisha zokon të mos i flisja në emër:

- Komisar, më thuaj si shkoi fati i atyre djemve që përcollëm për në luftë?

- Të gjithë janë shëndoshë e mirë, me përjashtim të ndonjë plagosjeje.

Po këta njerëz më kërkuan të mundësoja një vizitë të Ismail Kadaresë në Çeki. Kuptohet që me fondet e pakta që kisha në dispozicion muk mund ta bëja një gjë të tillë, por ata morën përsipër të gjitha shpenzimet. Kadareja edhe pse kishte qenë disa herë në Çeki, edhe pse axhenda e tij ishte tepër e mbingarkuar, për kënaqësinë e ne të gjithëve pranoi. Kohën më të madhe të vizitës së tij e shpenzoi me takimet me komunitetin shqiptar e kosovar. Kur i tregova se të dhjetë dyqanet luksoze të floririt ishin pronë e kosovarëve, nuk la pa thënë një batutë të bukur, nga ato që vetëm ai di të bëjë: *Me këto vitrina e paskan bërë Pragën edhe më të artë!*

* * *

Václav Havel, një president artist

Aty nga fundi i viteve ’80, kur në Europën lindor po lindnin lëvizje të fuqishme demokratike, si Solidarnosti në Poloni me në krye Leh Valensën, ose kur shkencëtari në fushën e fizikës bërthamore Andrei Sakharov në Bashkimin Sovjetik kishte dalë haptas kundër sistemit represiv të Brezhnjevit, në Çekosllovaki lindi “Forumi Civil”, në krye të të cilit doli një figurë e njohur e teatrit, ajo e dramaturgut Václav Havel.

Në dhjetor 1989, pas disa javë demonstratash paqësore, Parlamenti Federal i Çekosllovakisë komuniste e votoi unanimisht për president të vendit. Në kujtimet e tij, regjisori i madh Miloš Forman, shok fëmijërie dhe fitues i disa çmimeve Oskar, jo pa ironi kujton: “Komunistët e votuan unanimisht Vashkun (emër përkëdhelës) sepse ata nuk dinin të votonin ndryshe”.

Kur në vitet ’50 studioja në Pragë për kinematografi, çdo të enjte mbrëma kishim mundësi të shikonim filma të ndaluar, pra ata filma që censura çekosllovake nuk i lejonte të qarkullonin në publik. Pas shfaqjes shkonim të diskutonim në ndonjë birrari për filmin që kishim parë. Studenti i regjisurës Jan Njemec sillte me vete ilegalisht edhe djalin e tij të tezes, Václav Havel. Por askush nga ne nuk i jepte rëndësi djaloshit të ndrojtur që më shumë dëgjonte se fliste dhe as na shkonte në mendje se një ditë do të bëhej president i vendit. Kjo është arsyeja pse presidenti Havel bisedën intime kokë më kokë, pas dorëzimit të letrave kredenciale, e filloi me fjalët:

> Jam i lumtur që keni ardhur përsëri këtu. Por ju lutem mos më thoni asgjë për veten tuaj, pasi i di të gjitha. Më mirë më thoni si është situata në Shqipëri pas ngjarjeve të shëmtuara të vitit ’97.

Më vonë mësova se Njemec-i e kishte mirinformuar. Në fund të bisedës më kërkoi një këshillë:

- Dua një këshillë!

- Këshillë nga unë?

- Po. Këto ditë vjen në Pragë Ibrahim Rugova për të marrë çmimin “Homini Hominis” që fondacioni “People in Need” ia atribuon një herë në vit një personaliteti të shquar që ka kontribuar për paqen në botë. Kam dëshirë që këtë medalje t’ia jap me dorën time. Si do të reagojë qeveria shqiptare me këtë rast?

Është e vërtetë që Rugova është zgjedhur president nga një parlament që nuk njihet zyrtarisht nga serbët, por qeveria shqiptare jo vetëm që e njeh, por ka hapur edhe një zyrë përfaqësimi të Kosovës në Shqipëri. Përgjigja ime e gëzoi pa masë. Më vonë mësova edhe pse-në. Para disa muajsh kishte dashur t’i jepte një medalje kryebashkiakut të Vienës, zoti Zilka, për kontributin e tij në forcimin e marrëdhënieve miqësore Austri-Çeki, por një gazetë gjermane e kishte paralajmërur: “Havel, nëse do ja japësh atë deklaratë Zilkës, ne jemi të detyruar të nxjerrim dokumente që tregojnë se Zilka ka qenë bashkëpunëtor i sigurimit çek”. Haveli u tërhoq. Në një situatë të tillë, nuk kishte dëshirë të kishte “telashe”, mesa duket, edhe me Rugovën. Pas disa ditësh Rugova erdhi në Pragë dhe u prit me të gjitha nderet e një kryetari shteti, por shëndetligu Havel ato ditë u sëmur dhe nuk mundi të bëjë gjë tjetër, vetëm se t’i dërgonte urimet përmes zv.Kryeministrit që i akordoi medaljen.

Në muajt në vijim Havel ishte një ndër personalitetet më të fuqishëm politik në përkrahje të çështjes kosovare. Në ato ditë të trazuara në një intervistë për “Le Monde”, 29 prill 1999, shprehet: “Unë nuk jam ekspert në çështjet e Ballkanit, por mund të them se e kam ditur, ndoshta që para 20 vjetësh, se situata në Kosovë po shkonte drejt shpërthimit”. Në të njëjtin artikull, mediat ja atribuojnë Havelit shprehjen e famshme “Bombardime humanitare”, që shumë shpejt u zgjerua edhe në “luftë humanitare”.

ARBEN CICI

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës.
Periudha: 2010, tetor – 2014, tetor

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kroacisë. Ambasador në Bosnje-Hercegovinë (jo-rezident).
Periudha: 2000, shtator – 2006, gusht

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i R.Sh në Federatën Ruse. Ambasador në Bjellorusi, Moldavi, Armeni, Gjeorgji, Kazakistan dhe Uzbekistan (jo-rezident).
Periudha: 1992, tetor – 1995, shtator



Photo credit: Arkiva personale, Arben Cici.

Datëlindja: 5 maj 1960

Vendlindja: Korçë, Shqipëri

Diplomë: Fakulteti i Përkthimit,Universiteti i Algjerit, Algjeri.

Gradë shkencore: Doktor i Shkencave Historike në Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Gjuhët e huaja: Frëngjisht, anglisht, arabisht, italisht, kroatisht.

Bashkëshortja: Magi.

Fëmijët: Pandi, Tomas, Teodor.

Motoja: "Përsosmëria arrihet duke qenë vetvetja".

2010, 12 tetor Paraqet *letër-kredencialet* Madhërisë së Saj, Mbretëreshës së Danimarkës, si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës.

2008-2010 Pedagog i "Marrëdhënieve ndërkombëtare", Universiteti i Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji.

2007-2010 Pedagog i Marrëdhënieve ndërkombëtare, Kolegji Victory, Prishtinë; UBT (Universiteti për Biznes &Teknologji), Prishtinë.

2007, gusht - 2010, shtator Këshilltar Diplomatik i Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

2007-2009 Pedagog i "Marrëdhënieve ndërkombëtare", Universiteti Evropian i Tiranës.

2006 - 2010 Pedagog i "Marrëdhënieve ndërkombëtare", Fakulteti Histori-Filologji; Pedagog i "Gjuhës frënge", Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

2006, gusht - 2007, gusht Drejtor i Protokollit të Shtetit, Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.

2000, shtator - 2006, gusht Ambasador në Republikën e Kroacisë dhe jo rezident në Bosnje-Hercegovinë.



Foto e marrë më 2007, 10 qershor. Çaste nga ceremonia e dekorimit të Presidentit të ShBA-së, Xhorxh W. Bush, gjatë vizitës së tij në Tiranë. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu dhe Arben Cici, Drejtor i Protokollit të Shtetit. *Photo credit: Arkiva personale, Arben Cici.*

Botime, autor

- 2011 *Uloga Italije u stvaranju Monarhije u Albaniji* (The role of Italy in the creation of the monarchy in Albania). Podgoricë: Revista shkencore "MATICA Crnogorska".
- 2010 *Shqipëria e rivaliteteve italo-jugosllave në vitet 1926-27*. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, revista shkencore "Studime".
- 2010 *Pakti i Parë i Tiranës, afrim i detyruar politik. Trendi Global*. Prishtinë: Instituti i Hulumtimeve Shkencore, Kolegji Victory.
- 2008 *Hyrje në teoritë politike moderne* (bashkautor). Tiranë: Ideart.
- 2002 *Marrëdhëniet italo-shqiptare në vitet 1920-1934*. Tiranë: Aferdita. *Ribotim*, 2013, Tiranë: UET Press.

Publicistikë

- 2012, 10 qershor *Detajet e pathëna të vizitës së Presidenit Bush në Tiranë*. Shqiptarja.
- 2012, 7 qershor *Diplomacia, nga Alfabeti Mors tek Facebook-u*. Gazeta Shqip
- 2012, 5-6 shkurt *Për-se Serbisë duhet t'i kushtëzohet anëtarësimi në Bashkimin Evropian me njohjen e Kosovës, dhe jo vetëm*. Gazeta Shqip.

Ligjërata në konferenca dhe simpoziume

- 2010, dhjetor Konferenca Ndërkombëtare mbi marrëdhëniet Shqipëri-

1996-2000 Në këtë periudhë:

- 1996, tetor - 2000, gusht Drejtor i Protokollit të Shtetit, Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.
- 1996-2000 Pedagog në Katedrën e Gjuhës Frënge, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.
- 1999, qershor Fiton gradën "Doktor i Shkencave Historike" në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
- 1997, tetor Specializim i plotë mbi integrimin evropian pranë Qendrës së Studimeve Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Athinë, Greqi.

1995, tetor - 1996, shtator Drejtoria e Evropës, Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.

1993-1995 Studime pasuniversitare, Akademia Diplomatike, Ministria e Punëve të Jashtme, Moskë, Federata Ruse.

1992, tetor - 1995, shtator Ambasador në Federatën Ruse dhe jo rezident në Bjellorusi, Moldavi, Armeni, Gjeorgji, Kazakistan dhe Uzbekistan.

1992, qershor - 1992, tetor Drejtoria e Parë, Ministria e Punëve të Jashtme, Tiranë.

1991 Specializim katër mujor pasuniversitar për përkthim, Qendra Jacque Amiot, Paris.

Prof. Dr. Pëllumb Xhufi

Ambasadori Cici e tregon fibrën e tij prej studjuesi e diplomati të mprehtë që në përcaktimin e temës dhe përkufizimin kohor të saj.., na ilustron më së miri qerthullin vicioz në të cilin lëvizi dhe u detyrua të lëvizë politika e jashtme shqiptare në atë periudhë të parë të konsolidimit të shtetit shqiptar...

Valbona Nathanaili, për librin *Marrëdhëniet italo-shqiptare në vitet 1920-1934.* Tiranë: UET Press, 2013.

...Një libër i domosdoshëm ... dhe i shkruar me elegancë e profesionalizëm. Cici ofron një material të pasur arkivor për një periudhë të rëndësishme në historinë e ndërtimit e të zhvillimit të marrëdhënieve me Italinë.



Britani e Madhe, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Katedra e Historisë, Fakulteti Histori-Filologji.

- 2008, tetor Konferenca Ndërkombëtare "Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor, mundësi dhe sfida" Torino, Itali.
- 2006, qershor Instituti Diplomatik dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ministria e Punëve të Jashtme, Algjer, Algjeri. Tema: *Shqipëria dhe Bashkimi Evropian, histori suksesi*.
- 2005, tetor Simpoziumi Ndërkombëtar me rastin e 450 vjetorit të librit të parë në shqip, "Mesharit të Gjon Buzukut" Zagreb, Kroaci.
- 2005, prill Simpoziumi ndërkombëtar mbi jetën dhe veprën e Gjergj Kastriot Skënderbeut, Zagreb, Kroaci.
- 2003, mars Konferenca ndërkombëtare me rastin e formimit të Katedrës së Gjuhësisë të Fakultetit të Filologjisë, Universiteti Shtetëror të Saint-Petersburg, Saint-Petersburg, Rusi.
- 2002, nëntor Konferenca ndërkombëtare organizuar nga Arkiva e Shtetit të Shqipërisë mbi kontributin albanologjik të Milan Shuflajt, Tiranë.
- 2001, shkurt Akademia ndërkombëtare solemne me rastin e 70 vjetorit të vrasjes së Dr. Milan Shuflaj, Zagreb, Kroaci.
- 2000, tetor Konferenca ndërkombëtare *Diplomacia në kohën e globalizmit*, Dubrovnik, Kroaci
- 1996, qershor Konferenca ndërkombëtare për problemet historike dhe albanologjike, Saint-Petersburg, Rusi.

1988, shtator - 1992, maj Pedagog në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, Katedra e Gjuhës Frënge.

1981-1984 Kursi i plotë i gjuhës arabe, Fakulteti i Letërsisë dhe Gjuhësisë, Konstantinë, Algjeri.

1979-1981 Studime në Fakultetin Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës, Dega "Gjuhë frënge".

Pasioni / hobi: Leximi, basketbolli, muzika.

Çmime dhe vlerësime

2006, dhjetor *Medalja e Mirënjohjes* nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu.

2006, korrik Urdhëri i lartë *Duka Branimir me Shirit* (REDOM KNEZA BRANIMIRA S OGLICOM) nga Presidenti i Republikës së Kroacisë, Stjepan Mesić.



Ambasador Arben Cici dhe Presidenti i Republikës së Kroacisë, Stjepan Mesić

Prof. Dr. Valentina Duka

Autori ia ka dalë të krijojë një vepër të vlefshme jo vetëm për studentët e studiuesit e historisë së Shqipërisë, por edhe për diplomatët shqiptarë. Kjo monografi do të jete një burim i rëndësishëm reference për këdo që do të marrë përsipër të shkruajë për historinë e Shqipërise ndërmjet dy Luftrave Botërore.

Prof. Dr. Adem Mezini, për librin *Marrëdhëniet italo-shqiptare në vitet 1920-1934.* Tiranë: UET Press, 2013.

...Studimi i pedagogut të palodhur dhe diplomatit të karrierës Arben Cici duhet parë si sprovë e re në historinë diplomatike mbi Shqipërinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në shekullin 20...



2014, Ambasadori Arben Cici në pritjen e dhënë nga Mbretëresha e Danimarkës.
Photo credit: Arkiva personale, Arben Cici.

Rusi

Me nismën e Ambasadorit Cici, në mars të vitit 1993, krijohet në qytetin e Saint-Petersburg "Shoqata e Miqve të Shqipërisë", në bërthamë të së cilës marrin pjesë albanologë dhe dashamirës të gjuhës shqipe të Universitetit të St. Petërburgut, nxënësit dhe ndjekësit e veprës së Anja Desnickaja.

Tiranë

Ambasadori Cici, në cilësinë e Drejtorit të Protokollit të Shtetit përgatiti dhe organizoi me sukses vizitën historike në Tiranë të Presidentit të SHBA-së Xhorxh W.Bush më 10 qershor 2007.

Danimarkë

Botimi i Ismail Kadaresë. Gjatë qëndrimit të tij në Danimarkë, Ambasadori Cici nxiti botimin në danisht nga Shtëpia Botuese "TIDERNE SKIFTER" të veprës së Ismail Kadaresë, "Darka e gabuar", cili u prit dhe u pasqyrua pozitivisht nga kritika letrare vendase.

Promovimi i turizmit shqiptar. R.Sh, nëpërmjet Ambasadës së saj në Kopenhagen, promovon vlerat e kulturën kombëtare në Panairin Ndërkombëtar të Kopenhagës. Ambasadori Cici inicion promovimin e turizmit dhe traditës shqiptare në Shkollën e Bisnesit të Kopenhagenit (CBS), me pedagogë e studentë të vitit të tretë të Qendrës për Menaxhimin e Turizmit dhe Kulturës.

Shqiptarë të famshëm. Në Danimarkë e njohin të gjithë, por jo vetëm, pasi fama e tij ka pushtuar gjithë botën. Bëhet fjalë për René Redzepin, shqiptarin e famshëm, pronarin e Restorantit "NOMA" vlerësuar për katër vjet si "Restoranti më i mirë në botë" (2010, 2011, 2012 dhe 2014). Redzepi është një djalosh i qeshur, i hapur dhe shumë i çiltër, modest për peshën e rëndë të famës, i papërtuar të shpjegojë me doza të theksuara krenarie prejardhjen shqiptare dhe jashtëzakonisht i gatshëm të tregojë për pasionin e tij. Klientët e restorantit janë, njëkohësisht, edhe miqtë e tij, por kur ka miq shqiptarë, pritja duket se merr nuanca të tjera, më të ngrohta, sepse vetvetiu i shtohen dozat e buzëqeshjes dhe të përzemërsisë. Kam kënaqësinë që jo vetëm kam "bujtur" dhe provuar gatimin e këtij mjeshtri, por edhe të ndaj me lexuesin mbresat e mia, shprehet Ambasador Cici.



Ambasador Arben Cici dhe René Redzepin

Virgjil Muçi

… Ambasadori Cici i lejon vetes sqimën... të kryejë kohë pas kohe ndonjë rokadë elegante: herë-herë është diplomati që shkon dhe i lë vendin historianit, ndërsa herë tjetër është historiani që tërhiqet për t'i hapur udhë diplomatit.

Libri është një ftesë për të hedhur një vështrim kritik në të shkuarën tonë, jo të largët, si dhe për të reflektuar rreth sfidave aktuale me të cilat përballet jo vetëm vendi ynë e rajoni, por edhe më gjerë.

SHABAN MURATI

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Maqedoni.
Periudha: 1993-1997

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Suedisë.
Periudha: 2002-2007

Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i R.Sh në Finlandë, Norvegji, Islandë (jo resident).
Periudha: 2002-2007



Photo credit: Arkiva personale, Shaban Murati.

Datëlindja: 2 shtator 1945

Vendlindja: Durrës

Diplomë: Gjuhë & letërsi shqipe, Universiteti i Tiranës

Gjuhët e huaja: Anglisht, italisht, rusisht, maqedonisht.

Bashkëshortja: Dashuri

Fëmijët: Erl, Arba.

Motoja: "T'i ngjash detit në heshtjen dhe fuqinë e tij".

2014 Këshilltar i posaçëm i Ministrit të Jashtëm, Tiranë.

2008-2010 Drejtor i Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë.

2008-2010 I Dërguar Special i Shqipërisë në Organizatën e Bashkëpunimit Islamik, OIC.

2003-2007 Lektor në Universitetin e Upsalës, Suedi, me cikël leksionesh për Ballkanin dhe Kosovën.

2002-2007 Ambasador i Shqipërisë në Suedi. Ambasador i Shqipërisë (jorezident) në Finlandë, Norvegji dhe Islandë.

2001-2002 Drejtor i Drejtorisë së Ballkanit në Ministrinë e Jashtme.

2000-2001 Drejtor i Drejtorisë së Prognozës dhe Analizës në Ministrinë e Jashtme.

1998-1999 Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Partinë Demokratike.

1993-1997 Ambasadori i Shqipërisë në Maqedoni.

1991-1993 Korespondent i Parë i Agjencisë ANSA, Itali, në Tiranë.

1991-1992 Zëdhënës dhe Drejtor i Drejtorisë së Shtypit, Ministria e Jashtme, Tiranë.

1984-1990 Shef i sektorit të jashtëm, gazeta "Zëri i Popullit".

1984-1990 Anëtar i Katedrës së Historisë së Përgjithshme, Universiteti i Tiranës.



Foto e marrë më 1993. Ambasador Shaban Murati me Ministrin e Jashtëm të Maqedonisë, Stevo Crvenkovski. *Photo credit: Arkiva personale, Shaban Murati.*



2005, Suedi. Në një takim për Kosovën.
Photo credit: Arkiva personale, Shaban Murati.

1976-1983 Anëtar i Kolegjumit të Drejtorisë së Përgjithshme të RTVSH.

1974-1993 Pedagog i jashtëm dhe anëtar i Katedrës së Estetikës, Universiteti i Tiranës.

1967-1983 Analist i politikës së jashtme dhe shef i redaksisë së Europës Perëndimore, Ballkanit dhe SHBA në Radion e Jashtme.

Pasione/ hobi: Librat, kitara, noti.

Botime, autor

- 2014 *Rusia ballkanike Tiranë.* Tiranë: ENEAS, 354 f.
- 2013 *Diplomacia shqiptare në kërkim të identitetit* .Tiranë: ENEAS, 158 f.
- 2012 *Hije në diplomacinë shqiptare.* Tiranë: ENEAS, 286 f.
- 2009 *Çështja shqiptare pas pavarësisë së Kosovës, një testament diplomatik.* Tiranë: Globus R., 134 f. *Ribotuar*, 2012, (anglisht), me titull *Albanian question after the independence of Kosova: a diplomatic testament.* Tiranë: Instituti i Mendimit dhe Civilizimit Islam (AIITC), 132 f.
- 2009 *Profile të diplomacisë europiane në Ballkan.* Tiranë: UET Press, 292 f.
- 2007 *Enigmat diplomatike të pavarësisë së Kosovës. Fletë nga ditari i një ambasadori.* Tiranë: Kristalina-KH, 352 f.
- 2004 *Serbia kundër Serbisë. Analizë e një gjysëm revolucioni të lënë përgjysëm.* Tiranë: Albin, 254 f.

Agim Shehu, poet i njohur dhe studiues


Shaban Murati është një penë me peshë të çmuar e me dritë të gjallë, i rrallë në natyrën e tij. Gjykimet e Shaban Muratit rrezatojnë vlerë, përtej kohës kur shkruhen.

Dr. Jorgji Kote, diplomat dhe studiues

Ka një konsensus të plotë që, në fushën e analizave të gjithanshme për marrëdhëniet ndërkombëtare, shkëlqen diplomati, analisti dhe eksperti Shaban Murati. Autori njihet si analisti më i shquar në këtë fushë krejt specifike, me përvojë mbi 40-vjeçare. Nuk mund të mos kesh ndjesi pozitive kur sheh se sugjerimet dhe propozimet të tij po mirëpriten edhe nga institucionet e interesuara shtetërore, madje disa prej hapave të propozuara nga Murati janë në procesin e realizimit praktik.

Prof. Dr. Aleksandër Meksi

Shaban Murati, një ambasador nga më të mirët e vendit tonë dhe një kërkues i palodhur e i pashoq i mendimit të ri diplomatik shqiptar. Shaban Murati mund të thuhet se është patriarku i analizës diplomatike dhe të politikës së jashtme, sepse është e pashoqe krijimtaria e tij në këtë lëmë. Shaban Murati mishëron një autor krijues të mendimit diplomatik shqiptar, të përgjithësimit të përvojës diplomatike shqiptare dhe sjell një kontribut të ri në shkencën e mendimit diplomatik, me një guxim profesional dhe novacion mendimor të një niveli mjaft të lartë".



Artikuj shkencorë, kumtesa, referate

- 2010-2014 Kontribues i rregullt analizash diplomatike në revistën e specializuar "Diplomacia dhe mbrojtja", Greqi.
- 2008-2014 Bashkëpunëtor i Institutit të Mendimit dhe Civilizimit Islam, Tiranë.
- 2002-2007 Kontribues i rregullt analizash diplomatike në portalin "South European Times", ShBA.
- 1998-2002 Kontribues i rregullt analizash diplomatike në agjencinë AIM, Paris.
- 1992-2014 Analist diplomatik në shtypin e përditshëm shqiptar, me analiza për zhvillimet ndërkombëtare,
- 1991- 2014 Pjesëmarrje me kumtesa në dhjetra konferenca e seminare ndërkombëtare të politikës së jashtme brenda e jashtë vendit.



1995, Ohër, Maqedoni. Gjatë nënshkrimit të Deklaratës së Përbashkët ShBA-Shqipëri-Maqedoni në kuadër të projektit për mbrojtjen e liqenit të Ohrit. *Photo credit: Arkiva personale, Shaban Murati.*

Ambasador në Maqedoni

1994

Gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si Ambasador në Maqedoni, një nga aktivitetet kryesore që veçon Shaban Murati është përkrahja e fuqishme për themelimin e hapjen e Universitetit të Tetovës, zhvillimi i mësimit në gjuhën shqipe në auditorët e tij, në qershor të vitit 1994, si dhe veprimtaria diplomatike pranë autoriteteve maqedonase dhe faktorit ndërkombëtar për legalizimin e atij universiteti.

* * *

Anëtarësime

- 2012-2014 Anëtar i Bordit të Këshilltarëve të Qendrës së Studimeve Strategjike për Lindjen e Mesme, ORSAM, Turqi.
- 2011-2014 Këshilltar i lartë në Institutin e Shqiptar të Studimeve Ndërkombëtare dhe në Institutin Shqiptar të Medias.
- 1991-1993 Përfaqësues në Tiranë i Fondacionit amerikan "Fondi Ndërkombëtar i Medias", IMF, ShBA.
- 1969 Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Ditmir Bushati, Ministër i Jashtëm i Shqipërisë

Shaban Murati, skaner drithërues për politikën e jashtme dhe dimensionin rajonal të Shqipërisë.

Prof. Shinasi A. Rama, New York University, ShBA

Shaban Murati është një nga figurat më të spikatura të diplomacisë shqiptare. Autor i shumë librave, ndjekës i vëmendshëm në shtyp i proceseve politike ballkanike e më gjerë, një personalitet publik me rëndësi të veçantë, mendimi i shprehur i të cilit duhet analizuar me shumë seriozitet.

Ilir Meta, Ministër i Jashtëm, 2009

Shaban Murati është një nga diplomatët më të njohur që ka vendi ynë, me një përvojë të jashtëzakonshme dhe shumë të pasur në shërbimin diplomatik. Përpos saj, edhe publicist i shkëlqyer. Është shumë e rëndësishme që diplomatët me përvojë shkruajnë idetë e tyre".

Prof. Ksenofon Krisafi

Shaban Murati, i afirmuar si një nga diplomatët tanë më me përvojë dhe një nga ekspertët më të mirë të problemeve ndërkombëtare e sidomos të Ballkanit.



2006, Stockholm. Ambasadori Shaban Murati në Klubin e Ambasadorëve Këngëtarë.
Photo credit: Arkiva personale, Shaban Murati.

Ambasador në Suedi

Kosova dhe çështja e saj

Lobingu pranë qeverive të Suedisë, Finlandës dhe Norvegjisë për pavarësinë e Kosovës në prag të hapjes së bisedimeve për statusin e Kosovës, ku diplomacia nordike kishte një rol dhe vend prioritar.

2005, 20 janar

Merr pjesë në një takim të zhvilluar pranë Universitetit të Uppsalës, Suedi, me temë "Kosova dhe çështja e saj".

Fragment nga fjala e mbajtur
(*para një auditori të përbërë nga profesorë, studiues, studentë e aktorë të shqetësuar për çështjen e Kosovës)*

Realiteti dhe urgjenca e zgjidhjes së statusit të Kosovës diktojnë hapjen e diskutimeve dhe marrjen e një vendimi ndërkombëtar për këtë status dhe, rrjedhimit, edhe një rezolutë të re të OKB0-së. Të gjithë faktorët e rëndësishëm ndërkombëtarë e kanë bërë të qartë publikisht se Kosova nuk kthehet më në të kaluarën. Ajo shkon dhe do të shkojë nga pavarësia, sepse problemet që do të shkaktonte mosdhënia e pavarësisë, janë shumëfish më të rënda se sa problemet që do të shkaktonte dhënia e pavarësisë.

Çështja e Kosovës do të zgjidhet si çështje euroatllantike. Nuk duhet harruar se edhe një partneritet amerikano-europian ka një hierarki, që përcaktohet nga pesha politike dhe roli botëror në mbrojtje të lirisë. Në këtë pikë, nuk mund të mohohet se roli qendror si mbrojtës i lirisë i takon SHBA-ve. Këto janë perspektiva që përputhen me interesin strategjik të Prishtinës dhe Tiranës për pavarësinë e Kosovës.

2003 Koalicioni i "Vullnetit të mirë"

Organizimi, për herë të parë në Stokholm, me nismën e ambasadorit Murati, në prill 2003, i takimit të 35 ambasadorëve të vendeve pjesëmarrëse të "Koalicionit të Vullnetit", i krijuar për rrëzimin e Sadam Hyseinit, gjë për të cilin pati vlerësim nga Departamenti i Shtetit.

Klubi i Ambasadorëve Këngëtarë

Në Stockholm krijohet, për herë të parë në botën diplomatike ndërkombëtare, "Klubi i Ambasadorëve Këngëtarë". Në të merrnin pjesë ambasadorët që luanin ndonjë instrument muzikor, ose u pëlqente të këndonin. Klubi mblidhej së bashku çdo muaj. Pjesë e repertorit ishte paraqitja e këngëve ose pjesëve nga folklori i vendit të çdo ambasadori pjesëmarrës, të cilat mësoheshin nga të gjithë e, më vonë, debutonin para një publiku të gjerë.

Çmime dhe vlerësime

- 2012 Urdhëri *Mjeshtër i Madh,* nga Presidenti i Republikës me motivacion: "Për kontribut në fushën e diplomacisë". I pari diplomat me këtë titull.
- 2012 Çmimin e *Karrierës*, nga Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë.
- 1999 Çmimi vjetor i Fondacionit Soros *Për analizën më të mirë.*
- 1986 Urdhëri *Naim Frashëri* i Klasit të Parë, nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Shqipërisë.
- 1970-1991 Çmime të përvitshme në gazetën letrare *Drita* dhe revistat *Hosteni* & *Nëntori*.
- Pjesëmarrës, pesë here, në ceremonitë e përvitshme të akordimit të çmimeve *Nobël* organizuar nga mbreti i Suedisë.

PJESA E DYTË

Krijues diplomat, apo diplomat krijues?

Mendoni se ekziston një model i krijuesit diplomat?

Krijimi përballë motivit, statusit dhe praktikave diplomatike.

Antropologji e diplomatit krijues.

Çfarë bën një ambasador i kohëve moderne? Si duhen hartuar politikat e rekrutimit të tyre? Cilat janë njohuritë që duhet të kenë? A është ambasadori përfaqësuesi i vetëm politik i shtetit të tij në vendin e akredituar?

Në shekullin e ri kemi të gjitha të drejtat të shtrojmë pyetje të tilla, pasi vetë natyra e marrëdhënieve ndërmjet shteteve dhe komunikimi kanë ndryshuar ndjeshëm. Nga ana tjetër, ambasadorët tanë, duke qenë përfaqësues të një vendi të vogël sikundër është Shqipëria dhe me politika që ndryshojnë katërcipërisht në intervale të shkurtër kohorë, pyetjeve të tilla u shtohen edhe nuanca funksionaliteti. Problemet e rëndësishme për ne jo gjithmonë janë të rëndësishme edhe për pjesën tjetër të botës. Për më tepër, me shumë nga shtetet me të cilat kemi sot marrëdhënie na lidhin histori të dhimbshme, përfshirë luftëra periodike, interesa konfliktualë dhe një izolim i gjatë gjeografik e politik. Kjo kërkon që ambasadorët tanë *duhet* të gjejnë dhe *duhet* të dinë ta paraqesin vendin e tyre si partner të qëndrueshëm; akoma, *duhet* ta bëjnë interesantë në shoqëri që e kanë memorien të ngritur në institucion, që flasin gjuhë të ndryshme dhe, një farë mase, kanë edhe kultura të ndryshme. Shtuar faktin që jemi një vend i varfër, pra edhe me fonde e buxhete tepër modeste për përfaqësitë tona, të tërheqësh vëmendjen për problemet e Shqipërisë shpesh bëhet *mision i pamundur*, jo për të justifikuar, por për të argumentuar mbi baza reale.

A ja kanë dalë? Pyetje e vështirë për të dhënë një përgjigje të saktë sot. Nga ana tjetër, ne të gjithë jemi prodhim i kulturës, historisë dhe, pse jo, edhe burokracisë, veçanërisht në institucione delikate, sikundër është Ministria e Jashtme. Në shumë emërime një peshë të ndjeshme kanë luajtur krahas formimit të personit, edhe struktura familjare, prejardhja apo lidhjet, sikundër edhe paraqitja e jashtme dhe mosha.

Në këtë pjesë jemi kufizuar t'u japim përgjigje pyetjeve që lidhen me një traditë të shndërruar pothuaj në kulturë institucionale në të gjithë botën, por që vazhdon të ngjallë diskutime e hap debat, atë të rekrutimit të ambasadorëve nga fusha e krijimtarisë. Në forum shtjellojnë idetë, mendimet e sjellin përvojat e tyre personale A. Nesho, A. Cici, L. Rama, P. Kulla, P. Milkani, Sh. Sinani, T. Laço dhe Y. Aliçka për katër çështje delikate: Krijues diplomat, apo diplomat krijues? Mendoni se ekziston një model i krijuesit diplomat? Krijimi përballë motivit, statusit dhe praktikave diplomatike. Antropologji e diplomatit krijues.

I Krijues diplomat apo diplomat krijues?

Agim Nesho

Krijuesi përbën një vlerë për diplomacinë dhe si i tillë i ofrohet të bëhet pjesë e diplomacisë në arritjen e objektivave të saj të caktuara. Mbi të gjitha, është në gjendje të bëjë diferencën intelektuale nëpërmjet njohurive, vizionit, shkrimeve ose përgatitjes së tij si intelektual publik. Kjo formë diplomacie ka qenë e përhapur në shekullin e kaluar kur njohjet midis shteteve ishin të pakta dhe prezantimi i individëve të shquar krijonte një impakt pozitiv për vendin.

Sot diplomacia moderne kërkon diplomatin e karrierës, me njohjet dhe njohuritë e tij të gjera në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, përçimin e shpejtë të mesazhit, negociatorin rezultativ, një diplomat i cili gjatë viteve të eksperiencës diplomatike ka krijuar *network*-un e nevojshëm, shprehitë e punës dhe efikasitetin e realizimit të objektivave. Diplomacia njohëse dhe ajo kulturore është zhvendosur drejt diplomacisë së drejtpërdrejtë, asaj për zhvillimin ekonomik dhe zgjidhjes së problemeve të shoqërisë njerëzore në shekullin e 21-të. Një diplomat i tillë, nëpërmjet aktivizimit dhe rolit të tij të spikatur në organizmat botërore mund të sintetizojë eksperiencën dhe të jetë krijues. Diplomatët krijues janë elita e diplomacisë, ku nëpërmjet eksperiencës së tyre të gjerë evidentojnë trendet e zhvillimit botëror dhe çfarë është e nevojshme të realizohet në të ardhmen.

Arben Cici

Duket, në pamje të parë, sikur ka një ndryshim të madh mes krijuesit dhe diplomatit, ose sikur flasim për dy qënie që jetojnë në botë të ndryshme, sikur çdo njeri prej tyre përjashton tjetrin për të gjetur qetësinë, frymëzimin e qëllimit apo të misionit të vet. Në fakt, sipas mendimit dhe përvojës sime, por edhe sa kemi lexuar e nxënë nga përvoja botërore në fushën diplomatike, një diplomat domosdoshmërisht nuk mund të mos jetë krijues, ndërsa një krijues e ka më të lehtë të hapë shtegun për t'u ngjizur me diplomatin.

Në misionet e diplomatit, krahas atij të përfaqësimit dhe të shumë të tjerëve, është edhe ai i informimit. Diplomati mbetet një zbulues i palodhur i së vërtetës dhe një pasqyrues i papërtuar i saj në telegramet e tij diplomatike të përditshme, ndoshta edhe më të shpeshta apo edhe më të rralla. Misioni i tij është të zhveshë nga sipërfaqësia e tyre sendet dhe njerëzit, ngjarjet dhe fenomenet që e rrethojnë, për t'u zhytur thellësisht në thelbin e tyre, për të nxjerrë kuptimin e vërtetë të tyre e për ta bërë atë të vetën. Shpirti krijues apo dhuntia e tij prej krijuesi, në rastin më të keq të ushtruarit e tij për të krijuar, i dhurojnë arkivave diplomatike të vendit të vet faqe të panumërta me përshkrime, analiza e parashikime. Ky bagazh është dije e njohuri të cilat, me kurajë e pa cënuar normat e botës profesionale së cilës i përket, mund t'ja ofrojë publikut në formën e romaneve, poezive, publicistikës apo studimit shkencor. Kjo është një sfidë e madhe në jetën e tij profesionale dhe shpirtërore.

Luan Rama

Unë vij nga kinematografia e gazetaria dhe them se i përkas më shumë kategorisë së krijuesve diplomatë, pasi ne nuk vinim nga Akademitë Diplomatike, që atëherë nuk ekzistonin, ose nga funksione partiake e qeveritare, siç ndodhte gjer afër fundit të viteve '80. Pra, unë e shikoja diplomacinë përmes syve të një letrari që merrej me kinematografi e letërsi dhe shkruante poezitë e para i influencuar nga Eluard, Lorca, Ricos, i ç'penguar nga kornizat politike. Por sapo erdha në Francë, në mars të vitit 1991, kërkova që të hiqej portreti i Enver Hoxhës nga salloni zyrtar i ambasadës, pasi diplomacia sapo ishte deklaruar e depolitizuar, por mjerisht ajo do të hiqej pak muaj më vonë. Këtë mund ta bënte një letrar dhe jo një funksionar nga ata të fabrikuar në zyrat e pushtetit totalitar.

Pëllumb Kulla

Pyetje e drejtpërdrejtë! Ndërmjet krijuesit diplomat dhe diplomatit krijues sigurisht që zgjedh krijuesin diplomat. Besoj se merret me mend. Gjithsesi, mendoj se pyetja duhet lexuar e analizuar në sfondin e kolapsit të diktaturës të egër komuniste, kur strukturat shtetërore dhe diplomatike duheshin zëvendësuar urgjentisht me njerëz që shpresohej t'ia dilnin në krye për të sjellë një frymë të re dhe, sidomos miqësore, në familjen ndërkombëtare. Ishte një sfidë me të cilën duhej të përballeshin pothuaj të gjitha vendet e sapo dala nga hijet e komunizmit.

Përvoja që kam kaluar si diplomat më duket një temë interesante për letërsinë. Faktikisht, në ato vite, as Berisha, as Serreqi dhe as Kulla nuk patën qenë kurrë më parë "zëvendës" dhe jo më presidentë, ministra dhe ambasadorë. Ndoshta shtytja, ose propozimi i të tjerëve, ose edhe ambicia personale për sukses na bënë të arrinim deri këtu. Por secili prej nesh i ndërgjegjshëm për provën e madhe "nëse do i'a dilnim a jo"! Sigurisht që nuk na ka munguar ndihma. Gjatë gjithë kohës kam qenë edhe nxënës, edhe mësues i vetes. Në të tilla kthesa të mëdha ishin mjeranë ata që, në vend të të analizonin punën e përkushtimin, u mbetej në gojë pyetja "Nga u bëre ti?! Ti nuk ke qenë ndonjëherë!" E përkthyer nga shqipja në shqip, ata në krye të këtyre punëve deshën akoma edhe ca kohë Haxhi Llesh, Ramiz Ali, Behar Shtylla e të tjerë…

Piro Milkani

Nuk mund të quhet përjashtim që njerëzit e artit e të kulturës të merren me diplomaci. Por përpara se të shtjelloj idenë time për këtë çështje, me shumë dëshirë do sjell shembullin e piktorit të madh holandez Peter Paulus Rubens (1577-1640), autor i disa prej pikturave më të mrekullueshme të stilit barok për shumë nga oborret më në zë të kohës. Gjatë periudhës 1621-1630, Philip IV, Mbret i Spanjës, i beson Rubens-it shumë misione diplomatike në Angli, që në atë kohë gjendej nën mbretërimin e Charles I. Synimi ishte gjetja e një zgjidhje për konfliktin e gjatë me mbretërinë e Anglisë. Duket se ka punuar

shumë mirë, pasi të dy mbretërit e vlerësuan punën dhe veprën e tij në fushën e artit dhe të diplomacisë duke e nderuar me tituj: më 1624 Philip IV i Spanjës e bën fisnik dhe, më 1630, Charles I i Anglisë e bën kalorës.

Rubens i pëlqente të pikturonte në rrugët e periferitë e Madridit. Një grup aristokratësh kur e panë të pikturonte në rrugë, e pyesin:

- Që kur kanë filluar ambasadorët të zbaviten duke pikturuar?

Rubens u përgjigjet:

- Përkundrazi. Artistët herë pas here zbaviten duke bërë punën e diplomatit.

Emërimin tim si ambasador e perceptova si një mision të rëndësishëm, por provizor, një lloj sikundër edhe Rubens.

Shaban Murati

Është një debat i pazgjidhshëm për renditjen: krijues-diplomat, diplomat-krijues. Të dy modelet janë të aplikueshëm. Për vete do të preferoja modelin e krijuesit diplomat, sepse është më e lehtë të shkohet nga krijuesi tek diplomati se sa nga diplomati tek krijuesi. Në fund të fundit, krijimi ose krijimtaria është pjesë thelbësore e identitetit të diplomatit, sepse është i paplotësuar një diplomat, që nuk aftësinë krijuese.

Teodor Laço

Sigurisht që votoj për krijuesin diplomat. Në diplomaci, në përgjithësi, kemi të bëjmë me të ashtuquajturit "diplomatë të karierrës", promovimi i të cilëve ndjek rrugën e zakonshme të ngritjes nga një gradë diplomatike në tjetrën. Fillojnë me poste të ulëta pranë Ambasadave tona e më tej, në varësi të cilësive, performancës e ambicieve personale, ngrihen në detyrë. Një faktor shumë i rëndësishëm në këtë rast është jetëgjatësia në shërbim. Krijuesit angazhohen në raste të veçanta, sidomos në ato vende ku shteti ka interes të promovojë një nivel të lakmueshëm kulturor. Politikat janë të tilla që tentojnë të ruajnë një lloj raporti në secilin prej dy llojeve të përfaqësimeve, raport që sigurisht ka peshë të ndjeshme për diplomatët e karrerës.

Ylljet Aliçka

Kjo dilemë identitare më ka shoqëruar më së shumti në jetë. Kam qenë shqiptar, mësues, didakt, bashkëshort, funksionar, shkrimtar, ambasador, pedagog, por gjithçka ka qenë përgjysëm, pa u zhytur thellësisht askund, si një amfib, lindur nën shenjën e gaforres. Ndoshta pa u futur kurrë "në situatë" siç thonë shpesh njerëzit e teatrit.

Sidoqoftë mes termit diplomat apo ambasador preferoj të quhem ambasador, pasi unë nuk

jam diplomat karriere dhe për shumë aspekte teknike gjatë misionit tim u mbështeta te kolegët. Nga ana tjetër, edhe në letërsi kam hyrë vonë dhe rastësisht.

Mes shkrimtar apo autor, preferoj më shumë fjalën autor. Autor, përderisa vazhdoj të shkruaj dhe kam përshtypjen se jehona e krijimit ndihmoi apo ndikoi në propozimin e vendimmarrësve për postin e ambasadorit. Pra në rastin tim, pavarësisht moshës së avancuar mund t'a konsideroj veten një autor i ri dhe një diplomat i ri.

Por cilido qoftë termi: diplomat-shkrimtar apo shkrimtar-diplomat, përqasja e këtyre dy profesioneve (ose vokacioneve) ka qenë objekt i gjerë debatesh në kancelerit ndërkombëtare. Pavarësisht dallimeve (shkrimtari me të drejtën e emocionit, diplomati i imunizuar nga kjo ndjenjë, apo diplomati me prirjen për moderacion dhe kompromis, ndërsa letërsia si veprimtari e lirë e shpirtit), përvoja botërore ka treguar se diplomati dhe shkrimtari mund të bashkëjetojnë harmonikisht, në një aliazh dy kokësh duke njohur e respektuar funksionet respektive, sepse ata kanë një detyrë të përbashkët: të dëshmojnë. Shkrimtari-diplomat një dëshmitar i angazhuar, ndërsa diplomati i karrierës një dëshmitar i shkëputur.

Pranohet se si term, diplomati-shkrimtar u konsolidua pas vitit 1945, periudhë kjo e pasluftës që koincidoi me konsolidimin e diplomacisë kulturore dhe përfshirjen e personaliteteve të njohura të kulturës. Fillimisht u perceptua *si* një ekspresion kulturor francez, që integron artin e të shkruarit, kultin human me karrierën diplomatike. (*Lionel Chénedé, Olivier Chosalland et Isabelle Nathan: 2011, Diplomates ecrivains, Paris, Ministère des Affaires étrangéres et européennes.)*

Për mbështetësit e kësaj praktike, shkrimtari përfiton nga posti i ambasadorit si "një vend ideal vëzhgimi për të njohur natyrën njerëzore", ndërsa për disa të tjerë "kjo provokon një çarje progresive brenda vetes, nga ku nis një largim gradual nga letërsia" (Iver B.Neumann "To be a Diplomat" International Studies Perspectives", nr.6, 2005, ps. 72-93).

II Mendoni se ekziston një model i krijuesit diplomat?

Agim Nesho

Të flasësh për model të krijuesit diplomat ndoshta është pak e vështirë, për arsye se ata janë produkt i ngjarjeve dhe kohëve të ndryshme. Për t'u dalluar si krijues-diplomat duhet të plotësohen një sërë kushtesh të nevojshme, si epërsia intelektuale, terreni dhe problematika ku angazhohet, fuqia që përfaqëson në arenën botërore dhe rëndësia e çështjes në marrëdhëniet ndërkombëtare. Diplomatë të tillë të talentuar janë p.sh., George Kennan me teorinë e tij të "përmbajtjes" (*Containmen*t) gjatë Luftës së Ftohtë, Henri Kissinger, Hanz Morgenthau, Brzezinsky etj. Ata jo vetëm kanë qenë pjesë e diplomacisë së madhe, por edhe kanë përcaktuar zhvillimet e ardhshme duke krijuar doktrinat dhe teoritë e tyre.

Arben Cici

Përvojat e deritanishme botërore, por edhe ato shqiptare, përjashtojnë modelin e krijuesit-diplomat, po aq sa ofrojnë mjaftueshëm shembuj për t'u admiruar. Ata vijnë me emra të përveçëm duke mishëruar vlerat, cilësitë dhe vetitë më të mira të këtyre dy shpirtrave që përballen, bashkëjetojnë dhe prodhojnë për publikun.

Ata janë ngjizja e përkryer e dy botëve virtuale, imagjinare dhe shpirtërore në një botë reale, në një shpirt dhe në një mendje nga ku burojnë dije, përvojë dhe krijimtari.

Dashuria për dijen, dëshira dhe pasioni për të shkruar, aftësia dhe kurajoja për t'u përballur me publikun, kryeneçësia për ta informuar atë duke depërtuar muret e rënda të ministrive të jashtme, por pa i cënuar ato, kërkesa e pareshtur e tyre për të «njohur vetveten" janë disa nga të përbashkëtat e shembujve të kësaj specie të rrallë.

Ka shumë emra diplomatë-krijues; poetë, shkrimtarë, filozofë, historianë, publicistë etj., të cilët mundën të shkrijnë dy jetë në një të vetme, por shembulli më i mirë është ai i Chateaubriand-it, i cili përsosmërisht arriti të shkrijë karrierën me krijimtarinë ku më së miri duket në veprën e tij *Les Mémoires d'outre-tombe*.

Luan Rama

Modele të përcaktuara mendoj se nuk ka, pasi ashtu si në letërsi dhe në art, këta lloj diplomatësh krijojnë profile tepër individuale. Edhe pse diplomat-shkrimtar, Paul Claudel ndryshonte së tepërmi nga Saint-John Perse dhe që të dy këta ndryshonin, gjithashtu, nga Roman Gary, fitues dy herë i çmimit "Goncourt" në Francë.

Profili i Gary-së më ka joshur pa masë, pasi ai nuk i duronte rregullat strikte e burokratike, por duke qenë se kishte luftuar krah gjeneralit De Gaulle, rebelimi i tij tolerohej deri në një farë mase gjersa më në fund, edhe pse me një karrierë të gjatë diplomatike, mbeti jashtë diplomacisë, por letërsia e shoqëroi gjatë gjithë kohës si diplomat. Pra janë shkrimtarë që nuk e kanë ndarë diplomacinë nga artin.

Të dyja kanë bashkëjetuar brenda një njeriu për një kohë të gjatë, ndryshe nga Paul Morand ku koha e tij diplomatike ishte e shkurtër, ashtu siç ishte dhe e Lamartine, i cili u bë Ministër i Jashtëm i Francës.

Pëllumb Kulla

Të them të drejtën nuk më është dashur thellimi në këtë përgjigje. Më mjafton të përmend Konicën tonë dhe përvojën e Uiliam Sommerset Moem-it në dominionet britanike të Paqësorit.

Piro Milkani

Një nga armët më të forta të diplomatit është komunikimi, veçanërisht fjala. Krijuesi është zot i fjalës. Ka aftësinë të bindë dhe të përcjellë një ide shpesh në fare pak hapësirë. Akoma, të selektojë nga moria e informacionit atë që duhet për të bërë të kuptueshëm një personazh, ose të qartësojë një situatë.

Shaban Murati

Diplomacia është përkufizuar edhe art, edhe shkencë. Kjo do të thotë se nuk mund të ketë një model, sepse një model nuk i ezauron tërë hapësirat e zhvillimit të mëtejshëm të diplomacisë, qoftë si art, qoftë si shkencë. Modelet janë të shumta, si në diplomacinë botërore, ashtu dhe në atë shqiptare, por më shumë se modeli i krijuesit-diplomat duhet marrë në konsideratë gjurma dhe trashëgimia, që krijuesi diplomat lë në diplomaci.

Teodor Laço

Po, në dijeninë time kanë qenë mjaft shkrimtarë që kanë përfaqësuar vendet e tyre në shtete me peshë të madhe politike dhe kulturore. Dukuria ka qenë karakteristike sidomos për vendet e Amerikës latine. Shumë nga ambasadorët e këtyre vendeve të akredituar në Europë, veçanërisht në Francë, vinin nga fusha e krijimit. Do përmendja nobelistët Miguel Anhel Asturias, Octavia Paz etj. Sa i takon modelit shqiptar, mendoj se akoma nuk kemi një fizionomi të plotë dhe do vazhdojmë edhe për disa kohë të veçojmë me respekt të thellë figurën e Faik Konicës.

Kur ushtroja detyrën e Ministrit të Kulturës, në vitin 1995, një nga ngjarjet më mbresëlënëse ka qenë sjellja e eshtrave të Faik Konicës në Shqipëri. Fjalët që kam mbajtur për veprimtarinë e Konicës në New York, në prani të pothuaj të gjithë anëtarëve të Vatrës, si dhe në Katedralen e Shën Gjergjit, në Boston, edhe sot më japin emocione po aq të thella.

Ylljet Aliçka

Personalisht nuk kam ndjekur ndonjë model. Si model unë kam pasur dhe vazhdoj të kem shkrimtarët e mirëfilltë, s'di të jem frymëzuar nga shkrimtarët-diplomatë. Kur shkruaj, nuk mendoj se po krijoj një model. Ai që shkruan, ose krijon, shkruan pasi ka diçka për të thënë. Më tepër se sa modelin e të shkruarit te shkrimtarët-diplomatë, mund të them se më intereson mënyra se si e kanë administruar jetën e dyfishtë, pra si kanë ndërtuar jetën sipas kërkesave të profesionit.

Nga ana tjetër nuk mungojnë dhe sulmet apo "zhgënjimet" e vetë protagonistëve shkrimtarë-diplomatë nga karriera e tyre diplomatike. Romain Gary e përmbledh funksionin e tij diplomatik si "orë të gjata limontie, me shumë detyrime të mërzitshme mondane".

Ambasadori-shkrimtar Paul Morand në kujtimet e tij e portretizon veten në funksionin e ambasadorit si:

> ...një qenie e lehtë, snob bosh, ziliqar, pa shpirt, i dehur nga sukseset mondane, pa kulturë, as inteligjencë, tmerrësisht i modës, antipatik, që nuk mendon veç si të dëfrehet, tri recepsione në ditë, një shtazë e vogël egoiste. Notoj mes shkrimtarëve që më marrin për diplomat dhe diplomatëve që më marrin për shkrimtar, me ndjesinë e një jashtëtokësori...
>
> Nuk kam autoritet me vartësit, jam liberal me ta dhe, papritmas, bëhem nervoz, brutal, pra krejt e kundërta me një diplomat.

III Krijimi përballë motivit, statusit dhe praktikave diplomatike

Agim Nesho

Krijimi lind nga nevoja për të thënë diçka në formën e mendimit ose përgjithësimit të eksperiencës njerëzore. Krijimi kërkon aftësi të përkufizosh e përgjithësosh situata politike diplomatike, si dhe të shtjellosh ide rreth një problematike ose zhvillimeve të caktuara në marrëdhëniet ndërkombëtare. Motivet gjithmonë janë pozitive, duke filluar nga dobia kolektive e duke përfunduar tek ambiciet pozitive personale.

Statusi i diplomatit jo gjithmonë ndihmon në mesazhin dhe qëndrimin si krijues. Statusi është një lidhje e ngushtë me institucionin që përfaqëson, qëndrimin e të cilit je i detyruar ta respektosh dhe ta mbash në aktivitetet publike. Në shumicën e rasteve veprat më të mira kanë dalë pas përfundimit të misioneve diplomatike ose pjesëmarrjes direkte në aktivitete diplomatike.

Arben Cici

Një diplomati i duhet të shkruajë shumë. Shkrimet e tij duhet të jenë jo vetëm cilësore, por edhe të kujdesshme dhe të përgjegjshme, sepse përveç se lexohen nga një elitë profesionistësh e politikanësh, shërbejnë edhe si bazë, ose sistem referimi, për qëndrime diplomatike e shtetërore. Nga ana tjetër, që krijimet e tij të shikojnë dritën e botimit, ai duhet të sfidojë trysninë e mungesës së kohës dhe atë të praktikave shtrënguese diplomatike. Asgjë më shumë se përballja me publikun nuk e afron diplomatin krijues drejt një vlerësimi objektiv, duke e larguar, njëkohësisht, nga praktikat klienteliste, hipokrite e mediokre të vlerësimit që mbysin rëndom administratën, zyrat dhe kabinetet. Konica i madh është shëmbulli i padiskutueshëm i diplomatit përfaqësues dhe krijues, vepra e të cilit çlirohet nga kotësitë burokratike për të hedhur dritë, për të dhuruar qartësi dhe për të afruar me të vërtetën e kohës jo vetëm diplomatët e sotëm, studiuesit e apasionuar, historianët e

përhumbur në kërkimet e tyre, median e etur për pak sensacion, por edhe publikun e gjerë dhe dashamirësit e dijes. Paul Morand pohonte në kohën e vet në Paris: "Quai D'Orsay urren lavdinë që vjen nga jashtë zyrave të saj".

Luan Rama

Jeta e një letrari ose artisti në një përfaqësi diplomatike është e rëndomtë nga ana organizative, gati e mërzitshme, pasi rutina diplomatike bie ndesh me lirinë e artistit dhe vështrimin e tij të botës, madje dhe të shteteve me të cilët vendi yt ka probleme. Pablo Neruda kur ishte ambasador në Paris, i dërguar i presidentit socialist Allende, kaloi ndoshta mërzinë më të madhe të jetës së tij dhe shkroi shumë pak. Madje iku para kohe, edhe pse ishte në mes të veprimtarive të mëdha diplomatike e artistike të kohës në një metropol si Parisi. Megjithatë duhet thënë se për një artist, qenia e tij si diplomat, pikëtakimet e shumta politike e kulturore, qenia në kontakt me manifestimet e ndryshme të kulturës, e pasurojnë bagazhin e tij kulturor.

Unë besoj se nuk do të shkruaja 30 libra të ndryshëm po të mos isha në Paris. Parisi më tërhoqi në mënyrë magjepëse dhe më dha një optikë tjetër për botën dhe fatet njerëzore, si dhe për kërkimin e formave të reja artistike. Por kjo është shumë personale, pasi për një tjetër do të ishte e kundërta. Sidoqoftë, ndryshe nga diplomatë të tjerë unë kam tentuar ta lidh krijimtarinë me diplomacinë. P.sh., kur kam punuar në UNESCO shkrova një libër për UNESCO-n si organizatë, me titull «UNESCO. Shtëpia e shpresës», në të cilin jam përpjekur të përshkruajë historikun e marrëdhënieve Shqipëri-UNESCO, si dhe mbi dialogun e qytetërimeve.

Po kështu, gjatë punës në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë, shkrova disa libra: *Shqipëria Frankofone*; *Pont entre deux rives* mbi marrëdhëniet Francë-Shqipëri; *Nën hijen e eklipsit* mbi ngjarjet e Kosovës në vitin 1999. Të gjithë këta libra janë fryt, besoj, i lidhjes së diplomacisë me letërsinë.

Pëllumb Kulla

Periudha 1993-1997 ka qenë e ngarkuar në shumë dimensione. Nga ana tjetër, detyra e re si Ambasador, mjaft tërheqëse, por me shumë përgjegjësi dhe që erdhi e beftë do thoja, më shtrëngoi të shkëputesha nga praktika krijuese. Me kënaqësi them se dita të gjej një lloj balance, ose një lloj ngushëllimi për kohën që po "i vidhja" krijimit, sepse shihja të përmbusheshin shumë nga pritshmëritë që kishim vendosur këtu, ndoshta edhe përtej ambicies e pritshmërive të mia. Veçoj miratimin në Asamblenë e Përgjithëshme, - e kam përmendur edhe më lart, të Rezolutës së të Drejtave të Njeriut në Kosovë. Ishte një sukses i jashtëzakonshëm për të gjithë ne, shqiptarë e kosovarë. Por patëm shumë shqetësime me problemet e trazirat që sollën firmat piramidale. Në fillimet e '97 na u desh të punonim shumë për sigurimin e ndërhyrjes së forcës ushtarake shumëkombëshe në territorin e Republikës tonë. Me ngarkesa të tilla nuk bëhej fjalë për prodhimtari letrare.

Piro Milkani

Një ditë përpara kthimit tim në Shqipëri, Presidenti i Çekisë, Václav Havel, për shkak të njohjes sonë të hershme më rezervoi një takim jashtë çdo protokolli. Pasi konsumuam bisedat për sëmundjet që na kishin rënë të dyve, si koma dyjavore e tij dhe koma katërmujore e imja, më pyeti:

- Po tani çfarë do të bësh? Do të dalësh në pension?

- Unë nuk kam ndërmend të dalë ndonjëherë në pension. Do të merrem me profesionin tim. Do vazhdoj të bëj filma, – ishte përgjigja ime.

Pas pesë vjetësh u ktheva përsëri në Çeki për të realizuar, së bashku me djalin tim Eno, projektin filmik "Trishtimi i zonjës Shnajder".

Që në zanafillën e saj praktika e përfshirjes së personaliteteve kulturore në diplomaci ka pasur kundërshti, si nga institucionet administrative, ashtu dhe nga vetë lloji i shkrimtarëve.

Një diplomat karriere e di mirë se ku e ka vendin, ndërsa shkrimtari diplomat luhatet mes pavarësisë së mendimit dhe nënshtrimit ndaj hierarkisë që e ka vendosur. Nuk e dimë nëse e kanë ditur mirë vendin e tyre personalitete të tilla si Faik Konica apo Eqerem bej Vlora, ndërkohë që mjaft shkrimtarë të njohur "e kanë pësuar" nga karriera diplomatike, si italiani Malaparte, i cili sapo guxoi t'i bënte karshillëk Musolinit, e hoqi brenda 24 orësh.

Një shembull tjetër është ai i laureatit të çmimit prestigjioz *Goncour,* Jean-Victor Ruffy, ambasador i Francës në Senegal, i cili nuk pranoi të ndiqte linjën zyrtare të vendit të tij dhe, sado i parapëlqyer dhe propozuar nga Presidenti Sarkozy, sistemi i administratës franceze nuk hezitoi për t'a larguar po ashtu nga posti.

Shaban Murati

Krijimi është në themelin e një diplomacie të vërtetë. Sepse, ashtu si procesi krijues, edhe diplomacia kërkon intuitën, imagjinatën, njohjen shumëdimensionale, zhbirimin kulturor e psikologjik, aftësinë e sintetizimit të ngjarjes, të aktorëve shtetërore, të marrëdhënieve dhe të strategjisë së shteteve. Të gjitha këto shkrihen në veprën e krijuesit, që quhet produkt diplomatik.

Teodor Laço

Angazhimi i krijuesve në diplomaci, gjithsesi, paraqet sfida të shumta. Do rendisja si arsye kryesore faktin që nuk është e lehtë gjetja e një raporti të drejtë midis pasionit kryesor që është krijimtaria dhe detyrës shtetërore. Nuk ka dyshim që do të ishte gabim i pafalshëm të neglizhohej, ose akoma më keq, të harrohej e dyta, apo të shfrytëzohej koha dhe situata tinëzisht, duke spekulluar me lirshmërinë e kontaktet që të mundëson detyra e

ambasadorit. Akoma, Shqipëria, duke qenë një vend i vogël, marrëdhëniet diplomatike me shumë vende ndonëse i ka të themeluara, shpesh janë të një natyre relativisht formale, gjë që rrit riskun e "shkarjes" nga përgjegjësitë e angazhimet që kërkon detyra e Ambasadorit.

Ylljet Aliçka

Efektivisht ka një kontradiktë dialektike mes dy prirjeve pasi diplomati përpiqet të jetë impersonal, objektiv, duke fshehur aspektin emocional e shumëfishuar hipotezat, ndërsa krijuesi është pasionant dhe emotiv në atë që quhet formatim të fjalës dhe të raportit. Pa mohuar aspektet e rënduara të administratës apo asaj që quhet burokraci, funksioni diplomatik, ashtu si për këdo, veçanërisht për një krijues ofron një përvojë të pasur jetësore; nuk është një zanat, por një gjendje, një jetë. Vetë shkrimtari, edhe nëse nuk shkruan letërsi për arsye të ndryshme, pa qenë i vetëdijshëm ai mbledh "zahiretë" e dimrit për t'i përdorur në jetën tjetër që e pret.

A ka status shkrimtar-diplomat? Tek ecja një ditë në Paris në rrugën ku ka banuar nobelisti diplomat Romain Gary, Bashkia e Parisit kishte ngjitur në portën e tij një pllakë përkujtimore ku krahas emrit, datës së lindjes dhe asaj të vdekjes shkruhej "Shkrimtar-diplomat".

Por në traktatet diplomatike nuk ekziston ndonjë status zyrtar shkrimtar-diplomat. Pranohet që diplomati i karrierës di të drejtojë një dialog ndërkombëtar duke respektuar procedurat dhe ceremonialin. Ai di të ruajë sekretin shtetëror. Në dallim, shkrimtari përpiqet t'i pëlqejë një publiku të gjerë, sadoqë shpesh e gjen veten duke kontestuar, edhe pse i përmbajtur, rendin e vendosur shoqëror.

Ekzigjencat kontradiktore të dy prirjeve, më shumë konkurrente se sa konvergjente, bëhen të pajtueshme në momentin kur etosi i shkrimtarit përqendrohet mbi origjinalitetin, ndërsa ai i diplomatit mbi profesionalizmin. Përvoja ka dëshmuar se shkrimtari-diplomat e fiton legjitimitetin e diplomatit vetëm kur përvetëson praktikat diplomatike, pra jo nga superpozicionimi i identiteteve, por duke maskuar identitetet e tjera.

Unë e di që diplomacia është një shkencë, ndonëse unë u përpoqa ta pratikoj si një art, - shkruan shkrimtari-diplomat Paul Morand. (*En veillant Philippe Bethelot*, Editions du ond Point des Champs Elysée, p.194).

Sipas një pjese të madhe të opinioneve kundërshtuese, më shumë kemi të bëjmë me "një ngrefosje ose posturë mitike, të një gjasme krijuesi mitologjik jokonformist me sjellje prej shkrimtari, që kërkon të shitet si figurë e veçantë në shoqëritë moderne, por që s'janë gjë tjetër veçse individë me personalitet të dyfishtë që nuk e gjejnë ose përcaktojnë dot rolin e tyre në jetë." (Gisele Sapiro, 2001/1, "De l'usage des categories de droite et de gauche dans le champ litteraire", Societes et representationes, ps.19-53)

Për nobelistin turk Orhan Pamuk: "Shkrimtari duhet të qëndrojë veçan nga jeta

burokratike, t'u shmanget institucioneve, shtetit, çdo lloj jete familjare të zakonshme, t'a shikojë suksesin dhe famën letrare me dyshim. Ja parimet absolute të prirjes së këtij kleriku të ri sekular dhe të çdo lloj morali letrar modern." (*Konferencë në Universitetin e Ruenit,17 MARs 2009*).

IV Antropologji e diplomatit krijues

Agim Nesho

Një diplomat krijues duhet të njohë mirë politikën, gjeografinë, historinë dhe të ketë një formim të përgjithshëm intelektual të dallueshëm. Ai duhet të ketë njohje të thella të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe përvojë të vyer të këto fusha. Ajo që e bën atë krijues është eksperienca parësore në misione diplomatike, në institucione vendimmarrëse ose të planifikimit të politikave dhe strategjive, si dhe në njohjen e thellë të vendit ku kryen aktivitetin. Diplomati-krijues u jep zgjidhje situatave të komplikuara ndërkombëtare, krijon e zhvillon teori në marrëdhëniet ndërkombëtare, si dhe e përgjithëson fenomenin duke krijuar precedentët e nevojshëm ndërkombëtar. Ky është modeli i diplomatit krijues në fushën e diplomacisë.

Nga ana tjetër, çdo diplomat mund të mbetet krijues në fusha të tjera si letërsi, shkencë, politikë dhe t'i zhvillojë këto edhe gjatë shërbimit diplomatik. Ai mund të japë eksperiencat e tij, të shkruajë *memoir,* por në kuptimin e mirëfilltë të fjalës krijimi i tij mbetet tek eksperienca njerëzore individuale.

Arben Cici

Homo diplomaticus vetëm kaq është ende i panjohur ose i keqnjohur nga publiku i gjerë. Për të kapërcyer këtë hendek njohurish dhe perceptimesh, përballja me publikun është një histori suksesi që nuk fillon sot. Marr kurajën ta quaj dyzim antropologjik këtë krijesë, që përfaqëson një pjesë shumë të çmuar të trashëgimisë kulturore, sociale dhe intelektuale të një vendi.

Në botën e sotme shumëpolare, diplomati krijues duhet të mishërojë identitetin e qytetërimit të tij dhe të mund të jetë i aftë, gjithashtu, të hyjë brenda identitetit të një qytetërimi tjetër, sa më thellë, për ta njohur atë. Ai mbetet mbartësi, përçuesi dhe përballësi ideal i ndër-qytetërimeve, ndër-kulturave dhe ndër-traditave. Ku më mirë do të kuptonim, jo vetëm themelet dhe parimet e politikës së jashtme amerikane, por edhe krizat, sfidat dhe përballjet globale se në botimet e Henry Kissingerit apo Richard Holbrukut! Ku më bukur do të shijonim shpirtin latin, se në poemat dhe përshkrimet e jashtëzakonshme të diplomatit-poet Pablo Nerudo!

Luan Rama

Diplomati artist nuk e ndan punën diplomatike nga arti, çka e kemi vënë re në disa ambasadorë shqiptarë të kohës sonë. Misto Treska përkthente autorët francezë, duke filluar me Hugo. Por le të flas për një diplomat të shekullit XIX, August Dozon, i cili ishte konsull në Janinë dhe mblodhi e botoi përralla dhe këngë popullore të shqiptarëve. Edhe ai vinte në diplomaci nga letërsia, poet dhe mik i afërt i Baudelaire njëkohësisht. Meqë shkrova një libër për të, duke vëzhguar korrespondencat e tij nga Janina, vura re se ai vazhdimisht kërkonte të largohej për studime, të udhëtonte e të kërkonte rreth folklorit të shqiptarëve, serbëve, bullgarëve etj.

Mendoj se ekzistenca në radhët e diplomacisë të një grupi që vijnë nga shkrimtarët e artistët, veçanërisht për Shqipërinë, do të kishte interes po të kemi parasysh imazhin skematik të klisheve që ekzistojnë dhe do të ekzistojnë edhe për një kohë rreth shoqërisë shqiptare. Argumenti mendoj se bëhet më bindës po të kemi parasysh se integrimet bëhen normale duke filluar nga kultura, gjë që më sjell në vëmendje frazën e famshme të pionerit të Europës së Bashkuar, Jean Monet. Një ambasador-artist përçon jo vetëm diçka personale, por dhe kolektive, pra imazhin e një populli që përfaqëson. Fakt është që edhe në rang botëror, diplomatët vijnë nga shkollat diplomatike, ndërsa ambasadorët nga të besuarit e liderëve politikë të vendit. Presidentët dërgojnë njerëzit e afërt, ata që kanë kontribuar në programet dhe fitoret politike të tyre.

Përgjithësisht vendet e mëdha, sot nuk kanë nevojën e diplomatëve-shkrimtarë e artistë, por të njerëzve të fuqishëm politikisht. Pra krijuesi-diplomat është një specie në zhdukje dhe kjo ndihet më lehtë në Francë, në një vend me tradita të forta të diplomatëve-shkrimtarë që nga koha e monarkisë dhe më shumë në atë të Republikës Franceze, meqë Franca iluministe donte të përçonte idetë republikane e demokratike të saj. Një nga ambasadorët më të fundit francezë, Jacques Ruffin, shkrimtar i njohur, pas një mandati dha dorëheqjen, pasi shpesh, artisti, i cili në thelb është një njeri humanist e universalist dhe që si ideal ka të drejtat njerëzore, bie ndesh me politika që mbështeten në interesa më globale.

Pëllumb Kulla

U bënë shtatëmbëdhjetë vjet që jam larguar nga fusha e diplomacisë dhe, natyrisht, nuk priten shërbime diplomatike nga unë. Por sa isha në shërbimin diplomatik nuk pushova kurrë së qeni shkrimtar. Jo aq në botime, se sa në hartimet e atyre që do të shkruaja kur të mos isha aq i zënë me punë. Studioja karakteret që më rrethonin, vëreja e merrja shënim mënçurinë e kolegëve të huaj dhe pse jo, hera-herës edhe situatat komike, ose deri karakteret ekscentrikë që ata shfaqnin. Pas disa vitesh munda të realizoja një komedi me motive nga jeta në ambasadat tona, vepër që u vu në skenë me sukses nga Teatri "Bylis" i Fierit. Veç kësaj, blloqet e shënimeve të mia janë plot.

Piro Milkani

Më tepër se sa një çështje konjukturash, nevojash politike, ose emërimi politik, antropologjia e shkrimtarit-diplomat ka evoluar ose është konsoliduar si një lloj rigjenerimi i trupit diplomatik, pra si çështje strukturore e diplomacisë ose, e thënë thjesht, si një praktikë e politikës kulturore. Thënë ndryshe, më tepër si rregull, se sa si përjashtim.

Mund të thuhet se përfshirja e krijuesve në diplomacinë shqiptare nuk ka synuar të kompensojë ndonjë mungesë kompetencash, apo se ka kontribuar në transformimin e trupit diplomatik. Ndofta e kundërta është e vërtetë: dimensioni kulturor ka përforcuar egon e trupit diplomatik, si dhe ka ilustruar dimensionin simbolik të aksionit politik.

Shaban Murati

Antropologjia e diplomatit krijues përmban, në thelbin e vet, gjenezën e personalitetit dhe të laboratorit të krijimtarisë të diplomatit krijues. Duhen disa etapa për të arritur në pikën ku dy laboratorët shkrihen në personalitetin dhe kontributin e diplomatit-krijues. Krijuesi lartëson diplomatin dhe diplomati lartëson krijuesin. Në sistemin tonë diplomatik gjatë jetës mbi 100 vjeçare të shtetit kjo nuk është konsideruar në masën e duhur. Do thoja se ka ndodhur procesi i ruralizimit të diplomacisë dhe i efekteve jo pozitive të saj në veprimtarinë, strukturat diplomatike dhe pozitën rajonale e ndërkombëtare të shtetit. Konstatimi i hidhur është se ruralizimi i diplomacisë mori përmasa shqetësuese në periudhën e demokracisë.

Diplomacia është proces dhe fazë zhvillimore qytetare, civilizuese, elitare. Kjo kërkon dinamikën e evoluimit të diplomatit krijues dhe të ndarjes së tij nga kushtrimi i të parëve fizikë, biologjikë, krahinorë, fetarë etj. Krijuesit-diplomatë kanë aftësinë dhe avantazhin të ndahen të parët nga lidhjet me trashëgimitë negative dhe të kërkojnë progresin. Faktorë fizikë, natyrorë, sociologjikë, kulturorë, mjedisi fizik, gjeografik, shpirtëror dhe psikomental, ku është formuar diplomati, janë fusha për të hulumtuar progresin e qenies diplomatike. Vazhdimësia e dinamikës së progresit apo regresit të sistemeve shoqërore në jetën shqiptare dhe e homus albaniensis, përplasja mes tyre dhe idealeve të ngushtuara apo të zgjeruara të shtresëzimeve të kohës dhe ndikimeve të dhënie-marrjeve rajonale, ndihmojnë t'i japin diplomacisë krijuese ambicien e një shkalle gjithnjë e më të lartë të ekzistencës shtetërore dhe të performancës kombëtare. Në këtë proces evolucioni diplomacia krijuese të mund të arrijë të plasmojë jo vetëm vetveten, por edhe vetë shtetin në parametrat dhe standardet që i takojnë së ardhmes.

Teodor Laço

Kjo është një pyetje që kërkon një shtjellim me përmasat e një esseje. Mund të përmend nga përvoja ime ndonjë rast kur më është dashur gjithë gjakftohtësia dhe vendosmëria ime për ta kaluar. Kjo ndodhi në kohën që u shpall Pavarësia e Kosovës. Në selinë e ambasadës

na erdhi një kërcënim për vendosje bombe, i cili i shoqërua me protesta pas bllokut të ambasadës. Ngjarja u mbyll me njoftimin e policisë. Pra, nëse do bëja një antropologji të diplomatit krijues do filloja me gjakftohtësinë. Por na duhet të bëjmë kompromise, në varësi të përparësive që vendosim: kur kërkojmë diplomaci kulturore do zgjedhim edhe njerëzit e duhur. Sidoqoftë duhet thënë se në më të shumtën e herëve emërimi është bërë mbi bazën e individit dhe jo të një projekti dhe se kriteri i konjukturës mbizotëron ndaj praktikës klasike të strukturës administrative, gjë që e vështirëson edhe përcaktimin e një antropologjie për rastin në fjalë. Realiteti i ri kërkon praktika të reja.

Ylljet Aliçka

Strategjitë diplomatike të vendeve të njohura gjithmonë e më shumë po i modelojnë konturet e diplomacisë mbi baza antroplogjike, si dhe duke angazhuar refleksione mbi identitetet. Në kohën e sotme të diplomacisë publike kur një ambasador nuk është më një aktor i recepsioneve mondane apo i informacionit politik, por një mbështetës i ndërmarrjeve ekonomike dhe faktor i zhvillimit të pranisë kulturore lind pyetja: A do të vazhdojë personazhi i shkrimtarit diplomat të mbijetojë në erën numerike?

Sipas Stanisslas Jeanesson, "Revolucionet teknologjike mund të shërbejnë si trampolina të reja të fjalës diplomatike, e cila duhet të sipërmarrë funksionin e parë, atë të komunikimit". Nga ana tjetër "Wikileaks ose Valixhja e Ambasadorit Spanjoll" na tregojnë që disa anë letrare po gjejnë strehë në korrespondencën diplomatike, duke siguruar rekorde shitjesh. Përhapja në masë e sekreteve, manipulimeve të thashethemeve dhe konfidencave false po rezultojnë sot në botë si burim frymëzimi për letërsinë e bazuar te realiteti, autenticiteti. Diplomacia është e lidhur me zhvillime, mashtrime, drama dhe shpresa, që do të vazhdojnë të furnizojnë edhe për shumë kohë me material një kontingjent pafund të njerëzve të letrave. Po vihet në dyshim vetë epoka e dyshimit." (Stanisslas Jeanesson, 2009, *Diplomaties en renouvellement*. Cahiers de l'IRICE, nr 3, p. 129).

DY PËRRALLA: GAMILE, NUMRA DHE GJËRA TË TJERA

Sipas Johan Galtung

1.

Na ishte një herë e një kohë një mulla që ishte nisur për në Mekë mbi një gamile. Rrugës, pranë një oazi, sheh tre burra ulur që qanin. Ndalon gamilen dhe i pyet: - Bijtë e mi, çfarë keni? Ata i përgjigjen: - Babai ynë ndërroi jetë. Ne e donim shumë! Oh, - përgjigjet mullai, - besoj edhe ai ju donte shumë dhe, sigurisht, do ketë lënë diçka për ju.

Të tre burrat, ndalojnë vajtimin, e i thonë: Po, na ka lënë! Na la disa gamile. Dëshira e tij ishte që t'i ndanim ndërmjet nesh në këtë formë: djali i parë të marrë 1/2 e tyre, i dyti 1/3 dhe i treti, më i vogli, 1/9. Sigurisht që ne do zbatojmë vullnetin e tij, por ka një problem. Babai na ka lënë 17 gamile dhe, duke qenë se 17 është numër tek, na vjen keq t'i ndajmë gamilet në këtë formë. Ne i duam shumë gamilet, prandaj jemi të mërzitur.

Mullai mendohet pak e u thotë: Unë po ju fal gamilen time. Në këtë mënyrë, ju bëhen 18 dhe 18, duke qenë numër çift, plotpjestohet edhe me 2, edhe me 3 dhe, edhe me 9. Kështu mos u mërzisni.

Burrat u dukën të hutuar fillimisht, por pas insistimit të mullait, e pranuan dhuratën. Të 18 gamilet i ndanë sipas testamentit: 9 gamile mori djali i parë, 6 gamile i dyti dhe 2 gamile i vogli. Në total: 9+6+2=17. Mënjanë, "gjallë e shëndoshë" sikundër të gjitha gamilet e tjera, ishte edhe gamilja e mullait.

-Mbaruat? – I pyet mullai. - Jeni të kënaqur tani? A mund ta marr përsëri gamilen time?

Të tre burrat, ndonëse nuk e kuptuan shumë mirë se çfarë ndodhi, i shprehën mirënjohen. Mullai mori gamilen e tij përsëri, i hipi dhe, gjëja e fundit që panë nga ai ishte një re rëre që ngrihej nga pas, ndërkohë që rrezet e fundit të një dielli mbrëmjeje përqafonin tokën.

2.

Na ishte një herë e një kohë një avokat që ishte nisur për pushime në shkretërirë në një makinë të shtrenjtë. Rrugës, pranë një oazi, sheh tre burra të ulur që qanin. Ndalon makinën dhe i pyet: Çfarë ka ndodhur, pse qani. Ata i përgjigjen: - Babai ynë ndërroi jetë. Ne e donim shumë! Oh, - përgjigjet avokati, - besoj edhe ai ju donte shumë dhe, sigurisht, do ketë lënë diçka për ju. Unë mund t'u ndihmoj të zbatoni vullnetin e tij, kundrejt një pagese, sigurisht.

Të tre burrat, ndalojnë vajtimin, e i thonë: Po, na ka lënë! Na la disa gamile. Dëshira e tij ishte që t'i ndanim ndërmjet nesh në këtë formë: djali i parë të marrë 1/2 e tyre, i dyti 1/3 dhe i treti, më i vogli, 1/6. Sigurisht që ne do zbatojmë vullnetin e tij, por ka një problem. Babai na ka lënë 17 gamile dhe, duke qenë se 17 është numër tek, na vjen keq t'i ndajmë gamilet në këtë formë. Ne i duam shumë gamilet, prandaj jemi të mërzitur.

Avokati mendohet pak e u thotë: Shumë e thjeshtë. Pagesa ime është 5 gamile. Kështu ju mbeten 12. Numri 12, duke qenë numër çift, plotpjestohet edhe me 2, edhe me 3 dhe, edhe me 6. Llogaritë janë: 6 gamile për djalin e parë, 4 gamile për të dytin dhe 2 gamile për të voglin. Në total: 6+4+2=12 dhe pesë gamile për avokatin.

Dhe kështu bënë. Avokati i lidhi gamilet pas makinës, u nis dhe, gjëja e fundit që panë nga ai ishte një re rëre që ngrihej nga pas, ndërkohë që rrezet e fundit të një dielli mbrëmjeje përqafonin tokën.

TREGUESI ALFABETIK I EMRAVE

A

Agolli, Dritëro 26
Aliçka, Ylljet iii, vii, 2, 4, 11, 55, 109 - 112, 132, 135, 139, 143
Apollinaire, Guillaume 21, 24

B

Baholli, Sami 59
Bashkimi Sovjetik 76
Baze, Mero 26
Berisha, Sali 29, 38
Bidault, Georges 55
Bush, Xhorxh W. 124

C

Çakuli, Filip 26
Çeki vii, 2, 113, 118, 119, 120, 138
Cere, Naum 24
Chikozi, Llambi 24
Cici, Arben vii, 2, 3, 4, 5, 11, 40, 113, 121 - 124, 130, 134, 136, 140
Corion, Ann 24

D

Dishnica, Llambi 55
Djerdj, Josip 39
Dozon, August 141
Duka, Valentina 123

F

Floqi, Kristo 24
Franca vii, 45, 55, 56, 61, 62, 63, 74, 80, 81, 82, 87, 141

G

Gary, Romain 7, 135, 139
Georges-Picot, Guillaume 55
Grant, Hugh G. 17
Grant-Smith, Ulysses 17

H

Havel, Václav 49, 115, 116, 117, 120, 138
Hoxha, Enver 24, 39, 42, 46, 47, 55, 58, 67, 77, 81

I

Ikonomi, Ilir 5

K

Kadare, Ismail 30, 31, 78, 87, 104, 106, 108, 119
Kapo, Hysni 39, 58
Klosi, Sherif 45
Konica, Faik vii, 2, 5, 7, 11, 15, 17, 19 - 24, 138
Kosova 35, 118, 119, 126, 128
Kotta, Kosta 24
Kulla, Pëllumb vii, 2, 4, 5, 11, 17, 25 - 32, 131, 134, 137, 141

L

Laço, Teodor vii, 2, 4, 7, 11, 26, 27, 39, 49 - 53, 132, 135, 138, 142
Lang, Jacques 105
Lleshi, Haxhi 58, 59, 67, 81

M

Maggi, Ottavio 13
Malile, Reis 43, 48, 60
Malo, Javer vii, 2, 7, 11, 55, 57 - 63, 67, 74, 77, 79
Menant, Guy 55
Mesić, Stjepan 123
Meta, Ilir 38, 103, 104, 116, 127
Mezini, Adem 123
Milkani, Piro vii, 2, 4, 11, 49, 113, 115 - 120, 131, 135, 138, 142
Millot, Andre 60, 61
Milo, Paskal 29, 38, 103, 104, 116
Minxhozi, Skënder 35
Moisiu, Alfred 34, 38, 121, 123
Monet, Jean 141
Morand, Paul 7, 134, 136, 137, 139
Muçi, Virgjil 34, 124
Murati, Shaban vii, 2, 3, 4, 11, 32, 113, 125 - 128, 132, 135, 138, 142
Myrtaj, Faruk 26, 27

N

Nano Fatos 29, 34, 38, 104
Nase, Nesti 42, 43, 67, 81
Nathanaili, Petrit 41, 42, 45, 48
Nathanaili, Vasil vii, 2, 5, 11, 39, 41 - 48
Nesho, Agim vii, 2, 4, 5, 11, 17, 33 - 38, 130, 133, 136, 140
Ngjela, Spartak 106
Nishani, Omer 39, 59
Noli, Fan 22
Nushi, Ksenofon 43, 80, 87

O

OKB 17, 25, 29, 30, 32, 35, 37, 62, 103

P

Pamuk, Orhan 139
Papavrami, Tedi 107
Pipa, Arshi 21

R

Rajerson, Uilliam Eduin 17
Rama, Luan vii, 2, 4, 7, 11, 55, 99 - 104, 105, 131, 134, 137, 141
Redzepin, René 124
Rouil, Jacques 102
Rubens, Peter Paulus 131
Rusia 39

S

Sen, Amartya 4
Serreqi, Alfred 29
ShBA 2, 3, 14, 15, 17, 18, 19, 20, 21, 25, 27, 30, 31, 33, 34, 35, 38, 56, 75, 79, 121, 127
Shehu, Mehmet 67, 81
Shtylla, Behar 43, 45, 60, 131
Sternberg, Zdeněk 118
Stojnič, Velimir 39
Sula, Arion 6, 30

T

Treska, Misto vii, 2, 7, 11, 15, 55, 75 - 82, 141
Treska, Zana 75, 77, 78
Tromara, Elia 24

U

Urban, Marks 81

V

Vidal, Luc 101
Vinŝi, Prémysl 117
Vrioni, Jusuf vii, 2, 7, 11, 55, 105 - 108

X

Xhufi, Pëllumb 122

Y

Ylli, Kahreman 55

Z

Zyma , Margarita (Malo) 6, 57, 63

BIBLIOGRAFI

Aldrige, J. *Diplomati*. 1966, Tiranë: Naim Frashëri.

Cici, A. *Marrëdhëniet Marrëdhëniet italo-shqiptare në vitet 1920-1934*. 2013, Tiranë: UET Press.

Ikonomi, I. *Faik Konica. Jeta në Washington*. 2011, Tiranë: Onufri.

Kulla, P. *Luftë pa fund*. 2013, Tiranë: UET Press.

Moran R., T. et al. *Managing cultural differences*. 2007, London: Elsevier

Murati, Sh. *Diplomacia shqiptare në kërkim të identitetit*. 2013, Tiranë: ENEAS.

Nesho A. *Boshtet e mbivendosura të politikës së jashtme*. 2013, Tiranë: UET Press.

Ngjela, S. *Përkulja dhe rënia e tiranisë shqiptare*. 2013, Tiranë: UET Press

Papavrami, T. *Fugë për violinë*. 2014, Tiranë: UET Press.

Sen, A. *The idea of justice*. 2009: Harvard University Press.

Shaw J., *The Ambassador: Inside the life of a working diplomat*. 2006 Virginia: Capital Books, Inc.

Vrioni, J. *Kujtimet e një europiani*. 2008, Tiranë: Albimazh.

Burime *on line*

Katalogimi *on-line* i librave nga Biblioteka Kombëtare

Google Book

Tirana Book Review

Gazeta Mapo, suplementi për librin

Arkiva

Arkiva e gazetës Mapo

Arkiva e Ministrisë së Punëve të Jashtme

Arkiva personale Margarita Zyma (Malo)

Arkiva personale Petrit Nathanaili

Arkiva personale Zana Treska

AMBASADORËT TANË

Pikëtakime të diplomacisë me krijimtarinë

Vëllimi I

Valbona NATHANAILI

Ambasadorët tanë. Pikëtakime të diplomacisë me krijimtarinë është një udhërrëfyes në jetën dhe veprimtarinë e disa prej ish-ambasadorëve më të spikatur të Shqipërisë të rekrutuar nga fusha e krijimtarisë. Synimi është të tregojmë llojin e komunikimit që kanë arritur të ndërtojnë e vendosin krijuesit-ambasadorët, sa kanë qenë të aftë të promovojnë Shqipërinë, vlerat e kulturën tonë.

Në pjesën e parë paraqiten veprimtaria krijuese dhe diplomatike e disa prej emrave më të spikatur në këtë fushë: Faik Konica, Pëllumb Kulla, Agim Nesho, Vasil Nathanaili, Teodor Laço, Javer Malo, Misto Treska, Luan Rama, Jusuf Vrioni, Ylljet Aliçka, Piro Milkani, Arben Cici dhe Shaban Murati.

Në pjesën e dytë, në formën e një forumi, përmblidhen sugjerime, vërejtje, ide dhe perceptime që kanë për këtë lloj diplomacie A. Nesho, A. Cici, L. Rama, P. Kulla, P. Milkani, Sh. Murati, T. Laço dhe Y. Aliçka. Secili prej tyre përpiqet të na shpjegojë si ka arritur të gërshetojë "diplomacinë" me "kulturën", "detyrën" me "pasionin krijues", "përgjegjësinë si përfaqësuesi më i lartë politik i vendit tonë në vendin e atashuar" me "përkushtimin ndaj fjalës së shkruar", në katër rubrikat e këtij forumi: 1. Krijues diplomat, apo diplomat krijues? 2. Mendoni se ekziston një model i krijuesit diplomat? 3. Krijimi përballë motivit, statusit dhe praktikave diplomatike. 4. Antropologji e diplomatit krijues.

Libri shërben si një referencë shumë e mirë për të njohur kontekstin politik e social në periudha të rëndësishme të rritjes e konsolidimit të shtetit shqiptar, pasi trajton kontributet më të shqura në këtë fushë. Paraqitja korrekte dhe me elegancë e fakteve dhe ngjarjeve, shoqëruar me dokumente autentikë dhe foto të shumta ilustruese, një pjesë e mirë e të cilave publikohen për herë të parë, jo vetëm pasurojnë ndjeshëm përmbajtjen, por janë edhe një shtysë shumë e mirë për të gjithë dashamirësit e historisë, letërsisë, politikës, shkencave sociale e komunikimit për të hulumtuar në faqet e tij.

Sot mund të thuhet se perspektiva e diplomacisë dhe risitë e diplomacisë shqiptare për zgjerimin e fushës së saj në diplomaci kulturore, ekonomike, multilaterale, publike, po diktojnë dhe nevojën që letërsia dhe diplomacia të konsolidojnë termat e marrëdhënies së re që do u lejojë të vazhdojnë pjesëmarrjen aktive në një botë në rikompozim.

Ylljet Aliçka

UETPRESS
info@uet.edu.al www.uet.edu.al

Çmimi 2000 L
15 EURO

ISBN 978-9928-190-06-2
9 789928 190062